



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 187

Tiranë – E Enjte, 11 Dhjetor 2014

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 805, datë 26.11.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, të ndryshuar.....
	10171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 806, datë 26.11.2014	Për miratimin e Raportit të Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”
	10171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 807, datë 26.11.2014	Për disa shtesa në vendimin nr. 747, datë 5.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së grantit me shkëmbim letrash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së shtetit të Kuvajtit”.....
	10205
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 808, datë 26.11.2014	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2014, miratuar për Presidencën.....
	10206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 809, datë 26.11.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e numrit të punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2014 në njësitë e qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.....
	10206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 811, datë 26.11.2014	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 1148, datë 25.11.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Ruga hyrëse Fier””.....
	10206
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 812, datë 26.11.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Vorë (seksioni II, krahu i majtë).....
	10208

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 813, datë 26.11.2014	Për një shtesë në vendimin nr. 140, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar "Expo Milano 2015".....	10212
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 814, datë 26.11.2014	Për një shtesë në vendimin nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale të luftës kundër krimit të organizuar, trafikëve të paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020, dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016"	10212
	Anekset, pjesë e udhëzimit nr. 23, datë 9.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 186, datë 10.12.2014.....	10285

**VENDIM****Nr. 805, datë 26.11.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË
NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE
CIVILË/NËPUNËSVE,
ZËVENDËSMINISTRIT DHE
NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË
KRYEMINISTRIT, APARATET E
MINISTRIVE TË LINJËS,
ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT,
KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR
TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E
PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE
TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË
VARËSI TË KRYEMINISTRIT,
INSTITUCIONET NË VARËSI TË
MINISTRAVE TË LINJËS DHE
ADMINISTRATËN E PREFEKTIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, “Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Në pikën 1/1, emërtesat “Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe “Komisioni i Shërbimit Civil” zëvendësohen, përkatësisht, me “Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale” dhe “Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil”.

b) Në fund të pikës 1/2 shtohet emërtesa “Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)”.

c) Në fund të lidhjes nr. 3, që përmendet në pikën 3, shtohen dy ndarje, me këtë përmbajtje:

– Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, – inspektorë të ankesave dhe hetimit administrativ, kategoria III-a;

– Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil – inspektorë, kategoria III-b.”.

c) Në lidhjen nr. 9, që përmendet në pikën 13, emërtesat “Kryeinspektor në inspektoratet e mbrojtjes së tokës në qarqe” dhe “Inspektor në inspektoratet e mbrojtjes së tokës në qarqe” shfuqizohen.

d) Në lidhjen nr. 9/4, që përmendet në pikën 13/4, në ndarjen me kategorinë e pagës III-a/1, pas fjalëve “...Tiranë 3...” shtohen “...Tiranë 4 (zona turistike)...”.

2. Efektet financiare të këtij vendimi për:

– Qendrën e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Drejtorinë e ALUIZNI-t, Tiranë 4 (zona turistike), të fillojnë nga momenti i emërimit në detyrë të nëpunësve të kësaj qendre.

– Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të fillojnë nga momenti i miratimit nga Kuvendi i strukturës dhe organikës së secilit institucion.

– Parashikimet e tjera të fillojnë nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Efektet financiare të këtij vendimi, për vitin 2014, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRIT
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 806, datë 26.11.2014**

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT TË
KATËRT PERIODIK KOMBËTAR MBI
ZBATIMIN E KONVENTËS “PËR
ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE
TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE”**

Në mbështetje të neneve 100 e 122, të Kushtetutës dhe të nenit 1, të ligjit nr. 7767, datë 9.11.1993, “Për aderimin në konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave””, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Miratimin e Raportit të Katërt Periodik Kombëtar mbi zbatimin e konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Komiteti për Eliminimin
e Diskriminimit
ndaj Grave (CEDAW)

SHQYRTIMI I RAPORTEVE
DËRGUAR NGA SHTETET PALË NË
MBËSHTETJE TË NENIT 18
TË KONVENTËS MBI ELIMINIMIN E TË
GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT
NDAJ GRAVE
SHQIPËRIA
RAPORTI I IV-t PERIODIK KOMBËTAR

LISTA E SHKURTIMEVE

BE Bashkimi Europian
BGJ Barazia gjinore
CEDAË Konventa për Eliminimin e të Gjitha
Formave të Diskriminimit kundër Grave
DHBGJ Dhuna me bazë gjinore
DHF Dhuna në familje
DHkG Dhuna kundër grave
KB Kombet e Bashkuara
KiE Këshilli i Europës
LBGJ Ligji për barazinë gjinore
LDHF Ligji për dhunën në familje
OJF Organizata jofitimprurëse
OSHC Organizatat e shoqërisë civile
PAK Persona me aftësi të kufizuara
PuPa Punëkërkuar të papunë
RSH Republika e Shqipërisë

I. HYRJE

Raporti IV-rt periodik kombëtar, paraqitur në zbatim të nenit 18 të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), u hartua në përputhje me udhëzimet mbi formën dhe përmbajtjen e raporteve që duhen paraqitur nga shtetet palë¹, për periudhën kohore

2010 – 2014. Raporti përmban informacion mbi zbatimin e dispozitave të Konventës dhe rekomandimeve të Komitetit mbi Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave², bazuar dhe në Vërejtjet Përmbyllëse (shtator 2010)³. Vend të rëndësishëm zënë progresi i arritur në aspektin ligjor dhe institucional, politikat e hartuara dhe vështirësitë/sfidat për garantimin e të drejtave të grave pa asnjë diskriminim.

Pas dhënies së rekomandimeve nga Komiteti, Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta⁴ ndërmori një sërë hapash mbështetur edhe nga agjencitë e KB⁵. Rekomandimet e përkthyer dhe botuara në gjuhën zyrtare iu përcollën institucioneve kryesore si Presidentit të Republikës, Kryeministrit, Kryetares së Kuvendit, ministrive të linjës, gjyqësorit, institucioneve të tjera publike dhe OSHC-ve, gjatë seminareve/aktiviteteve ndërgjegjëse.

Gjatë periudhës raportuese, Shqipëria kaloi dy procese zgjedhore të rëndësishme: në nivel vendor (2011) dhe zgjedhjet parlamentare (2013), që sollën në qeverisje koalicionin e majtë. Qeveria e re riorganizoi institucionet kryesore qendrore, si dhe një pjesë të atyre që kanë përgjegjësi specifike për zbatimin e kësaj Konvente⁶.

Raporti u hartua si rezultat i koordinimit të punës dhe përfshirjes së institucioneve shtetërore, sipas fushave të kompetencës mbi çështjet që trajton Konventa. Grupi Ndërmintor i Punës (GNP) ngritur për këtë qëllim (urdhri i Kryeministrit nr. 112/2014)⁷ përbëhej nga institucione shtetërore dhe të pavarura, si: Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Policia e Shtetit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, Kuvendi, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokati i Popullit, etj. Ngritja e GNP u pasua nga një proces konsultimesh për përmirësimin e draftraportit, me përfaqësues të

² Këtej e tutje “Komiteti”.

³ (CEDAW/C/ALB/CO/3).

⁴ Aktualisht Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

⁵ Programi “Një OKB - për BGJ në Shqipëri”.

⁶ Në raport citohen emërtimet e institucioneve sipas periudhave përkatëse.

⁷ “Për ngritjen e GNP mbi hartimin dhe pjesëmarrjen në shqyrtimin e raporteve në kuadër të konventave ndërkombëtare për të drejtat e njeriut”



institucioneve shtetërore, vendore, shoqërisë civile (organizatave të të drejtave të njeriut, grave, minoriteteve), Kryeministrisë, Kuvendit, organizatave ndërkombëtare, etj. Rol të rëndësishëm luajti mbështetja e agjencive të KB⁸, përmes vënies në dispozicion të burimeve financiare e njerëzore⁹.

Shqipëria e zgjedhur si anëtare e Këshillit për të Drejtat e Njeriut për periudhën 2015-2017, do të vazhdojë të përmbushë detyrimet në fushën e të drejtave të njeriut, duke pasur si prioritet edhe promovimin, mbrojtjen e të drejtave të grave.

Raporti u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave nr..., datë 2014.

II. MASAT E NDËRMARRA PËR ZBATIMIN E 16 NENEVE KRYESORE TË KONVENTËS, REKOMANDIMEVE TË KOMITETIT, SI DHE VËREJTJEVE PËRMBYLLËSE

Neni 1

1. Në legjislacionin shqiptar përkufizimi i diskriminimit ndaj grave është tërësisht në përputhje me nenin 1 të Konventës CEDAW, siç shprehet në nenin 4/3 të ligjit nr. 9970/24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

Neni 2

2. Parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të gjinisë parashikohet nga Kushtetuta dhe legjislacioni, që përmirësohet vazhdimisht.

Masat ligjore

Ligji nr. 10 221/4.2.2010 “Për mbrojtjen nga Diskriminimi”¹⁰ rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë edhe në lidhje me gjininë. Ai garanton të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë, barazi të shanseve/mundësive për të ushtruar të drejtat, gëzuar liritë dhe marrë pjesë në jetën publike, si dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit atë. Bazuar në këtë ligj është ngritur edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.¹¹

Ligji nr. 10 329/30.9.2010 për ndryshimin e ligjit nr. 9669/18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, të ndryshuar, parashikon masa për krijimin e rrjetit të koordinuar të institucioneve përgjegjëse për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave.

Ligji nr. 10 399/17.3.2011 për ndryshimet në ligjin “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, parashikon të drejtën për tërheqjen e ndihmës ekonomike edhe nga gratë e dhunuara, kur pajisen me urdhra mbrojtjeje, masën e kësaj ndihme dhe dokumentacionin që duhet paraqitur.

Ligji nr. 143/2013 për ndryshimin e ligjit nr. 10039/22.12.2008 “Për ndihmën juridike” parashikon ndër të tjera kushtet, llojin, mënyrën, kriteret dhe procedurat për dhënien e ndihmës juridike nga shteti për individët, parimet për ushtrimin efektiv të së drejtës për t’iu drejtuar organeve të administratës publike të sistemit të drejtësisë, si dhe ngritjen/funksionimin e klinikave ligjore vendore, për dhënien e informacionit dhe ndihmës ligjore të nevojshme.

Ligji nr. 54/2012 për ndryshimet në ligjin “Për programet sociale të strehimit të banorëve të zonave urbane” trajton me përparësi përfitimin e strehimit edhe për: gratë e shkurorëzuara që kanë në ngarkim fëmijë, gratë me aftësi të kufizuar, vajzat, gratë jetime (nga dalja nga qendrat e përkujdesjes shoqërore deri në moshën 30 vjeç), gratë emigrante të rikthyera.

Ligji nr. 10 295/1.7.2010 “Për faljen”, përjashton nga ky përfitim personat e dënuar për vepra penale ndaj grave shtatzëna, “shfrytëzimi i prostitucionit në rrethana rënduese”, “trafikimi i femrave”, veprat penale ndaj të miturve.

Ndryshimet në Kodin Penal (ligjet nr. 23/2012 dhe nr. 144/2013) parashikojnë DHF si vepër penale, kriminalizojnë sjelljet shqetësuese në raport me gratë, ashpërsojnë dënimet për veprat penale në familje dhe ndaj grave. Parashikohen si vepra penale edhe: “shtrëngimi apo pengimi për të bashkëjetuar, për të lidhur/zgjidhur martesë”; “plagosja e rëndë me dashje”; “shkaktimi i vetëvrasjes”¹², “dhuna seksuale”, “kryerja e marrëdhënieve seksuale me dhunë dhe midis bashkëshortëve/bashkëjetuesve”, “ngacmimi seksual”, “shfrytëzimi i prostitucionit”, “trafikimi i

⁸ UN Women dhe UNFPA.

⁹ Dy konsulentë, që punuan në vazhdimësi me grupin e punës.

¹⁰ Përafruar me katër direktiva të BE për antidiskriminimin.

¹¹ Detajet tek “mekanizmat kundër diskriminimit”.

¹² Shtohet rrethi i familjarëve si subjekte aktive/pasive të veprave penale dhe ashpërsohen dënimet përkatëse.



personave të rritur¹³”, “përfitimi, përdorimi i shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar”, “veprimet që lehtësojnë trafikimin”, bashkë me ashpërsimin e dënimeve përkatëse, etj. Parashikohen si rrethana rënduese për kryerjen e veprave penale identiteti gjinor, orientimi seksual. Në veprat penale “nxitja e urrejtjes, grindjeve”, parashikohen edhe rastet për shkak të orientimit seksual, “shkelja e barazisë së shtetasve” për shkak të identitetit gjinor, orientimit seksual. Për veprën penale të gjakmarrjes parashikohet ashpërsimi i masës së dënimit. Parashikohet si vepër penale “zhdukja me forcë”, që përfshin edhe kryerjen e saj ndaj grave shtatzëna, fëmijëve, personave të pambrojtur.

Ndryshimet në Kodin Zgjedhor (ligji nr. 74/2012) parashikojnë se për çdo zonë zgjedhore, të paktën 30% e listës shumemërore dhe 1/3 emrat e parë të listës duhet t'i përkasë secilës gjini¹⁴.

Ligji nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar” garanton të drejtën e arsimimit, pa diskriminim gjinor.

Ligji nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, garanton të drejtën e pronësisë së gruas, duke parashikuar dispozita mbi regjistrimin e pasurive të paluajtshme në bashkëpronësi, domosdoshmërinë e pëlqimit të bashkëshortes së paregjistruar në kryerjen e procedurave të shitjes pranë noterëve.

Ndryshimet në Kodin e Procedurës Civile (ligji nr. 122/2013) parashikojnë eliminimin e zvarritjeve në procedurat gjyqësore civile, garantimin e procesit të rregullt, të drejtë gjyqësor, përmirësimin e pozitës procedurale të mbrojtësit, cilësisë së shërbimit, rastet për mbrojtje të detyrueshme.

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” ka qëllim krijimin e një shërbimi civil të qëndrueshëm, profesional të bazuar në meritë, integritet moral dhe paanësi politike, si dhe përcakton të drejtat që i garantohen nëpunësit të shërbimit civil. Administrimi i shërbimit civil udhëhiqet nga ligji dhe bazohet në parimin e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, meritës, transparencës, profesionalizmit, paanësisë politike, garanton qëndrueshmërinë në detyrë të nëpunësit civil, vazhdimësinë e shërbimit civil”.

Ndryshimet në ligjin “Për organizimin e pushtetit gjyqësor” (ligji nr. 114/2013), dhe ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë” parashikojnë rritjen e efikasitetit të sistemit gjyqësor, rritjen e transparencës, përgjegjshmërisë, llogaridhënies, përmirësimin e statusit të gjyqtarëve, me qëllim reduktimin e korrupsionit në sistemin gjyqësor.

Ligji nr. 108/2013 “Për të huajt” rregullon regjimin e hyrjes, të qëndrimit, të punësimit daljes së të huajve në/nga RSH, funksionet, kompetencat e autoriteteve shtetërore, subjekteve të tjera, publike dhe private.

Ndryshimet me ligjin nr. 40/2014 të ligjit nr. 8328/16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve dhe të paraburgosurve”, parashikojnë se “gratë e dënuara, të paraburgosura trajtohen duke respektuar liritë, drejtat themelore, pa diskriminim, duke parandaluar çdo akt dhune me bazë gjinore që sjell dëmtim fizik, seksual, psikologjik, vuajtje, çdo formë tjetër abuzimi, keqtrajtimi”.

Ligji kuadër nr. 93/2014 “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e PAK”, ka qëllim nxitjen, mbrojtjen e të drejtave të PAK për të mundur pjesëmarrjen e plotë, efektive në shoqëri, në kushte të barabarta me të tjerët, nëpërmjet ofrimit të ndihmës dhe mbështetjes. Mosdiskriminimi dhe barazia gjinore, janë ndër parimet e ligjit.

Janë miratuar, rishikuar, zbatuar një sërë strategjish/plane veprimi në fushën e barazisë gjinore, shëndetësisë, arsimimit, pronësisë, mbrojtjes sociale, mbrojtjes nga diskriminimi, kundër dhunës në familje, kundër trafikimit, mbrojtjes së grupeve të veçanta (PAK, romë, etj)¹⁵.

Rendi ligjor i Konventës

3. Sipas Kushtetutës, çdo marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar bëhet pjesë e së drejtës së brendshme dhe zbatohet në mënyrë të drejtpërdrejtë, përveç rasteve kur nuk është e vetëzbatueshme dhe zbatimi i saj kërkon nxjerrjen e një ligji. Nuk ka ende një studim me fokus çështjet e vetëzbatueshmërisë së CEDAW (si dhe për instrumentet e tjera ndërkombëtare të ratifikuar). Bazuar në rregullat e përgjithshme të zbatimit të normës juridike, subjektet mund të kërkojnë të zbatohen drejtpërdrejt vetëm ato nene të CEDAW për të cilat nuk lind nevoja e krijimit të mekanizmave të tjerë të brendshëm. Mekanizmat e

¹³ “Trafikimi i femrave” nuk është vepër penale e veçantë, përfshihet në këtë dispozitë.

¹⁴ Detajet në nenin 7.

¹⁵ Siç trajtohen në vijim, në nenet përkatëse.



ngritur për mosdiskriminimin dhe barazinë gjinore, ndikojnë në zbatimin efektiv të neneve të CEDAW. Nga praktika rezulton se ka filluar referimi tek CEDAW në kërkesë paditë e hartuara/dorëzuara në Gjykatë, në kërkesat drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjithashtu gjykatat në arsyetimin e disa vendimeve i janë referuar edhe Konventës¹⁶.

Mekanizmat kundër diskriminimit

4. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), funksionon nga viti 2010¹⁷, zgjidhet nga Kuvendi, si institucion publik, i pavarur dhe autoritet përgjegjës për mbrojtjen nga sjelljet diskriminuese të kryera nga autoritetet publike/subjektet private. KMD-ja shqyrton ankesat e personave/grupeve të personave që pretendojnë se janë diskriminuar nga organizatat që kanë një interes të ligjshëm për të vepruar me pëlqimin e individëve/grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminim, si dhe kryen hetimet administrative me iniciativën e tij. KMD-ja nxjerr vendime, jep rekomandime, vendos sanksione me gjobë dhe mund të përfaqësojë ankuesin, me miratimin e tij, në organet gjyqësore në çështje civile.

5. Pranë KMD-së janë regjistruar: 4 ankesa (2010), 15 ankesa dhe 1 çështje *ex-officio* (2011), 90 ankesa dhe 14 *ex-officio* (2012), 166 ankesa dhe 25 *ex-officio* (2013), 91 ankesa dhe 6 *ex-officio* (deri shtator 2014). Nga 166 ankesa (2013), 149 janë individuale (53 femra). Numri i ankueseve femra nuk ka pasur një rritje të dukshme në 2013 krahasuar me 2012, por është dyfishuar numri i ankuesve meshkuj. Numri i ankesave me pretendim për diskriminim gjinor është i vogël. Nga shqyrtimi i ankesave rezulton se viktimat të diskriminimit për shkaqe të ndryshme, janë më shumë gra. Përgjithësisht, objekti i ankesave me pretendim diskriminim gjinor ka qenë mosrespektimi i të drejtave në fushën e të mirave, shërbimeve nga institucionet publike¹⁸. Ka

tendencë për rritjen e numrit të çështjeve ku gjykata kërkon opinion me shkrim nga KMD-ja apo pjesëmarrjen e tij si palë e tretë në proceset gjyqësore.

Avokati i Popullit (AP)

6. AP është institucion kushtetues që mbron të drejtat, liritë, interesat e ligjshëm të individit nga veprimet/mosveprimet e paligjshme, të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj. AP nxjerr rekomandime kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive themelore nga organet e administratës publike dhe legjitimohet të verë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese. AP nuk ka kompetencë përfaqësimin e ankuesit në organet gjyqësore. AP ka nënshkruar 130 marrëveshje bashkëpunimi me OSHC-në (50 me OJF në mbrojtje të të drejtave të grave të dhunuara, me aftësi të kufizuar, të minoriteteve). Bashkëpunimi fokusohet në trajtimin/referimin e rasteve, ndërgjegjësimin e komunitetit, aktivitete të përbashkëta, etj.

7. Nga ankesat mbi DHkG dhe DHF evidentohen 5 raste të trajtuara, me rekomandimet përkatëse:

- AP me iniciativën e tij, inspektoi Qendrën Kombëtare të Trajtimit të Viktimave të Dhunës (prill 2012) dhe paraqiti rekomandim për largimin nga detyra të Drejtoreshës (u zbatua).

- Në 2013 filloi hetimi administrativ për rastin e refuzimit të punës nga një mjeke për infermieren me shami, duke rekomanduar marrjen e masës disiplinore ndaj mjekes dhe angazhimin e strukturave shëndetësore, për mospërsëritjen e rasteve të diskriminimit me bazë fetare, jo vetëm ndërmjet personelit mjekësor, por edhe ndaj pacientëve (u zbatua).

- Në 2013 është paraqitur një rekomandim (në formë studimi) “Për përmirësimin e punës parandaluese dhe luftës me efikasitet të organeve të zbatimit të ligjit, për veprat penale të DHF”, drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, Ministrit të Brendshëm dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

AP ka bërë rekomandime edhe mbi disa ndryshime në Kodin e Punës (parashikimin e

¹⁶ Konkretisht në vendimin nr. 8792, datë 26.7.2013 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me objekt “zgjidhje martesë, ushtrimin e përgjegjësisë prindërore për fëmijën”, Gjykata i referohet nenit 16 të Konventës.

¹⁷Bazuar në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi. Aktualisht ka një staf prej 23 personash dhe nuk ka zyra rajonale.

¹⁸ Për një çështje diskriminimi gjinor (vendim nr. 93/30.9.2013) është konstatuar diskriminimi i drejtpërdrejtë i ankueses për shkak të gjinisë, shtatzënisë, gjendjes

martësore dhe civile. KMD-ja ka dërguar rekomandim Entit Rregullator të Energjisë “Për rishikimin e kontratës tip mbi “Kushtet e përgjithshme të kontratës së furnizimit me energji elektrike për klientët familjarë”.



dispozitave mbi “ngacmimin seksual”, “ngacmimin moral në punë dhe në shtëpi”, “ngacmimin moral të punëmarrësit nga ana e punëdhënësit”, etj).

Mekanizmat ekzistues të ankimit

8. Mbështetur në Kushtetutë, çdo individ ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik, brenda një afati të arsyeshëm dhe nga një gjykatë e pavarur, e paanshme, e caktuar me ligj. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, nga gjykatat e apelit, si dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj. Gjykata Kushtetuese bën gjykimin përfundimtar të ankesave të individëve për shkeljen e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, pasi janë shterur të gjitha mjetet juridike për mbrojtjen e tyre. Në varësi të shkeljes së të drejtave dhe lirive, rrugët për mbrojtjen e së drejtës përfshijnë ankimin administrativ dhe gjyqësor. Në rastet e ankimit administrativ kompetente për zgjidhjen janë të gjitha organet administrative, të cilat veprojnë në bazë të Kodit të Procedurave Administrative dhe legjislacionit përkatës në fuqi. Për rastet e diskriminimit gjinor, ligji për barazinë gjinore përcakton se çdo ankesë për shkeljen e barazisë gjinore shqyrtohet nga organet administrative. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, palët mund të ndjekin procedurat e zgjidhjes me pajtim/ndërmjetësim. Risi përbën edhe krijimi i gjykatave administrative¹⁹ mbi shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative, mosmarrëveshjeve për shkak të ndërhyrjes së paligjshme, mosveprimit të organeve publike.

Aksesi në drejtësi

9. Bazuar në ligjin mbi gjykatat administrative të drejtën e ngritjes së padisë e ka edhe: a) çdo subjekt, që pretendon se i është cenuar një e drejtë apo interes i ligjshëm nga një veprim/mosveprim i organit publik; b) punëmarrësi ose punëdhënësi për mosmarrëveshjet në fushën e marrëdhënieve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike; c) çdo subjekt që pretendon se është cenuar në të drejtat, interesat e tij të ligjshme për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik, që nuk kanë formën e aktit administrative; d) çdo shoqatë apo grup interesi që pretendon se është cenuar një interes i ligjshëm publik. Ligji parashikon rastet e ngritjes së padisë për ndryshimin, shfuqizimin, konstatimin e pavlefshmërisë absolute të aktit administrativ, për

detyrimin e organit publik për kryerjen/ndalimin e veprimit administrativ të nevojshëm për mbrojtjen e të drejtave apo të interesave të paditësit, për saktësimin e të drejtave, detyrimeve ndërmjet paditësit dhe organit publik, për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të punës, kur punëdhënësi është një organ i administratës publike.

10. Sipas udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave (2013) parashikohet reduktimi i tarifave gjyqësore. Udhëzimi ndikon edhe në rritjen e aksesit të gruas në proceset gjyqësore.

Ndihma juridike

11. Ndryshimet në ligjin "Për ndihmën juridike" (2013-2014) parashikojnë: subjektet përfituese të ndihmës juridike; kriteret për përfitimin e ndihmës juridike konkretisht të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat që: a) kanë nevojë për ndihmë gjatë procesit penal në të gjitha fazat e tij, dhe për shkak të pamundësive financiare, nuk kanë zgjedhur një avokat/kanë mbetur pa të; b) kanë nevojë për ndihmë në çështjet civile/administrative, por nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare; c) kanë nevojë të mbrohen nëpërmjet paraqitjes së kërkesëpadisë, por nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare për taksën mbi aktet, shpenzimet për njoftimet, shërbimet e tjera gjyqësore. Që personi të përfitojë ndihmën juridike, duhet të vërtetohet: i) përfshihet (plotëson kushtet për t'u përfshirë) në programet e mbrojtjes sociale; ii) është viktimë e DHF ose trafikimit të qenieve njerëzore, për çështjet gjyqësore që lidhen me to. Komisioni Shtetëror i Ndihmës Juridike vlerëson plotësimin e kriterëve të përfitimit të ndihmës juridike. Personat që deklarojnë se përfshihen në programet e mbrojtjes shoqërore, të miturit përjashtohen nga detyrimi për paraqitjen e dokumentacionit. Ndihma juridike përfshin edhe përjashtimin e individit nga pagimi i taksës mbi aktet, shpenzimeve për njoftimet/shërbimet e tjera gjyqësore, në proceset gjyqësore civile/administrative. Kërkesa për dhënie të ndihmës juridike në formën e përjashtimit nga pagesa, shqyrtohet nga Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike brenda 10 ditëve. Në rast urgjence, ndihma juridike jepet menjëherë.

12. Ndryshimet ligjore parashikojnë ngritjen, funksionimin e klinikave ligjore vendore, për dhënie të asistencës së nevojshme ligjore për

¹⁹ Ligji nr. 49/2012.



përfitim të ndihmës juridike. Klinikat vendore parashikohen të ngrihen në një kohë të shpejtë në disa rrethe të vendit²⁰. Gjatë 2013 janë regjistruar 4 kërkesa për ndihmë juridike pranë Komisionit Shtetëror të Ndihmës Juridike, mbi raste të dhunës në familje, për të cilat është dhënë ndihma për marrjen e urdhrit të mbrojtjes.

Barra e provës

13. Kodi i Procedurave Administrative parashikon se barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi palët e interesuara. Palët e interesuara mund të bashkëngjisin dokumente, mendime apo të kërkojnë nga administrata marrjen e masave për sigurimin e provave, që nevojiten për marrjen e vendimit përfundimtar (neni 82). Lidhur me barrën e provës në çështjet administrative, ligji mbi gjykatat dhe mosmarrëveshjet administrative parashikon: organi i administratës publike, si rregull, ka detyrimin të provojë bazueshmërinë në ligj dhe fakte, të veprimeve të kryera prej tij. Ligji parashikon detyrimin e organit publik për të provuar ligshmërinë e aktit administrativ, kontratës administrative, veprimit administrativ, të nxjerrë jo me kërkesë të paditësit. Organi i administratës publike ka detyrimin të provojë ligshmërinë e veprimeve në marrëdhënien e punës, nga ka lindur mosmarrëveshja, objekt gjykimi. Në rastet e tjera, pala ka detyrimin të provojë faktet, ku bazon pretendimin e saj, por gjykata edhe kryesisht, me vendim të ndërmjetëm, mund të vendosë kalimin e barrës së provës tek organi publik, kur ka dyshime të arsyeshme, të bazuara në prova shkresore, që vërtetojnë se organi publik fsheh, nuk paraqet me dashje fakte, prova për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ky vendim ankimohet së bashku me vendimin përfundimtar.

14. Në Kodin e Punës parashikohet se “kur punëmarrësi parashtron të dhëna serioze që lënë të kuptojnë ekzistencën e një diskriminimi, punëdhënësi është i detyruar të provojë të kundërtën”. Në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës nga punëdhënësi, kur gruaja është në punë gjatë periudhës së shtatzënisë ose është kthyer në punë pas lindjes së fëmijës, i takon punëdhënësit të vërtetojë se shkak i pushimit nga puna nuk ka qenë shtatzënia ose lindja e fëmijës”.

15. Ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi” përcakton se ankuesi “mund të paraqesë ankesë

dhe provat e disponueshme para Komisionerit” (neni 33/1). Paditësi ka detyrim të sjellë prova në mbështetje të padisë, duke përdorur çdo lloj prove të ligjshme, që mund të provojë sjelljen diskriminuese”. Pasi paditësi paraqet provat mbi të cilat bazon pretendimin e tij dhe në bazë të të cilave gjykata mund të pretendojë sjelljen diskriminuese, i padituri detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim sipas këtij ligji (neni 36/5/6).

16. MMSR-ja ka parashikuar ndryshime në Kodin e Punës për barrën e provës²¹. Rekomandime të ngjashme për heqjen e “barrës së provës” kanë propozuar edhe KMD, AP, që janë në proces shqyrtimi.

17. Njohja me Konventën dhe Protokollin shtesë:

- Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me Shkollën e Magjistraturës organizojnë trajnime të përvitshme të prokurorëve, ku ndër të tjera trajtohet edhe Konventa.

- MMSR-ja vijon përpjekjet për ndërgjegjësimin e institucioneve, publikut mbi Konventën.

- Botimi i tekstit mësimor “BGJ dhe mosdiskriminimi” për studentët e ligjit, që përmban ndër të tjera edhe Konventën CEDAW.

- Komisioni i Përhershëm për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë në Kuvend ka monitoruar zbatimin në praktikë të rekomandimeve të Konventës, ligjeve të miratuara në mbrojtje të grave nga diskriminimi.

KMD ka përfshirë informacion mbi CEDAW në botimin “Mbrojtja nga diskriminimi – manual trajnimi për OJF-të”²² dhe raportet vjetore, raportet e veçanta.²³

Harmonizimi i legjislacionit të brendshëm

18. Ende nuk ka një monitorim të plotë të ndikimit të legjislacionit të BGJ-së dhe antidiskriminimit, pavarësisht se për pjesë të caktuara të tij ka pasur analiza dhe raporte të kryera me mbështetjen e organizatave ndërkombëtare dhe OSHC-së. Viojnë përpjekjet në këtë drejtim.

Në vitin 2011, KMD-ja ka zhvilluar monitorimin mbi situatën e diskriminimit me fokus nivelin e njohjes së ligjit mbi diskriminimin, sjelljet

²¹ Referim nenit 11.

²² Projekt i Komitetit Shqiptar të Helsinkit në partneritet me KMD mbështetur nga Zyra e Kooperacionit Zvicran.

²³ Raporte “Mbi situatën e diskriminimit të komunitetit rom”, “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të komunitetit LGBT në Shqipëri”.

²⁰ Durrës, Gjirokastrë, Korçë, Shkodër, Tiranë, Vlorë.



diskriminuese në sistemin arsimor.

Ndërgjegjësimi mbi legjislacionin antidiskriminim

19. Konferenca “Mbrotjtja nga diskriminimi: Modelet pozitive dhe sfidat”²⁴ synoi ndërgjegjësimin e aktorëve të ndryshëm, mbi mjetet ligjore kundër diskriminimit. Ndër rekomandimet evidentohet monitorimi i ligjit nga KMD, realizimi i fushatave ndërgjegjëse. Rekomandimet e konferencës janë pjesë e veprimtarisë së KMD-së, për 2014.

Adresimi i diskriminimit të shumëfishtë

20. Kategoria e grave me aftësi të kufizuara trajtohet brenda grupimit të PAK dhe rrallëherë janë trajtuar në mënyrë specifike. Ato, si edhe burrat, përfitojnë nga shërbimet sociale pagesat e akorduara për PAK. Po bëhen përpjekje për trajtimin me përparësi të kësaj kategorie duke ofruar kurse të dedikuara formimi profesional, dhe programet e ndërmjetësimit për punësim. Me ndryshimet në ligjin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, gratë me AK që mund të jenë nëna të vetme apo kryefamiljare trajtohen me shërbime mbështetëse nga qendrat publike komunitare dhe orientohen tek OJF-të që ofrojnë shërbime alternative, në rast se strukturat shtetërore nuk i mundësojnë ato. Sipas Urdhrit të Ministrit të MMSR-së nr. 286/16.12.2013 “Për tarifat e sistemit të formimit profesional publik”, aplikohen tarifa falas për grupe të veçanta, përfshirë dhe gratë/vajzat me AK.

21. Gratë e moshuara. Pensioni mesatar që marrin gratë (10.335 lekë) është më i vogël se pensioni mesatar i burrave (12,948 lekë)²⁵, që tregon se gratë kanë pasur një punë më pak të paguar dhe për pasojë gratë e moshuara preken më shumë nga varfëria dhe fenomene të tjera (dhuna, neglizhenca, abuzimi etj.). Në dokumentin e politikave ndërsektoriale për moshën e tretë janë parashikuar masa që marrin në konsideratë nevojat e grave, pabarazitë gjinore, lidhur me skemën e pensioneve, pjesëmarrjen aktive në shoqëri zhvillimin e tyre. Parashikohet hartimi i një projektligji për moshën e tretë, ku gratë do trajtohen si kategori më vete.

Në kuadër të vitit evropian për mplakje aktive dhe solidaritet midis brezave janë organizuar

konferenca dhe studime për moshën e tretë (2012), por ende nuk ka analizë dhe statistika të plotë mbi gratë e moshuara, gjendjen e tyre faktike sipas fushave të Konventës.

22. Gratë migrante. “Strategjia për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer në vend 2010- 2015 dhe plani i veprimit”, krijon mekanizëm lehtësues, mbështetës për riintegrimin e shtetasve shqiptarë të kthyer nga emigracioni, përfshirë gratë migrante. Strategjia mbështetet në parimet e barazisë, ndjeshmërisë gjinore, trajtimit të barabartë, adresimit të nevojave gjinore. Sipas masave në planin e veprimit, gratë migrante pas kthimit në vend intervistohen mbi nevojat e tyre, informohen, referohen në strukturat përkatëse, ndihmohen për punësim, formim profesional, sigurimet shoqërore, shëndetësore, arsimim, etj. Janë planifikuar trajnime të vazhdueshme për punonjësit e strukturave që ofrojnë shërbime riintegrimi për gratë shqiptare të kthyera nga emigrimi.

23. Në Strategjinë e re për Punësimin dhe Aftësitë, 2014-2020 të MMSR, janë parashikuar masa mbi: politika informimi para nisjes së punëtorëve migrantë në vendin e destinacionit; hartimi i marrëveshjeve dypalëshe të punësimit sipas standardeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të punëtorëve migrantë; rishikimi, përmirësimi i legjislacionit, praktikës së agjencive private të punësimit në përputhje me konventat ndërkombëtare në këtë fushë; monitorimi i të drejtave të punëtorëve migrantë.

24. Kanë aplikuar për leje qëndrimi 439 shtetase të huaja (2010); 519 shtetase të huaja (2011); 301 shtetase të huaja (2012); 467 shtetase të huaja (2013). Aktualisht janë pajisur me leje qëndrimi me afate të ndryshme kohore 727 shtetase të huaja.

25. Informacioni në lidhje me gjendjen e punëtorëve gra migrante, dërgesat në para nuk disponohet.

26. Shqipëria ka ratifikuar në fushën e migracionit disa konventa të KiE, ILO.

27. Gratë LGBT. Legjislacioni shqiptar është përmirësuar ndjeshëm në këtë drejtim. Ndryshimet në Kodin Penal parashikojnë si rrethanë rënduese, kryerjen e veprës penale për motive lidhur me identitetin gjinor, orientimin seksual dhe “nxitjen e urrejtjes, grindjeve” për shkak të orientimit seksual. MPCSSHB miratoi (dhjetor 2012) një “Plan masash për mosdiskriminimin për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor, 2012-

²⁴ Organizuar nga KMD, nëntor 2013.

²⁵ Drejtoria e Shërbimit Social MMSR



2014”, me 5 prioritete kryesore mbi kuadrin ligjor dhe institucional, si dhe politikat antidiskriminuese në: punësim, të mirat dhe shërbimet, arsim dhe pushtetin vendor. Aktivitetet fokusohen tek rishikimi i legjislacionit në përputhje me dispozitat antidiskriminuese të dokumenteve ndërkombëtare, rekomandimeve në këtë fushë, fushata ndërgjegjësuese, ngritja/fuqizimi i kapaciteteve të institucioneve përgjegjëse. Zbatimi i Planit u mbështet nga Projekti i KiE “Lufta kundër diskriminimit për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor”.

28. Avokati i Popullit u ka drejtuar institucioneve përgjegjëse rekomandime për përmirësimin e të drejtave të personave LGBT.

29. Komisioneri KMD ka shqyrtuar ankesat, ka tërhequr vëmendje mbi diskriminimin e personave LGBT, ka paraqitur vendime²⁶ dhe rekomandime.

Neni 3

30. Qeveria shqiptare tregon ndjeshmëri për fuqizimin e strukturave dhe kapaciteteve në fushën e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje dhe bazohet në rekomandimet e Komitetit, orientimet në Platformën për Veprim të Pekinit.

Mekanizmi kombëtar

a) Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)

31. Në bazë të ligjit për barazinë gjinore dhe ligjit kundër dhunës në familje autoriteti përgjegjës në këto fusha deri në shtator 2013 ishte ministri i (MPÇSSHB) që e ushtronte këtë autoritet nëpërmjet strukturës së Drejtorisë së Politikave të Shanseve të Barabarta dhe Familjes (DPSHBF). DPSHBF-ja kishte mision formulimin e zhvillimin e politikave për nxitjen e barazisë gjinore, reduktimin e dhunës në familje. Nga shtatori 2013 autoritet është ministri i MMSR, nëpërmjet strukturës së Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore (DPSBGJ), nën varësinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Politikave Sociale në MMSR. DPSBGJ-ja kryen të njëjtat funksione të DPBGJF-së me synim ndërlidhjen më të mirë mes programeve të përfshirjes sociale (me fokus gratë nga grupet më vulnerable) me barazinë gjinore.

32. MMSR-ja planifikon buxhetin vjetor²⁷ për çështjet e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje brenda programeve buxhetore për: a) shanset e barabarta²⁸; b) mbrojtjen sociale²⁹; c) tregun e punës³⁰, ka marrëveshje bashkëpunimi me PNUD dhe UN WOMEN³¹. Buxheti i planifikuar për çështjet e barazisë gjinore, kundër dhunës në familje është rritur nga viti në vit. Megjithatë është ende e pamundur paraqitja e pjesës së buxhetit kombëtar që investohet për promovimin e barazisë gjinore, fuqizimin e grave. Buxheti për çdo ministri alokohet në total dhe veprimet specifike mbulohen nën programe të ndryshme. Pjesë e buxhetit të shtetit për këto çështje është edhe shuma që akordohet për OJF-të nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.³² Agjencitë e KB japin mbështetje edhe për OJF-të³³.

b) Nëpunësit gjinorë në nivel qendror dhe vendor

33. Ngritja dhe fuqizimi i këtij rrjeti nxit përfshirjen e politikave gjinore në të gjitha nivelet qeverisëse. Deri në shtator 2013 në nivel qendror, vetëm 3 nga 15 ministri kishin të përcaktuar me strukturë një nëpunës gjinor, ndërsa ministrinë e tjera kishin pika fokale për çështjet e barazisë gjinore. Aktualisht janë caktuar pika fokale në

²⁷ Sqarim: Kursi i këmbimit: 100 lekë shqiptare (AL) përafërsisht 1USD.

²⁸ 1.220.000 lekë/12.000 USD (2013). Sqarim 100 lekë shqiptare-përafërsisht 1 USD.

²⁹ 1.479.263.000 lekë/150.000 USD (2013): 11200 gra kryefamiljare përfituan ndihmë ekonomike (total 538.000.000 lekë); 52 gra të dhunuara shoqëruar me fëmijë, përfituan shërbime rezidenciale gjatë 2013 (buxheti i Strehëzës Kombëtare ishte 13.300.000 lekë); buxheti 2013 për shërbime rezidenciale për gratë, gratë/vajzat e trafikuar që përfitojnë shërbime rezidenciale, ndihmë ekonomike-20.153.000 lekë; 28.100 gra/vajza me aftësi të kufizuara përfituan pagesë invaliditeti për 2013 (total 909.000.000 lekë).

³⁰ 564,500,000 lekë (2013). 561 gra/vajza PuPa përfituan nga programet e nxitjes së punësimit për 2013 (total 60.000.000 lekë); 3073 gra/ vajza morën formim profesional gjatë 2013 (total 4.500.000 lekë).

³¹ 7,327,134 lekë (2013).

³² Për 2010-52 kontrata me OJF-të (total 62,959,000 lekë), ku projektet për DHF zinën 7% (8,838,767 lekë), projektet për luftën kundër trafikimit- 3.4% (4,337,266 lekë). Për 2012 u financuan 69 OJF (76,900,000 lekë), projektet për DHF- 7.5% (5,764,200 lekë), projektet për luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore- 0.41% (314,750 lekë).

³³ Gjatë 2013: 17,270,383.00 lekë (UNDP); 88,000 USD (UNFPA) dhe 290.000 USD (UN Women)

²⁶ Kryesisht vendimet lidhen me gjuhën e urrejtjes ndaj komunitetit LGBT, asociimit të orientimit seksual si sjellje devijante, shpërndarjes së informacionit të gabuar.



ministritë e linjës, Kryeministri, Departamentin e Administratës Publike dhe Policinë e Shtetit (gjithsej 18 punonjëse/gra). Në nivel vendor, nga 65 bashki në total, 18 kanë zyra të posaçme të BGJ me nëpunës gjinorë të emëruar me kohë të plotë, ndërsa 47 bashki kanë pika fokale të BGJ. Nëpunësit gjinorë trajnohen në vazhdimësi dhe nga dhjetori 2013, MMSR po punon për formalizimin e pozicionit të tyre dhe ngritjen e kapaciteteve, në bashkëpunim me Departamentin e Administratës Publike dhe Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Organ këshillimor

34. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore (KKBGJ) funksionon nga viti 2009, i riformatuar pas zgjedhjeve parlamentare 2013, ka në përbërje 9 zëvendësministra, 3 përfaqësues të shoqërisë civile dhe drejtohet nga ministri i MMSR-së. Në mbledhjet e KKBGJ-së janë trajtuar çështje të ndryshme të barazisë gjinore, janë miratuar akte nënligjore apo raporte monitoruese vjetore dhe janë dhënë rekomandime për institucionet në nivel qendror dhe vendor.

Në nivel parlamentar

35. Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë shqyrton ndër të tjera, çështjet e barazisë gjinore dhe kundër dhunës në familje, nëpërmjet seancave dëgjimore. Në vitin 2013 brenda këtij komisioni është ngritur “Nënkomisioni për Çështjet e të Miturve, Barazinë Gjinore dhe Dhunën në Familje” (drejtohet nga grua), me qëllim monitorimin e politikave qeveritare në mbështetje të gruas, familjes, përfshirjen e OSHC-së në këtë proces. Brenda Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut funksionon Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut.

36. Aleanca e Grave Deputete (AGD) u krijua në tetor 2013 nga lobimi i grave deputete³⁴, si një tjetër mundësi për të vënë në prioritet çështjet e grave, arritjen e barazisë gjinore. AGD ka kryer aktivitete ndërgjegjësuere në këtë fushë.

Politikat qeveritare

37. Nga vlerësimi i zbatimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore dhe Dhunës në Familje (SKBGJ&DHF) 2007-2010, rezultoi se pati përmirësime të dukshme në: kuadrin ligjor, ngritjen

dhe fuqizimin e strukturave (qendrore dhe vendore), ndërgjegjësimin e opinionit publik dhe thyerjen e disa koncepteve mbi denoncimin e rasteve të dhunës në familje, zbutjen e stereotipeve gjinore për përfaqësimin e grave në vendimarrjen politike, publike, etj. Rishikimi i SKBGJ&DHF 2007-2010 dhe hartimi i Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore, Reduktimin e Dhunës me Bazë Gjinore dhe Dhunës në Familje, 2011-2015 dhe Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e saj³⁵, (në vijim “Strategjia Kombëtare”) miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 573/16.6.2011 u nxit edhe nga nevoja për përputhjen e afateve me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integritim (SKZHI). Strategjia Kombëtare ka katër prioritetet strategjike: i) Forcimi i Mekanizmit Institucional dhe Ligjor; ii) rritja e pjesëmarrjes së grave në vendimarrje; iii) fuqizimi ekonomik i vajzave/grave; iv) Zvogëlimi i DHBGJ/DHF; shoqërohet nga një plan veprimi³⁶ dhe ka të përcaktuar kostot financiare, që sigurohen nga buxheti i shtetit, buxheti i njësisë të qeverisjes vendore dhe donatorët. Në planin e veprimit janë përfshirë edhe rekomandimet e dhëna nga Komiteti (2010), për nevojat e grupeve të caktuara të grave që provojnë disavantazh më të theksuar, që rrjedhin nga situata të lidhura me aftësitë e kufizuara, origjinën shoqërore dhe etnike apo orientimin e tyre seksual. Monitorimi i Strategjisë Kombëtare është i përvitshëm dhe bazohet në treguesit e harmonizuar gjinorë, sipas informacioneve të mbledhura nga institucionet përgjegjëse (qendrore dhe vendore). Raporti vjetor paraqitet dhe miratohet në mbledhjet e KKBGJ. Rekomandimet shërbejnë për një bashkërendim më të efektshëm ndërmjet strukturave për arritjen e objektivave të përcaktuara.

38. Për realizimin e integritimit gjinor janë hedhur hapa të rëndësishëm në drejtim të buxhetimit gjinor³⁷. Aktet nënligjore parashikojnë që ministritë

³⁵ Me mbështetjen e programit “Një OKB - Për BGJ në Shqipëri”

³⁶ 14 objektiva specifike, 113 aktivitete, që synohet të zbatohen gjatë 2011-2015.

³⁷ Në zbatim të Programit të Përbashkët të Qeverisë Shqiptare dhe KB 2012-2016: Miratimi i “Treguesve të harmonizuar mbi BGJ dhe statusin e grave në Shqipëri” (udhëzimi nr. 1220/27.05.2010), ndryshimet e ligjit nr. 10.399/17.3.2011, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 465/16.7.2012 “Për integrimin gjinor në programin

³⁴ Aktualisht përbëhet nga 27 gra deputete: 14 të PS, 9 të PD dhe 4 të LSI.



e linjës brenda programeve buxhetore, të përcaktojnë minimalisht objektiva, tregues, produkte të qarta, për realizimin e integritit gjinor në proceset buxhetore. Zbatimi i vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 465/16.7.2012 “Për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm” u pilotua gjatë 2013 në dy ministri dhe gjatë vitit 2014 në 8 ministri (9 programe buxhetore).

39. Disa prioritete të qeverisë për 2013-2017:

1. Angazhimi efektiv i institucioneve publike në luftën kundër DHBGJ, forcimi i rolit të sistemit të drejtësisë në parandalimin, mbështetjen e viktimave/të mbijetuarve të DHBGJ/DHF, dënimi i dhunuesve. 2. Krijimi i sistemit kombëtar elektronik të regjistrimit, monitorimit të rasteve të DHBGJ/DHF, sigurimi i funksionimit të linjës telefonike kombëtare për trajtimin/referimin e tyre.

2. Riintegrimi i grave/vajzave të mbijetuara të DHBGJ/DHF nëpërmjet ofrimit të banesave sociale, punësimit, formimit profesional, ndihmës, shërbimeve sociale.

3. Fuqizimi i pozitës së grave/vajzave përmes punësimit, nxitjes së sipërmarrjes, formimit dhe kualifikimit profesional, ofrimit të trajnimeve falas, për të gjitha të rejat e papuna nën moshën 25 vjeç.

4. Zgjerimi i mbështetjes për nënat e reja në periudhën e parë të jetës së fëmijës së tyre.

Përfitimi i lejes së lindjes për çdo nënë, pavarësisht nga kontributet në sigurimet shoqërore, ofrimi nga shteti, shoqëria i kujdesjes për fëmijën e sapolindur dhe nënën.

Neni 4

40. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi (neni 11, “veprimet pozitive”) parashikon: “Masa e përkohshme, e veçantë që synon përsheptimin e vendosjes reale të barazisë, kur mungesa e barazisë është shkaktuar nga diskriminimi për çdo shkak evidentuar (sipas nenit 1), konsiderohet veprim pozitiv dhe nuk përbën diskriminim. Kjo masë ndërpritet sapo të jenë arritur objektivat e trajtimit, ofrimit të mundësive të barabarta”. Ligji parashikon detyrimin e institucioneve përgjegjëse për marrjen e

masave pozitive kundër diskriminimit mbi të drejtën për punësim³⁸, arsimim³⁹.

41. Ligji për barazinë gjinore (nenin 8/1) përcakton: “Masat e veçanta të përkohshme përfshijnë kuotat për arritjen e përfaqësimit të barabartë gjinor, rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje, jetën politike, fuqizimin ekonomik, pozitën e personave të secilës gjini në fushën e punës, përmirësimin në mënyrë të barabartë të nivelit arsimor, masa të tjera në çdo fushë ku personat e njëres gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë me personat e gjinisë tjetër. Sipas nenit 8/2, këto masa pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat e barazisë gjinore për të cilat janë krijuar.

42. Masat e veçanta të përkohshme gjatë 2010-2014:

1. Rishikimi i Kodit Zgjedhor (2012) për kuotat gjinore, sanksionet: së paku 30% e listës shumëmemërore dhe një në tre emrat e parë të listës duhet t’i përkasë secilës gjini⁴⁰.

2. Policia e Shtetit⁴¹ vendosi kuotën prej 50% (gra) në pranimet e reja në polici; hapi fushatën e rekrutimit vetëm për gra, renditi fituesit sipas gjinisë; shtyu afatin e paraqitjes së lejes së drejtimit të automjetit për gratë, brenda një viti nga momenti i pranimit në polici.

3. Forcat e Armatosura për rritjen e përfaqësimit të grave në aspektin civil, ushtarak vendosën objektivin 15%, në “Strategjinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Forcat e Armatosura, 2011-2015”; hartuan politika/rregullore që promovojnë ecurinë e grave në gradë, karrierë.

4. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 143/12.3.2014 “Për procedurat e rekrutimit, përzgjedhjes, periudhës së provës, lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët, të mesme drejtuese”, përcakton se kandidatët me pikë të barabarta renditen: a) I pari, nëse njëri nga kandidatët përfshihet në

³⁸ Neni 14, parashikon “marrjen e masave me karakter pozitiv kundër diskriminimit mbi të drejtën për punësim. Masat janë: vendosja e politikave të posaçme, të përkohshme, me qëllim nxitjen e barazisë, në veçanti midis burrit dhe gruas, midis personave me aftësi të plotë fizike dhe atyre me aftësi të kufizuara”.

³⁹ Neni 18/1 parashikon marrjen e masave pozitive kundër diskriminimit mbi të drejtën për arsimim”.

⁴⁰ Detaje referim neni 7.

⁴¹ Ndryshimet në ligjin për Policinë e Shtetit, Rregullore e Personelit, Procedurat Standarde të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore.

buxhetor afatmesëm”, udhëzimi i përbashkët nr. 21/21.06.2013, midis MPCSSH, Ministrisë së Financave “Për përcaktimin e procedurave që duhet të ndiqen për integrimin gjinor në programin buxhetor afatmesëm”, janë rrjedhojë e ndërhyrjeve direkte të UN Women në kuadër të programit për buxhetimin gjinor.



kategorinë e personave me aftësi të kufizuar; b) Nëse janë të gjinive të ndryshme përzgjidhet i pari ai që i përket gjinisë më pak të përfaqësuar; c) Kur nuk mund të aplikohen alternativat e mësipërme, me short.

Ky përcaktim është në përputhje me nenin 22 të LBGJ “Masat e veçanta të përkohshme në marrëdhëniet e punës”.

Neni 5

Masat për adresimin e stereotipeve gjinore

43. Qeveria Shqiptare ka vijuar përpjekjet për adresimin e stereotipeve gjinore duke sfiduar traditat e dëmshme që shkelin të drejtat e grave, vajzave, konkretisht:

a) Fushata ndërgjegjësimi dhe plane veprimi

44. MMSR organizon fushata ndërgjegjëse të përvitshme që kanë rritur ndjeshmërinë ndaj çështjeve gjinore dhe respektimit të të drejtave, reflektuar kjo me ndryshimin e qëndrimeve tradicionale, rritjen e numrit të denoncimeve pranë organeve përkatëse për rastet e DHKG/DHF.

Fushata mbarëbotërore “16 Ditët e Aktivizmit kundër DHKG/DHF”⁴², realizohet në bashkëpunim me OJF-të, pushtetin vendor dhe organizatat ndërkombëtare (sidomos të KB).

Fushatat gjatë 2012, 2013 u fokusuan në përfshirjen aktive të burrave/djemve, si advokues për BGJ, kundër dhunës ndaj grave. Fushata e 2013 u zhvillua nën sloganin e përbashkët koordinues nga të gjitha institucionet shoqëria civile në nivel qendror, vendor. Ajo u zgjat deri në 8.3.2014, me qëllim shpërndarjen e informacioneve/mesazheve, për të theksuar lidhjen mes të drejtave të grave, përparimit të tyre, reduktimit të DHBGJ. Në këtë linjë do të zhvillohet fushata e vitit 2014. Fushata ndërgjegjësimi organizohet edhe në kuadër të 8 Marsit⁴³. Në korrik 2014 MMSR i'u bashkua fushatës “HeForShe” të UN WOMEN, duke nxitur rreth 30 të rinj/të reja të kontribuojnë në thyerjen e stereotipeve gjinore. Rreth 65 mesazhe të djemve/burrave shqiptarë mbi fuqizimin,

mbështetjen e grave, vajzave në shoqëri, janë vendosur në faqen e internetit “One Story”⁴⁴.

45. Gjatë 2013, MMSR⁴⁵ hartoi “Planin Kombëtar të Veprimit për Angazhimin e Burrave/Djemve si Partnerë të Grave/Vajzave në luftën kundër DHBGJ/DHF (2014 – 2019)”. Parashikohen veprime konkrete: krijimi i lëvizjes kombëtare të të rinjve për BGJ; ndërtimi i kapaciteteve të profesionistëve, liderëve të komuniteteve (përfshirë dhe ato fetare) për adresimin e çështjeve të BGJ dhe DHF; edukimi i familjeve, qytetarëve si nxitës të ndryshimit. Plani do të paraqitet në mbledhjen e radhës së KKBGJ (nëntor 2014) ndërkohë që elementë të tij do fillojnë zbatohen gjatë fushatës së “16 Ditëve”.

b) Takime/aktivitete/trajnime

46. Gjatë fushatës së “16 Ditëve”, Komisioni Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale, Shëndetësinë në bashkëpunim me AGD, zhvilloi në 2013, seancën dëgjimore me institucionet shtetërore, organizatat ndërkombëtare, shoqërinë civile, mbi angazhimet, rolin e tyre në parandalimin, luftën ndaj fenomenit të DHKG, duke evidentuar problematikat.

47. Në qershor 2014, Nënkomisioni për Çështjet e të Miturve, BGJ, DHF, mori pjesë në fushatën kundër DHF në qytetin e Korçës⁴⁶. Në fushatë u përfshinë anëtarët e Mekanizmit të Referimit për rastet e DHF, përfaqësues të policisë, nxënës shkollash. Nënkomisioni organizoi sesion informimi për DHF mbi kuadrin ligjor ndërkombëtar, vendas (qershor 2014). Anëtarët shprehën angazhimin për përfshirjen në luftën kundër DHF, për të garantuar një mbrojtje efektive të viktimave/të mbijetuarave.

48. KMD realizoi: takim informues⁴⁷ me gazetarët, aktivitete mbi diskriminimin gjinor në sektorin ekonomik⁴⁸, trajnim me zyrat rajonale të punësimit për mbrojtjen nga diskriminimi, të drejtat për punësim të grave/vajzave viktime të trafikimit. Për ndërgjegjësimin e grave rurale, është

⁴⁴<https://www.onestory.com/campaigns/djente-e-burrat-per-barazine-gjinore>
<https://www.facebook.com/heforshe/posts/273067892888673>

⁴⁵ Mbështetur nga UN WOMEN, UNDP, UNFPA.

⁴⁶ Organizuar nga OSBE, Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, bashkia Korçë.

⁴⁷ Projekti “Zbatimi i parimit të BGJ, programit të DHBGJ”, në bashkëpunim me PNUD.

⁴⁸ Mbështetur nga UN Women.

⁴² E përvitshme, 25 nëntor – 10 dhjetor

⁴³ 2010: Konferenca “Të Drejta të Barabarta, Mundësi të Barabarta, Progres për të Gjithë”; 2011: Aktivitet “Një orë me poezi për gruan”; 2013: Ekspozita fotografike (8-14 mars): “Retrospektivë dhe realitet, vajza/gra të suksesshme në botë”, mbështetur nga UN Women, me 120 foto të grave/ vajzave me histori suksesi para, pas viteve '90.



nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me Postën Shqiptare për shpërndarjen e materialeve informuese.

49. Instituti i Shëndetit Publik ka organizuar në 10 rrethe aktivitete promovuese me stafin shëndetësor në komunitet, shkolla, për rritjen e ndërgjegjësimit ndaj DHBGJ/DHF.

c) Rishikimi i kurrikulave shkollore

50. Ministria e Arsimit dhe Sporteve në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse adreson çështjet e steriotipeve, integritit gjinor përmes: 1) rishikimit/hartimit të programeve në arsimin parauniversitar, universitar, përfshirë nxitjen/aplikimin e kuotave për vajzat, djemtë, në degë studimi jo tradicionale sipas stereotipit gjinor⁴⁹; 2) trajnimit të autorëve të teksteve për rishikimin/hartimin e teksteve të reja shkollore për përfshirjen e perspektivës gjinore, eliminimin e steriotipeve; 3) hartimit të udhëzimeve/materialeve metodologjike për integrimin gjinor në kurrikula; 4) krijimit të shanseve/kushteve të barabarta për pjesëmarrjen në aktivitete, ekipe sportive me përparësi vajzat/gratë.

Dhuna kundër grave, dhuna me bazë gjinore dhe dhuna në familje

51. Parashikimi i DHF si vepër penale. DHF⁵⁰ është parashikuar si vepër penale; rritja e sanksionet për dhunuesit; parashikimi si vepër penale e veçantë, përdhunimi martesor; janë shtuar rrethanat rënduese kur vepra penale kryhet kur viktima është nën urdhër mbrojtjeje; është parashikuar si vepër penale ngacmimi seksual. Pas këtyre ndryshimeve, vetëm për nenin 130/a (DHF) është rritur çdo vit numri i procedimeve: 249 procedime (2012); 761 procedime (2013); 769 procedime (janar–qershor 2014).

52. Ratifikimi i Konventës së KiE për parandalimin dhe luftimin e DHkG dhe DHF (4.2.2013). Me hyrjen në fuqi të Konventës (gusht 2014), MMSR po identifikon fushat e ndërhyrjes, nevojën për mbështetje (burime/ekspertizë) për zbatimin e saj, bazuar në vlerësimin e 2012-2013 mbi situatën aktuale, efektet financiare për përmbushjen e standardeve bazë⁵¹.

53. Ndryshimet në ligjit “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” (2010) sanksionuan: 1) krijimin e rrjetit të koordinuar të institucioneve përgjegjëse (qendrore, vendore), për mbrojtjen, mbështetjen dhe rehabilitimin e viktimave; 2) fuqizimin e gjyqësorit për marrjen e masave të mbrojtjes ndaj DHF; 3) sigurimin/garantimin për viktimat e DHF të shërbimit të shpejtë, të pakushtueshëm në përputhje me ligjin, pranë gjykatës, organeve të tjera kompetente.

Zbatimi i ligjit për DHF solli:

54. Ngritja e mekanizmave të referimit. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 334/17.2.2011 “Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të DHF dhe mënyrën e procedimit të tij (MKR)” janë ngritur në 27 bashki mekanizma me përfaqësues të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e ligjit. Shërbimet e ofruara për viktimën/të mbijetuarën janë afatshkurtra (mbrojtje e menjëhershme, siguri, mbështetje shëndetësore, strehim, transport në vend të sigurt, informacion/asistencë për procedurat për urdhër mbrojtjeje, referim tek shërbimet e tjera sipas nevojës) dhe afatgjata (mbështetje për punësim, ndihmë ekonomike, strehim afatgjatë, këshillim, ndihmë ligjore për zgjidhje martesë, këshillim dhe psikoterapi, ndihmë për fëmijët, transferimi në ambiente të tjera edukimi, këshillime/terapi, etj). Nga monitorimi i punës së MKR rezulton se pavarësisht efektivitetit të funksionimit të tij në pjesën më të madhe të bashkive ku është ngritur, anëtarët ndeshen me një sërë sfidash. Evidentohet nevoja për më shumë burime për shërbimeve të kompletuara. Disa nga prioritetet e punës për përmirësimin e situatës *de facto* mbi DHkG/DHF janë: ngritja e linjës telefonike 24-orëshe, ngritja e strehëzave rajonale.

55. Ngritja e shërbimeve të reja: Strehimi. Përveç strehimit që ofrohet nga OJF-të, është ngritur “Qendra e parë kombëtare për trajtimin e viktimave të DHF” (25.4.2011)⁵², që ofron shërbim 24-orësh, multidisiplinar, me standarde. Nga praktika rezulton se gjatë 2011-2012 janë akomoduar 64 përfitues (25 gra; 39 fëmijë, 3 të pashoqëruar nga nëna); gjatë 2012 – 2013 janë akomoduar 62 përfitues (34 gra; 28 fëmijë); gjatë

⁴⁹ Strategjia Kombëtare 2011-2015.

⁵⁰ Siç evidentohet në nenin 2.

⁵¹ Udhërrëfytyrësi për zbatimin e Konventës së KE për parandalimin dhe luftimin e DHkG dhe DHF. Vlerësim i situatës aktuale dhe efekteve financiare të zbatimit të

Konventës për Shqipërinë” (Shoqata “Refleksione”, MMSR, mbështetur nga UN Women).

⁵² Urdhri i Kryeministrit nr. 36/18.03.2011, mbështetur nga UNDP përmes programit Një OKB.



janar-korrik 2014, janë akomoduar 53 përfitues (19 gra; 34 fëmijë, 1 i pashoqëruar nga nëna). Për vitin 2014 janë 28 raste të reja. Moshë e grave të akomoduar varion 19 - 51 vjeç. Rreth 70% e tyre vijnë nga zonat rurale. Përgjithësisht rastet referohen nga policia, struktura të tjera shtetërore dhe OJF-të. Pavarësisht këtij modeli pozitiv, bashkëpunimit të shtetit me strehëzat e OJF-ve, duhet pranuar se disponueshmëria e shërbimeve mbështetëse për gratë viktime/të mbijetuara të DHBGJ/DHF nuk është e njëjtë në të gjithë Shqipërinë dhe jo për të gjitha viktimat/të mbijetuarat. Gratë/vajzat nga zonat rurale kanë akses më të kufizuar në shërbimet e mbështetjes direkte.

56. Këshillimi. Paralelisht me OJF-të që ofrojnë shërbime këshillimi për grupe të ndryshme në nevojë, përfshirë dhe të mbijetuarat e DHF, qeveria ka prioritet ngritjen e një linje këshillimi kombëtare për trajtimin e DHkG. Në tetor 2011, UNFPA mbështeti MPÇSSHB për studimin e fizibilitetit mbi shërbimet ekzistuese të këshillimit, modelet më të përshtatshme për t'u aplikuar, për ngritjen e linjës kombëtare. Vijon organizimi i takimeve, tryezave teknike, për finalizimin e këtij shërbimi. Gjithashtu pranë çdo drejtorie policie në qarqe funksionon numri telefonik 24-orësh (nr. 129) pa pagesë, për denoncimin edhe të rasteve të DHF.

57. Shërbimet për dhunuesit. Siç parashikohet edhe në kuadrin ligjor ekzistues, MMSR po bashkëpunon me OJF-të e specializuara, donatorët për ngritjen e shërbimeve për dhunuesit. Në 2013 u hap Qendra e Këshillimit për Dhunuesit. Në shtator 2014 u certifikua grupi i parë i burrave/djemve të trajnuar si këshillues për ofrimin e shërbimit⁵³.

58. Shëndetësia. Urdhri nr. 410/12.7.2010 i Ministrisë të Shëndetësisë nxit riorganizimin e shërbimit shëndetësor, psikosocial për ofrimin e ndihmës për personat e dhunuar në familje. Nga praktika rezulton ofrimi në kohë i ndihmës së parë, por ndjehet mungesa e shërbimit psikosocial në qendrat shëndetësore. “Strategjia e Shëndetit Riprodhues dhe Plani i Veprimit 2010-2015”, mbulon fushat prioritare për shëndetin riprodhues, përfshirë dhunën në familje, ndaj fëmijës. Strategjia synon: rishikimin, përshtatjen, ndryshimet e

programeve/shërbimeve/institucioneve të shëndetit riprodhues, sipas kërkesave të LDHF rritjen me 50% të aksesit në shërbimet shëndetësore për viktimat e DHF, ndaj fëmijës; përfshirjen e treguesve të DHF në sistemin e informacionit shëndetësor; rritjen e ndërgjegjësimit, ndryshimet në sjellje për mospranimin e dhunës. Vlerësimi përfundimtar i Planit të Veprimit do bëhet në 2015.

59. Ndihma ligjore falas. Ndonëse numri i rasteve që kanë përfituar ndihmën juridike falas nga zbatimi i ligjit është ende i vogël (4 raste/ 2013; 2 raste për gjashtëmujorin e I-rë 2014 -një shtetase shqiptare, një e huaj), efektet flasin qartësisht për përmirësimin e aksesit në drejtësi të grave/vajzave.

Rritja e numrit të denoncimeve dhe pajisja e viktimave me urdhra mbrojtjeje

60. Rritja e besimit të komunitetit në strukturat e policisë sjell rritjen e numrit të denoncimeve, siç evidentohet më poshtë:

Viti	Evidentuar	Trajtuar me kërkesë-padi UMM/UM	Raste/ DHkG	Raste/dhunë ndaj fëmijëve	Shkelje të UM
2010	1998	1234	1660	120	93
2011	2181	1345	1779	98	86
2012	2526	1562	2036	58	119
2013	3020	1851	2346	108	138
janar-qershor 2014	1893	1147	1448	95	64

Sipas Policisë së Shtetit, për vitin 2014 të gjitha rastet e shkeljes së UM autorët janë proceduar penalisht në përputhje me nenin 320, 321, 130/a të Kodit Penal.

Monitorimi i vendimeve gjyqësore mbi zbatimin e LDHF

61. Ministria e Drejtësisë (MD) inspektoi 2689 vendime gjyqësore të çështjeve me objekt “Lëshimin e urdhrit të menjëhershëm të mbrojtjes” dhe “Lëshimin e urdhrit të mbrojtjes”⁵⁴, për periudhën janar 2011–korrik 2012, pranë 28 gjykatave të vendit⁵⁵. Gjetja kryesore ishte shkelja sistematike e afateve procedurale të vendosura nga ligji për shqyrtimin e kërkesave dhe dhënien e vendimeve gjyqësore mbi to. Në 183 raste janë

⁵⁴Vendimi nr.297/9/15.11.2012 të Këshillit të Lartë të Drejtësisë <http://kld.al/korniza-ligjore/akte-n%C3%ABnligjore/raport-mbi-dhunen-ne-familje>

⁵⁵ 6 gjykata apeli, 22 gjykata të shkallës së parë. Gjykata me ngarkesë më të lartë çështjesh u konstatuan: gjykatat e apelit Tiranë (1024 çështje), Durrës (446 çështje), Vlorë (446 çështje), Shkodër (315 çështje), Korçë (272 çështje), Gjirokastrë (186 çështje).



konstatuar shkelje të afateve ligjore (6.8 % e volumit në shkallë vendi). Evidentohen dy fenomene shqetësuese: i) një numër i lartë çështjesh pushohen dhe nuk marrin një vendim themeli gjyqësor; ii) numri i ankimeve në gjykatat më të larta është jashtëzakonisht i ulët. Shkaku kryesor i pushimit të çështjeve është mosparaqitja e paditësës, heqja dorë e saj, megjithatë nuk mungojnë rastet kur gjykata vendos pushimin për shkak të normalizimit të marrëdhënieve midis palëve ndërgjyqëse. Numri i ulët i ankimeve tregon se ka një problem me aksesin në drejtësi të të dëmtuarave nga DHF. Në 17 gjykata⁵⁶ nuk ka pasur asnjë vendim të ankimuar. 13 vendime nga 2689 të dhëna gjithsej janë cenuar, që zënë masën 0.4 %. Nga inspektimi u konstatua se në *gjykata nuk ka një bazë solide të të dhënave mbi DHF*, që vështirëson identifikimin e rasteve, monitorimin e tyre dhe analizën e të dhënave. Gjykata të ndryshme kanë ndjekur praktika të ndryshme regjistrimi, duke vështirësuar nxjerrjen e statistikave, duke penguar në disa raste gjykimin për shkak se gjyqtarët japin dorëheqje në çështje që i kanë gjykuar më parë. Lidhur me këtë çështje, Ministria e Drejtësisë ka njoftuar kancelarët e 28 gjykatave të inspektuara për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin e regjistrave me qëllim evidentimin veçmas të rasteve të DHF. Është sugjeruar përfshirja e rubrikave që gjenerojnë të dhëna të përgjithshme për çështjen gjyqësore, të dhëna të posaçme për çështjen, palët në proces (rastet e recidivizmit, të dhëna të detajuara për palët: mosha, niveli ekonomik, niveli arsimor, profesioni, zbatueshmëria direkt e akteve ndërkombëtare të ratifikuara, të dhëna të tjera).

62. Sipas MD, totali i titujve ekzekutivë me objekt urdhër mbrojtjeje të regjistruara për ekzekutim pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror është 629 çështje/19 vijojnë të jenë në ekzekutim.

63. Ndërtimi/fuqizimi i kapaciteteve të punonjësve në fushën e DHBGJ/DHF

2010-2013 u trajnuan 4400 punonjës të shëndetësisë⁵⁷ në 12 rajonet e vendit: (1275 gra-

2010); 730 gra-2011); 1067 gra-2013). Në rrethet janë emëruar personat përgjegjës brenda Drejtorive të Shëndetit Publik për çështje mbi DHF, mbrojtjen e fëmijëve.

2012-2014 janë trajnuar 339 anëtarë (210 femra) të Ekipeve Teknike Ndërdisciplinare⁵⁸, pjesë e mekanizmave të referimit të rasteve të DHF.

2013, Shkolla e Magjistraturës⁵⁹ ofroi cikël të plotë trajnimesh për 151 profesionistë të sistemit të drejtësisë (69 gjyqtarë, 27 prokurorë, 11 mjekë ligjorë, 44 profesionistë të tjerë).

2012⁶⁰ u trajnuan 31 punonjëse (femra) të Qendrës Kombëtare për viktimat e DHF, kurse 2014 u trajnuan 37 punonjës të shërbimeve sociale dhe Qendrës Kombëtare (28 femra). Janar-prill 2014 MMSR⁶¹ trajnoi 51 nëpunës gjinorë dhe koordinatorë vendorë për përdorimin e sistemit elektronik të regjistrimit të rasteve të DHF.

Gjatë janar – qershor 2014 janë trajnuar 224 oficerë policie (62 femra)⁶².

Studimi i shkaqeve dhe pasojave të DHK

64. INSTAT-i realizoi vërtetimin e dytë kombëtar për DHF në Shqipëri (2013). Të dhënat treguan rritje të % së grave të dhunuara nga 56,0% (2007) në 59,4% (2013). Rezultoi se 53,7% e grave po përjetonin “aktualisht” DHF; 58,2% e grave kishin përjetuar dhunë psikologjike “gjatë jetës”. Krahasuar me vitin 2007, ka rënie të përqindjes së grave që kishin përjetuar dhunë fizike, dhunë seksuale “gjatë jetës”. Ky tregues dëshmon tendencën për ndryshimin e formave të dhunës dhe na sinjalizon të tregojmë kujdes për trajtimin e formave të ndryshme të saj. Për sa kohë dhuna seksuale do vijojë të mbetet tabu, statistikave dhe denoncimit të saj nuk do kenë ndryshime, Duhet thelluar më tej analiza e fenomenit, shkaqeve, pasojave, efektivitetit të zbatimit të masave të planifikuara.

Mbledhja e të dhënave

65. Në zbatim të udhëzimit nr. 1220, datë 27.5.2010 “Për mbledhjen e treguesve gjinorë dhe për DHF”, institucionet shtetërore përgjegjëse

viktimave të DHBGJ”, zbatuar nga QKSS në bashkëpunim me MSH dhe Drejtoritë Rajonale të Shëndetit Publik, mbështetur UNFPA.

⁵⁸ Mbështetur nga UNDP si pjesë e programit “Një OKB”.

⁵⁹ Mbështetur nga UNDP.

⁶⁰ Mbështetur nga UNDP.

⁶¹ Mbështetur nga UNDP.

⁶² Mbështetur nga programi i Qeverisë Suedeze.

⁵⁶ Gjykatat e Apeleve Tiranë, Durrës, Shkodër, Vlorë, Gjirokastër, Korçë, si dhe Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Dibër, Krujë, Kurbini, Mat, Kavajë, Kukës, Pukë, Berat, Lushnjë, Gjirokastër dhe Përmet.

⁵⁷ Projekti “Ndërtimi i kapaciteteve të punonjësve të shëndetësisë për t’u përgjigjur në mënyrë efektive



përcjellin periodikisht të dhënat pranë MMSR, si autoriteti kryesor përgjegjës. Ministria e Brendshme ka ndërmarrë veprime administrative për hartimin e udhëzuesve/formularëve për evidentimin e rasteve të DHF. Me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 327/28.5.2014 Ministria e Shëndetësisë ka përcaktuar formatin dhe mënyrën e raportimit të të dhënave për rastet e DHF -së.

MMSR⁶³ ngriti në korrik 2014 sistemin elektronik kombëtar për regjistrimin e rasteve të DHF-së të trajtuara në nivel vendor nga anëtarët e MKR-së. Deri në fund të gushtit 2014, rezultojnë 29 bashki që hedhin të dhënat në sistem, nga përpunimi i të cilave evidentohen 639 të dhunuar në nivel kombëtar, 631 dhunues dhe 877 referime.

Statistika

66. Sipas prokurorisë, për 2012 - 2013, vepra 130/a e Kodit Penal zë respektivisht 88% dhe 87% të procedimeve të regjistruara për grup për veprat penale kundër fëmijëve, martesës, familjes në totalin e 371 procedimeve (2012) dhe 946 procedimeve (2013). Numri i procedimeve është rritur me 150% në 2013 (826 procedime penale me 791 të pandehur, krahasuar me 328 procedime me 255 të pandehur në 2012). Ka rritje me 255% të numrit të personave ndaj të cilëve është ngritur akuzë në gjykatë gjatë 2013 (dërguar për gjykim 589 procedime dhe ngritur akuza për 606 të pandehur, krahasuar me 159 procedime dërguar për gjykim dhe 171 akuza të ngritura për 2012). Për këtë vepër penale janë dënuar: 69 të pandehur (2012); 405 të pandehur (2013). Mbi dhunën seksuale, rezultoi 1 procedim penal i regjistruar për kryerje të marrëdhënieve seksuale me dhunë midis bashkëshortëve/bashkëjetuesve (2013).

67. Sipas Policisë së Shtetit, të dhënat e formularit statistikor “krimet seksuale (të dëmtuara femra), përcaktojnë gjininë dhe jo moshën. Për vitin 2013 rezultojnë 69 raste. Krime kundër personit (të dëmtuara femra) janë 110 raste, nga 20 raste vrasje, 17 raste janë në marrëdhëniet familjare.

Numri i vrasjeve në familje

Viti	Gjithsej	Gra	Fëmijë
2010	20	12	-
2011	30	15	3
2012	28	14	3
2013	28	17	1

Të dhëna nga Instituti i Mjekësisë Ligjore

Viti	Femra nën 14 vjeç	Femra mbi 14 vjeç
2010	12	424
2011	17	353
2012	19	441
2013	18	462

Lloji i dhunës

Viti	Marrëdhënie seksuale me dhunë nën 14 vjeç	Marrëdhënie seksuale me dhunë mbi 14 vjeç	DHF	Dhunë nga persona të tjerë
2010	2	20	98	316
2011	3	7	107	253
2012	4	12	93	351
2013	4	14	141	321

Neni 6

Kuadri ligjor

68. Ndryshimet në Kodin Penal (ligji nr. 144/2013) ku përfshihen ndër të tjera: shfuqizimi i nenit për ushtrimin e prostitucionit, dallimi i trafikimit të brendshëm nga trafikimi ndërkufitar, shmangia e konfliktit ligjor në zbatim apo konkurrimit mes neneve të ndryshme të trafikimit, masat ndëshkuese në rast shpërblimi për përfitim personal të prostitucionit, penalizimi i përdorimit të shërbimeve të personave të trafikuar dhe atyre që përfitojnë nga këto shërbime, përjashtimi nga dënimi i personave të dëmtuar nga veprat penale që lidhen me trafikimin e personave.

69. Ndryshimet në ligjin për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, (2010-2011) plotësuar me ligjin për buxhetin, udhëzimin e Ministrit të Financave, sipas të cilave MMSR-ja transferon fonde në programin e “Mbrotjes sociale” për viktimat e trafikimit (VT) që marrin shërbime në qendrat pritëse dhe ndihmë ekonomike pas daljes nga këto qendra, deri në momentin e punësimit të tyre.

70. Miratimi i akteve nënligjore (2010-2012) në zbatim të ligjit nr. 10192/3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë” për: ngritjen dhe funksionimin e Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPSK); bashkëpunimin, pagesat për shërbimin përmbartimor, kriteret e vlerësimit, procedurat e dhënies në përdorim/tjetërsimit të pasurive të konfiskuara, përfitimit nga VT të shërbimeve shëndetësore. Është parashikuar ngritja e fondit të posaçëm (157,000 €), përfituesit e të cilit janë Drejtoria e Përgjithshme e Policisë Shtetit, Prokuroria e Përgjithshme, OJF-të që mbështesin,

⁶³ Në bashkëpunim me UNDP



trajtojnë VT/VMT dhe Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile. Në 2014, AAPSK mbështeti qendrat pritëse/riintegruese me materiale të ndryshme.

71. Gjithashtu janë bërë propozimet për ndryshime në Kodin e Procedurës Penale, për rritjen e aksesit në drejtësi, sigurimin e mbrojtjes efektive për VT/VMT, përmes përfaqësimit të drejtpërdrejtë ligjor falas, heqjes së tarifave/taksave të procesit, kompensimit brenda procesit penal.

Politikat/masat kryesore

72. Urdhri i Kryeministrit nr. 179/19.6.2014, “Për ngritjen e Komitetit Shtetëror kundër Trafikimit të Personave”, udhëzimi nr. 3799/8.7.2014 “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen, riintegrimin e viktimave të mundshme” (Ministria e Punëve të Brendshme, MPB Ministrinë e Punëve të Jashtme, MPJ Ministria e Arsimit, Sporteve (MAS), Ministria e Shëndetësisë (MSH), Ministria e Mirëqenies Sociale, Rinisë (MMSR).

73. Hartimi/miratimi i strategjive, planeve: 1. Strategjia Kombëtare e Luftës kundër TP dhe Plani i Veprimit 2014–2017 (proces miratimi); 2. Plani i Punës mes Institutit të Shëndetit Publik, Drejtorisë së Policisë Qarkut Tiranë, Drejtorisë së Tatimeve (nëntor 2013) për identifikimin në kohë të situatave të mundshme të shfrytëzimit dhe parandalimin e trafikimit; 3. Plani i Veprimit të MMSR-së dhe Koordinatorit Kombëtar Antitrafik (KKA) për fëmijët në situatë rruge; 4. Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) për identifikimin, referimin, shërbimet për VT (2011), (me përfshirjen edhe të MSH-së; 5. Marrëveshjet e bashkëpunimit me OJF-të, njësitë lëvizëse, drejtoritë e policive të qarqeve (nëntor 2013).

74. Ngritja e mekanizmave, si: 1. Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR), mbrojtjes, riintegrimit të VT/VMT (korrik 2012) dhe Task-Forca (nëntor 2013); 2. Njësitë Lëvizëse në Tiranë, Vlorë, Elbasan (qershor 2013); 3) Seksioni për Hetimin e Çështjeve mbi TP (2010), (3 prokurorë, një Oficer e Policisë Gjqësore (femër)); 4. Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) në 194 bashki/komuna, që trajtojnë edhe raste të fëmijëve në risk trafikimi.

Akordimi i buxhetit të veçantë për Koordinatorin Kombëtar Antitrafik (KKA) gjatë 2014 për aktivitete parandaluese, ndërgjegjësuere; funksionimi i Linjës Kombëtare 116006 falas

(qershor 2014), për të raportuar raste trafikimi nëpërmjet thirrjeve, sms-ve; krijimi i një sistemi efektiv administrimi të dhënash për VT/VMT, (Sistemin e Informacionit për VT-SIVET).

75. Ngritja e grupit të punës për vlerësimin e situatës mbi hetimin dhe gjykimin e veprave penale të TP, (nëntor 2012-urdhër të përbashkët midis MPB-së, Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme, me pjesëmarrjen e OSHC-së, qendrave pritëse/rehabilituese për VT/VMT, organizatave ndërkombëtare, Ambasadës Amerikane dhe OPDAT); Propozimi nga KKA për ngritjen e Task-Force mes Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Gjykatës së Krimeve të Rënda, Policisë së Shtetit, për forcimin e bashkëpunimit, diskutimin e rasteve të TP. Zyra e KKA dhe ICITAP po përgatisin Termat e Referencës.

76. Miratimi (2011) i Marrëveshjes së përbashkët (MPB, MPJ, Shërbimit Ligjor Falas (TLAS)), hapi rrugën për regjistrimin e fëmijëve të lindur jashtë vendit (që pengohet më parë nga mungesa e aktit të lindjes/dokumentacionit të nevojshëm nga ana e prindërve). Sipas Marrëveshjes, shërbimet tona konsullore sigurojnë dokumentacionin nga shërbimi shëndetësor i vendit ku ka lindur fëmija, TLAS-ja mbulon shpenzimet për sigurimin e dokumentacionit, MPB-ja bën regjistrimin nëpërmjet Drejtorisë Përgjithshme të Gjendjes Civile. Gjatë 2012, janë regjistruar 76 fëmijë të lindur jashtë kufijve.

77. Zvogëlimi i mundësisë së trafikimit të fëmijëve të paregjistruar përmes: a) aplikimit të dokumentit “Certifikatë-Asistencë në lindje” (urdhri nr. 508/7.12.2011), redukon mundësitë për mosregjistrim të fëmijëve të sapolindur duke përfshirë numrin e identitetit, mbiemrin e vajzërisë së nënës; b) miratimit të procedurave/procesverbaleve që duhet të plotësohen nga policia, njësitë vendore për rastet e fëmijëve të gjetur, të paregjistruar në gjendjen civile; c) udhëzimi nr. 7/10.1.2012), me synim zvogëlimin e numrit të rasteve të paregjistruara.

78. Sipas studimeve/raporteve, Shqipëria mbetet kryesisht vend origjine për TP. Kryesisht femrat (të rritura, të mitura) i nënshtrohen shfrytëzimit për prostitucion brenda, jashtë vendit (viktimat shpesh pranojnë oferta të rreme për punësim, trafikohen me anë të mashtrimit të “të dashurit”).



Përpjekjet e qeverisë në luftën kundër trafikimit të personave (TP) rezultojnë të suksesshme, siç vlerësohen edhe në raportin e Departamentit Amerikan të Shtetit (qershor 2014). Shqipëria renditet nga lista e “vendeve në vëzhgim Grupi 2” (2013) në “Grupin 2”.

79. Sipas të dhënave të zyrës së KKA: 2013- 95 viktima/viktima të mundshme trafikimi (52 gra, 29 të mitura); 85 viktima të mundshme (53 femra) të identifikuar nga njësitë lëvizëse (prej qershorit 2013).

Sipas Policisë së Shtetit: mbi “trafikimin e femrave” janë evidentuar 31 çështje me 30 autorë, 1 ndaluar (2013); 26 çështje (2012); 17 çështje (2011); 33 çështje (2010).

80. Sipas Prokurorisë së Krimeve të Rënda, për shfrytëzimin e prostitucionit, gjatë 2013 ka rritje në 51 procedime, me 33 të pandehur, për shkak të parashikimit në Kodin penal të kryerjes së veprës në rrethana rënduese. Kanë marrë vendim dënimi 21 të pandehur. Në 2012 rezultojnë 26 procedime “trafikimi i femrave”; 19 procedime “shfrytëzim prostitucioni”. Në 2011 rezultojnë 20 procedime “trafikimi i femrave”. Në 2010 rezultojnë²⁹ procedime “trafikimi i femrave” dhe 11 procedime “shfrytëzim prostitucioni”.

81. Në Gjykatën e Krimeve të Rënda, Shkalla I-rë: gjatë 2011 për 5 çështje “trafikimi i femrave”, ka përfunduar gjykimin me vendim përfundimtar, dënuar 5 persona. Dënimet variojnë nga 10- 15 vjet burgim, dhe gjobë nga 4-6 milionë lekë. Në 2010 rezultojnë 15 çështje “trafikimi i femrave” (4 regjistruar në dhjetor 2010) - akuzuar 21 persona të sjellë për gjykim. Në një çështje me tre të pandehur ka ndryshuar kualifikimi ligjor në “shfrytëzim prostitucioni në rrethana rënduese” sipas nenit 114/a, 5/6 të Kodit Penal.

Mbrojtja, asistenca dhe riintegrimi

82. Strehëzat. Në Shqipëri funksionojnë katër strehëza (tre jopublike) për VT/VMT, që ofrojnë shërbime për viktimat e huaja, vendase, fëmijë, të rritur, meshkuj ose femra: “Qendra Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit” (QKPVT qendër publike) dhe “Të ndryshëm & të barabartë” (Tiranë), “Tjetër Vizion” (Elbasan), “Vatra” (Vlorë). Strehëzat ofrojnë shërbime multidisiplinare: strehim, këshillim psiko-social, ligjor, përfaqësim në gjykatë, trajtim të nevojave shëndetësore, formim profesional, etj.

MMSR-ja transferon fonde (ushqimi) për VT/VMT, edhe tek qendrat pritëse jopublike. Për 2013 asnjë prej tre strehëzave nuk arriti të marrë fondet e kërkuara sipas dokumentacionit. Për 2014 në projektbuxhetin afatmesëm 2014-2017 është projektuar një fond prej 37,924,000 lekë për produktin TP ku: planifikimi (ushqim) për qendrat jopublike është 2,757,200 lekë, është çelur fondi prej 2,079,000 lekë, masa e ndihmës ekonomike për person është 3000 lekë/muaj, planifikimi për QKPVT për 2014 është 21,970,000 lekë (3,000,000 lekë më shumë sesa 2013).

83. Punësimi. VT përfitojnë kualifikime profesionale të ofruara nga zyrat e punës, nga programet kualifikuese të qendrave pritëse, që raportojnë vështirësi të mëdha për punësimin e tyre. Ndonëse ekziston bashkëpunimi me biznesin privat, nevojitet përmirësimi i veprimtarisë ndërmjetësuese të zyrave të punës në këtë drejtim.

84. Kompensimi i VT. Gjykata e Shkallës I-rë Tiranë mori vendimin (2010), që VT i njihet e drejta e kompensimit në një vlerë të konsiderueshme, që do shlyhet nga autori i veprës penale. Ky vendim, i pari i këtij lloji, shënon hap pozitiv drejt krijimit të praktikës për kompensimin e VT.

85. Ndërgjegjësimi, fuqizimi i kapaciteteve

- Memorandumi i Mirëkuptimit për zbatimin e projektit “Adresimi i TP-së nëpërmjet teknologjisë celulare” nënshkruan (tetor 2013)⁶⁴. Aplikacioni i instaluar në telefonat smart-phone “Raporto dhe shpëto” synon rritjen e ndërgjegjësit, forcimin e partneritetit me komunitetin, rritjen e numrit të identifikimeve fillestare të viktimave të mundshme, aksesin e shpejtë për asistencë, informacion.

- Futja e temave të TP në kurrikulën e arsimit bazë (krahas çështjeve të mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve, BGJ, DHF, edukimit seksual).

- Shpërndarja e 500 postera, 2500 fletëpalosje, 2000 Fotonovela “Jepi fund stigmës”, manual, broshura për parandalimin e trafikimit, migracionin e rregullt; realizimi i spoteve, dokumentarëve, emisione televizive/radiofonike, krijimi i himnit kundër DHBGJ/DHF “Zbrite Diellin”.

- Organizimi i përvitshëm i Ditës Europiane kundër TP (18 tetor); Javës Antitrafik (18-24 tetor) me mesazhe sensibilizuese; forume të hapura; emisione televizive; dokumentarë; pjesë teatrale;

⁶⁴ MPB, Fondacioni Vodafone Albania, World Vision.



ekspozitë me punime artistike nga VT; reklamimi i Linjës Kombëtare 116006.

- Njësia Antitrafik, IOM shpërndanë 4000 broshura informuese për PSV-të, për aktorët përgjegjës; trajnuan 500 specialistë nga 12 qarqet (janar 2012–maj 2013). Ministria e Shëndetësisë, IOM trajnuan 40 përfaqësues të shërbimeve shëndetësore kryesisht mjekë familjeje, 2/3 femra, (12 qarqet-2013-2014).

- Trajnimet për prokurorët e krimeve të rënda, gjyqtarët, oficerët gjyqësorë, punonjësit e policisë, Shërbimit Social Shtetëror, NJMF fokusohen: mbi fenomenin, kuadrin ligjor, procedurat e hetimit, konfiskimit, kompensimit, mekanizmat. Trajnimet kryhen në bashkëpunim me IOM, TAIEK, OPDAT, Shkollën e Magjistraturës, OJF-të. Për personelin e përfaqësive diplomatike, konsullore janë hartuar udhëzues/materiale informuese mbi procedurat gjatë kontakteve me VT/VMT.

- Seminare me përfaqësues të medias mbi raportimin e duhur të çështjeve të TP-së; seminare me nxënës të shkollave të mesme, përfaqësues të zyrave të punës⁶⁵ (rreth 100 pjesëmarrës).j.

- Takime për ngritjen e Grupit Këshillimor të OSHK të specializuara në çështjet e trafikimit, me iniciativën e KKA, si pjesë e iniciativave për fuqizimin e bashkëpunimit kombëtar (2013).

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar

86. KKA luan një rol aktiv në institucionalizimin e këtij bashkëpunimi: përmes: 1. Protokollit shtesë të bashkëpunimit me Kosovën “Për intensifikimin e bashkëpunimit në luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe për përmirësimin e identifikimit, njoftimit, referimit dhe kthimit vullnetar të ndihmuar të VT/VMT, në veçanti të fëmijëve” (qershor 2012); 2. Hartimit të Protokollit të Bashkëpunimit me Malin e Zi; 3. Hartimit të Marrëveshjes së Bashkëpunimit për luftën kundër TP me Mbretërinë e Bashkuar, Italinë, Francën, në bashkëpunim me përfaqësitë diplomatike të akredituara në Shqipëri, etj.

Neni 7

Përfaqësimi politik

87. Niveli qendror. Përfaqësimi i grave në legjislaturat 2005-2009-10 gra (7%); 2009-2013 -23 gra (16%). Pas zgjedhjeve të qershorit 2013, legjislatura 2013-2017 rezultuan 25 gra (18%), numri i të cilave për vitin 2014 është rritur në 30

gra (21%) për shkak të vakancës (neni 64/6 Kodi Zgjedhor). Gratë përfaqësojnë 31,7% në partitë politike.

Parlamenti

Total 2009-2013	Femra	Posti	Total 2013-2017	Femra
1	1	Kryetar	1	0
2	0	Nënkryetar	2	0
140	23	Deputete	140	30
8	1	Kryetarë të Komisioneve Parlamentare	8	3
3	0	Kryetarë të Grupeve Parlamentare	5	0

Kabineti Qeveritar

Total 2009-2013	Femra	Posti	Total 2013-2017	Femra
1	0	Kryeministër	1	0
1	0	Zëvendëskryeministër	1	0
14	1	Ministra	19	7
37	8	Zëvendësministra	23	9

88. Roli i grave deputete është rritur ndjeshëm me krijimin e Aleancës së Grave Deputete (2013), që lobon për plotësimin nga këndvështrimi gjinor të disa ligjeve, si ligji “Për dhënie amnistie” (2014), ndryshimet në ligjin nr. 47/2014 “Për ndihmën shërbimet shoqërore”(2014). Aktivitetet të AGD: mbi mbrojtjen e të drejtave të grave të dënuara; ndjekja e dy rasteve dhune ekstreme ndaj grave⁶⁶; kontakte me shoqatat e jetimëve; hartim peticioni për sensibilizim ndaj çështjes së vajzave nigeriane të rrëmbyera; vëmendje disa projekteve të USAID për fuqizimin ekonomik të grave⁶⁷; aktivitete për krijimin e rrjetit të grave biznesmene⁶⁸; tryeza diskutimi me Ministrin e MMSR. Në kuadër të shtrirjes së bashkëpunimit rajonal për promovimin e grave në politikë, AGD ka zhvilluar aktivitete të përbashkëta me gratë deputete të Kosovës.

89. Niveli vendor. Pas zgjedhjeve të vitit 2011 gratë përfaqësohen: 3 kryetare bashkie⁶⁹ (7.7%); 2 kryetare minibashkie për Tiranën (18 %)⁷⁰; 13.8% anëtare të këshillave bashkiake; 2 kryetarë komunash (0.6%); 1 kryetare qarku (8.3%).

90. Ndryshimet në Kodin Zgjedhor në vitin 2012 (neni 67/6,7 nenet 164, 175) dhe Kodin Penal në vitin 2012 (veprat penale që prekin zgjedhjet e lira, sistemin demokratik të zgjedhjeve), parashikojnë:

⁶⁶ Lezhë, Durrës.

⁶⁷ Pukë, Lezhë.

⁶⁸ Shkodër, Fier, Elbasan.

⁶⁹ Burrel, Konispol, Patos

⁷⁰ Njësia nr. 1, nr. 5

⁶⁵ Berat, Durrës, Lezhë.



1. Së paku 30% e listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini.

2. Një në tre emrat e parë të listës shumemërore duhet t'i përkasë secilës gjini.

3. Për herë të parë, krahas listës shumemërore të kandidatëve, subjekti i paraqitjes së listës deklaroi vendet sipas kuotës gjinore, me qëllim zbatimin e përgjithshmit për plotësimin e vakancës kur ekzistojnë kushtet e përcaktuara në Kod. Vakanca që i përket një mandati të fituar në kushtet e nenit 64/6, plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë. Emrat e tjerë të asaj gjinie ngjiten në listë duke marrë renditjen e kandidatit paraardhës të së njëjtës gjini.

4. Vendosja e sanksioneve administrative, për çdo zonë zgjedhore ku konstatohet shkelja, në rast mospërbushjeje të njërit prej kushteve të nenit 67/6, për përbërjen e listës shumemërore⁷¹. Sanksionet aplikohen për zgjedhjet qendrore dhe vendore.

5. Ndryshimet në Kodin Penal (2012) përbëjnë përpjekje për të shmangur votimin familjar, që në shumicën e rasteve në zonat rurale ndëshkon gratë/vajzat.

91. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në procesin e verifikimit të listave shumemërore për zgjedhjet (qershor 2013), konstatoi se 3 partitë kryesore politike nuk kishin respektuar kriterin e gjinisë (PS në 6 zona zgjedhore, PD në 4 zona zgjedhore, LSI në 4 zona zgjedhore).

Përfaqësimi në jetën publike

92. Administrata publike. Për 2011 rezultojnë 64,9% gra në nivel specialisti, 39,2% gra në nivel të mesëm drejtues, 24,3% gra në nivel të lartë drejtues. Për vitet 2012, 2013 të dhënat janë⁷²:

Kategoria e pozicionit	Viti 2012		Viti 2013	
	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj
Nivel i lartë drejtues	29%	71%	47%	53%
Nivel i mesëm drejtues	43%	57%	49%	51%
Nivel i ulët drejtues	54%	46%	49%	43%

⁷¹ Sanksionet në lidhje me BGJ (neni 175) parashikojnë “mospërbushja nga subjekti zgjedhor i detyrimeve mbi kuotën gjinore, në përbërjen e listës, dënohet nga KQZ me gjobë 1,000,000 lekë për zgjedhjet për Kuvendin; 50,000 lekë për zgjedhjet për organet e pushtetit vendor”.

⁷² Të dhënat i referohen Këshillit të Ministrave, Ministrive.

Kategoria	% më shumë femra për 2013
Nivel i lartë drejtues	18%
Nivel i mesëm drejtues	6%
Nivel i ulët drejtues	5%
Nivel ekzekutiv	5%

93. Mbrojtja. Përqindja e grave është rritur: 12.3%-2010; 13.6% -2011; 15.2%-2012; 17.7%-2013. Tejkalohe me 2.7% objektivi i vendosur. Prezenca e grave në operacionet paqeruajtëse fillon të jetë e përhershme (1% -1.5 %). Drejtorë në Ministrinë e Mbrojtjes, Forcat e Armatosura- 4 gra (16%)-2 ushtarake (grada kolonel) dhe 2 civile. Shefe të degëve/sectorëve të Forcave të Armatosura janë 9.3% gra (2.4 % e numrit të përgjithshëm të grave). Përqindja e grave për vitin akademik 2012-2013 rezultoi: a) Për oficerët: 20% kolonele; 19.4% nënkolonele; 2% majore; b) Kurset nënoficerë: 12.5% fillestar; 9.78% bazë; 15.2% i avancuar; 16.4% i lartë; 11.2% i instruktorit; c) Gjuhët e huaja: 25.5%.

94. Policia e Shtetit. Nga 9508 punonjës, 1003 janë gra (10.5%). Me grada policore janë 558 gra: 10, nivel i mesëm drejtues (drejtues i parë, drejtues); 208, niveli i parë drejtues (komisar, kryekomisar); 340, nivel zbatues (nëinspektor, kryeinspektor); 2 janë përfaqësuese të minoriteteve; 1 nivel i parë drejtues, 1 nivel zbatues. Në funksione civile janë 445 gra, 1 nga minoritetet.

Drejtësia

95. Të dhëna mbi numrin e grave gjyqtare në gjykatat e shkallës së parë dhe apelit:

- 2009, 149 gra gjyqtare/355 gjyqtarë.
- 2010, 150 gra/362 gjyqtarë.
- 2011, 155 gra/359 gjyqtarë.
- 2012, 160 gra/364 gjyqtarë.
- 2013, 168 gra/371 gjyqtarë.
- 2013, Gjykata Kushtetuese, 2 gra/9 anëtarë.
- 2013, Gjykata e Lartë, 4 gra/16 anëtarë.
- 2013, Gjykatat e Apelit 3 gra kryetar/ 7; dhe 26 gra/75 gjyqtarë.
- 2013, Gjykatat e Rretheve 4 gra/ kryetarë; dhe 100 gra/200 gjyqtarë.
- 2013, Gjykatat Administrative 7 kryetarë/1 grua; dhe 15 gra/25 gjyqtarë.

96. Të dhëna mbi numrin e grave prokurore.

2009-2010, 85 prokurore gra

2011-2012, 86 gra

2013-2014, 90 gra.

Prokurori i Përgjithshëm ishte grua (deri 2012).

Prokurorët e rretheve 254/77 gra.

Prokurorët e apelit 28/3 gra.



Prokurorët e Krimeve të Rënda 16/3 gra.

Aktualisht në institucionin e Prokurorisë janë 324 prokurorë/90 femra (28) %. Në pozicione drejtuese janë 6 gra/30 (17%). Krahasuar me 2010 numri i grave drejtuese është rritur nga 4-7 (6%).

97. Trupi mësimor shkencor efektiv në arsimin e lartë:

Titujt	Profesorë		Doktorë		Docentë dhe pedagogë pa tituj	
	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra
2010-2011	73	27	44	56	43	57
2011-2012	74	26	52	48	40	60
2012-2013	71	29	53	47	38	62
2013-2014	61	39	49	51	18	82

Neni 8

Përfaqësimi i grave në arenën ndërkombëtare

98. Numri i grave deputete në delegacionet e përhershme parlamentare në Parlamentin Evropian është: 14 anëtarë delegacioni/2 gra; Asamblea Parlamentare e OSBE-së-3 anëtarë/ kryetarja është grua; Asamblea Parlamentare e NATO-s 4 anëtarë/1 grua; Asamblea Parlamentare e KiE 4 anëtarë/1 grua, kryetare e delegacionit; Unioni Ndërparlamentar-9 anëtarë/2 gra; Asamblea Parlamentare për Bashkëpunimin e Evropës Perëndimore-2 anëtarë/1 grua; Delegacioni i përhershëm “Iniciativa e Evropës Qendrore”- 3 anëtarë/1 grua; Delegacioni i Asamblesë Parlamentare Euro-Mesdhetare-2 anëtarë/1 grua; Asamblea Parlamentare e Frankofonisë- 2 anëtarë/1 grua.

99. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) përqindja e grave diplomate është rritur nga 28% (2010) në 36% (2014), në përfaqësitë diplomatike është rritur nga 47.8% (2010) në 50.4% (2014). Prej 2010 është rritur numri i grave në postet drejtuese të MPJ në 10 gra. Në vitin 2014 në poste drejtuese janë 7 gra. Nga 55 përfaqësi diplomatike, 11 drejtohen nga ambasadore femra.

100. Në Forcat e Armatosura (2011), pjesëmarrëse në operacione ndërkombëtare ishin 8 gra. Për herë të parë, çështjet e BGJ kanë zënë vend në Direktivën e Mbrojtjes (2012) ku theksohet edhe përfshirja e grave në stërvitje të përbashkëta (brenda/jashtë vendit), misionet dhe operacionet e pages, sektorë të tjerë të sigurisë, shpërndarja e drejtë e kurseve, kualifikimeve, shpërndarja më e barabartë e gradave burra/gru, shmangia e roleve tradicionale të grave, përfshirja

në çdo funksion, në përputhje me specialitetin, arsimin, gradën.

Neni 9

101. Legjislacioni shqiptar mbi shtetësinë e grave dhe fëmijëve të tyre është tërësisht në përputhje me nenin 9 të Konventës.

Neni 10

Legjislacioni, politikat, masat

102. Kuadri ligjor garanton të drejtën për arsimim shtetasve shqiptarë, të huaj, personave pa shtetësi, pa diskriminim gjinie race, ngjyre, etnie, gjuhe, orientimi seksual, bindjet politike, fetare, gjendja, ekonomike, sociale, mosha, vendbanimi, aftësitë e kufizuara, arsye të tjera. Programi i shkollimit është i njëjtë për të dyja gjinitë, jepen mundësi të barabarta për bursa, ndihmë, konkretisht:

- Ligji nr. 69/29.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar” vendosi standarde bashkëkohore, gjithëpërfshirëse në arsimin parauniversitar shqiptar, sipas parimeve/praktikave të vendeve të BE-së.

- Hartimi i planeve mësimore dhe 37 programeve lëndore fëmijët e ngujuar⁷³ (udhëzimi nr. 36/13.8.2013 “Për procedurat për arsimimin e fëmijëve të ngujuar”; udhëzimi nr. 29/2013 “Për procedurat e ndjekjes së arsimit bazë me kohë të pjesshme”). U hartuan planet mësimore, 37 programe lëndore për

- Udhëzimi nr. 38/13.08.2013 “Për arsimin e individëve të moshës shkollore në institucionet e përkujdesjes shoqërore”, institucionalizon raportet/procedurat për arsimimin e fëmijëve të këtyre institucioneve.

- Bazuar në Dispozitat Normative⁷⁴, në drejtoritë arsimore rajonale dhe zyrat arsimore janë ngritur dhe funksionojnë komisionet multidisiplinare për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara.

- Udhëzimi nr. 21/8.8.2014 “Për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë”. Fëmijët romë përjashtohen nga pagesa e depozitës së garancisë në Tiranë, nga pagesat e bordeve të

⁷³ Për 2013-2014 në Shkodër janë 4 nxënës të ngujuar (3 vajza) për ciklin e ulët, 10 nxënës (5 vajza) në ciklin e lartë, 13 nxënës (7 vajza) në arsimin e mesëm. Malësia e Madhe ka 2 nxënës të ngujuar.

⁷⁴ Urdhi i Ministrisë të Arsimit nr. 343/2013.



prindërve romë në të gjithë vendin. Drejtoritë/zyrat arsimore shohin me përparësi sigurimin e transportit për fëmijët romë të moshës parashkollore.

- Udhëzimi nr. 34, datë 30.09.2014 “Për kriteret, procedurat e përzgjedhjes, regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbrit, të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të jetimit, romët dhe egjiptianët, në programet e ciklit të parë të studimeve me kohë të plotë, në programet e studimeve jouniversitare profesionale, në programet e integruara të studimeve të ciklit të dytë, në institucionet publike të arsimit të lartë (2014 – 2015)”.

- Udhëzimi nr. 38 datë 07/10/2014, “Për kriteret e punësimit të mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuar në institucionet publike të arsimit parauniversitar”. Risi caktimi i mësuesit ndihmës për fëmijët me nevoja të veçanta në shkollat e zakonshme.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 29.10.2014 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa, konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve e të studentëve, në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2014 - 2015” trajton me përparësi nxënësit/studentët nga shtresat në nevojë, me prioritet vajzat.

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 709/5.10.2011 “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e mësuesve dhe të nxënësve që punojnë e mësojnë jashtë vendbanimit” mbulohen shpenzimet për transportin e mësuesve (distanca mbi 5 km nga vendbanimi kthimi brenda ditës), për nxënësit (distanca mbi 2 km).

- Strategjia Kombëtare e Sporteve 2008-2013, inkurajon pjesëmarrjen e grave në aktivitetet sportive, bordet drejtuese sportive, zgjedhjen e femrave në borde në kuotën prej 30% të anëtarëve.

103. Sigurimi i shërbimit arsimor cilësor për të gjithë nxënësit e moshës së detyrimit shkollor, rritja e numrit të nxënësve/studentëve në arsimin e mesëm dhe universitar, është objektiv i MAS. Gjatë 2011-2012 braktisja e femrave ishte 0.40% (kundrejt 0.45% e një viti më parë); në arsimin e mesëm u regjistruan 91% e nxënësve që përfunduan arsimin 9-vjeçar (47% vajza).

- Në zbatim të “Planit Kombëtar për braktisjen zero 2009-2013”, jepet përparësi arsimimit të nxënësve të moshës së detyrimit shkollor të grupeve në nevojë, fëmijëve romë, egjiptianë, fëmijëve me aftësi të kufizuara, mbështetjes së

vajzave të këtyre grupeve. Nga 2010 MAS po krijon bazën e të dhënave të arsimit për nxënësit romë, egjiptianë; me aftësi të kufizuara; sipas gjinisë, vendndodhjes, kategorisë së paaftësisë, me qëllim marrjen e masave konkrete.

MAS ka ndërmarrë politika subvencionimi të teksteve shkollore për nxënësit e grupeve në nevojë. Nga kompensimi i blerjes së teksteve shkollore, përfitojnë rreth 120 mijë nxënës (50% vajza)⁷⁵. Prej vitit 2011 fëmijët romë në arsimin e detyruar i marrin tekstet shkollore falas në shkollën ku janë të regjistruar. Në 2012, u pajisën 3231 nxënës; 2013, 3370 nxënës.

- MAS ka hartuar 27 programe për pakicat kombëtare, ka ndërtuar platforma të veçanta pune për ngritjen e shërbimit psiko-social në njësitë arsimore vendore për nxënës djem/vajza; krijimin e profesionistëve të mirëfilltë të arsimit special. Në kurrikulat universitare (programet 3-vjeçare, master) përfshihen leksione, kapituj të veçantë për arsimin special në fakultetet e mësuesisë; janë krijuar degë mbështetëse për aftësinë e kufizuar pranë Fakultetit të Mjekësisë.

Niveli i edukimit

104. Të dhënat e Censurit 2011 tregojnë tendencë rritëse të nivelit arsimor të popullsisë, sidomos tek femrat. Arsimi parashkollor (3-5 vjeç). Nga 2010-2011 deri në 2013-2014, përqindja e vajzave në kopshte është 47.1% dhe regjistrimi i tyre për 2013-2014 është 47.6% (rritur me 0.5%). Udhëzimi nr. 21/2014 i Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve (MAS) për rritjen e ndjekjes së arsimit parashkollor nga fëmijët romë, trajton me përparësi regjistrimet e tyre në kopshte, i përjashton nga detyrimet financiare dhe krijon lehtësi në ndjekjen e kopshtit pranë zonave të tyre të banimit.

105. Nxënësit (në mijë) në shkolla:

Programi	2008 - 2009		2010-2011		2012-2013		2013-2014	
	meshkuj	femra	meshkuj	femra	meshkuj	femra	meshkuj	femra
Mesëm	51	49	54	46	54	46	52.5	47.5
Cikli 9-vjeçar	51	49	52	48	52	48	52.7	47.3
Fillor	52	48	53	47	53	47	52.6	47.4

106. Arsimi i lartë. Në fakultete të ndryshme, raporti femra-meshkuj është i ndryshëm. Femrat në arsimin me kohë të plotë, kohë të pjesshme, për

⁷⁵ Sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107/10.02.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen, shitjen e teksteve shkollore, të sistemit arsimor parauniversitar”, ndryshuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 212/16.3.2011.



2012-2013 55.7%; 83.6% të studentëve në edukim; 69% në shëndetësi; 65.3% në shkencë humanitare dhe arte; 49.7% në shkencë natyrore; 55.8% në shkencë sociale, biznes, drejtësi.

Femra të diplomuara gjatë 2012-2013 janë: 64% cikl I (bachelor); 66.6% master profesional; 71.4% master shkencor.

107. Niveli arsimor i popullsisë mbi 25 vjeç (%)

Grupmoshat	25-39		40-64		mbi 65	
	meshkuj	femra	meshkuj	femra	meshkuj	femra
S'kanë ndjekur asnjëherë shkollën	3	2	2	2	7	21
Arsim fillor	2	2	4	8	34	44
Arsim 9-vjeçar	45	49	40	47	28	22
Arsim i mesëm	34	36	42	34	19	10
Arsim i lartë	15	21	12	10	11	3

108. Aftësia e lexim-shkrimit e personave mbi 15 vjeç rezulton 98.4% për meshkujt, 96.1% për femrat.

109. Mësueset femra përbëjnë mbi 61% në arsimin e mesëm; mbi 70% në arsimin 9-vjeçar. Gra mësuese në qytet -61.6% (2009-2010); 62.2% (2010-2011); 62.5% (2011-2012). Në zonat ruralet 51.1%, 51.9%, 53% (2010, 2011, 2012). Në arsimin e lartë, dy vitet e fundit femrat docente, pedagogë pa tituj janë në numër më të madh⁷⁶.

110. Arsimimi i PAK. Sipas Censurit 2011, 55,6% e popullsisë mbi 15 vjeç me aftësi të kufizuar kanë përfunduar arsimin bazë; 3,3% arsimin e lartë, pasuniversitar; 24,3% nuk e kanë ndjekur asnjëherë shkollën. 1,9% e popullsisë mbi 15 vjeç që kanë ndjekur/janë duke ndjekur shkollën janë pa diplomë, (59,6% femra). Ky kufizim rritet me rritjen e moshës. Për 2013-2014 në shkallë vendi, janë regjistruar 2410 fëmijë në kopshte, shkolla normale të arsimit parauniversitar 1013 fëmijë me paaftezi mendore; 465 fizike; 298 pamore; 126 dëgjimore; 505 fëmijë autikë). Në ndërtimin, rehabilitimin e infrastrukturës shkollore po krijohen mundësitë për të lehtësuar përfshirjen kopshte, shkolla të fëmijëve me aftësi të kufizuara.

Eliminimi i diskriminimit në arsim

111. MAS punon vazhdimisht për rishikimin e kurrikulave, teksteve nga këndvështrimi gjinor, eliminimin e qëndrimeve përjashtuese, inferiore ndaj vajzave, eliminimin e diskriminimit të tërthortë.

- Integrimi gjinor. Programi “Arsimi universitar” përfshin nxitjen/aplikimin e kuotave

për të sjellë vajzat/ djemtë në degë studimi jotradicionale. Në universitetet publike të vendit janë rishikuar kurrikulat e përgatitjes fillestare të mësuesve. Në degët e Shkencave Sociale dhe Mësuesisë zhvillohen lëndë, module të veçanta për BGJ, programe të veçanta studimi të përgatitjes së nëpunësve gjinorë në nivelin “Bachelor”, “Master”. Në 2012 filluan studimet në Shkollën Bazë të Policisë 20 kursantë (50% gra). Në dhjetor 2013, u rihap konkurrimi për Shkollën Bazë të Policisë “Patrullë e Përgjithshme”, pati 10.000 aplikime (1400 gra), u finalizuan 1000 aplikues (500 gra). Gjatë 2012 për Forcat e Armatosura nën uniformë, 596 aplikantë (46 gra ose 7.71%), fituan 30 gra 11.2%, me arsim të lartë 26.6%. Për 2013, 560 aplikantë (41 gra -7.32%), fituan 8 gra (5.6%), 50% me arsim të lartë.

- Në sporte: Prej 2009, Federata Shqiptare e Futbollit organizon kampionatin e Futbollit për femra (10 ekupe). Është krijuar ekipi përfaqësues i Shqipërisë në futbollin për femra (2011), hartohet projekti për përfshirjen e futbollit edhe për femrat në sistemin arsimor fillor. Prej 2010 organizohet “Festival Graff Roots” (6 qytete, pjesëmarrës 400-500 fëmijëve/të rinj, ekupe meshkuj/femra/mikse). Femrat përfshihen në kampionatet kombëtare në basketboll, volejbol, not, shah, në poste drejtuese (federatat e notit, të shahut, gjimnastikës, karatesë).

- Gjatë 2011, u rishikuan 96 kurrikulave lëndore (klasa 1-9): lënda gjuhë shqipe, lëndët shoqërore, artistike, sportive, për tematikat mbi historinë, kulturën rome. Rreth 300 mësues (Korçë, Gjirokastrë) janë informuar për integrimin e gjuhës, kulturës, traditës rome dhe egjiptiane në kurrikulat e arsimit bazë. Hartimi dhe botimi i paketës së moduleve (manuali) “Historia, kultura rome dhe përfshirja e saj në kurrikulën shkollore”. Funksionon Departamenti i Gjuhëve Sllave, Ballkanike pranë Universitetit të Tiranës, Departamenti i Gjuhës, Letërsisë, Qytetërimit Grek pranë Universitetit të Gjirokastrës.

- Sipas udhëzimit nr. 40/13.10.2014 “Kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes, regjistrimit për kandidatët me statusin e të verbrit, invalidit paraplegjik/tetraplegjik, të jetimit, rom, egjiptian në programet e ciklit I-rë të studimeve me kohë të plotë”, kandidatët mund të aplikojnë direkt në MAS, për 65 kuotat për 2015.

⁷⁶ Referim neni 7.



Neni 11

112. Legjislacioni shqiptar ndalon diskriminimin në fushën e punësimit, veprimtarisë profesionale dhe përfitimeve nga sigurimet shoqërore. Kushtetuta, Kodi i Punës, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, LBGJ, etj. përfshijnë parimin e mosdiskriminimit, të barazisë e të trajtimit të barabartë si për burrat dhe gratë në marrëdhëniet e punësimit, shpërbllimit të barabartë.⁷⁷ Ndryshimet në ligjin nr. 7703/11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH” me ligjin nr. 104/31.7.2014, parashikojnë:

- Rritjen graduale të moshës së daljes në pension për gratë me dy muaj në vit, për të arritur në 63 vjeç 2032. Në 2032 moshë e daljes në pension për burrat do të rritet me një muaj në vit dhe për gratë me dy muaj në vit duke synuar barazinë e moshës për të dyja gjinitë në 67 vjeç, në vitin 2056⁷⁸. Përmirësimin e mënyrës së llogaritjes së pensioneve për nënat me shumë fëmijë, pensionet familjare, duke përcaktuar si moshë për përfitimin e pensionit nga bashkëshortët, moshën e daljes në pension.

- Ngritjen e skemave profesionale që i japin mundësinë çdo personi të kontribuojë për rritjen e të ardhurave në pleqëri.

- Të drejtën e babait për të marrë kujdes fëmije të pagueshëm, nëse këtë të drejtë nuk e ushtron, nuk ka kushte për ta përfituar nëna.

- Pas 2015 e ardhura për barrë lindje për gratë e siguruara si të vetëpunësuar në bujqësi të llogaritet bazuar në pagën mbi të cilën janë paguar kontributet, që është e njëjtë si në qytet.

1. Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” aktet nënligjore në zbatim, bazuar në parimet e shanseve të barabarta, mosdiskriminimit, profesionalizmit, transparencës, qëndrueshmërisë.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave nr.143/12.3.2014 “Për procedurat e rekrutimit, përzgjedhjes, periudhës së provës, lëvizjes paralele

e ngritjes në detyrë për nëpunësit civilë të kategorisë ekzekutive, të ulët, të mesme drejtuese”.

Rishikimi i Kodit të Punës në proces

113. Prej 2010 MMSR-ja punoi duke zgjeruar rrethin e aktorëve, reflektoi vërejtjet/rekomandimet e Komitetit të Ekspertëve të ILO-s, Komitetit Evropian të të Drejtave Sociale për përafrimin me *acquis communautaire*, ka marrë në konsideratë rekomandimet e Komitetit CEDAW për barrën e provës mbi ngacmimin seksual. Për gratë dhe barazinë gjinore, draft-kodi parashikon: zëvendësimin e termit “seks” me “gjini”; shton si shkaqe të mosdiskriminimit edhe orientimin seksual, identitetin gjinor; parashikon masa për gratë shtatzëna, nënat me fëmijë në gjii.

114. Për shqetësimin seksual në vendin e punës LBGJ, ligji për mbrojtjen nga diskriminimi parashikojnë rregulla, sanksione të veçanta. Draft-Kodi i Punës për këtë çështje synon përputhjen e përkufizimit të shqetësimit seksual me atë të direktivës së BE mbi trajtimin e barabartë. Lidhur me barrën e provës parashikon: “Kur çështja paraqitet për shqyrtim në gjykatë dhe paditësi paraqet fakte nga të cilat mund të pretendohet se është diskriminuar, i padituri duhet të provojë se nuk është shkelur parimi i trajtimit të barabartë, apo se ka pasur cenim të parimit të trajtimit të barabartë.”

Tregu i punës-punësimi

115. Sipas të dhënave të Anketave së Forcave të Punës (AFP) 2012, 2013 të punësuar gjithsej në 2012 ishin: 1.117 mijë persona; 2013 ishin 1.024 mijë, ku femrat përbënin respektivisht 43,9% dhe 45%. Shkalla e punësimit për femrat në moshë 15-64 vjeç ishte 49,5% (2012); 43,1% (2013). Për meshkujt respektivisht 63,2%, 57,3%. Nga analiza sipas sektorëve të ekonomisë, në sektorin privat jo-bujqësor, të punësuarit meshkuj përbëjnë 69,2 % (2012); 66,6% (2013). Në sektorin privat bujqësor femrat përbëjnë 54% (2012); 54,4% (2013). Në sektorin shtetëror, femrat përbëjnë 43,9% (2012); 48% (2013). Analiza e punësimit sipas grup-profesioneve (2012) tregon se për disa grup-profesione ka diferenca të dukshme në punësimin e meshkujve dhe femrave. Në grupin e ligjvënësve, nëpunësve të lartë dhe drejtuesve: 14,6% janë femra dhe 85,4% meshkuj. Në grup-profesionet “Punëtorë të shërbimeve, shitblerjeve dhe dyqaneve” femrat përbëjnë 37,7% të të punësuarve ndërsa meshkujt 62,3%. Në Shëndetësi dhe Arsim

⁷⁷ Kuadri i plotë ligjor mbi këtë nen është dhënë në Raportin III.

⁷⁸ Bazuar mbi analizën e ndryshimeve demografike, faktit që, për shkak të nivelit më të lartë të jetëgjatësisë, femrat gëzojnë pension më gjatë, në disbalancë me raportin e shumës së kontributeve të paguara shumës së përfituar si pension. Rritja graduale e moshës së daljes në pension për gratë do të ulë shpenzimet për pension, do të shmangë diskriminimin e deritanishëm, në plotësim të rekomandimeve të BE dhe harmonizim me vendet e tjera të rajonit dhe Europës.

femrat zënë peshën më të madhe të të punësuarve përkatësisht 66,9% dhe 68,3% (2012) dhe 68,2% dhe 72,4% (2013). Në ndërtim, transport telekomunikacion meshkujt përbëjnë 92,8 % dhe 87,7 % të të punësuarve (2012); 97,3% dhe 80,5% (2013).

Papunësia

116. Sipas AFP 2012 rezultojnë të papunë 173.420 persona, 38,8% femra; 2013 rezultojnë 194 mijë persona, (37,2% femra). Shkalla e papunësisë për femrat e grupmoshës 15-29 vjeç është 21,4%; për grupmoshën 30–64 vjeç është 9,7%, respektivisht 23,6%, 11,2%. (2013). Shkalla e papunësisë për meshkujt e grupmoshës 15-29 vjeç është 27,4%, për grupmoshën 30-64 vjeç është 10,2% (2012), respektivisht 29,7%, 14,6% (2013).

Politikat për punësimin e grave

117. Politikat e punësimit për 2010-2013 fokusoheshin në zhvillimin e tregut të punës, nxitjen e punësimit, si komponentët kryesorë të politikave shtetërore për rritjen e nivelit të punësimit, reduktimin e varfërisë. (Strategjia Kombëtare e Punësimit dhe Formimit Profesional, 2007- 2013).

PuPa të punësuar:

Vitet	2010	2011	2012	2013	Qershor 2014
Gjithsej	12.317	12.748	12.965	12.241	8865
Femra në % ndaj totalit	51.5	48.3	55.0	50.1	50.2

Nëpërmjet këshillimit dhe orientimit për profesion dhe punësim, u kushtohet kujdes grupeve të veçanta, të përcaktuara në ligj dhe në akte nënligjore, si dhe duke respektuar BGJ.

PuPa që përfitojnë këshillim/orientim për profesion dhe punësim:

Vitet	2010	2011	2012	2013	Qershor 2014
PuPa (në mijë)	143	142	141.8	144.4	143.3
Femra (në mijë)	72.9	73.8	73.00	74.6	73.5

Nga analiza e shkallës së papunësisë në vite sipas gjinisë, megjithëse diferenca mes meshkujve dhe femrave ka ardhur duke rënë, tregu i punës reflekton pabarazi gjinore në punësim. Të dhënat administrative për papunësinë tregojnë se kjo diferencë ishte mesatarisht 5% (2000-2010), 3% (2011). Në 2013 shkalla e papunësisë sipas gjinisë është 9,3% për meshkujt; 13,7 % për femrat. Gjatë 2010-2013, papunësia është rritur tek meshkujt, ulur tek femrat.

118. Qeveria në programin 2013 – 2017 fokusohet te punësimi, zhvillimi cilësor i forcës së punës, në përputhje me vizionin, direktivat e BE, Strategjisë Europiane 2020, kriterëve për integrimin evropian të Shqipërisë. Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësitë 2014-2020 (në proces miratimi) synon identifikimin, hartimin e politikave nxitëse të punësimit dhe formimit profesional të forcës së punës, për hapjen e vendeve pune cilësore, mundësi për aftësi, gjatë të gjithë ciklit të jetës, mundësi PuPa të formohen profesionalisht, punësohen.

A) Politikat aktive:

Ndërmjetësimi për punë, Këshillimi dhe orientimi për profesion dhe punësim

119. Gjatë periudhës 2010-qershor 2014 të punësuarit nëpërmjet ndërmjetësimit nga Shërbimi Kombëtar i Punësimit (SHKP) në shkallë vendi janë rreth 12 mijë persona (mesatarisht 50% femra).

120. Programet e nxitjes së punësimit:

Po zbatohen 6 programe:

- “Programi i nxitjes së punësimit nëpërmjet formimit në punë”⁷⁹ mbështet PuPa në marrjen e profesionit në vendin e punës, mundësinë e punësimit në të njëjtin subjekt.

⁷⁹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 47/16.01.2008, i ndryshuar.



- “Programi i nxitjes së punësimit të PuPa në vështirësi⁸⁰”: PuPa punësohen për 12 muaj, duke siguruar mbështetjen për punësimin e plotë të tyre.

- Programi “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programeve të praktikave profesionale për PuPa, që mbarojnë arsimin e lartë, brenda apo jashtë vendit”⁸¹ siguron marrjen e praktikës profesionale në ambientet e punës, ku studentët aftësohen, përfitojnë shkathtësitë e profesionit të studiuar.

- “Programi i nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr.27/11.1.2012, i ndryshuar, mbështet financiarisht punëdhënësit që punësojnë PuPa femra nga grupet e veçanta për një periudhë 1 vjeçare, duke ofruar 100% financim sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore të pjesës së punëdhënësit dhe 4 paga mujore minimale gjatë periudhës së programit.

- Programi i nxitjes “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të PuPa të rinj”; Mbështetja dhe orientimi i PuPa të grupmoshës së re nga 16-30 vjeç, për punësimin⁸².

- “Programi i nxitjes së punësimit të personave me aftësi të kufizuar”, vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 248/30.4.2014: punëdhënësi që punëson me kontratë me kohëzgjatje njëvjeçare PuPa PAK, përfiton financim për një vit në masën 100%, të sigurimeve të detyrueshme shoqërore të pjesës së punëdhënësit; financim për 6 muaj, në masën 100% të pagës minimale në shkallë vendi, 6 muaj 50% të pagës minimale në shkallë vendi; financim për përshtatjen e vendit të punës për PAK (përshtatja e arsyeshme); përgatitje thelbësore për punën deri në masën 100.000 lekë, jo më shumë se 200.000 lekë, nëse punëson më shumë se dy persona.

121. Numri i pjesëmarrësve në këto programe

Vitet	2010	2011	2012	2013	6-mujori I-rë 2014
PuPa gjithsej	1757	1170	919	834	3078
Femra (rreth 70%)	1229	757	658	521	2155

122. Programet e nxitjes së punësimit financohen plotësisht nga buxheti i shtetit, me fonde që i alokohen MMSR çdo vit. Për periudhën 2010-2013 fondet ishin të limituara (90 milion lekë çdo vit; 2014 janë trefishuar 270 milion lekë.

3-Programi i formimit profesional

123. Qeveria mbështet krijimin e kapaciteteve për formim profesional në sasi, cilësi, nëpërmjet zhvillimit të sistemit të arsimit, formimit profesional publik, i cili në kuadër të reformave të ndërmarra aktualisht, kalon nën përgjegjësinë e MMSR-së, duke formuar një sistem unik. Kjo qasje do të kontribuojë në zhvillimin e aftësimin cilësor profesional të forcës së punës, me fokus të rinjtë, gratë, grupet në nevojë.

124. Formimi profesional mundëson integrimin, riintegrimin në tregun e punës të PuPa, nëpërmjet 10 qendrave të punësimit, formimit profesional (QPFP), (njëra prej tyre është qendër e lëvizshme. QPFP ofrojnë kurse të afat-shkurtra (4-6 javë), afatgjata (deri në shtatë muaj), kryesisht për individët e papunë (të regjistruar në SHKP ose jo), janë të hapura edhe për punëtorët dhe studentët, në varësi të nevojave të tyre për kualifikim. Deri nëntor 2013 është aplikuar reduktimi i tarifës së regjistrimit prej 50%, për PuPa të regjistruar në zyrat e punësimit; tarifa falas për grupet në nevojë (romë, jetimë, PAK, vajzat/gratë e trafikuar, personat që kanë vuajtur dënimin me burgim). Nga dhjetori 2013 tarifa falas aplikohen për gjithë PuPa, bazuar në urdhrin e Ministrit (MMSR) nr. 286/16.12.2013 “Për tarifat e sistemit të formimit profesional publik”. Në vitin 2012 numri i individëve që ndoqën kurse në QPFP ishte 25% më i lartë se 2009. Afërsisht 54.5% e pjesëmarrësve ishin të rinj të moshës nën 25 vjeç; mbi 53% ishin femra.

⁸⁰ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 48/16.01.2008 i ndryshuar: Të papunët afatgjatë, personat që përfitojnë ndihmë ekonomike; personat që përfitojnë pagesë papunësie; personat që hyjnë për herë të parë në tregun e punës (18-25 vjeç), personat mbi 45 vjeç me arsimi i mesëm, ekuivalent të tij, PAK, personat nga komuniteti rom, emigrantët e kthyer me probleme ekonomike.

⁸¹ Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 873/27.12.2006, i ndryshuar.

⁸² Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 199/11.01.2012 i ndryshuar.



Numri i të certifikuarve në QPFP

Vitet	2010	2011	2012	2013	Qershor 2014
Gjithsej	8485	8531	8357	8884	5212
Femra	4515	4751	3798	3898	2503
PuPa	911	1041	1045	1119	893

B) Programet pasive të tregut të punës /programi i pagesës së papunësisë

125. Sigurojnë mbështetjen me të ardhura të të papunëve në momentin e daljes së tyre si të tillë, duke synuar krijimin e kushteve për rikthimin e tyre në tregun e punës. Në 2013 është shënuar numri më i vogël i përfituesve në 14 vitet e fundit ndërkohë që numri total i PuPa për këtë vit ka qenë në rritje. Ky fakt përforcon konstatimin, që rritja e numrit të PuPa të regjistruar ka ardhur si rezultat i promovimit të fortë të bërë kohëve të fundit për shërbimet që ofrohen, hapjes së zyrave të reja moderne të punës.

PuPa në pagesë papunësie

Vitet	2010	2011	2012	2013
Gjithsej	9265	9367	8861	7887
Femrat në %	51	50	49	49
Meshkujt në %	49	50	51	51

E drejta për shpërblim të barabartë

126. Legjislacioni shqiptar nuk është diskriminues, mbi shpërblimin e barabartë midis burrit dhe gruas, pagat caktohen për vende pune, pa dallim gjinie. Duke pasur parasysh rëndësinë e parimit të shpërblimit të barabartë për punë me vlerë të barabartë, është punuar për përmirësimin e legjislacionit ekzistues për zbatimin e këtij parimi. Në Draft-Kodin e Punës mbi këtë parim janë bërë disa propozime për ndryshime.

127. INSTAT-i, në bashkëpunim me MMSR-në,⁸³ prezantuan (dhjetor 2011) studimin “Për përdorimin e kohës 2010-2011 në Shqipëri”, mbi punën e papaguar të grave. Nga studimi rezultoi se femrat kalojnë shumë më tepër kohë duke kryer punë të papaguar, për sa i përket numrit të orëve, minutave, përqindjes të personave që kryejnë punë të papaguar në një ditë mesatare. Lidhur me punën e paguar dhe të papaguar (puna totale), kontributet e grave në kohë e tejkalojnë kontributin e burrave me afërsisht dy orë/ në një ditë mesatare. Grupi i vetëm që shpenzon më shumë orë në punë totale është ai i femrave në zonat rurale.

Sigurimet shoqërore

128. Skema e sigurimit vullnetar⁸⁴ si pjesë e sigurimit shoqëror të detyrueshëm u krijua për të ofruar mundësinë, zgjeruar hapësirën e mbulimit me sigurim shoqëror të personave që për shkak të ndryshimeve pas viteve 90 mbetën pa punë (pavarësisht përkatësisë së gjinore). Sigurimi vullnetar është një mundësi për mbulimin, plotësimin e periudhave të prapambetura me sigurim shoqëror, si për gratë shtëpiake apo ato që në një moment të caktuar dalin papunë, edhe për gratë shqiptare në emigracion, që në përqindje të lartë punojnë në tregun informal të punës. Në funksion të mbulimit me sigurim vullnetar, janë zhvilluar edhe fushata ndërgjegjëse.

Marrëveshjet dypalëshe

129. Vazhdon bashkëpunimi me shtetet fqinje, si Italia për përfshirjen e emigrantëve shqiptarë në skemën e sigurimit vullnetar, informimin e tyre mbi periudhat kontributive në Shqipëri. Në kuadër të detyrimeve që burojnë nga MSA-ja me BE-në, aderimit në instrumentet ligjore ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes shoqërore, rregulloreve nr. 1408/71; nr. 883/2004 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, MMSR-ja ka intensifikuar përpjekjet për zgjerimin e procesit të koordinimit të skemave të mbrojtjes shoqërore, në mbrojtje të të drejtave të emigrantëve shqiptarë jashtë vendit dhe shtetasve të huaj në Shqipëri (pavarësisht përkatësisë gjinore). Aktualisht është miratuar marrëveshja dypalëshe për mbrojtjen shoqërore me Belgjikën. Janë në proces negociimi marrëveshja me Luksemburgun, me Maqedoninë, me Hungarinë, me Çekinë, me Rumaninë dhe me Kanadanë.

Siguria dhe shëndeti në punë

130. Në Kodin e Punës janë parashikuar rregulla të veçanta për mbrojtjen e gruas punëtore lidhur me punët e rënda. Nuk ka parashikime ligjore që ndalojnë punën e natës për gratë. Ndalohet puna e

⁸⁴ Në ligjin nr. 7703/11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), neni 3 “Sigurimi shoqëror vullnetar” dhe rregulloren nr. 4/25.5.2009 “Për sigurimin vullnetar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore” përcaktohen rastet se kur personat kanë të drejtë të bëjnë sigurimin vullnetar, përfitimet dhe mënyrat e realizimit. Të drejtën për të bërë sigurim vullnetar e gëzon shtetasi shqiptar që banon brenda apo jashtë territorit të RSH-së që ka mbushur moshën 18 vjeç.

⁸³ Mbështetur nga SIDA, UNFPA dhe UN WOMEN.



natës vetëm për gratë shtatzëna. Me rishkrimin e Kodit është propozuar ndryshimi në përputhje me nenin 6 të Konventës nr. 171 “Për punën natën 1990”, për përjasje më të përgjithshme për mbrojtjen e grave gjatë, pas shtatzënisë.

131. Ligji nr. 10237/18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” përcakton: kur ekspozimi ndaj agjentëve të rrezikshëm, proceseve apo kushteve të punës përbën një rrezik për sigurinë, shëndetin apo ka efekt mbi shtatzëninë dhe ushqimin e fëmijës më gj, punëdhënësi duhet të marrë masa për eliminimin e rrezikut ose të përshtatë vendin e punës.

Në zbatim të tij, në rregulloret e të gjitha ministrive, ku përfshihet dhe siguria e shëndeti në punë, janë parashikuar dispozita të veçanta për mbrojtjen e gruas, grave shtatzëna dhe nënave me fëmijë në gj.

132. Gjatë muajit qershor 2014, është punuar për hartimin e draft-vendimi i Këshillit të Ministrave që transponon direktivën e Këshillit 92/85 EEC-ja “Mbi paraqitjen e masave për të inkurajuar përmirësimin e sigurisë dhe shëndetit në punë për punëtorët shtatzëna dhe punëtorët të cilat sapo kanë lindur ose janë me fëmijë në gj”⁸⁵, ku përcaktohen masat dhe standardet minimale që duhet të ndërmerren. Në të gjitha marrëveshjet kolektive të punës në nivel degë-profesioni, të depozituara në MMSR janë referencat ligjore përkatëse për mbrojtjen e grave shtatzëna dhe nënave me fëmijë në gj.

Inspektimet në punë – puna informale

133. Inspektoriati Shtetëror i Punës (ISHP) (në 12 degë rajonale), ushtron kontroll në subjektet ekonomike të licencuara në territorin e RSH-së, mbi zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi, duke përfshirë: marrëdhëniet, kushtet, sigurinë në vendin e punës. Nga kontrollet/rikontrollet në subjektet private në ekonominë formale (që raportohet në tatim-taksa për procedura të mëtejshme) rezulton:

Për periudhën 2010-2014 janë evidentuar: 4491 punëmarrës të pasiguruar (45% femra) në 54,524 subjekte të kontrolluara me 567,631 punëmarrës.

Nga një këndvështrim i shkurtër vihet re se punojnë të pasiguruar më shumë punëmarrës

meshkuj (73%) sesa femra (37%). Në ndërmarrjet prodhuese janë 67.6% punëmarrëse femra të pasiguruara.

Neni 12

134. Legjislacioni shqiptar nuk është diskriminues në fushën e kujdesit shëndetësor dhe garanton, mbi bazën e barazisë së burrit dhe gruas, të drejta, mundësi për të përfituar shërbime mjekësore, shërbime të planifikimit familjar.

Është licencuar ofrimi i shërbimeve shëndetësore nga sektori privat për: laboratorë (mikrobiologjikë, klinik-biokimik, gjenetik, dentar, optik), kabinete mjekësore, klinika/kabinete stomatologjie, qendra mjekësore, shërbime të tjera kurative, shërbime ekspertizë dhe ndërhyrëse higjeno-sanitare, shërbim spitalor, prodhim, tregtim me shumicë i barnave.

Masat ligjore dhe politikat

135. Ndryshimet në ligjin “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit” (76/2014), ligji “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik” (105/2014), ligji “Për pajisjet mjekësore” (89/2014), ligji “Për Urdhrin e Mjekëve” (123/2014), ndryshimet në ligjin “Për Urdhrin e Infermierit” (124/2014), ligji “Për Urdhrin e Stomatologut” (127/2014) etj., ndikojnë në përmirësimin e kujdesit shëndetësor për gruan dhe pse nuk e targetojnë specifikisht atë. Vlen të evidentojmë zbatimin e strategjive kombëtare për: “Sigurimin e kontraceptivëve”, “Parandalimin e HIV/AIDS”, “Shëndetin publik dhe promocionin shëndetësor”, “Zhvillimin e sistemit shëndetësor shqiptar (strategji afatgjatë)”; “Transfuzion gjaku të sigurt”, “Menaxhimin e sëmundjeve të lindura të gjakut”, “Parandalimin dhe minimizimin e dëmeve alkool-lidhura (2011-2015)”; Planin e Veprimt për Zhvillimin e Shërbimeve të Shëndetit Mendor 2013 – 2022, etj. Për periudhën 2010-2014, buxhetit i shëndetësisë është rritur çdo vit me 7%.

Në kuadrin e fushatës kundër korrupsionit në shërbimin spitalor (2014-2015), me urdhr të Ministrit nr. 421/1.10.2014 “Për mbikëqyrjen e institucioneve të kujdesit shëndetësor” janë ngritur 6 grupe monitorimi dhe mbikëqyrjeje.

Përmirësimi i kujdesit shëndetësor për gratë

136. Kujdesi parësor i shëndetit të gruas në zonat urbane, ofrohet përmes konsultoreve të gruas, që sigurojnë shërbimet kryesore parandaluese dhe kontrollin e sëmundjeve,

⁸⁵ Me asistencën e ILO-s, në kuadër të projektit IPA 2010, Faqe|10198



promovimin shëndetësor, shëndetin riprodhues, planifikimin familjar, kujdesin antenatal dhe postnatal të nënës, ushqyerjen, parandalimin e HIV/AIDS-it, kaceret e traktit riprodhues, këshillimi për menopauzën, etj.

137. Në zonat rurale kujdesi ofrohet nëpërmjet qendrave shëndetësore, ambulancave të fshatit, nga mjekët e familjes, infermieret dhe mamitë/infermiere. Shërbimet për kujdesin para/pas lindjes, lindjen, planifikimin familjar, testimi për HIV/AIDs janë falas. Kujdesi për shëndetin e gruas është pjesë e veçantë e “paketës bazë të shërbimeve në kujdesin shëndetësor parësor”, që përfshin ofrimin e shërbimeve cilësore.

138. Shërbimet specifike për mbrojtjen e shëndetit të grave të ofruara nëpërmjet rrjetit të këshillimoreve të gruas, në të gjithë vendin, bazohen në udhërrëfyes ndërkombëtar për mbrojtjen e shëndetit. Synimi kryesor mbetet kalimi nga mjekësia kurative drejt asaj parandaluese dhe ndërgjegjësimi i grave për ruajtjen e shëndetit. Informacioni mbi kujdesin shëndetësor për meshkujt dhe femrat jepet në shërbimet publike të ofruara nga MSH-ja. Përmirësimi i shërbimeve të këshillimoreve të nënës dhe fëmijës është pjesë e reformës së sistemit shëndetësor. Gjatë periudhës 2011-2012, maternitetet në 16 rrethe të vendit janë pajisur me sete aparaturash mjekësore bashkëkohore, si ndërhyrje efikase infrastrukture që ul mortalitetin foshnjor, amtar. Janë përpiluar 15 protokolle klinike kombëtare për obstetrikën, neonatologjinë, 27 protokolle klinike për pediatri⁸⁶. Prej 2011 po punohet për zhvillimin e standardeve, udhëzuesve, protokolleve për shërbimet në kujdesin shëndetësor parësor. Në 2013, MSH-ja⁸⁷ miratoi udhërrëfyesit për kujdesin para/pas lindjes për gruan, fëmijën, ushqyerjen, mirërritjen, zhvillimin e fëmijës. Janë miratuar treguesit për monitorimin e performancës për shërbimet e këshillimoreve të nënës, fëmijës në kujdesin shëndetësor parësor⁸⁸.

139. Nëpërmjet iniciativës “Spitalet mike të fëmijës”⁸⁹ në maternitete janë marrë masa për

ushqyerjen me gji, si ndërhyrje që ndikon ndjeshëm në parandalimin e vdekshmërisë foshnjore dhe amtare. Gjatë 2010-2013 u zbatua programi i përbashkët për zvogëlimin e kequshqyerjes tek fëmijët⁹⁰, për parandalimin, adresimin e kequshqyerjes, pasigurisë ushqimore te nënat, fëmijët, si grupe me rrezik të lartë.

140. Në 2011 përfunduan modulet e integruara të trajnimit mbi ushqyerjen e gruas shtatzënë dhe të fëmijës, që mbështeten në evidencat bashkëkohore për ushqyerjen. Në 2012 u zhvillua fushata ndërgjegjësuere mbi reduktimin e kequshqyerjes së gruas para konceptimit, gjatë/pas shtatzënisë dhe përmirësimin e praktikave të ushqyerjes së fëmijëve.

141. Gjatë 2012-2013 u zbatua projekti⁹¹ “Përmirësimi i praktikave të ushqyerjes për fëmijët e moshës 0-5 vjeç”, me objektiva: përmirësimi i shëndetit të fëmijëve 0-5 vjeç nëpërmjet promovimit të ushqyerjes me gji dhe plotësimit me ushqime të përshtatshme cilësore, edukimi i ushqyerjes, praktikat e suksesshme për ushqyerjen e shëndetshme dhe të sigurt të foshnjës/fëmijës, fuqizimi i bashkëpunimit me partnerët. Përfitues ishin: 1200 gra shtatzëna, 5500 gra 15-49 vjeç, 240 vullnetarë dhe 7251 fëmijë të moshës 0-5 vjeç. Nga tetori 2013, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) mbledh të dhëna vjetore nga qendrat shëndetësore dhe maternitetet për treguesit mbi praktikën e ushqyerjes me gji.

142. Gjatë periudhës 2011-2013 u trajnuar personeli shëndetësor i kujdesit parësor, spitalor (mjeke/ë, infermiere/ë, obstetër-gjinekologe/ë, infermiere/mami) kryesisht në veri të vendit⁹². Gjatë 2013 vazhdoi trajnimi i personelit mbi kujdesin dhe ushqyerjen për gruan shtatzënë, si dhe ushqyerjen me gji.⁹³

143. Kanceri i qafës së mitrës. Parandalimi, diagnoza e hershme dhe trajtimi i sëmundjeve tumorale të organeve riprodhuese tek gratë, është prioritet. Një studim⁹⁴ (shtator-tetor 2013) vlerësoi kapacitetet, mundësitë ekzistuese, në 12 rajonet e vendit, për kapjen e hershme të kancerit të qafës së mitrës. Në tetor 2013 u nënshkrua “Deklarata e

⁸⁶Akredituar nga Qendra Kombëtare e Akreditimit dhe Cilësisë.

⁸⁷Mbështetur nga UNICEF.

⁸⁸ Me urdhrat e Ministrit të Shëndetësisë nr.469/03.09.2013 dhe nr.470/03.09.2013.

⁸⁹ Mbështetur nga OBSH/UNICEF

⁹⁰Mbështetur nga UNICEF, OBSH dhe FAO.

⁹¹Kryqi i Kuq.

⁹²Shkodër, Lezhë, Pukë, Malësi e Madhe, Kukës, Has, Tropojë.

⁹³Durrës, Shkodër, Lezhë, Kukës, Tropojë.

⁹⁴MSH, ISHP, QSUT, UNFPA



mençurisë" (dokumenti bazë mbi qëllimet dhe objektivat e aleancës kundër kancerit të qafës së mitrës) që bën thirrje për ndërhyrje të menjëhershme të përbashkëta, për zvogëlimin brenda 5 viteve të numrit të vdekjeve nga kjo sëmundje. Deklarata dhe çdo iniciativë ligjore që përmirëson, shpëton jetën e gruas mbështeten nga AGD. Kuvendi dhe gratë deputete kanë ndërmarrë iniciativa dhe për kujdesin shëndetësor të grave apo parandalimin e kancerit të gjirit.

145. Incidenca për kancerin e qafës së mitrës rezulton: 94 raste (2010); 96 raste (2011) dhe 90 raste (2012). Prevalenca për shtrimet në spital: 441 raste (2010); 397 raste (2011) dhe 487 raste (2012). Po studiohet shpërndarja e shtameve që e shkaktojnë atë, për zgjedhjen dhe përfshirjen e vaksinës së përshtatshme në kalendarin e vaksinimit, për vitet pasardhëse.

146. Është ngritur Komiteti Kombëtar i Kontrollit të Kancerit⁹⁵ dhe është hartuar "Programi kombëtar i kontrollit të kancerit 2011-2020". Në janar 2014 u zhvillua seminari mbi politikën e kontrollit të kancerit të qafës së mitrës dhe u përgatit dokumenti këshillues teknik me ndërhyrjet prioritare. Gjatë 2014 janë zhvilluar aktivitete për rritjen e kapaciteteve për diagnostikimin e hershëm të sëmundjes, dhe zhvillimin e protokolleve të detajuara mjekësore, për fillimin e programit pilot të depistimit brenda vitit 2015.

147. Kanceri i gjirit. Në tetor 2013 u miratua urdhri i ministrit të Shëndetësisë për përjashtimin nga tarifat e shërbimeve mjekësore për të sëmurët me sëmundje tumorale dhe gratë shtatzëna. Parashikohet përjashtimi nga tarifat i grave me kancer të traktit riprodhues. Në tetor 2013, Këshilli i Ministrave miratoi kredinë prej 2,000,000 euro për blerjen e akserelatorit linear, për trajtimin e këtyre sëmundjeve.

148. Incidenca për kancerin e gjirit, rezulton: 332 raste (2010); 359 raste (2011) dhe 318 raste (2012). Prevalenca: 3993 raste (2010); 3412 raste (2011) dhe 3737 raste (2012). Gjatë 2013 janë kryer mbi 250,000 ekzaminime të kancerit të gjirit. Janë prokuruar mamografi lëvizëse, që do përmirësojë aksesin në shërbimet e depistimit, për gratë që

banojnë larg qendrave të mëdha urbane.

149. Mjekët e familjes, infermierët dhe profesionistët e shëndetit publik trajnohen periodikisht mbi kapjen e hershme të kancerit të gjirit. Nga shtatori 2013: janë trajnuar 200 mjekë, 100 infermierë; janë shpërndarë materiale informuese/ndërgjegjësuere për gratë; ka filluar monitorimi sistematik i ekzaminimit klinik të gjirit, në gjithë vendin. ISHP-ja po punon për fuqizimin e kapaciteteve të stafit të kujdesit shëndetësor lokal nëpërmjet trajnimeve për parandalimin, depistimin, mundësitë e trajtimit, kujdesin paliativ. Çdo vit, gjatë muajit tetor zhvillohen aktivitete sensibilizuese/ndërgjegjësuere për kancerin e gjirit.

Aksesi në kujdesin shëndetësor për minoritetet

150. Personave që u përkasin minoriteteve, përfshirë edhe minoritetin rom, u ofrohet kujdes shëndetësor në gjithë vendin. Në rrethe të ndryshme drejtoritë rajonale bashkëpunojnë me OJF-të përfshirë dhe ato rome, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore të nevojshme⁹⁶, (p.sh rasti i familjeve rome të sistemuara në zonën e Shishtufinës, Tiranë, tetor 2013).

Metodat kontraceptive, edukimi seksual, planifikimi familjar

151. Zbatimi i Strategjisë Kombëtare të Sigurisë së Kontraceptivëve 2012 - 2016, mundëson që burrat dhe gratë të zgjedhin, marrin, përdorin kontraceptivë dhe shërbime të planifikimit familjar me cilësi të lartë. Strategjia ka si objektiv rritjen e konsumit të metodave moderne të kontracepsionit me 30% më shumë se niveli i vitit 2008 (që ishte 11%). Synohet zgjerimi i gamës së metodave kontraceptive që shpërndahen në qendrat shëndetësore dhe sistemit të referimit për to⁹⁷. Shërbimet e planifikimit familjar ofrohen falas në sistemin shëndetësor publik përmes: qendrave shëndetësore dhe ambulancave të kujdesit shëndetësor parësor, qendrave të planifikimit familjar në maternitetet e rretheve, apo dhe nga OJF-të. Këto shërbime mbështeten mbi parimet e zgjedhjes së informuar, respektimit të të drejtave të klientit, shumëllojshmërisë së metodave, si dhe integritetit me shërbimet/programet e shëndetit të nënës dhe fëmijës apo shëndetit riprodhues. Qendrat e planifikimit familjar (431 qendra në 36

⁹⁵Organ konsultativ me përfaqësues të MSH QSUT, ISHP, INSTAT, MSH, OBSH dhe shërbimeve të specializuara ambulatoriale dhe spitalore.

⁹⁶ Edhe rastin e familjeve rome të sistemuara në zonën e Shishtufinës, Tiranë, tetor 2013.

⁹⁷Parashikohet rritja e konsumit të kondomit me 30%.



rrethe) ofrojnë falas disa lloje kontraceptivësh dhe kanë personel të trajnuar për dhënien e informacionit dhe këshillimin mbi planifikimin familjar. Opsione të tjera për popullatën janë, marketingu social dhe tregu i hapur farmaceutik. Në zonat rurale, mamitë ofrojnë edhe këshillim për planifikimin familjar, gjatë vizitave të kujdesit në shtëpi për gruan shtatzënë.

152. Prej 6-mujorit II-të 2014 po punohet për: rifreskimin e udhëzimeve dhe përfshirjen e normave/standardeve për kontracepsionin, përditësimin e protokolleve të planifikimit familjar për kujdesin shëndetësor parësor dhe rishikimin e udhëzimeve për kryerjen e aborteve nga maternitetet.

153. Edukimit seksual, planifikimit familjar, parandalimit të SST apo shtatzënive të padëshiruara, u kushtohet rëndësi e veçantë. Në bashkëpunim me OJF-të targetohen vazhdimisht të rinjtë/rejat përmes takimeve dhe shpërndarjes së informacioneve. MSH (ISHP/departamentet e promocionit) organizon periodikisht, në gjithë vendin, aktivitete promociionale mbi kujdesin për fëmijën, ushqyerjen, planifikimin familjar, SST, parandalimin e shtatzënisë së hershme, me fokus veçanërisht tek gratë/vajzat Rome.

154. Sipas të dhënave (në sektorin publik dhe privat), aborti paraqet tendencë uljeje.

Vitet	2010	2011	2012
Aborte (numër) gjithsej	8085	8307	7846
% në sektorin publik	90.5	88.8	90.0
% në sektorin privat	9.5	11.2	10.0

155. Nga viti 2013 abortet lejohen të kryhen vetëm në maternitetet e spitaleve publike/private, nuk licencohen më klinikat private. Kjo masë siguron shërbim eficient, sipas standardeve/legjislacionit dhe lehtëson monitorimin e statistikave mbi abortet e kryera. Për 2013 janë raportuar 6442 aborte (1404 raste më pak se në 2012). Raporti i abortit për 1000 lindje të gjalla rezulton: 239 (2010); 242 (2011); 224 (2012).

HIV/AIDS dhe transmetimi nga nëna te fëmija

156. Shqipëria vazhdon të mbetet vend me prevalencë të ulët të infeksionit HIV, por vitet e fundit ka rritje të rasteve të diagnostikuara. Në vitin 2013, totali i personave të infektuar me HIV/AIDS gjatë periudhës 1993-2013 ishte 699 raste (212 femra dhe 34 fëmijë).

157. Diagnostikimi me vonesë mbetet një çështje që duhet adresuar. Gjatë periudhës 2007 – 2013, më shumë se 50% e rasteve të diagnostikuara çdo vit janë kapur në një fazë shumë të vonshme të statusit të virusit HIV-AIDS. Gjatë 2013 ishin nën terapi 316 të rritur dhe 19 fëmijë. Prej vitit 2004, trajtimi me antiretrovirale është falas, pa dallim gjinor, racor, përkatësie të grupeve vulnerabël. Në komponentët e kujdesit mjekësor përfshihen: aplikimi i terapisë antiretrovirale, diagnostikimi, trajtimi i infeksioneve oportuniste, patologji të tjera bashkëshoqëruese dhe mbështetja psikosociale.

158. Parandalimi i transmetimit të virusit HIV nga nëna te fëmija është objektiv kryesor i Strategjisë Kombëtare për Parandalimin e HIV/AIDS. Shërbimet parandaluese ofrohen për gjithë popullatën nga qendrat e këshillimit dhe testimit vullnetar për HIV/AIDS. Ato funksionojnë pranë drejtorive të Shëndetit Publik në 12 prefekturat dhe ofrojnë testim vullnetar dhe këshillim para/pas testimit. Këshillimi për nënat shtatzëna mund të ofrohet edhe pranë qendrave të planifikimit familjar në poliklinikat dhe maternitetet. Është ngritur Qendra Referente për Parandalimin e Transmetimit nga Nëna te Fëmija, pranë Spitalit Universitar Obstetrik-Gjinekologjik. Prej 2007, funksionon Klinika Ambulatore për personat që jetojnë me HIV/AIDS pranë QSUT-së, që ofron shërbime falas në fushat e terapisë ARV, monitorim, mbështetje psikosociale, këshillim dhe testimit vullnetar për HIV/IST. Në kuadër të projekteve të ndryshme⁹⁸ janë realizuar ndërhyrje parandaluese si reduktimi i dëmit, ofrimi i terapisë mbajtëse me metadon (MMT), mbështetje psiko-sociale. Janë organizuar trajnime, fushata sensibilizuese mbi parandalimin e HIV/AIDS te grupet vulnerabël, përdoruesit e drogave me injektim dhe punonjëset e seksit.

159. Gjatë 2013, nga 33 raste të diagnostikuara HIV pozitiv, 25 janë fëmijë të infektuar nga transmetimi vertikal (nga nëna). Trendi në rritje i këtij lloj infektimi sugjeron nevojën për rritjen e promovimit dhe rekomandimit të testeve për gratë shtatzëna. HIV/AIDS mbetet një problem i zonës urbane me 73.5% të rasteve dhe me 26.7% të rasteve në zonën rurale. Rreth 50% e rasteve janë

⁹⁸ Grante nga donatorë të ndryshëm dhe Granti i Fondit Global (2007-2012).



në Tiranë. Është rritur përqindja e grave që njohin rrezikun e transmetimit të HIV-it nga nëna tek fëmija, nëpërmjet ushqyerjes me gji.

160. Personeli i kujdesit shëndetësor parësor ofron këshillim, testim vullnetar dhe shpërndarjen e kondomeve. Trajnimet e personelit në fushën e parandalimit të HIV realizohen dhe në zonat ku banon minoriteti rom. Gjatë 2013 janë trajnuar 120 punonjës të qendrave shëndetësore.

161. Shkollat luajnë rol të rëndësishëm në formulimin e qëndrimeve, opinioneve dhe sjelljeve të të rinjve. Për edukimin e tyre mbi transmetimin e HIV-it, janë marrë masa për: trajnimin e mësuesve; ndërgjegjësimin e komunitetit të prindërve dhe nxënësve; përgatitjen e fletëpalosjeve informative dhe realizimin e emisioneve televizive në orare të përshtatshme. Rëndësi i kushtohet ndërgjegjësimit kundër diskriminimit, përjashtimit social të grave me HIV/AIDS.

162. Në kuadër të bashkërendimit të përpjekjeve institucionale, Komisioni Parlamentar për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë zhvilloi (dhjetor 2013) një seancë dëgjimore me institucionet shtetërore, organizatat ndërkombëtare dhe ato të shoqërisë civile, mbi parandalimin e transmetimit të HIV-it nga nëna tek fëmija, masat ndërhyrëse dhe hapat për përmirësim.

Neni 13

Përfitimet sociale dhe ekonomike

163. Sistemi i mbrojtjes sociale bazohet: programet e sigurimeve shoqërore; ndihmës ekonomike; mbështetjes me të ardhura të personave me aftësi të kufizuar; shërbimeve shoqërore.

Ndryshimet e ligjit nr. 7703/11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore” (korrik 2014) parashikuan për herë të parë pensionin social, që përfitohet për të gjithë të moshuarit mbi 70 vjeç, rezident në Shqipëri gjatë 5 viteve të fundit (pavarësisht përkatësisë gjinore), që nuk plotësojnë kushtet e nevojshme për përftimin e një pensioni.

164. Me ndryshimet (2014) në ligjin nr. 9355/10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, parashikohet:

- kalimi i ndihmës ekonomikesi përgjegjësi e gruas në familje;

- mbështetja me subvencione shtesë për çdo fëmijë që ndjek arsimin e detyrueshëm, për çdo fëmijë të vaksinuar të familjeve të skemës së

Faqe | 10202

ndihmës ekonomike;

- gratë me aftësi të kufizuara që mund të jenë nëna të vetme apo kryefamiljare trajtohen me shërbime mbështetëse nga qendrat publike komunitare dhe orientohen te OJF-të që ofrojnë shërbime alternative, në rast se strukturat shtetërore nuk i mundësojnë ato.

165. Gjatë vitit 2013 qeveria nisi një reformë të re për Shërbimet e Kujdesit Social që synon të ndërtojë një sistem të integruar të përkujdesit shoqëror, koherent dhe të qëndrueshëm në nivel strategjie, politikash, buxhetesh dhe kapacitetesh. Deinstitutionalizimi i shërbimeve rezidenciale të përkujdesit është një nga prioritetet e kësaj reforme duke synuar krijimin e modeleve me bazë familjen dhe ato komunitare.

166. Gjatë 2014 po punohet për hartimin e Strategjisë së Përfshirjes Sociale 2015-2020, që do të fokusohet tek përfshirja e grupeve në rrezik, duke i parë edhe nga këndvështrimi gjinor.

Gratë dhe biznesi

167. INSTAT raporton se 27,4% e bizneseve aktive (nga totali 104,275) gjatë vitit 2012 janë në pronësi/administrohen nga gratë, me një rritje prej 1,5% krahasuar me një vit më parë. Gratë kanë kryesisht ndërmarrje të vogla me 1-4 punëmarrës, pjesa më e madhe janë të vetëpunësuar/pronare të bizneseve të vogla, që kanë përqindjen më të madhe të rritjes (me 3%) nga viti 2007 deri në 2011. Ndonëse rritja është pozitive, në prizëm afatgjatë kufizimi tek vetëpunësimi apo bizneset e vogla, mund t'i verë gratë përballë rrezikut të moszgjërimit apo dështimit të bizneseve të tyre.

168. Gjatë vitit 2011, pronësia nga gratë e ndërmarrjeve të mëdha me 5-9, 10-49 dhe mbi 50 punëmarrës ishte rreth 14-15%. Zhvillim pozitiv shihet dhe në ndërmarrjet e grave me më shumë se 50 punëmarrës, që janë rritur me rreth 2% nga viti 2007 deri në 2011. Tendencë në rritje e ndërmarrjeve të reja në pronësi/menaxhim të grave (me 6% nga 2007-2011) ndërkohë që numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të reja ka treguar tendencë në zbritje, tregon zotësinë e grave për të gjetur drejtime të reja për vazhdimësinë, hapjen e bizneseve, mbrojtjen nga kriza financiare dhe luhatjet e biznesit⁹⁹.

⁹⁹ Studim për sipërmarrjen e grave në Shqipëri, Instituti i Studimeve Bashkëkohore dhe UN Women, mars 2013



169. Sipas Bankës së Shqipërisë rezultojnë se 31,4% nga totali i kredisë së dhënë për vitin 2011 është marrë nga biznese me pronare/administratore gra (por në vlerë përbën vetëm 11,5%)

Për mbështetjen dhe rritjen e aftësisë konkurruese të SME-ve, që nga viti 2007 është krijuar fondi shqiptar i konkurrueshmërisë – (skemë e ndarjes së kostove) me një vlerë prej 20,000 milion lekë/vit. Financohen kompanitë me bashkëfinancim deri në 1,000,000 lekë por jo më shumë se 50% e vlerës së kostos së projektit. Aktivitetet që përfitojnë nga ky fond¹⁰⁰, lidhen me përmirësimet në sistemin e menaxhimit, certifikime produkti, studime tregu, marketing të produkteve, pjesëmarrje në panaire dhe ekspozita etj. Gjatë vitit 2013 u miratuan 8 projekte (1 drejtohej nga grua sipërmarrëse). Fondi i inovacionit, gjatë vitit 2013 ka miratuar 7 projekte nga të cilat nuk ka përfutur asnjë grua sipërmarrëse.

Gratë dhe pronësia

170. Sipas studimit të Bankës Botërore rezultojnë: Në një kampionim prej 73755 pronarësh, 27741 janë gra dhe 46014 burra (2013). Nga totali i grave pronare: 4374 zotërojnë 100% të pronës; 9063 zotërojnë 99%-50% të pronës; 4886 zotërojnë 49%-25% të pronës dhe 9418 zotërojnë më pak se 25% të pronës. Përafërsisht për të tre vitet (2011-2013), burrat kanë marrë 2/3 e hipotekave që janë dhënë dhe gratë kanë marrë vetëm 1/3. Numri i grave që trashëgojnë pronësinë po rritet nga 38.71% në 2011, në 45.11% në 2012 dhe në 2013 pothuajse i njëjtë me përqindjen e burrave.¹⁰¹

171. Zbatimi i reformës së planifikuar gjatë 2012, për të drejtat e pronësisë, ka shumë pak progres në disa komponentë dhe nevojitet rishikimi i planeve të veprimit dhe shoqërimi me burime të qëndrueshme financiare. Qeveria ka ngritur tre struktura konsultative dhe monitoruese dedikuar zbatimit të reformës, por duhet fuqizuar bashkëpunimi ndërmjet institucioneve dhe nevojitet koordinimi i informacionit të digjitalizuar të zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (ZRPP), me sistemet e institucioneve të tjera.

172. Legjislacioni shqiptar ka një dukje asnjansë sa i përket aspekteve gjinore, por rezultatet që vijnë nga zbatimi i tij në mënyrë evidente vërtetojnë se burrat zotërojnë dhe administrojnë pronën më shumë se gratë. Aksesit i kufizuar në kredi dhe mungesa e kolateralit, si në rastin kur gratë janë ose jo të regjistruara si bashkëpronare ose kanë kolateral së bashku me burrat, i privon ato nga të drejtat për fillimin e bizneseve. Pra ende ka vend për përmirësimin dhe ndërmarrjen e masave pozitive, me qëllim realizimin e barazisë *de facto*. Kodi Civil dhe Kodi i Procedurës Civile u njohin grave dhe burrave të drejta të barabarta, por zbatimi i tyre duket se nuk sjell të njëjtin rezultat.

Nxjitja e sipërmarrjes së grave

173. Në Strategjinë e Biznesit dhe të Investimeve 2014-2020 janë parashikuar një numër objektivash për përmirësimin e klimës së biznesit në përgjithësi dhe sipërmarrjen e grave në veçanti. Veprimet e MZHETS-së për mbështetjen/fuqizimin e gruas sipërmarrëse për 2013-2014 janë:

- Studimi për gruan sipërmarrëse¹⁰² dhe hartimi i Planit të Veprimit për mbështetjen e gruas sipërmarrëse 2014-2020 (urdhri i ministrit të MZHETS-së nr. 339/19.6.2014), me masa specifike për krijimin e një mjedisi inkurajues për fillimin e bizneseve, si dhe një qasje bashkëpunuese me palët e interesit, për zhvillimin e bizneseve të grave. Plani është në përputhje me objektivat e Strategjisë së Biznesit dhe Investimeve, si dhe me objektivat/prioritetet e BE për sipërmarrjen e grave.

- Krijimi i Grupit Këshillimor për Koordinimin dhe Monitorimin e Zbatimit të Planit të Veprimit (urdhri i ministrit të MZHETS-së, nr. 340/19.6.2014) me pjesëmarrjen e aktorëve të interesuar, për angazhimin strategjik afatgjatë, avokati dhe udhëheqje për fuqizimin e sipërmarrjes së gruas.

- Krijimi i fondit në mbështetje të gruas sipërmarrëse, me vlerë të përgjithshme 26,500,000 lekë, për një periudhë zbatimi 4 vjet.

¹⁰⁰ AIDA - agjencia që po menaxhon fondin.

¹⁰¹ Gender disaggregated data – Western Balkans, Statistical Reports 2005-2013, publikuar në Konferencën e BB për Tokën dhe Varfërinë (Washington 2014)

¹⁰² Në bashkëpunim me UN Women.



174. Në kuadër të marrëveshjes së bashkëpunimit midis qeverisë shqiptare dhe asaj italiane në mbështetje të SME-ve, Kooperacioni Italian me kontributin e MZHETS-së ka ndryshuar procedurat për financimin e projekteve për gruan sipërmarrëse, duke dhënë "bonus" për të gjitha projektet e propozuara nga ato.

Gratë dhe kultura

175. Gratë në Shqipëri kanë treguar gjithmonë interes për artin, kulturën dhe trashëgiminë ndër vite, përmes kontributit direkt dhe transmetimit ndër breza.

Ministria e Kulturës nxit pjesëmarrjen dhe gjithpërfshirjen e grave në sektorët e kulturës duke mbështetur projektet apo organizatat kulturore që drejtohen nga to¹⁰³. Për gratë në nevojë është krijuar harta gjeografike dhe mbështeten aktivitetet artizanale (për një numër të madh grash fshatare të zonave të largëta), duke mundësuar integrimin e tyre përmes kulturës.

176. Në të gjitha dokumentet strategjike dhe programet e Ministrisë së Kulturës synohet trajtimi i barabartë i artistëve pa dallim gjinie, përfshirja e grave si persona me eksperiencë të shumta jetësore e modele pozitive. Në Programin 2013-2017 të kësaj Ministrie garantohet akses në jetën kulturore, i të gjitha shtresave dhe komuniteteve dhe edukimi i qytetarit përmes kulturës. Theksohet edukimi artistik masiv që në moshat e vogla, me fokus sensibilizimin dhe promovimin kundër diskriminimit, si dhe integrimin plotësisht të BGJ.

177. Ruajtja e ekuilibrave dhe shanseve të barabarta për të dyja gjinitë dhe vlerësimi i kontributit të tyre në gjenerimin e kulturës, mbetet një nga drejtimit parësore në hartimin dhe zbatimin e dokumenteve strategjike.

Neni 14

Gratë rurale

178. Legjislacioni shqiptar nuk bën dallim midis grave në zonat urbane dhe fshatare, por në praktikë jeta e grave fshatare është më e vështirë. Gruaja fshatare ka vështirësi në aksesin për shërbimet shëndetësore, arsimore apo në drejtësi dhe pjesëmarrja në jetën politike e publike, është tepër e ulët. Edhe kur informacioni apo shërbimet bazë ekzistojnë, në mjaft raste grua fshatare duhet të

drejtohet në qendrat përkatëse në qytet për të marrë shërbimin e duhur – çfarë vështirëson tej mase pozitën e saj (pamundësia ekonomike, mentaliteti, mungesa e infrastrukturës, etj.). Edhe kushtet e shërbimeve ekzistuese në fshat lenë shumë për të dëshiruar. Ekzistenca e një shkalle të lartë papunësie, kryerja e shumë punëve në bujqësi, mungesa e mundësive kualifikuese, por dhe niveli arsimor i ulët, i bën gratë fshatare shumë më të prekshme nga papunësia dhe varfëria. Emigracioni i burrave jashtë shtetit, apo aktiviteti tregtar i tyre, i lë gratë të përballojnë vetë pjesën më të madhe të punëve bujqësore. Kontributi i gruas në ekonominë e familjes bujqësore është i rëndësishëm, por as ky fakt nuk e favorizon atë për të pasur një vend kryesor në drejtimin e saj. Ligjërisht grua fshatare është anëtare e familjes bujqësore dhe ka të drejtën e bashkëpronësisë me anëtarë të tjerë të familjes, por rrallëherë ajo ka rolin e kryetares së familjes. Gruaja, përgjithësisht, mban rolin e kryefamiljarit vetëm në rastet kur është e ve, kur ka zgjidhur martesën ose kur burri është larguar në emigracion afatgjatë.

179. Politikat qeveritare janë fokusuar kryesisht tek fuqizimi i gruas fshatare. Gjatë 2012, Ministria e Bujqësisë, në kriteret e vlerësimit të aplikimeve për financim, parashikoi që nëse ferma bujqësore është pronë/menaxhohet nga një grua, vlerësohet me 20 pikë më shumë. Në ligjin "Për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor" po punohet që në kriteret e vlerësimit të skemave të subvencioneve, shoqëritë që do të drejtohen nga gratë të vlerësohen me më shumë pikë. Po evidentohen shoqatat që drejtohen nga gratë në zonat rurale, për promovimin e aktivitetit të tyre. Vetëm 7% e fermave bujqësore drejtohen nga gratë (2011) dhe 6% (2012).

180. Nga analiza shërbimeve bujqësore, rezulton se strategjitë tradicionalisht kanë favorizuar fermerët meshkuj. Rolet e grave, ngarkesa e tyre e përditshme, kufizimet në lëvizjen e tyre dhe nevoja për kujdesin ndaj fëmijëve ndërsa ndjekin trajnime, nuk janë marrë parasysh. Prandaj duhen shtrirë shërbimet bujqësore përmes zbatimit të programeve relevante njëjloj si për gratë dhe burrat fermerë. Strategjia Sektoriale e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural 2007-2013 ka në fokusin e saj reduktimin e pabarazisë aktuale ekonomike dhe sociale ndërmjet rajoneve të vendit dhe përcakton prioritar rolin e gruas fshatare në formimin e kooperativave të prodhimit, si dhe trajtimin e

¹⁰³ Mbështetur në ligjin për artin dhe kulturën, si dhe ligjin për trashëgiminë.



barabartë që i'u duhet bërë këtyre grave në drejtim të dhënies së kredive, apo të pagesave direkte.

Neni 15

Barazia para ligjit

181. Në Shqipëri të drejtat dhe liritë themelore të njeriut qëndrojnë në themel të rendit juridik, kushdo ka të drejtë të paraqesë padi, ose ankesa para organeve administrative dhe gjyqësore, për gratë nuk ka pengesa ligjore për të marrë pjesë në gjykime dhe gjykata, kujtdo i garantohet liria e lëvizjes, etj. Praktika tregon se zbatimi i këtyre të drejtave ndesh vështirësi – zgjedhja e vendbanimit apo liria e lëvizjes kufizohen nga një sërë faktorësh kulturorë e socio-ekonomike që influencojnë jetët e grave, sidomos të grupeve të caktuara (gra fshatare, rome, egjiptiane, me aftësi të kufizuara, etj.).

182. Ligji nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, mbi të drejtën e pronësisë së gruas parashikon se aktet, që përmbajnë fitimin e pronësisë dhe të të drejtave të tjera reale mbi pasurinë e paluajtshme, të cilat u përkasin bashkërisht dy apo më shumë personave, regjistrohen në regjistrin e pasurive të paluajtshme, duke treguar identitetin, pjesët e secilit bashkëpronar, kur kjo është e mundshme. Nëse pasuria, objekt i kontratës së kalimit të pronësisë, realizuar në favor të personave fizikë, që në regjistrin e gjendjes civile kanë statusin e të martuarit, është pasuri e fituar gjatë martesës, në përputhje dispozitat e Kodit të Familjes, regjistrimi në seksionin përkatës të kartelës së pasurisë bëhet në bashkëpronësi të të dy bashkëshortëve. Lidhur me zbatimin e këtij ligji, strukturat kompetente janë angazhuar për trajnimin e personelit.

Neni 16

Martesa dhe jeta familjare

183. Legjislacioni shqiptar në këtë drejtim përputhet mirë me nenin 16 të Konventës CEDAW. Parimi i barazisë së bashkëshortëve në aspekte të ndryshme të jetës familjare, para/pas martesore (personale e pasurore) dhe në raport me fëmijët, zë vend prioritar.

Por nga praktika evidentohen raste të shkeljes së këtyre parimeve sa u takon martesave të hershme apo të detyruara në komunitetet Rome dhe Egjiptjane, martesave të fëmijëve, të drejtave pronësore, etj. Studimet e fundit mbështetur në praktikën gjyqësore, dëshmojnë për njohuri të

kufizuara të grave para martesës, për regjimet pasurore. Ministria e Drejtësisë¹⁰⁴ po realizon një cikël trajnimesh për noterët dhe punonjësit e Zyrrave të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për respektimin e BGJ në veprimtarinë e regjistrimit.

184. Rekomandimi 44. Pranimi i ndryshimit të nenit 20, paragrafi 1 i Konventës

Me ligjin 10373, datë 10.2.2011 “Për një shtesë në ligjin nr. 7767 datë 9.11.1993 “Për aderimin në konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, Shqipëria ka pranuar ndryshimin e nenit 20/1, të Konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, lidhur me kohën e mbledhjes së Komitetit të Konventës.

VENDIM

Nr. 807, datë 26.11.2014

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 747, DATË 5.11.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT ME SHKËMBIM LETRASH, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETIT TË KUVAJTIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 747, datë 5.11.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohen paragrafët i dytë dhe i tretë, me këtë përmbajtje:

“Autorizohet ministri i Financave për të nënshkruar kontratën e përdorimit të grantit.

Lërimi i grantit të bëhet në një llogari speciale në Bankën Qendrore.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama

¹⁰⁴ Mbështetur nga UN Women

**VENDIM****Nr. 808, datë 26.11.2014**

**PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2014, MIRATUAR
PËR PRESIDENCËN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Presidencës, në buxhetin e miratuar për vitin 2014, t’i shtohet fondi prej 3 000 000 (tre milionë) lekësh, për shpenzime korrente.

2. Ky fond të përballohet nga fondi i kontingjencës, miratuar për vitin 2014.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Presidenca për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

VENDIM**Nr. 809, datë 26.11.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 35, DATË 29.1.2014, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E
NUMRIT TË PUNONJËSVE ME
KONTRATË TË PËRKOHSHME PËR
VITIN 2014 NË NJËSITË E QEVERISJES
QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, dhe të nenit 11, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 35, datë 29.1.2014, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme për vitin 2014, në njësitë e qeverisjes qendrore është 911 veta, sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7 dhe nr. 8 që i bashkëlidhen këtij vendimi.”.

b) Pas lidhjes nr. 7, bashkëlidhur vendimit në fuqi, shtohet lidhja nr. 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi, e cila detajon ndarjen e shtesës prej 4 punonjësish, të miratuar me këtë vendim, për Ministrinë e Financave.

2. Efektet financiare për zbatimin e këtij vendimi përballohen nga shpenzimet korrente të miratuara në buxhetin përkatës të ministrisë për vitin 2014.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**

Lidhja nr. 8

Emri i institucionit	Nr. i punonjësve	Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
Ministria e Financave	4			
Aparati i Ministrisë	4	Specialiste	8 orë/ditë	15.11.2014-31.12.2014
Total punonjës me kontratë	4			

VENDIM**Nr. 811, datë 26.11.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHITESA
NË VENDIMIN NR. 1148, DATË 25.11.2009,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “RRUGA
HYRËSE FIER””**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave



VENDOSI:

Në vendimin nr. 1148, datë 25.11.2009, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Pikat 3, 4 dhe 5 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 1 139.4 (një mijë e njëqind e tridhjetë e nëntë pikë katër) m², tokë “truall”, me vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 13 672 800 (trembëdhjetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e tetëqind) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 322 500 (treqind e njëzet e dy mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, sipas pikës 3, të këtij vendimi, të përballohet, përkatësisht:

- 9 488 400 (nëntë milionë e katërqind e tetëdhjetë e tetë mijë e katërqind) lekë nga llogaria e veçantë e Ministrisë së Financave, në Bankën e Shqipërisë, “Fondi i shpronësimeve”;

- 4 184 400 (katër milionë e njëqind e tetëdhjetë e katër mijë e katërqind) lekë, nga buxheti i vitit 2015, zëri “Detyrimet e prapambetura”.

2. Në tabelën e të shpronësuarve, bashkëlidhur vendimit, të shtohet edhe tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
Sektori i Shpronësimeve
Autoriteti Rrugor Shqiptar

LISTA E SHPRONËSIMIT PËR PRONA PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR “RIKONSTRUKSIONI I RRUGËS TEODOR I II I MUZAKAJVE (HYRJA
E FIERIT)

Nr.	Pronari			Z.K	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sip. shpronësimi (m ²)	Çmimi (l/m ²)	Vlera (leke)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri							
1	Gjergji		Trifoni	8532	2/419	Truall	61	12000	732000	Konf.nga ZVRPP
2	Qazim		Temova	8532	2/420	Truall	91	12000	1092000	Konf.nga ZVRPP
3	Kate	Vllasi	Divia	8532	3/276	Truall	8.7	12000	104400	Konf.nga ZVRPP
	Leonard	Vllasi	Divia							
	Piro	Vllasi	Divia							
	Valentina	Vllasi	Dimo							
	Aristir	Vllasi	Divia							
	Miranda		Prifti							
4	Themi	Zoi	Divia	8532	3/277	Truall	4.7	12000	56400	Konf.nga ZVRPP
5	Ana	Nasi	Semea	8532	3/278	Truall	6.2	12000	74400	Konf.nga ZVRPP
	Arqile	Nasi	Devija							
	Pandeli	Nasi	Devija							
	Rapi	Nasi	Devija							
	Thoma	Nasi	Devija							
6	Ana	Nasi	Semea	8532	3/279	Truall	9.9	12000	118800	Konf.nga ZVRPP
	Arqile	Nasi	Devija							
	Pandeli	Nasi	Devija							
	Rapi	Nasi	Devija							
	Thoma	Nasi	Devija							
7	Ana	Nasi	Semea	8532	3/280	Truall	10.4	12000	124800	Konf.nga ZVRPP
	Arqile	Nasi	Devija							
	Pandeli	Nasi	Devija							
	Rapi	Nasi	Devija							
	Thoma	Nasi	Devija							
8	Themi	Zoi	Divia	8532	3/281	Truall	5	12000	60000	Konf.nga ZVRPP
9	Bajram	Jonuz	Pirra	8532	2/432	Truall	28	12000	336000	Konf.nga ZVRPP
	Hysen	Jonuz	Pirra							
10	Bilbil	Safet	Hysenaj	8532	3/552	Truall	54	12000	648000	Konf.nga ZVRPP



11	Durim	Brahim	Kodheli	8532	3/591	Truall	1	12000	12000	Konf.nga ZVRPP
12	Arshim	Rakip	Myrto	8532	3/600	Truall	9.6	12000	115200	Konf.nga ZVRPP
13	Thoma	Kost	Kulari	8532	3/601	Truall	10.2	12000	122400	Konf.nga ZVRPP
14	Robert	Asqeri	Feleqi	8532	3/567	Truall	49	12000	588000	Konf.nga ZVRPP
	Shuma						348.7		4184400	

VENDIM**Nr. 812, datë 26.11.2014**

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE
TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I
SEGMENTIT RRUGOR TIRANË-VORË
(SEKSIONI II, KRAHU I MAJTË)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë -Vorë (seksioni II, krahu i majtë).

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë tokë “truall”, tokë “arë” dhe “pemëtores”, me sipërfaqe të përgjithshme 58 516 (pesëdhjetë e tetë mijë e pesëqind e gjashtëmbëdhjetë) m² dhe vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 32 957 260 (tridhjetë e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekësh.

4. Vlera totale e shpronësimit prej 32 957 260 (tridhjetë e dy milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekësh të përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2014, planifikuar për Autoritetin Rrugor Shqiptar, zëri “Shpronësimet”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet, për efekt shpronësimi, në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

9. Brenda 30 ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës mbi hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe, me fillimin e procesit të likuidimit, të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin që do të realizohet procesi i hedhjes së trupit të rrugës mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

11. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI
Edi Rama**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Autoriteti Rrugor Shqiptar
Sektori i Shpronësimeve

RRUGA PARALELE TIRANË-VORË (KRAHU I MAJTË), VAZHIDIMI

Nr.	Pronari			Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja m²	Çmimi l/m²	Vlera (lekë)	Fshati	Vlera totale	SHËNIME
	Emri	Atësia	Mbiemri									
1	Shogeria Sakuli			2183	103/27	arë	138	420	57960	Vorë	57960	KONFIRMUAR NGA ZRPP
2	Shogeria Sakuli			2183	103/25	arë	150	420	63000	Vorë	63000	KONFIRMUAR NGA ZRPP
3	Qazim	Anif	Gjoka	2183	103/2	arë	75	420	31500	Vorë	31500	KONFIRMUAR NGA ZRPP
4	Sarni	Bajram	Gjoka	2183	103/3	arë	45	420	18900	Vorë	18900	KONFIRMUAR NGA ZRPP PLOT.DOK. PRONESIE
5	Sherif	Bajram	Gjoka	2183	103/4	arë	45	420	18900	Vorë	18900	KONFIRMUAR NGA ZRPP PLOT.DOK. PRONESIE
6	Ardjan+Kujtim		Maloku	2183	103/5	arë	75	420	31500	Vorë	31500	KONFIRMUAR NGA ZRPP PLOT.DOK. PRONESIE
7	Qemal	Haxhi	Maloku	2183	103/29	arë	75	420	31500	Vorë	31500	KONFIRMUAR NGA ZRPP
8	Muhamet	Mustafa	Gjoka	2183	103/7	arë	85	420	35700	Vorë	35700	KONFIRMUAR NGA ZRPP
9	Ismail	Xhemal	Gjoka	2183	103/8	arë	80	420	33600	Vorë	33600	KONFIRMUAR NGA ZRPP
10	Shaban	Xhelal	Gjoka	2183	103/9	arë	75	420	31500	Vorë	31500	KONFIRMUAR NGA ZRPP
11	Vuid	Kadri	Gjoka	2183	103/10	arë	70	420	29400	Vorë	29400	KONFIRMUAR NGA ZRPP
12	Feti	Sefer	Egra	2183	131/8	arë	1044	420	438480	Vorë	438480	KONFIRMUAR NGA ZRPP
13	Shaban	Xhemali	Gjoka	2726	137/48	arë	1089	448	487872	Muçaj	487872	KONFIRMUAR NGA ZRPP
14	Durim	Sherif	Muka	2726	137/2/46	arë	329	448	147392	Muçaj	147392	KONFIRMUAR NGA ZRPP
15	Durim Beharë	Haxhi Zeqir	Korniku	2726	137/2/47	arë	389	448	174272	Muçaj	174272	KONFIRMUAR NGA ZRPP
16	Anila	Mirhat	Selenica	2726	137/39	arë	680	448	304640	Muçaj	304640	KONFIRMUAR NGA ZRPP
17	Agron		Muka	2726	137/2/48	arë	130	448	58240	Muçaj	58240	KONFIRMUAR NGA ZRPP
18	Bashpronarët		Driza	2726	137/42	arë	360	448	161280	Muçaj	161280	KONFIRMUAR NGA ZRPP
19	Aleksander	Asllan	Shehu	2726	137/29	tr.+ndert	594	2395	1422630	Muçaj	1422630	KONFIRMUAR NGA ZRPP
20	Aleksander	Asllan	Shehu	2726	137/34	arë	306	448	137088	Muçaj	137088	KONFIRMUAR NGA ZRPP
21	Gentjan	Mustafa	Shkupi	2726	137/41	arë	126	448	56448	Muçaj	56448	KONFIRMUAR NGA ZRPP
22	Arben	Refik	Resuli	2726	137/37	arë	1134	448	508032	Muçaj	508032	KONFIRMUAR NGA ZRPP
23	Pjeter		Prendi	2726	162/20	arë	450	448	201600	Muçaj	201600	KONFIRMUAR NGA ZRPP
24	Muhamet	Baftjar	Hasrrema	2726	162/26	arë	666	448	298368	Muçaj	298368	KONFIRMUAR NGA ZRPP
25	Selman	Ali	Mema	2726	162/35	arë	450	448	201600	Muçaj	201600	KONFIRMUAR NGA ZRPP
26	Gjergji	Leonidha	Petro	2726	162/39	arë	486	448	217728	Muçaj	217728	KONFIRMUAR NGA ZRPP
27	Beqir	Sinan	Mustafa	3974	166/72	arë	378	434	164052	Picari	164052	KONFIRMUAR NGA ZRPP
28	Beqir	Sinan	Mustafa	3974	166/88	truall	1080	1193	1288440	Picari	1288440	KONFIRMUAR NGA ZRPP
29	Minere	Mehmet	Kraja	3974	166/83	arë	684	434	296856	Picari	296856	KONFIRMUAR NGA ZRPP
30	Sokol	Gani	Kraja	3974	166/84	truall	691	1193	824363	Picari	824363	KONFIRMUAR NGA ZRPP
31	Rexhep	Ismail	Sula	3974	166/77	arë	90	434	39060	Picari	39060	KONFIRMUAR NGA ZRPP
32	Zija	Nazif	Hidri	3974	166/9/1	pentore	887	434	384958	Picari	384958	KONFIRMUAR NGA ZRPP
33	Erik Luljeta	Vincent Gjon	Granëchr	3974	166/39	arë	1494	434	648396	Picari	648396	KONFIRMUAR NGA ZRPP
34	Olisjan		Dedëj	3974	166/94	arë	468	434	203112	Picari	203112	KONFIRMUAR NGA ZRPP
35	Vasil		Muca	3974	166/96	arë	747	434	324198	Picari	324198	KONFIRMUAR NGA ZRPP
36	Arben	Refik	Resuli	3974	166/75	arë	774	434	335916	Picari	335916	KONFIRMUAR NGA ZRPP
37	Pashk	Ndue	Gjinaj	3974	166/55	arë	810	434	351540	Picari	351540	KONFIRMUAR NGA ZRPP
38	Mark	Ndue	Gjinaj	3974	166/57	arë	810	434	351540	Picari	351540	KONFIRMUAR NGA ZRPP
39	Shoq. "UKRO METAL" sh.a			3974	166/37	truall	1152	1193	1374336	Picari	1374336	KONFIRMUAR NGA ZRPP
40	Helidon Genci	Gezim	Muca	3974	166/90	truall	750	1193	894750	Picari	894750	KONFIRMUAR NGA ZRPP
41	Emira Agim	Haxhi	Kroi Kroi	3974	166/52	arë	396	434	171864	Picari	171864	KONFIRMUAR NGA ZRPP
42	Agim	Haxhi	Kroi	3974	166/67	arë	72	434	31248	Picari	31248	KONFIRMUAR NGA ZRPP



43	Hektor Refik	Ismail Ismail	Brahimi Brahimi	3974	166/66	truall	477	1193	569061	Picar	569061	KONFIRMUAR NGA ZRPP
44	Ylli	Myharrem	Ferhati	3974	166/92	arë	522	434	226548	Picar	226548	KONFIRMUAR NGA ZRPP
45	Gentjan Sitki	Mustafa Mustafa	Shkupi Shkupi	3974	166/28	arë	486	434	210924	Picar	210924	KONFIRMUAR NGA ZRPP
46	Gentjan Sitki	Mustafa Mustafa	Shkupi Shkupi	3974	166/41	arë	1044	434	453096	Picar	453096	KONFIRMUAR NGA ZRPP
47	Fatos	Rushdi	Picari	3974	243/37	arë	1260	434	546840	Picar	546840	KONFIRMUAR NGA ZRPP
48	Fisnik	Vait	Picari	3974	243/38	arë	20	434	8680	Picar	8680	KONFIRMUAR NGA ZRPP
49	Arben		Picari	3974	243/47	arë	268	434	116312	Picar	116312	KONFIRMUAR NGA ZRPP
50	Zanun	Ramazan	Allmeta	3974	243/5	arë	1620	434	703080	Picar	703080	KONFIRMUAR NGA ZRPP
51	Kostandin Kristo Papa	Kristo	Papa	3974	247/84	arë	2191	434	950894	Picar	950894	KONFIRMUAR NGA ZRPP
52	Bashpronarët	Kandri	Ref.0730	3974	247/52	arë	360	434	156240	Picar	156240	KONFIRMUAR NGA ZRPP
53	Bashpronarët	Kandri	Ref.0730	3974	247/19	arë	342	434	148428	Picar	148428	KONFIRMUAR NGA ZRPP
54	Shoq."DUA GAZ" sh.p.k			3974	257/13	arë	1650	434	716100	Picar	716100	KONFIRMUAR NGA ZRPP
55	Shoq."DUA GAZ" sh.p.k			3974	257/4	truall	780	1193	930540	Picar	930540	KONFIRMUAR NGA ZRPP
56	Lefter Fisnik Afrim		Hajderaj Hajderaj Hajderaj	1751	40/19	arë	117	434	50778	Picar	50778	KONFIRMUAR NGA ZRPP
57	Lefter Fisnik Afrim		Hajderaj Hajderaj Hajderaj	1751	40/22	arë	117	434	50778	Picar	50778	KONFIRMUAR NGA ZRPP
58	Lefter Fisnik Afrim		Hajderaj Hajderaj Hajderaj	1751	40/25	arë	117	434	50778	Picar	50778	KONFIRMUAR NGA ZRPP
59	Lefter Fisnik Afrim		Hajderaj Hajderaj Hajderaj	1751	40/28	arë	117	434	50778	Picar	50778	KONFIRMUAR NGA ZRPP
60	Fatbardha	Muhamet	Kadilli	1751	40/16	arë	252	434	109368	Picar	109368	KONFIRMUAR NGA ZRPP
61	Kudret Alkion	Skender Sulejman	Mersini Dizdari	3974	40/46	arë	531	434	230454	Picar	230454	KONFIRMUAR NGA ZRPP
62	Kudret Alkion	Skender Sulejman	Mersini Dizdari	3974	40/47	arë	468	434	203112	Picar	203112	KONFIRMUAR NGA ZRPP
63	Kudret Alkion	Skender Sulejman	Mersini Dizdari	3974	40/48	arë	486	434	210924	Picar	210924	KONFIRMUAR NGA ZRPP
64	Kudret Alkion	Skender Sulejman	Mersini Dizdari	3974	40/58	arë	396	434	171864	Picar	171864	KONFIRMUAR NGA ZRPP
65	Kujtim Ali	Skender Kadri Sulejman	Seferi Fejza	3974	40/39	arë	594	434	257796	Picar	257796	KONFIRMUAR NGA ZRPP
66	Demir	Rifat	Rusi	3974	40/32	arë	584	434	253456	Picar	253456	KONFIRMUAR NGA ZRPP
67	Demir	Rifat	Rusi	3974	40/31	truall	414	1193	493902	Picar	493902	KONFIRMUAR NGA ZRPP
68	Arben	Demo	Çakranji	1751	40/13	arë	1026	663	680238	Gjokaj	680238	KONFIRMUAR NGA ZRPP
69	Adelina Bashkim	Beqir Hamid	Gjoka Gjoka	1751	40/17	arë	270	663	179010	Gjokaj	179010	KONFIRMUAR NGA ZRPP
70	Besnik	Musa	Picari	1751	40/18	arë	762	663	505206	Gjokaj	505206	KONFIRMUAR NGA ZRPP
71	Gezim	Besnik	Picari	1751	40/1	arë	396	663	262548	Gjokaj	262548	KONFIRMUAR NGA ZRPP
72	Skifter	Besnik	Picari	1751	40/23	arë	10	663	6630	Gjokaj	6630	KONFIRMUAR NGA ZRPP
73	Petrit	Xhafer	Kurni	2119	147/57	arë	423	395	167085	Katund i Ri	167085	KONFIRMUAR NGA ZRPP
74	Petrit	Xhafer	Kurni	2119	147/61	arë	585	395	231075	Katund i Ri	231075	KONFIRMUAR NGA ZRPP
75	Eglo Albania Sh.p.k.			2119	147/48	arë	1080	395	426600	Katund i Ri	426600	KONFIRMUAR NGA ZRPP
76	Lorenc	Gezim	Mullaj	2119	147/59	arë	300	395	118500	Katund i Ri	118500	KONFIRMUAR NGA ZRPP
77	Fadil	Ramazan	Valisi	2119	147/60	arë	774	395	305730	Katund i Ri	305730	KONFIRMUAR NGA ZRPP
78	"ILK. AJAKS			2119	147/64	truall	314	2457	771498	Katund i Ri	771498	KONFIRMUAR NGA ZRPP



	BALLKAN" sh.p.k											
79	"HLK AJAKS BALLKAN" sh.p.k			2119	147/63	arë	253	395	99935	Katund i Ri	99935	KONFIRMUAR NGA ZRPP
80	Shkelqim	Xhemal	Adushi	2119	147/3	arë	450	395	177750	Katund i Ri	177750	KONFIRMUAR NGA ZRPP
81	Bujar Rabihane	Xhemal Refat	Adushi Adushi	2119	147/4	arë	800	395	316000	Katund i Ri	316000	KONFIRMUAR NGA ZRPP
82	Lorenc	Gezim	Mullaj	2119	147/30	arë	607	395	239765	Katund i Ri	239765	KONFIRMUAR NGA ZRPP
83	Hajdar	Luftulla	Murati	2105	1171/34	arë	270	415	112050	Kashar	112050	KONFIRMUAR NGA ZRPP
84	Hajdar	Luftulla	Murati	2105	1171/41	arë	720	415	298800	Kashar	298800	KONFIRMUAR NGA ZRPP
85	Dritan	Rrapush	Murati	2105	1170/24	arë	206	415	85490	Kashar	85490	KONFIRMUAR NGA ZRPP
86	Ymer		Murati	2105	1170/27	arë	414	415	171810	Kashar	171810	KONFIRMUAR NGA ZRPP
87	Shefqet	Rrapush	Murati	2105	1170/3	arë	206	415	85490	Kashar	85490	KONFIRMUAR NGA ZRPP
88	Misar	Rrapush	Murati	2105	1170/4	arë	206	415	85490	Kashar	85490	KONFIRMUAR NGA ZRPP
89	Arben	Rrapush	Murati	2105	1170/29	arë	288	415	119520	Kashar	119520	KONFIRMUAR NGA ZRPP
90	Adrian Elton Armando		Haziraj Haziraj Haziraj	2105	1170/23	arë	1026	415	425790	Kashar	425790	KONFIRMUAR NGA ZRPP
91	Isuf	Ramazan	Kamberi	2105	1169/1	arë	72	415	29880	Kashar	29880	KONFIRMUAR NGA ZRPP
92	Baftjar	Jusuf	Kamberi	2105	1169/2	arë	176	415	73040	Kashar	73040	KONFIRMUAR NGA ZRPP
93	Ramazan	Isuf	Kamberi	2105	1169/3	arë	317	415	131555	Kashar	131555	KONFIRMUAR NGA ZRPP
94	Zyber	Jonuz	Kamberi	2105	1169/4	arë	270	415	112050	Kashar	112050	KONFIRMUAR NGA ZRPP
95	Lulzim	Baki	Kamberi	2105	1169/5	arë	72	415	29880	Kashar	29880	KONFIRMUAR NGA ZRPP
96	Xhavit	Muharrem	Kamberi	2105	1169/6	arë	244	415	101260	Kashar	101260	KONFIRMUAR NGA ZRPP
97	Behar	Shaban	Kamberi	2105	1169/7	arë	137	415	56855	Kashar	56855	KONFIRMUAR NGA ZRPP
98	Muhamet	Mustafa	Kamberi	2105	1169/8	arë	137	415	56855	Kashar	56855	KONFIRMUAR NGA ZRPP
99	Sulejman	Mustafa	Kamberi	2105	1169/10	arë	134	415	55610	Kashar	55610	KONFIRMUAR NGA ZRPP
100	Shyqyri	Mustafa	Kamberi	2105	1169/11	arë	198	415	82170	Kashar	82170	KONFIRMUAR NGA ZRPP
101	Sami	Hamit	Kamberi	2105	1169/12	arë	130	415	53950	Kashar	53950	KONFIRMUAR NGA ZRPP
102	Lutfi	Hamit	Kamberi	2105	1169/13	arë	125	415	51875	Kashar	51875	KONFIRMUAR NGA ZRPP
103	Zyhdi	Hamit	Kamberi	2105	1169/14	arë	125	415	51875	Kashar	51875	KONFIRMUAR NGA ZRPP
104	Haxhire Ilir	Jusuf Baki	Kamberi Kamberi	2105	1169/15	arë	126	415	52290	Kashar	52290	KONFIRMUAR NGA ZRPP
105	Ritvan	Baki	Kamberi	2105	1169/16	arë	126	415	52290	Kashar	52290	KONFIRMUAR NGA ZRPP
106	Ali		Kamberi	2105	1169/17	arë	225	415	93375	Kashar	93375	KONFIRMUAR NGA ZRPP
107	Vehip		Guri	2105	168/8	truall	99	2276	225324	Kashar	225324	KONFIRMUAR NGA ZRPP
108	Aleksander		Docit	2105	168/7	truall	741	2276	1686516	Kashar	1686516	KONFIRMUAR NGA ZRPP
109	Eugen	Karagjos	Kasneçi	2105	1168/5	arë	252	415	104580	Kashar	104580	KONFIRMUAR NGA ZRPP
110	Engjell Altin	Bashkim Agim	Burimi Gedçj	2105	1180/35	arë	2178	415	903870	Kashar	903870	KONFIRMUAR NGA ZRPP
111	Shefqet	Xhemal	Lamaj	2105	1180/38	arë	384	415	159360	Kashar	159360	KONFIRMUAR NGA ZRPP
112	Familja Kamberi			2105	1179/2 deri 1179/34	arë	5220	415	2166300	Kashar	2166300	I PAKONFIRMUAR
		TOTALI					58516		32957260		32957260	

**VENDIM****Nr. 813, datë 26.11.2014****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 140, DATË 12.3.2014, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PJESËMARRJEN E SHQIPËRISË NË PANAIRIN NDËRKOMBËTAR "EXPO MILANO 2015""**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 185/2013, "Për buxhetin e vitit 2014", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 7, të vendimit nr. 140, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 7.1, me këtë përmbajtje:

"7.1 Kostoja paraprake për konceptimin dhe projektimin artistik të pavionit shqiptar, si dhe organizimin për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Panairin Ndërkombëtar "Expo Milano 2015", prej 39 000 000 (tridhjetë e nëntë milionë) lekësh, të përballohet, si më poshtë vijon:

a) 4 000 000 (katër milionë) lekë nga buxheti i vitit 2014, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes/AIDA;

b) pjesa tjetër të përballohet nga buxheti që do të miratohet për vitin 2015 për Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Financave, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve dhe Komisari i Përgjithshëm i Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM**Nr. 814, datë 26.11.2014****PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 663, DATË 17.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË NDËRSEKTORIALE TË LUFTËS KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, TRAFIQEVE TË PALIGJSHME DHE TERRORIZMIT, 2013-2020, DHE PLANIT TË VEPRIMIT PËR VITET 2013-2016"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 663, datë 17.7.2013, të Këshillit të Ministrave, shtohet shtojca 1, me titull "Strategjia e Luftës kundër Trafikimit të Personave e plani i veprimit, 2014-2017", sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integritetit Evropian, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

SHTOJCA 1**STRATEGJIA E LUFTËS KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE E PLANI I VEPRIMIT 2014 - 2017****SHKURTIMET**

PSH Policia e Shtetit
PKK Pikë kalimi kufitar
PKM Policia Kufitare dhe e Migracionit
NjMF Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve
NjDF Njësitë për të drejtat e fëmijëve



DKM Drejtoria e Kufirit dhe Migracionit
 PP Prokuroria e Përgjithshme
 ICITAP Programi i Asistencës Ndërkombëtare për Trajnimin e Hetimet Penale
 ON Organizatat ndërkombëtare
 IOM Organizata Ndërkombëtare e Migrimit
 OPGj Oficer i Policisë Gjyqësore
 MD Ministria e Drejtësisë
 MPB Ministria e Punëve të Brendshme
 MMSR Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
 MAS Ministria e Arsimit dhe Sporteve
 MZHE/TS Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes
 MD Ministria e Drejtësisë
 MF Ministria e Financave
 MPJ Ministria e Punëve të Jashtme
 MSh Ministria e Shëndetësisë
 MM Ministria e Mbrojtjes
 MZHU/TS Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit
 KKSAT Koalicioni Kombëtar i Strehëzave Antitrafik
 TF TTP Task Forca Kombëtare për Trafikimin e Personave
 ZKP Zyra Kombëtare e Punësimit
 OJF Organizatë jofitimprurëse
 MKR Mekanizmi Kombëtar i Referimit
 ZKLDNj Zyra e Komisionerit të Lartë për të Drejtat e Njeriut
 ZKKA Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Antitrafikimin
 OSBE Organizata për Sigurinë dhe Bashkëpunimin në Evropë
 VMT Viktimë e mundshme e trafikimit (sipas MKR-së)
 AP Autoriteti përgjegjës (Mekanizmi Kombëtar i Referimit)
 KRAT Komitet Rajonal Antitrafik
 ZRShSSH Zyra Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror
 ASHMD/TS Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve
 GJKR Gjykata për Krime të Rënda
 GJL Gjykata e Lartë
 PKR Prokuroria për Krime të Rënda
 SLKTP Sektori për Luftën kundër Trafikeve të Paligjshme (Policia)
 ISHPSHSH Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore
 ShSSH Shërbimi Social Shtetëror
 TTP Trafikimi i personave
 MNR Mekanizmi Ndërnacional i Referimit
 VT Viktimë e trafikimit
 OKB Organizata e Kombeve të Bashkuara
 UN E/OMEN Kombet e Bashkuara për Gratë

I. HYRJE

Trafikimi i personave është krim i rëndë, por, pikë së pari, një shkelje e të drejtave të personave të prekur prej tij. Ai mund të trajtohet vetëm në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe ndërsektoriale, ku të përfshihet një gamë e gjerë e aktorëve shtetërorë dhe sidomos joshtetërorë, nga një larmi fushash dhe specialitetesh.

Strategjia dhe ky plan veprimi antitrafik është një instrument për të mbledhur të gjithë aktorët e interesuar shtetërorë dhe joshtetërorë, si edhe partnerët ndërkombëtarë, në një dakordësi mbi situatën në lidhje me trafikimin e personave, sfidat e ngritura dhe si mund të kapërcehen ato. Këtu hidhet baza për një qasje kaq të frytshme dhe të harmonizuar shumëinstitucionalëshe, pasi krijohet kuadri për bashkërendimin dhe bashkëpunimin mes të gjithë aktorëve si dhe roleve e përgjegjësisë të tyre. Duke bërë këtë, Strategjia dhe Plan i Veprimit janë gjithashtu me rëndësi kyçe për sigurimin e mbështetjes politike si edhe financiare, aq të nevojshme për zbatimin e masave të përfshira në to.

Strategjia dhe Plan i Veprimit 2014 - 2017 u hartuan në një proces konsultativ me të gjithë aktorët e përfshirë shtetërorë dhe joshtetërorë, si edhe ata ndërkombëtarë. Në prill dhe maj 2014 u mbajtën një sërë takimesh konsultative mbi tema specifike të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, si edhe një seminar dyditor, gjatë të cilave u mblodhën mendimet dhe sugjerimet e të gjitha palëve të interesuara. Për më tepër u morën në konsideratë edhe studime e raporte vlerësimi të kësaj fushe. Më pas projektstrategjia dhe Plan i Veprimit u shpërndanë te të gjithë aktorët për shqyrtim e mendim, dhe procesi u finalizua me përgjigjet e tyre.

Gjatë këtij procesi, Zyra e Koordinatorit Kombëtar u ndihmua nga një eksperte me përvojë në fushën e trafikimit të personave dhe në hartimin e strategjive. Zyra dëshiron të shprehë vlerësimin dhe mirënjohjen e saj ndaj të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshtetërorë të përkushtuar për antitrafikimin, të cilët kanë kontribuar në hartimin e kësaj Strategjie. Gjithashtu dëshirojmë të falënderojmë Zyrën e Kombeve të Bashkuara kundër Drogës dhe Krimit për mbështetjen e tyre bujare duke na ofruar ekspertin, si dhe duke na mbështetur vazhdimisht nga ana financiare dhe teknike.



Strategjia dhe Plani i Veprimit 2014-2017 u miratua në parim nga Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Personave në takimin e tij dhe do të prezantohet zyrtarisht gjatë Konferencës Kombëtare në muajin tetor, të vitit 2014. Pra, ajo gëzon mbështetjen dhe përkushtimin e të gjitha palëve të përfshira.

II. ANALIZË E SITUATËS

Situata aktuale e trafikimit të personave në Shqipëri

Shqipëria ka bërë përparime të matshme vitet e fundit në drejtëm të luftës ndaj trafikimit të personave falë përpjekjeve të përbashkëta e të gjithanshme të agjencive shtetërore dhe joshetërore, si dhe mbështetjes së vazhdueshme të organizatave partnere ndërkombëtare dhe atyre të shoqërisë civile.

Duke analizuar të dhënat zyrtare mbi personat e trafikuar të identifikuar në Shqipëri,¹⁰⁵ si edhe informacionet e tjera të marra nga aktorët antitrafik në terren, arrijmë në konkluzionin se Shqipëria mbetet kryesisht një vend origjine për trafikimin e burrave, grave dhe fëmijëve që i nënshtrohen shfrytëzimit për prostitucion dhe punë të detyruar. Shumë viktima shqiptare kryesisht femra (të rritura e të mitura) i nënshtrohen shfrytëzimit për prostitucion brenda vendit dhe në vendet fqinje e më tej, sidomos në Belgjikë, Francë, Gjermani, Irlandë, Itali, Holandë, Zvicër dhe në Mbretërinë e Bashkuar (viktimat shpesh pranojnë oferta të rreme për punësim, si kameriere, banakiere, kërcimtare apo këngëtare sidomos në Kosovë, Greqi dhe Maqedoni apo trafikohen me anë të mashtrimit të “të dashurit”).¹⁰⁶

Trafikimi i brendshëm i të miturve dhe të rriturve ka rritur shifrat e përgjithshme të trafikimit në Shqipëri, gjë që dëshmohej nga numri i identifikimeve që janë bërë nga njësitë lëvizëse proaktive, të krijuara së fundmi, gjatë vitit 2013.¹⁰⁷

Për ilustrim, vetëm gjatë periudhës qershor 2013 – korrik 2014 nga njësitë lëvizëse janë identifikuar 85 viktima të mundshme trafikimi, një shifër kjo e përafërt me numrin e përgjithshëm të viktimave/viktimave të mundshme të identifikuara gjatë 2011-2013. Trafikimi i brendshëm tregon një tendencë në rritje sidomos në qendrat e reja urbane (si pasojë e migrimit të brendshëm) dhe në kuadër të migrimit sezonal në zonat turistike (trafikimi i grave për shfrytëzim prostitucioni dhe trafikimi i fëmijëve për shfrytëzim seksual dhe/ose lypje).

Në mënyrë të ngjashme, masa të tilla, si përfshirja e Inspektoratit Shtetëror të Punës në identifikimin e rasteve të mundshme të trafikimit të brendshëm me qëllimin shfrytëzimin për punë ka sjellë identifikimin e viktimave të shfrytëzimit për punë nga Filipinet; gjithsesi, shkalla e trafikimit, me qëllim shfrytëzimin për punë brenda Shqipërisë të shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj mbetet për t'u vlerësuar.

Kthimi nga jashtë shtetit dhe ndihma për riintegrim ndaj shtetasve shqiptarë të trafikuar, të identifikuar apo të paidentifikuar si viktima të trafikimit, përbën gjithashtu një çështje që mbetet për t'u adresuar, së pari si një sfidë humanitare për t'u mundësuar viktimave të rindërtojnë jetën e tyre dhe të riintegrohen në shoqëri, por edhe për të parandaluar rritjen e trafikimit, apo që personat e trafikuar të kthehen në trafikantë, dukuri kjo e cila mbetet ende aktuale.

Grupet vulnerabël dhe faktorët që çojnë në trafikim

Nga puna e këtyre viteve në terren vlerësohen si grupe vulnerabël ndaj trafikimit gratë dhe fëmijët nga familje të varfra, gratë e dhunuara, fëmijët në situatë rruge, si edhe burrat, gratë dhe fëmijët nga komunitetet e varfra rome dhe egjiptiane të qendrave të reja urbane¹⁰⁸.

Situata social-ekonomike e vendit është një faktor kontribues ndaj trafikimit. Rritja ekonomike e viteve të fundit ka qenë e pabarabartë¹⁰⁹: disa

¹⁰⁵ Gjatë vitit 2011 janë identifikuar 84 viktima/ viktima të mundshme trafikimi, nga të cilat 45 të rritur dhe 39 të mitur, në 2012 janë identifikuar gjithsej 92 viktima/viktima të mundshme, nga të cilat 26 janë të mitur, dhe 66 të rritur, ndërsa në 2013 janë identifikuar 95 viktima/ viktima të mundshme trafikimi, nga të cilat 52 të rritur (të gjitha gra) dhe 43 të mitur (nga të cilët 14 meshkuj). Të dhënat nga raportet periodike të ZKKA-së.

¹⁰⁶ Shih Raportin për Trafikimin e Njerëzve 2013, pjesën për Shqipërinë, të Departamentit të Shtetit, SHBA

¹⁰⁷ Njësitë lëvizëse (NjL) për identifikimin dhe referimin e VT, të zbatuara nga IOM në partneritet me Koalicionin Faqe | 10214

Kombëtar të Strehëzave Antitrafik (KKSAT), me mbështetjen financiare të Departamentit të Shtetit, SHBA, Zyra për Trafikimin e Njerëzve.

¹⁰⁸ Shih vlerësimin e KKSAT/IOM, tek: NjL për Identifikimin dhe Referimin e VT: Metodologjia e Punës, Praktikat dhe Mësimet e Marra; IOM, dhjetor 2013.

¹⁰⁹ Indeksi i Zhvillimit Njerëzor është 0.749, shkalla e varfërisë 12.4%. Studimi i Zhvillimit Njerëzor, UNDP 2013



zona të vendit kanë qenë më pak të favorizuara nga pikëpamja e zhvillimit ekonomik, gjë që ka nxitur migrimin brenda vendit nga zonat rurale drejt zonave urbane, nga veriu rural drejt qendrës dhe jugut të vendit (p.sh. në Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, etj.). Komunitetet e reja të formuara si rrjedhojë e migrimit brenda vendit janë edhe më vulnerabel ndaj trafikimit të personave për shkak të lidhjes dhe mbështetjes së dobët të komunitetit të tyre. Këto pabarazi ekonomike kanë nxitur edhe emigrimin e shtetasve shqiptarë, shpesh në rrugë të parregullta, duke u shoqëruar nga rreziku i të rënit pre e trafikimit. Në Shqipëri, mundësitë për punësim dhe për të fituar mjetet e jetesës për femrat paraqiten më të pakta krahasimisht me ato të meshkujve, duke krijuar një hendek mes dy gjinive, përsa i përket pjesëmarrjes në tregun e punës prej rreth 20%¹¹⁰. Shqipëria gjithashtu është një prej vendeve me popullsinë më të re në moshë të Evropës, me një mesatare 30-vjeç, ku 25% e popullsisë i përket grupmoshës 15-29 vjeç, dhe me një shkallë papunësie të dyfishuar për grupmoshën 20-64 vjeç. Shkalla e papunësisë është më e lartë se të rinjtë me nivel të ulët arsimor¹¹¹, ç'ka sjell një prirje më të madhe drejt trafikimit dhe shfrytëzimit.

Dhuna në familje shihet po ashtu si një dukuri e lidhur ngushtë me trafikimin. Ajo konsiderohet si një faktor që jo vetëm i paraprin, por edhe e shoqëron fenomenin e trafikimit. Më shumë se gjysma e popullsisë femër është e prekur nga kjo dukuri – një anketim i vitit 2013 për dhunën në familje zbuloi se 53.7% e grave në kohën e anketimit po përjetonin një formë të dhunës në familje¹¹², çka shton cënueshmërinë e grave dhe fëmijëve përkatës. Të gjithë këta faktorë sëbashku janë më të pranishëm në grupet e pakicave rome dhe egjiptiane, përfshirë fëmijët.

Faktorët social-ekonomikë mund të jenë thelbësorë në rritjen e mundësive për trafikim dhe për t'u trafikuar, por ka edhe faktorë të tjerë ndërmjetës, si p.sh. mungesa e ndërgjegjësimit, që çojnë drejt trafikimit.

Trafikimi i fëmijëve mbetet një problem shqetësues. Fëmijët trafikohen për një larmi

qëllimesh, përfshirë ato për shfrytëzimin seksual, lypje të detyruar, si dhe forma të tjera të punës së detyruar, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Lypja e detyruar në rrugë e fëmijëve (kryesisht romë) në Tiranë mbetet një problem i madh, siç është edhe lypja dhe puna e detyruar (sezonale) në qendrat turistike në Shqipëri. Trafikimi ndërkombëtar i fëmijëve për në vendet fqinje, sidomos drejt Kosovës, ka qenë në rritje. Numri i fëmijëve (kryesisht romë) që punojnë dhe lypin në rrugë mbetet shumë i lartë. Ka patur raporte edhe për raste trafikimi për punë të detyruar apo shfrytëzim seksual pas martesave të ndërmjetësuara.¹¹³ Referuar studimit të kryer gjatë periudhës maj 2013-shkurt 2014 në kuadër të reformës së Shërbimeve Sociale, nga Ministria e Mirëqenies sociale dhe Rinisë, Zyrës së Bashkëpunimit Zviceran në Shqipëri, dhe ARSIS, mbështetur nga UNICEF dhe Save the Children për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge, rezultoi se 1/3 e fëmijëve në situatë rruge janë në rrezik trafikimi dhe MKR-së i janë referuar mbi 31 raste të trafikimit të fëmijëve, përfshirë shfrytëzimin seksual dhe lypjen në Shqipëri dhe Kosovë.¹¹⁴

Fëmijët e përkatësisë rome apo egjiptiane mbartin një rrezik shumë më të lartë trafikimi dhe shfrytëzimi; përkatësia në një grup pakice etnike është e shoqëruar me varfëri, mundësi të kufizuara për përfitim nga shërbimet e mbështetja shëndetësore dhe sociale, nivel të ulët arsimor dhe papunësi të lartë. Ndër faktorët e tjerë janë varfëria dhe dhuna në familje.

ARRITJET

Qeveria Shqiptare është e ndërgjegjshme për ekzistencën e problemit të trafikimit të personave në Shqipëri dhe prej vitit 2005 ka ndërmarrë një sërë masash të rëndësishme drejt parandalimit dhe goditjes së këtij fenomeni. Më poshtë jepet një pamje e përgjithshme e masave të ndërmarra:

- Është ndërtuar një strukturë ndërsektoriale për bashkërendimin e përpjekjeve antitrafik, e cila përbëhet nga Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Personave, Koordinatori Kombëtar/Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Njësia Antitrafik, Mekanizmi Kombëtar i Referimit për Viktimat dhe Viktimat e

¹¹⁰ UN Women, Raport Kombëtar mbi Gjendjen e Grave dhe Barazinë Gjinore në Shqipëri (2011)

¹¹¹ Studim i Krahut të Punës në Shqipëri 2011, cituar nga Organizata Ndërkombëtare e Punës ILO

¹¹² Anketim mbi dhunën në familje 2013, INSTAT dhe UNDP

¹¹³ TIP report 2014

¹¹⁴ Studim "Për identifikimin e fëmijëve në situatë rruge" (2014)



Mundshme të Trafikimit të Personave (MKR), Task Forca Kombëtare e MKR-së, Komitetet Rajonale Antitrafik (KRAT), si dhe ka hartuar tri Strategji/Plane Veprimi Kombëtare Antitrafikim.

- Është ngritur Mekanizmi Kombëtar i Referimit, që ka si synim identifikimin, referimin dhe dhënien e ndihmës ndaj personave të trafikuar; si edhe “Autoriteti përgjegjës” i të gjithë firmëtarëve të MKR-së, i cili u ngrit për të drejtuar dhe mbikëqyrur punimet e MKR-së.

- Janë hartuar Procedurat Standarde të Veprimit (PSV), të cilat përcaktojnë bashkëpunimin në çështje konkrete mes të gjithë aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë të përfshirë në procesin e identifikimit, referimit, ndihmës dhe mbrojtjes, si dhe ndihmës për riintegrimin afatgjatë të viktimave të mundshme dhe viktimave të trafikimit.

- Janë mbledhur dhe hedhur të dhënat mbi personat e trafikuar, bazuar në përkufizimet e unifikuara në Bazën e të Dhënave për Viktimat e Trafikimit (SIVET); dhe po punohet për një sistem të unifikuar për të dhënat mbi çështjet e trafikimit (hetime, ndjekje penale, dënime).

- Është krijuar një bazë e shëndoshë ligjore-rregullatore për luftën kundër trafikimit, e cila përmirësohet vazhdimisht për të qenë në përputhje me standardet përkatëse ndërkombëtare/evropiane dhe për të përballuar sfidat e reja të trafikimit.

- Janë forcuar kapacitetet dhe bashkëpunimi mes autoriteteve ligjzbatuese dhe gjyqësore, si dhe bashkëpunimi i tyre me ofruesit e shërbimeve shtetërorë e joshetërorë.

- Janë miratuar një sërë marrëveshesh bashkëpunimi dypalëshe e ndërkombëtare, me synim përmirësimin e parandalimit të trafikimit, si dhe identifikimin dhe referimin e viktimave jashtë vendit; janë lidhur marrëveshje specifike për fëmijët.

- Është krijuar Koalicioni Kombëtar i Strehzave Antitrafik (KKSAT), gjithsej katër strehëza (një shtetërore dhe tre të OJF-ve), bazuar në “standardet e përkujdesjes” të miratuara për viktimat e trafikimit.

- Është përmirësuar identifikimi i VMT dhe VT-ve, duke përfshirë edhe trafikimin e brendshëm, nëpërmjet punës pro-aktive të Njësisë Lëvizëse.

- Janë marrë masa për të forcuar mjedisin mbrojtës të fëmijëve (të përqendruara tek Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve - NjMF).

- Janë organizuar veprimtari ndërgjegjësuere për publikun, grupet vulnerabël, si dhe aktorët e interesuar që ka mundësi të bien në kontakt me persona të trafikuar. Ndër to janë ditët kombëtare të ndërgjegjësimit, spotet televizive, funksionimi në mbarë vendin i një linje telefonike falas për ndihmë 116 006, si dhe prezantimi i një aplikacioni në celularët smartphone, i quajtur “Raporto! Shpëto!”.

- Janë marrë një sërë masash administrative për të parandaluar dhe/ose goditur trafikimin në kufi, përtej kufijve, si dhe brenda vendit, si edhe përmirësimi i mundësive për regjistrimin civil, kodet e sjelljes për turizmin, licencimi dhe monitorimi i agjencive private të punësimit, etj.

- Është ngritur një grup/ rrjet shumë i motivuar dhe i përkushtuar aktorësh antitrafik, të cilët janë forca shtytëse e veprimtarive për përmirësimin e luftës kundër trafikimit.

FUSHAT PËR PËRMIRËSIM NGA KJO STRATEGJI

Pavarësisht arritjeve, qeveria shqiptare pranon nevojën e përmirësimit të veprimtarisë antitrafikim. Strategjia dhe Plani Kombëtar i Veprimit 2014-2017 përqendrohen tek:

- Përmirësimi i reagimit nga policia, prokuroria dhe sistemi gjyqësor në drejtim të zbatimit rigoroz të ligjeve në fuqi, në drejtim të ushtrimit të ndjekjes penale, zhvillimit të procesit gjyqësor dhe garantimin e të drejtave të viktimave të trafikimit.

Krijimi i instrumenteve të nevojshme për dëmshpërblim dhe kompensim për viktimat e trafikimit.

- Përmirësimi i identifikimit të hershëm dhe referimit të të gjitha kategorive të personave të trafikuar (për të gjitha format e shfrytëzimit) si dhe sigurimi i ndihmës gjithëpërfshirëse, mbrojtjes dhe mbështetjes për riintegrim afatgjatë të gjithë personave të trafikuar, sipas nevojave individuale.

- Bërja tërësisht funksional e MKR-së, duke përmirësuar zbatimin e PSV-ve dhe duke e zgjeruar në nivel bashkie.

- Sigurimi i respektimit të standardeve të përkujdesjes, standardeve për trajtimin e VT-ve që janë bashkëpunëtorë të drejtësisë, si dhe PSV-ve të miratuara për identifikimin, referimin dhe asistencën.

- Përmirësimi i parandalimit të trafikimit nëpërmjet forcimit të sistemeve mbrojtëse, krijimit të mundësive social-ekonomike dhe mundësive të tjera të jetesës, si dhe rritjes së ndërgjegjësimit.



- Fuqizimi i kuadrit antitrafik në nivel rajonal dhe në nivel vendor.

- Forcimi i bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar.

- Përmirësimi i menaxhimit të të dhënave dhe informacionit mbi trafikimin e qenieve njerëzore, si dhe krijimi i një mekanizmi për monitorimin, vlerësimin dhe rishikimin e vazhdueshëm të përpjekjeve antitrafik.

- Monitorimi dhe vlerësimi i veprimtarisë antitrafik dhe rishikimi i saj në vitin 2017.

- Sigurimi i qëndrueshmërisë financiare dhe institucionale të veprimtarisë antitrafik.

- Së fundmi, por jo për nga rëndësia, parandalimi dhe lufta e rreptë kundër trafikimit të fëmijëve, nëpërmjet fuqizimit të mbrojtjes së fëmijëve dhe zbatimit të standardeve dhe PSV-ve ekzistuese.

III. VIZIONI, PARIMET DHE SYNIMET STRATEGJIKE

VIZIONI

Vizioni që mishërohet në këtë strategji është:

Trafikimi i personave mund të parandalohet me sukses nëpërmjet fuqizimit social dhe ekonomik të individit, grupeve dhe popullatës në përgjithësi, nëpërmjet zbatimit efikas të ligjit dhe ndëshkimit të shkelësve, si dhe nëpërmjet identifikimit të çdo viktime trafikimi, duke i dhënë asaj ndihmën, mbrojtjen dhe mbështetjen e nevojshme për t'u rimëkëmbur e kthyer në jetën normale, si dhe duke siguruar dëmshpërblimin dhe kompensimin.

PARIMET MBI TË CILAT MBËSHTETET STRATEGJIA

Strategjia Kombëtare kundër Trafikimit të Personave është një strategji sektoriale, në themel të së cilës qëndron Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë, e miratuar me ligjin nr. 103/2014. Kjo Strategji dhe Plani i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave është ndërtuar mbi parimet drejtuese të mëposhtme, të cilat përbëjnë kuadrin konceptual për veprimtarinë antitrafik:

Përgjegjësia e Qeverisë

Megjithëse është fryt i përpjekjeve të bashkërenduara të qeverisë, shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë, përgjegjësia për këtë Strategji dhe Planin e Veprimit bie mbi Qeverinë dhe institucionet e saj. Qeveria mban përgjegjësi edhe për garantimin e zbatimit të saj, si dhe monitorimit të zbatimit, në bashkëpunim me të

gjithë aktorët antitrafik.

Si rrjedhojë, Qeveria angazhohet të mobilizojë burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare për implementim, kryesisht nga burimet e saj.

Pjesëmarrja e shoqërisë civile dhe qasja ndërsektoriale

Pranohet fakti që pjesëmarrja e shoqërisë civile është e domosdoshme për arritjen e synimeve të kësaj strategjie, d.m.th. parandalimin dhe goditjen e trafikimit të personave, si dhe identifikimin e dhe ndihmën ndaj viktimave të këtij krimi. Të gjithë aktorët shtetërorë dhe joshetërorë, përfshirë shoqërinë civile, marrin pjesë në hartimin dhe zbatimin e veprimtarisë antitrafik, në monitorimin e zbatimit të saj dhe në shqyrtimin e rregullt. Organizatat e shoqërisë civile, dhe në veçanti OJF-të, luajnë një rol kyç në luftën kundër trafikimit, dhe si të tilla janë të përfshira aktivisht në vendimmarrje. Mendimet dhe pikëpamjet e tyre janë të pasqyruara mirë në hartimin dhe zbatimin e kësaj strategjie dhe planin kombëtar të veprimit.

Qasje dhe trajtim i viktimave, i mbështetur tek të drejtat e njeriut

Kjo strategji ka një qasje të mbështetur tek të drejtat e njeriut, pasi pranohet detyrimi që kanë shtetet për të mbrojtur të drejtën që ka individit të ushtrojë të drejtat e tij, detyrimi për të hetuar shkeljet e të drejtave të njeriut, për të ndëshkuar shkelësit, si dhe për t'u dhënë viktimave zgjidhje të frytshme. Gjatë gjithë këtyre veprimeve, në qendër të të gjitha masave antitrafik¹¹⁵ duhet të jenë të drejtat e të trafikuarve, dhe masat antitrafik nuk duhet të ndikojnë negativisht tek të drejtat e viktimave të trafikimit. Ky shqetësim kryesor duhet të ekuilibrohet me dëshirën dhe nevojën për të hetuar, ndjekur penalisht dhe dënuar shkelësit.

Në zemër të veprimtarive antitrafik janë dhënia e ndihmës gjithëpërfshirëse dhe mbrojtjes VMT-ve dhe VT-ve, pavarësisht dëshirës apo aftësisë së viktimës për të dëshmuar në gjykatë. Ofrimi i mundësisë për t'u rehabilituar pas krimit që kanë vuajtur, dhënia e mundësisë që të rifillojnë jetën normale nuk është thjesht një detyrim njerëzor i shteteve, por edhe një masë parandaluese ndaj ritrafikimit. Kjo parandalon kthimin e viktimave në trafikues dhe rrit shkallën e ndjekjeve penale dhe

¹¹⁵ Parimet dhe Udhëzimet e Rekomanduara mbi të Drejtat e Njeriut dhe Trafikimin e Qenieve Njerëzore; Raportim i UNHCHR përpara Këshillit Ekonomik dhe Social – E/2002/68/Add/1, fq. 3



dënimeve, pasi shton gatishmërinë e viktimave të mundshme të trafikimit që të afrohen dhe të bashkëpunojnë me organet e drejtësisë.

Mbrojtja e të drejtave të fëmijës

Kjo strategji merr në konsideratë në mënyrë specifike detyrimin e posaçëm që ka shteti në lidhje me fëmijët, më konkretisht mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi të Drejtat e Fëmijës (1989), si dhe të drejtën e tyre për trajtim të posaçëm e joviktimizues, në respektim të të drejtave të posaçme dhe nevojave të posaçme, sipas interesit të fëmijës, të drejtën për mosdiskriminim, të drejtën për informim, të drejtën për konfidencialitet, respektim të mendimit të fëmijës, si dhe të drejtën për t'u mbrojtur. Në mënyrë që t'i garantojë këto, Plani i Veprimit përmban një seksion mbi trafikimin e fëmijëve, ku theksohen masat e nevojshme për garantimin e përmbushjes së nevojave të fëmijëve për mbrojtje të posaçme.

Mbrojtja e të drejtave të grave

Strategjia është hartuar në koherencë të plotë dhe në përputhje me nenin 6 të Konventës së OKB-së për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), miratuar në vitin 1980, dhe hyrë në fuqi në vitin 1981: "Shtetet palë do të marrin të gjitha masat e përshtatshme, duke përfshirë legjislacionin, për luftimin e të gjitha formave të trafikimit të grave dhe të shfrytëzimit për prostitucion të grave". Në të janë përfshirë edhe rekomandimet e Komitetit të kësaj Konvente, si: masat legjislative, parandalimi efektiv, intensifikimi i luftës kundër trafikimit të brendshëm dhe rritja e trafikimit të viktimave, ndihma ligjore, falas, mbështetja sociale dhe shëndetësore, rehabilitimi dhe riintegrimi, si dhe përmirësimi i sistemit të monitorimit.

Bashkërendimi ndërinstitucional dhe veprimtaritë ndërsektoriale në nivel qeveritar, si dhe mes Qeverisë, OJF-ve dhe ON-ve

Duke pasur parasysh kompleksitetin e trafikimit të personave, veprimtaria antitrafik duhet të funksionojë në një mënyrë "ndërdisiplinare", pra duke bashkuar njohuritë dhe ekspertizën e disiplinave të ndryshme dhe duke krijuar ndërhyrje "ndërsektoriale" të cilat të përfshijnë të gjithë sektorët e shoqërisë (si strukturat ligjzbatuese, gjyqësori, tregjet e punës, arsimi, etj.)

Vlerësimi sistematik dhe qëndrueshmëria

Strategjia ka synim të krijojë një përgjigje të qëndrueshme dhe të institucionalizuar ndaj trafikimit të personave, e cila mbështetet gjithmonë e më shumë me fonde të buxhetit të shtetit (nëpërmjet caktimit rregullisht në buxhetin e shtetit të fondeve për financimin e strukturave bashkërenduese dhe veprimtarive kryesore antitrafik, etj.) dhe nga burime të tjera financimi kombëtare, dhe që të ketë kapacitetin të përshtatet me lehtësi ndaj kushteve të ndryshueshme, nëpërmjet monitorimit, (vetë)vlerësimit dhe rishikimit.

SYNIMET STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Strategjia ndahet në pesë fusha:

1. Ndjekja penale,
2. Mbrojtja,
3. Parandalimi,
4. Bashkërendimi,
5. Fëmijët.

Synimet strategjike si edhe objektivat specifike nëpërmjet të cilëve do të arrihen synimet strategjike janë si më poshtë (sipas fushës së ndërhyrjes):

I. NDJEKJA PENALE

1. Synimi strategjik: Rritja e numrit të çështjeve penale të suksesshme (hetimeve, ndjekjeve penale, dënimeve të përshtatshme për të gjitha format e trafikimit të personave), nëpërmjet hetimeve dhe procedurave gjyqësore të drejta dhe të ndjeshme ndaj viktimave, dhe që garantojnë të drejtat e viktimave të trafikimit.

OBJEKTIVA SPECIFIKË:

1. (a) Rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe identifikimeve proaktive të viktimave të trafikimit si brenda ashtu edhe jashtë vendit (përfshirë hetimet financiare dhe ato për pastrimin e parave)

1. (b) Sigurimi i përputhjes së kuadrit ligjor dhe rregullator kombëtar mbi TjP në të gjitha format e tij, me standardet dhe praktikën evropiane dhe ndërkombëtare (të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Kombeve të Bashkuara) duke rishikuar legjislacionin sipas nevojave dhe duke përmirësuar zbatimin e tij

1.(c) Rritja e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë dhe prokurorëve në mënyrë që të përmirësohet bashkëpunimi dhe bashkërendimi mes policisë dhe prokurorisë, gjë që do të sjellë një përmirësim të luftës kundër trafikimit të personave.



1. (d) Përmirësimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes policisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve të drejtësisë penale, si dhe krijimi i një sistemi të unifikuar për menaxhimin dhe raportimin e informacionit dhe të dhënave.

1. (e) Përmirësimi i bashkëpunimit dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar ligjor, juridik dhe ligjzbatues në luftën kundër trafikimit të personave.

1. (f) Respektimi dhe forcimi i të drejtave të personave të trafikuar (VMT dhe VT) dhe sigurimi i trajtimit të drejtë, jodiskriminues, nga autoritetet ligjzbatuese dhe gjyqësore

2. Synim strategjik: Garantimi i kompensimit dhe dëmshpërblimit ligjor të viktimave të trafikimit

3. Synim strategjik: Garantimi i sigurisë fizike dhe mbrojtjes së të gjitha viktimave si dhe i mbrojtjes së posaçme të viktimave që paraqiten si dëshmitarë, në Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve

OBJEKTIVA SPECIFIKË

3. (a) Garantimi i sigurisë fizike dhe mbrojtjes së të gjitha viktimave të mundshme të trafikimit, pavarësisht nëse janë bashkëpunëtorë të drejtësisë

3. (b) Garantimi i mbrojtjes së posaçme për të gjitha viktimat që bashkëpunojnë me drejtësinë gjatë procedimeve penale (mbrojtje përpara gjyqit, gjatë gjyqit dhe pas gjyqit, përfshirë vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut), duke nxitur kështu më shumë persona të trafikuar që të bashkëpunojnë me institucionet e zbatimit të ligjit/gjyqësorin.

4. Synim strategjik: Ulja e përfshirjes së punonjësve të zbatimit të ligjit në trafikimin e personave.

2. MBROJTJA

1. Synim strategjik: Garantimi i identifikimit të hershëm dhe referimit të të gjithë të miturve dhe të rriturve si viktimat të mundshme trafikimi dhe viktimat e trafikut për qëllime shfrytëzimi, dhe referim i menjëhershëm pranë shërbimeve të duhura të asistencës, bazuar në nevojat individuale në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të) e miratuara.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

1. (a) Rritja e funksionimit efikas të “Mekanizmit Kombëtar të Referimit” dhe shtrirja e tij në nivel qarku dhe bashkie (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese) dhe identifikimin e personave të trafikuar në përputhje me standardet dhe PSV-të në

zbatim.

1. (b) Forcimi i kapaciteteve të të gjitha strukturave/aktorëve të përfshirë në parandalimin, identifikimin, referimin dhe asistencën ndaj personave vulnerabël dhe personave të trafikuar, në përputhje me PSV për identifikimin dhe referimin.

1.(c) Nxitja e zbatimit të PSV-ve për identifikimin dhe referimin e viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të trafikimit nëpërmjet monitorimit dhe sigurimit të përshtatshmërisë së tyre nëpërmjet shqyrtimit të standardeve dhe PSV-ve.

1.(d) Rritja e identifikimit dhe referimit të hershëm të të gjitha viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit dhe për të gjitha format e shfrytëzimit brenda vendit, në kufi, jashtë vendit, si dhe rritja e vetidentifikimit të personave të trafikuar.

2. Synim strategjik: Garantimi i aksesit për asistencë gjithëpërfshirëse, mbrojtje dhe shërbime për të gjitha viktimat e mundshme të trafikimit dhe për të gjitha viktimat e trafikimit, sipas nevojave dhe preferencave individuale (në streha ose komunitet) dhe pavarësisht dëshirës së tyre për të bashkëpunuar me strukturat e zbatimit të ligjit

OBJEKTIVA SPECIFIKË

2. (a) Ofrimi i asistencës së menjëhershme, në momentin e identifikimit, për të gjithë VT dhe VMT, në përputhje me nevojat individuale që ata kanë.

2. (b) Garantimi dhe qëndrueshmëria e ofrimit të shërbimeve gjithëpërfshirëse dhe të përshtatshme për viktimat e mundshme të trafikimit dhe viktimat e trafikimit në strehëza ose jashtë, përfshirë asistencë sociale, mjekësore, psikologjike dhe ligjore, si dhe garantimi i respektimit të procedurave kombëtare të përcaktuara dhe PSV-ve.

2. (c) Garantimi i sigurisë fizike për të gjithë personat e trafikuar (VMT dhe VT).

3. Synim strategjik: Nxitja e kthimit dhe riintegritetit dhe përfshirjes sociale të të miturve dhe të rriturve si persona të trafikuar (VMT dhe VT) dhe ulja e rrezikut për personat e trafikuar për t'u riviktimizuar dhe rritrafikuar, ose që të kthehen në trafikues.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

3. (a) Nxitja e kthimit vullnetar dhe riintegritetit të VMT dhe VT shqiptarë nga jashtë; dhe kthimi i personave të huaj të trafikuar;



3. (b) Forcimi i programeve për dhënie e asistencës afatgjatë me qëllim riintegrimin dhe përfshirjen shoqërore të të rriturve dhe të miturve që janë VMT dhe VT, në përputhje me nevojat individuale dhe me PSV-të;

3. (c) Rritja e zbatimit të PSV-ve për kthimin vullnetar dhe riintegrimin/përfshirjen sociale të viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të trafikimit nëpërmjet monitorimit (në përputhje me MKR/PSV për monitorimin e identifikimit dhe referimit).

3. PARANDALIMI

1. Synim strategjik: Rritja e ndërgjegjësimit publik mbi të gjitha format e trafikimit të personave (trafikimi i brendshëm, shfrytëzimi i punës, lypja nga fëmijët, etj.) si dhe pasojat e tij.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

1. (a) Rritja e ndërgjegjësimit mbi trafikimin e personave dhe pasojat e tij mes popullsisë në përgjithësi, si dhe rritja e rolit të medias në parandalimin e trafikimit nëpërmjet ndërgjegjësimit publik;

1. (b) Rritja e ndërgjegjësimit mbi trafikimin e personave dhe pasojat/rreziqet e tij, tek grupet e identifikuar si “në rrezik”;

1. (c) Përmirësimi i ndërgjegjësimit të fëmijëve dhe të rinjve mbi trafikimin dhe rreziqet/pasojat e tij;

1.(d) Rritja e ndërgjegjësimit të aktorëve shtetërorë dhe joshetërorë që punojnë me grupet “në rrezik”, përfshirë punonjësit e shëndetit publik mbi kontributin e specialistëve të shëndetit në lidhje me identifikimin fillestar, asistencën shëndetësore dhe referimin e VT/VMT; si dhe klientët/shfrytëzuesit e mundshëm.

2. Synim strategjik: Ulja e cenueshmërisë nga trafikimi i personave

OBJEKTIVA SPECIFIKË

2. (a) Rritja e mundësive ekonomike dhe mundësive të tjera fitimprurëse për grupet e viktimave të mundshme (*shih Strategjinë e Përfshirjes Sociale*);

2. (b) Përmirësimi i përfshirjes sociale të grupeve të viktimave të mundshme.

3. Synim strategjik: Garantimi i mekanizmeve parandalues dhe mbrojtës si dhe dhënie e ndihmës në nivel bashkie, duke iu shërbyer grupeve/personave viktimë të mundshme si dhe viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

3. (a) Krijimi/forcimi i një mekanizmi funksional në nivelin vendor për parandalimin (identifikimin e personave viktimë të mundshme, si dhe ndërhyrjet parandaluese dhe mbështetëse), si dhe identifikimin, referimin dhe dhënie e ndihmës ndaj personave të trafikuar;

3. (b) Garantimi i shërbimeve psiko-sociale, ligjore, shëndetësore dhe mbështetëse së përshtatshme për viktimat e mundshme dhe grupet/personat e trafikuar, për riintegrimin e tyre në shoqëri, duke përfshirë shërbime për parandalimin e krizave, si lehtësimi i përdorimit të shërbimeve sociale, ndihma sociale, strehimi, aftësimi për jetën, shpërndarja e informacionit tek grupet dhe personat në nevojë;

4. Synim strategjik: Shkurajimi i trafikimit të mundshëm të personave dhe eliminimi i situatave aktuale të trafikimit shfrytëzues nëpërmjet masave administrative.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

4. (a) Sigurimi i normimit dhe monitorimit të të gjithë sektorëve të shoqërisë që mund të ndikohen nga trafikimi, si dhe parandalimi/identifikimi nëpërmjet masave në kufi;

4. (b) Detyrimi i zbatimit të kërkesave për regjistrim në gjendjen civile (dokumentacioni i ligjshëm për lindjet, shtetësinë dhe martesën) në mënyrë që të lehtësohet përfshirja sociale dhe përfshirja në sistemin arsimor.

4. BASHKËRENDIMI

1. Synim strategjik: Bashkërendimi i të gjitha masave antitrafik dhe bashkëpunimi i frytshëm mes të të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit në Shqipëri dhe veçanërisht me Mekanizmin e Dhunës në familje dhe Mekanizmin e Dhunës ndaj Fëmijëve.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

1. (a) Garantim i mbikëqyrjes së vazhdueshme të të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave dhe i projekteve/masave të marra në vend, si dhe nxitja e shkëmbimit të informacionit mes të gjitha organizatave partnere, shtetërore dhe joshetërore;

1.(b) Funksionimi efikas i kuadrit bashkërendues dhe bashkëpunues për të mundësuar përcaktimin e politikave dhe standardeve, monitorimin dhe shqyrtimin, si dhe mekanizma efikas menaxhimi çështjesh për identifikimin, referimin, mbrojtjen, ndihmën,



integrimin dhe riintegrimin e personave të trafikuar (viktima dhe viktima të mundshme të trafikimit) nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR), duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë përkatëse, si dhe ndarjen e detyrave dhe mekanizmat e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes të gjithë aktorëve në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, si dhe duke forcuar kapacitetet e organeve bashkërenduese;

1. (c) Forcimi i luftës antitrafik në nivel rajonal dhe në nivel bashkie;

1. (d) Ndërgjegjësimi i të gjithë vendit mbi Strategjinë Antitrafik dhe Planin Kombëtar të Veprimit, si dhe garantimi që rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të jenë kuptuar qartë dhe të nxisin zbatimin e strategjisë/planit kombëtar të veprimit.

2. Synim strategjik: Garantimi që i gjithë informacioni dhe të dhënat e nevojshme për vlerësimin e trafikimit të personave dhe për luftën dhe parandalimin e suksesshëm të tij ekziston, është i përdorshëm nga të gjithë aktorët e përfshirë dhe shkëmbehet rregullisht si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

2. (a) Krijimi i mekanizmit për shpërndarjen e informacionit dhe të dhënave, në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, me përkufizimet e rena dakord dhe për të dhënat kryesore të përcaktuara;

2. (b) Rritja e kërtimeve mbi të gjitha format e trafikimit të personave si dhe mbi të gjitha fushat e luftës antitrafik.

3. Synim strategjik: Përmirësimi i vazhdueshëm i luftës antitrafik në nivelet strategjike dhe operacionale, dhe përshtatja e tyre me kërkesat e reja dhe rrethanat e ndryshuara, duke krijuar/forcuar një sistem për shqyrtimin, monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të strategjisë dhe PKV antitrafik.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

3. (a) Garantimi i mbledhjes dhe analizës sistematike dhe të vazhdueshme të të gjitha informacioneve dhe të dhënave me interes në nivelet operacionale dhe strategjike në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, për krijimin/forcimin e një mekanizmi funksional në nivel vendor për parandalimin (identifikimin e personave viktima të mundshme, si dhe ndërhyrjet parandakuese dhe

mbështetëse), si dhe identifikimin, referimin dhe dhënien e ndihmës ndaj personave të trafikuar;

3. (b) Vlerësimi rregullisht i të gjitha veprimtarive të parashikuara në PKV;

3. (c) Garantim i shqyrtimit rregullisht të të gjitha veprimtarive të parashikuara në PKV dhe i rishikimit/përditësimit të strategjisë/PKV 2014-2017 duke u mbështetur tek gjetjet e shqyrtimit.

4. Synim strategjik: Sigurimi i të gjitha burimeve të nevojshme për zbatimin e Strategjisë Kombëtare Antitrafik dhe PKV-së, si dhe për rritjen e pjesës së fondeve shtetërore dhe burimeve financuese të tjera shtetërore në fondin e përgjithshëm për zbatimin e strategjisë/PKV-ve.

5. FËMIJËT

Në kuadër të njohjes së sfidave të posaçme dhe detyrimeve në lidhje me trafikimin e fëmijëve dhe trajtimin e fëmijëve, Strategjia përmban një seksion ku përmbledhen veprimet specifike të nevojshme për përmbushjen e këtyre detyrimeve.

Siç është përmendur edhe më lart, Strategjia Kombëtare dhe Plan i Veprimit kundër Trafikimit të Personave 2014-2017 në lidhje me fëmijët mbështetet në instrumentet kryesore ndërkombëtare për mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve, viktima të trafikimit. Ndër më kryesoret është Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijës (1989). (për më shumë hollësi shih seksionin “Parimet”):

NDJEKJA PENALE

1. Synim strategjik: Rritja e numrit të ndjekjeve penale të suksesshme, si dhe masave të duhura të dënimit për të gjitha format e trafikimit të fëmijëve, dhe mundësimi i procedimeve penale të duhura e të ndjeshme ndaj fëmijëve, të cilat garantojnë të drejtat dhe interesin e fëmijës.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

1. (a) Sigurimi i përputhjes së bazës ligjore e rregullatore kombëtare mbi trafikimin e personave në të gjitha format, me standardet dhe praktikat evropiane dhe ndërkombëtare (të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Kombeve të Bashkuara) duke ndryshuar legjislacionin sipas nevojës, si dhe përmirësimi i zbatimit të legjislacionit aktual.

1. (b) Zbatimi i standardeve dhe procedurave standarde të veprimit (PSV-ve) për trajtimin e ndjeshëm të viktimave fëmijë gjatë hetimeve dhe



procedimeve penale, nëpërmjet specializimit dhe përmirësimit të aftësive të punonjësve përkatës, si dhe garantimi i të drejtave të fëmijës për kompensim dhe dëmshpërblim ligjor.

MBROJTJA

1. Synim strategjik: Identifikimi, referimi dhe dhënia e mbrojtjes dhe asistencës për riintegrim fëmijëve në rrezik dhe fëmijëve viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit, në përputhje me PSV-të për trajtimin e fëmijëve.

OBJEKTIVA SPECIFIKË

1. (a) Përmirësimi i zbatimit të PSV-ve për trajtimin e fëmijëve viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit, si dhe monitorimi nga afër i zbatimit të tyre;

1. (b) Identifikimi i fëmijëve viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit dhe referimi i tyre tek shërbimet e duhura si dhe për mbrojtje;

1. (c) Nxitja e riintegritit dhe përfshirjes sociale të fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit, si dhe ulja e rrezikut të riviktimizimit dhe ritrafikimit, nëpërmjet sigurimit të mbështetjes së specializuar për riintegrim, të fokusuar tek familja dhe të mbështetur tek komuniteti, në përputhje me standardet e rena dakord dhe me PSV-të.

PARANDALIMI

1. Synim strategjik: Garantimi i një mjedisi mbrojtës dhe mbështetës për fëmijët dhe familjet e tyre, dhe sigurimi i ndihmës parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese për personin e synuar.

POLITIKAT NË MBËSHTETJE TË KËSAJ STRATEGJIE

Disa prej synimeve të kësaj strategjie në lidhje me parandalimin e trafikimit të personave duke ulur cenueshmërinë, rritur mbrojtjen, ndihmën për riintegrim ndaj personave të trafikuar varen gjerësisht nga një sërë sektorësh dhe politikash ndërsektoriale, përfshirë ato në fushat e arsimit, punësimit, përfshirjes dhe mbrojtjes sociale, zhvillimit dhe integritit, gjinisë, dhunës në familje, mbrojtjes së fëmijëve, antidiskriminimit, etj. Zgjerimi i shërbimeve sociale, përfshirja e suksesshme e pakicave romë e egjiptiane, rritja e mbrojtjes së fëmijëve, fuqizimi në përgjithësi i sistemeve të mbrojtjes sociale dhe strategjitë efikase për nxitjen e barazisë gjinore, pjesëmarrjen e grave në tregjet e punës dhe luftën efikase kundër dhunës në familje e

mbështetjen për gratë e dhunuara janë gjithashtu me rëndësi jetike për arritjen e synimeve të kësaj Strategjie, sidomos përsa i përket parandalimit dhe riintegritit të personave të trafikuar.

Në kuadër të Reformës së Shërbimeve Sociale, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR) në bashkëpunim me UNICEF po punon për krijimin e një sistemi shërbimesh sociale të integruara në një nivel të decentralizuar për trajtimin e çështjeve të fëmijëve, grave dhe grupeve vulnerabël. Duke marrë në konsideratë nevojën aktuale për hartimin e masave specifike për parandalimin dhe asistencën, për të përmbushur nevojat e personave të trafikuar apo që aktualisht janë në rrezik, parashikohet që fushat e veprimtarisë antitrafikim do të jenë pjesë e këtyre politikave dhe e programeve të aktorëve shtetërorë, dhe sidomos e sistemeve të asistencës dhe mbrojtjes sociale.

PËRKUFIZIMET E PËRDORURA NË KËTË STRATEGJI

Për qëllimet e kësaj strategjie:

Trafikim i personave nënkupton “rekrutimin, transportimin, transferimin, fshehjen ose pritjen e personave nëpërmjet kërcënimit, përdorimit të forcës e formave të tjera të shtrëngimit, mashtrimit, marrjes me forcë, dredhisë ose abuzimit të pushtetit ose të pozitës vulnerabël ose dhënien apo marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që kontrollon një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi. Shfrytëzimi përfshin, së paku, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose format e tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktikatat e ngjashme me skllavërinë, heqjen e organeve ose servitudet” (neni 3. (a) i Protokollit të Palermos)¹¹⁶, brenda apo jashtë vendit.

Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e një fëmije për qëllime shfrytëzimi, do të konsiderohet “trafikim i personave” edhe nëse në të nuk përfshihen mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a) të nenit 3 të Protokollit të Palermos (shih paragrafin e parë); për më tepër,

¹¹⁶ Protokollit i OKB për Parandalimin, goditjen dhe ndëshkimin e trafikimit të qenieve njerëzore, sidomos grave dhe fëmijëve, në mbështetje të Konventës së OKB kundër Krimit të Organizuar trans-nacional (2000), [neni 3 (a)]; si dhe neni 110.a dhe neni 114.b i Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë



pëlqimi i fëmijës viktimë e trafikimit për shfrytëzimin e planifikuar nuk merret parasysh, edhe nëse nuk janë përdorur mjetet e parashikuara në nënparagrafin (a) të nenit 3.¹¹⁷

Fëmijë është çdo person nën moshën 18 vjeç;¹¹⁸

Viktimë trafikimi: çdo person i cili është subjekt i trafikimit të personave, sipas përkufizimit më lart¹¹⁹; si edhe personat e trafikuar të identifikuar zyrtarisht nga grupi/struktura përgjegjëse për Identifikimin Formal të Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR) të Shqipërisë, në përputhje me “Procedurat Standarde të Veprimit për Identifikimin dhe Referimin e Viktimave dhe Viktimave të Mundshme të Trafikimit”¹²⁰

Viktimë e mundshme e trafikimit i referohet çdo personi që nga agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikimin fillestar të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, është konsideruar si i trafikuar.¹²¹

Një fëmijë i pashoqëruar është çdo fëmijë që udhëton pa prindërit apo pa një kujdestar të ligjshëm.¹²²

Termat persona/grupe vulnerabël, dhe personat/grupet në rrezik trafikimi, janë një grup më i gjerë personash me një mundësi apo rrezik më të madh për t’u trafikuar, bazuar në ekzistencën e disa faktorëve të caktuar të rrezikut, si p.sh. papunësi, varfëri, dhunë në familje, familje me një prind, numri i anëtarëve të familjes, etj. Këto kritere do të përcaktohen nga ZKKA me aktorët përkatës.

Baza ligjore e rregullatore shqiptare dhe ndërkombëtare për trafikimin e personave dhe trafikimin e fëmijëve mund të gjendet tek shtojca.

¹¹⁷ Shih edhe udhëzimet e UNICEF për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve VT të Evropës Juglindore (2003)/instrumente të tjera të OKB dhe ndërkombëtare.

¹¹⁸ Neni 3 (d)] i Protokollit të Palermos

¹¹⁹ Shih Protokollin e Palermos, Konventën e KE-së mbi veprimin kundër TiP, neni 4 (e); ligji nr. 9642 i 20 nëntorit 2006, “Mbi ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës”, neni 4 (e).

¹²⁰ Procedurat Standarde të Veprimit për identifikimin dhe referimin e VT dhe VMT, Ministria e Brendshme, ZKKA, Tiranë 2011.

¹²¹ Si më lart.

¹²² Neni 3.11 i ligjit nr. 9959, datë 17.7.2008

IV. FINANCIMI

Qeveria e Shqipërisë e pranon përgjegjësinë për zbatimin e kësaj strategjie që ka si synim parandalimin dhe goditjen e trafikimit të personave, dhe si rrjedhojë edhe atë të sigurimit të fondeve të nevojshme për zbatimin e saj.

Aktualisht, një pjesë e konsiderueshme e burimeve që nevojiten për zbatimin e masave kryesore të kësaj strategjie dhe PKV në lidhje me identifikimin e personave të trafikuar dhe dhënien e shërbimeve dhe asistencës për riintegrim afatgjatë mbulohen me fonde të donatorëve të jashtëm. Për shkak se fondet e donatorëve po reduktohen gradualisht, një synim i menjëhershëm i kësaj strategjie është krijimi i një baze të qëndrueshme financimi për këto veprimtari, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe burimeve të tjera kombëtare të financimit. Strategjia është hartuar në përputhje dhe në koherencë të plotë me PBA-në, i cili parashikon periudhën kohore 2014-2017.

Duke miratuar këtë Strategji dhe Plan Veprimi 2014-2017, të gjithë aktorët angazhohen të sigurojnë zbatimin e detyrave të përfshira në këtë dokument dhe nën përgjegjësinë e tyre përkatëse, përfshirë sigurimin e burimeve të kërkuara. Si rrjedhojë në PKV janë parashikuar masa për të siguruar përfshirjen e masave antitrafik në buxhetet individuale të institucioneve përkatëse shtetërore, si dhe për të parashikuar dhënien e buxheteve të posaçme p.sh. për veprimtari që do të porositen nga ata apo për të cilat nevojiten burime shtesë, jo të zakonshme.

Plani i Veprimit bashkëngjitur përmban vetëm burimin e buxhetit, por jo koston e saktë të çdo mase; parashikohet që në vitin 2015 të hartohen raporte të plota buxheti dhe shpenzimesh dhe të hartohen modele financimi të qëndrueshëm për antitrafikimin, duke përfshirë Fondin e Posaçëm të krijuar nga pasuritë e sekuestruara, i cili mund të përdoret si për mbështetjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit, ashtu edhe për ofrimin e shërbimeve personave të trafikuar.

V. LLOGARIDHËNIA

Zbatimi

Komiteti Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Personave ka përgjegjësinë e përgjithshme për reagimin ndaj trafikimit, nëpërmjet Task Forcës Kombëtare për Trafikimin e Personave (përfshirë të gjitha palët e interesuara shtetërore ose joshetërore në lidhje me



antitrafikimin) dhe nën bashkërendimin e Zyrës së Koordinatorit Kombëtar Antitrafik (e përbërë nga Koordinatori Kombëtar dhe Njësia Antitrafik).

Të gjithë aktorët shtetërorë ose jo, të përmendur në Strategji dhe Planin e Veprimit, janë secili përgjegjës për zbatimin e veprimtarive të tyre përkatëse sipas PKV. Organet e pushtetit vendor dhe rajonal do të marrin një rol të rëndësishëm në forcimin e reagimit ndaj trafikimit në nivel vendor, duke garantuar disponueshmërinë e mbështetjes dhe masave të asistencës të parashikuara në këtë PKV (nëpërmjet planifikimit rajonal dhe planeve të veprimit për trafikimin e personave) dhe duke garantuar që personat e trafikuar do të identifikohen, asistohen dhe mbrohen, si dhe do të marrin mbështetje që mundëson riintegrimin e tyre në shoqërinë shqiptare.

Procesi i zbatimit do të orientohet drejt arritjes së synimeve, objektivave dhe veprimtarive strategjike të specifikuara në këtë dokument.

Monitorimi dhe vlerësimi

Rritja e përgjegjësisë nëpërmjet prezantimit të një sistemi për monitorimin dhe zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për antitrafikimin është përparësi e deklaruar e strategjisë aktuale. Masat konkrete për monitorimin dhe zbatimin e standardeve dhe procedurave për trajnimin e personave të trafikuar në njërën anë, dhe e gjithë strategjia/PKV në anën tjetër, formojnë një pjesë përbërëse të kësaj strategjie/PKV. Një sistem ekzistues për monitorimin do të ndihmonte në vazhdimin e zbatimit dhe gjithashtu është një parakusht për vlerësimet e rregullta, (vetë)-vlerësimet dhe për rishikimin e reagimit ndaj trafikimit.

Përgjegjësia për monitorimin dhe zbatimin e kësaj Strategjie Kombëtare dhe Planit të Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave është e Komitetit Shtetëror për Luftën kundër Trafikimit të Personave nëpërmjet Zyrës së Koordinatorit Kombëtar, dhe me përfshirjen e Taks Forcës Kombëtare për Trafikimin e Personave.

Zyra e Koordinatorit Kombëtar (ZKKA), me mbështetje të Task Forcës Kombëtare për Trafikimin e Personave do të hartojë një plan për monitorimin dhe vlerësimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit, duke marrë në konsideratë edhe udhëzimet ekzistuese për monitorimin e strategjive

ndër-sektoriale¹²³. Monitorimi do të bëhet bazuar në përfundimet e treguesve (sipas PKV), sipas një modeli të përcaktuar nga Task Forca Kombëtare për Trafikimin e Personave, bazuar në vlerësimin e situatës, i planifikuar për të mbuluar të gjithë vendin. Task-Forca do të hartojë termat e referencës për monitorimin e Strategjisë. Raportet monitoruese vjetore, do të hartohen nga Zyra e Koordinatorit Kombëtar, duke mbledhur informacione nga strukturat shtetërore dhe joshetërore, organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare që operojnë në fushën e trafikimit.

Është parashikuar që çdo aktor, shtetëror ose jo, i cili ka detyrime sipas kësaj strategjie, do të raportojë pranë ZKKA çdo tre muaj mbi punën e tyre për zbatimin e PKV, bazuar në planet e tyre të punës dhe planet e monitorimit (duke mbuluar të gjitha veprimtaritë e asaj ministrie/institucioni, përfshirë treguesit e performancës), në përputhje me modelet e miratuara të monitorimit.

Gjithashtu, është parashikuar vlerësimi i zbatimit të strategjisë/PKV, duke angazhuar një vlerësues të pavarur dhe/ose duke kryer një vetëvlerësim (Task Forca Kombëtare për Trafikimin e Personave).

Rishikimi i Strategjisë

Strategjia ka afat deri në vitin 2017. Ajo do të rishikohet në fund të vitit 2017 për të përcaktuar suksesin e saj, duke matur progresin në lidhje me arritjet e synimeve strategjike të parashikuara dhe objektivave specifike. Bazuar në përfundimet e rishikimit do të përgatitet një strategji/PKV e rishikuar.

VI. SHTOJCA: KUADRI LIGJOR DHE RREGULLATOR

Aktet ligjore

- Ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Për Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

Ligji nr. 8920, datë 11.7.2002, “Për ratifikimin e Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Krimit të Organizuar Ndërkombëtar dhe dy protokolleve shtesë të saj”;

- Ligji nr. 9188, datë 12.2.2004, shtesa për Kodin Penal ka prezantuar veprën penale të trafikimit të femrave dhe trafikimit të të miturve. Ligji prezanton përkufizime të reja për veprën e

¹²³ Shiko urdhrin e Kryeministrit nr. 137, datë 1.7.2010 “Për zbatimin e Procesit të Monitorimit të Strategjive Sektoriale dhe ndërsektoriale”.



trafikimit në përputhje me Protokollin e Palermos për Trafikimin;

- Ligji nr. 9187, datë 12.2.2004 “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Penale në lidhje me përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit si: përgjimet, agjentët e infiltruar, etj., përdorur për hetimin e krimit të organizuar përfshirë edhe trafikimin e personave;

- Ligji nr. 9284, datë 30.9.2004 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar”, i cili parashikon sanksione penale, si dhe konfiskimin e pasurive të trafikantëve;

- Ligji nr. 9355, datë 10.3. 2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, të ndryshuar. Me këtë ligj bashkitë kanë kompetencë të financojnë shërbime të ofruara nga OJF-të me fondet e buxhetit të shtetit;

- Ligji nr. 9544, datë 29.5.2006 “Për ratifikimin e Marrëveshjes midis Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Greke, për mbrojtjen dhe asistencën për fëmijët viktime të trafikimit”;

- Ligji nr. 9642, datë 20.11.2006 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për veprim kundër trafikimit të qenieve njerëzore”;

- Ligji nr. 9668, datë 18.12.2006, “Për migrimin e shtetasve shqiptarë për motive punësimi”. Disa nene të këtij ligji lidhen me parandalimin e trafikimit të personave dhe lehtësimin e riintegrit në tregun e punës;

- Ligji nr. 9686, datë 26.02.2007 “Për disa ndryshime në nenin 298 të Kodit Penal” mbi ndihmën për kalimin e paligjshëm të kufirit”;

- Ligji nr. 9833, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve për përfshirjen e fëmijëve në konflikte të armatosura”;

- Ligji nr. 9834, datë 22.11.2007 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Protokollin Opsional të Konventës së OKB-së për të drejtat e fëmijëve, për shitjen e fëmijëve, prostitucionin e fëmijëve dhe pornografinë e fëmijëve”;

- Ligji nr. 9749, datë 4.6. 2007 “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar;

- Ligji nr. 9859, datë 21.1.2008 Për disa shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal ku nenet e shtuara janë neni 124/b, “Keqtrajtimi i fëmijëve”, i cili midis të tjerave kriminalizon fenomenin e shfrytëzimit të fëmijëve për punë të detyruar, lypje

dhe shërbime të tjera të detyruara; paragrafi që u shtua në nenin 117 “Pornografia” në lidhje me pornografinë e të miturve, si dhe amendimi i nenit 128/b “Trafikimi i të miturve”, i cili kriminalizon me ligj jo vetëm rekrutimin, fshehjen, marrjen e fëmijëve, por edhe shitjen e tyre;

- Ligji nr. 10129, datë 11.5.2009 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar;

- Ligji nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar dhe trafikimit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”;

- Ligji nr. 10173, datë 22.10.2009 “Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë”;

- Ligji nr. 10347, datë 04.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”;

Ligji nr. 10301, datë 15.7.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, të ndryshuar;

- Ligji nr. 108/2013 “Për të huajt”;

Ligji nr. 144/2013, datë 2.5.2013 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”:

- Neni 114/a i KP për shfrytëzim e prostitucionit nën rrethana rënduese dhe Neni 114/b “Trafikimi i femrave” u shfuqizuan me ligjin e mësipërm, dhe nuk janë më në përputhje me nenet e trafikimit.

- Neni 110/a i KP “Trafikimi i personave ”: emri u ndryshua në “Trafikimi i personave të rritur”. Neni i ri i ndryshuar dallon trafikimin e brendshëm nga trafikimi ndërkufitar, duke i dhënë kështu fund diskutimeve ligjore në lidhje me zbatueshmërinë e këtij neni për rastet e trafikimit të brendshëm.

- Shtimi i një neni të ri i cili garanton ndalimin e ndjekjes penale për viktimat e trafikimit për përfshirjen e tyre në aktivitet kriminal, të cilin ato janë detyruar ta kryejnë si rrjedhojë direkte e të qenit subjekt i trafikimit (neni 52/a paragrafi (II)).

- Shtimi i nenit 110/b të KP për “Përfutimet nga ose përdorimi i shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar”, përfutimi apo përdorimi i shërbimeve të ofruara nga personat e trafikuar, apo i shërbimeve që janë objekt i shfrytëzimit nga trafikimi, duke pasur dijeni që personi është i trafikuar, dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.



- Shtimi i nenit 110/c i KP për “Veprimet që lehtësojnë trafikimin” përcakton se falsifikimi, zotërimi ose sigurimi i dokumentit të identitetit, i pasaportave, i vizave ose i dokumenteve të tjera të udhëtimit apo mbajtja, heqja, fshehja, dëmtimi ose shkatërrimi i tyre, që kanë shërbyer për trafikimin e personave mbi 18 vjeç, por pa pasur dijeni për këtë fakt, përbën vepër penale dhe dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet.

- Ligji nr. 143/2013 “Për disa shtesa në ligjin nr. 10 039 datë 22.12.2008 “Për ndihmën juridike”, i cili rregullon dhe lehtëson dhënien e ndihmës juridike falas për viktimat e dhunës në familje dhe viktimat e trafikimit;

- Ligji nr. 103/2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë”.

Aktet nënligjore:

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 11.2.2005 “Për miratimin e Strategjisë Kombëtare kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrotjes së Fëmijëve Viktima të Trafikimit”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 564 datë 12.8.2005, “Për licencimin e ofruesve të shërbimeve të përkujdesjes shoqërore”;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 25, datë 22.2.2005 “Për miratimin e Planit të Veprimit për periudhën 2005-2007 në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Luftës kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore”;

- Urdhër i Këshillit të Ministrave nr. 203, datë 19.12.2005 “Për funksionimin e Njesisë Antitrafik”;

Urdhri i Ministrit të Brendshëm nr. 282 datë 13.2.2006 “Për vendosjen e një numri telefoni pa pagesë për denoncimin e korrupsionit dhe procedurat e kryerjes së këtij aktiviteti në strukturat e Ministrisë së Brendshme për Drejtorinë e Kontrollit të Brendshëm”;

- Udhëzimi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës nr. 6, datë 29.3.2006 “Për regjistrimin e fëmijëve romë në shkollë, të cilët nuk kanë certifikatë lindje”;

- Urdhri i Kryeministrit nr. 139, datë 19.6.2006 “Për krijimin e Komiteteve Rajonale të Antitrafikimit”;

- Urdhri i përbashkët nr. 1192, datë 19.5.2006 i Ministrit të Brendshëm, Ministrit të Punëve të Jashtme dhe Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Mundësive të Barabarta për krijimin e

Autoritetit Përgjegjës për Mekanizmin Kombëtar të Referimit;

- Marrëveshje bashkëpunimi e grupit teknik të përbashkët, 20 shtator 2006, “Për të drejtat e fëmijëve” midis përfaqësuesve të institucioneve shtetërore (Ministria e Brendshme, MPÇSSHB, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Avokati i Popullit), OJF dhe donatorë të cilët merren me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve;

- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 632, datë 18.9.2003 “Për programin e nxitjes së punësimit të punëkërkesve të papunë, femra”;

- Urdhri nr. 645, datë 20.3.2006 “Për prioritetet e programit promocional të punësimit për vitin 2006”;

- Urdhri nr. 782, datë 4.4.2006 “Për tarifat e sistemit të formimit profesional”;

Sipas këtij urdhri, disa grupe njerëzish, përfshirë gratë dhe vajzat e trafikuar, përjashtohen nga pagesa e tarifave të regjistrimit për të ndjekur kurse profesionale për personat e papunësuar të regjistruar në zyrat e punësimit;

- Urdhri nr. 714 datë 3.11.2006 i Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë “Për procedurat e ndjekura për shtetasit shqiptarë dhe të huaj që kthehen nga vendet e tyre”.

Ky urdhër përcakton detyrat e oficerëve të Policisë Kufitare dhe Migrimit dhe Sektorit të Luftës kundër Trafikeve të Paligjshme në trajtimin e personave të kthyer, të identifikuar si viktimat e trafikimit dhe masat që duhen marrë;

- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 195, datë 11.4.2007 “Për miratimin e Standardeve të Shërbimeve të Përkujdesit Shoqëror, në qendrat rezidenciale, për personat e trafikuar ose në rrezik trafikimi”;

- Urdhri i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr. 871, datë 27.12.2007 “Për procedurat që duhen ndjekur për intervistimin e shtetasve të huaj dhe shqiptarë të kthyer nga vendet e tyre”;

- Urdhri i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë nr. 865, datë 26.12.2007 “Për hedhjen e të dhënave në një bazë të dhënash për viktimat e trafikimit”.

- Marrëveshja e Bashkëpunimit për Funksionimin e Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat dhe Viktimat e Mundshme të Trafikimit të Personave ndërmjet Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Punëve të



Jashtme, Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Prokurorisë së Përgjithshme, Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) –Tiranë, organizatës Ndërkombëtare “Eorl Vision”, organizatës jofitimprurëse “Arsis”, organizatës jofitimprurëse “Të ndryshëm dhe të Barabartë”, Qendrës Kombëtare Pritëse për Viktimat e Trafikimit, organizatës jofitimprurëse Qendra

Psiko-Sociale “Vatra”, Vlorë, organizatës jofitimprurëse “Tjetër Vizion”, Elbasan, datë 15.6.2012;

- Urdhër nr. 179, datë 19.6.2014 “Për ngritjen e Komitetit Shtetëror kundër Trafikimit të Personave”;

Udhëzimi i përbashkët nr. 3799, datë 8.7.2014 “Për ngritjen e autoritetit përgjegjës për identifikimin, referimin, mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit”.

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR LUFTËN KUNDËR TRAFIKIMIT TË PERSONAVE KUADRI OPERACIONAL 2014-2017

NDJEKJA PENALE

1. SYNIMI STRATEGJIK

Rritja e numrit të çështjeve penale të suksesshme (hetimeve, ndjekjeve penale, dënimeve për të gjitha format e trafikimit të personave), nëpërmjet hetimeve dhe procedurave gjyqësore të drejta dhe të ndjeshme ndaj viktimave dhe që garantojnë të drejtat e viktimave të trafikimit.

Treguesit: Numri i çështjeve penale (arrestime, ndjekje penale, dënime) sipas formës së shfrytëzimit; përqindja e arrestimeve që përfun-dojnë me dënime; përqindja e viktimave që paraqiten si dëshmitarë.

Synimi: Rritje e numrit të çështjeve penale me 30 %.

1. (a) OBJEKTIV SPECIFIK

Rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe identifikimeve të viktimave të trafikimit si brenda ashtu edhe jashtë vendit (përfshirë hetimet financiare dhe ato për pastrimin e parave).

Treguesit: Numri i viktimave të mundshme të trafikimit (VMT) dhe viktimave të trafikimit (VT) të identifikuar, numri i çështjeve penale dhe numri/përqindja e ndjekjeve penale për trafikim të nisura mbështetur në prova të mbledhura nga hetime pro-aktive; numri dhe përqindja e dënimeve të mbështetura në prova proaktive.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(a).1	Trajnim i vazhdueshëm për teknikat e hetimit pro-aktiv, për punonjësit e policisë antitrafik dhe prokurorët.	Prokuroria, Policia e Shtetit, Qendra e Formimit Policor, Shkolla e Magjistraturës, ON, OJF	Në vazhdimësi	Treguesit: Numri i punonjësve ligjzbatues të trajnuar profesionalisht për përdorimin e teknikave të hetimit të udhëhequra nga informacioni. Synimi: të paktën një punonjës policie në çdo Drejtori Policie Qarku ka njohuri mbi teknikat e hetimit pro-aktiv Numri i trajnimeve të përbashkëta dhe i të trajnuarve	Prokuroria PSH Shkolla e Magjistraturës
1.(a).2.	Trajnim mbi mbledhjen e informacionit të zbulimit të nivelit bazë për punonjësit e policisë (në nivelin e patrullës së përgjithshme) si pjesë e kurseve të trajnimit për fillestarët si dhe trajnim rifreskues Trajnim i vazhdueshëm i	Qendra e Formimit Policor SHISH	Në vazhdimësi	Numri dhe përqindja e punonjësve të policisë të cilët janë trajnuar për mbledhjen e informacionit të zbulimit të nivelit bazë në lidhje me rastet e trafikimit të personave (TiP)	PSH SHISH



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	punonjësve të SHISH, në kuadër të grumbullimit /mbledhjes së informacionit				
1.(a).3	Vazhdim i shkëmbimit të përvojave me agjencitë e huaja ligjzbatuese, nëpërmjet trajnimeve, vizitave studimore, pjesëmarrjes në projekte rajonale/ndërkombëtare, etj. Shkëmbimi i përvojave të SHISH me shërbimet partnere nëpërmjet trajnimeve, vizitave studimore, pjesëmarrjes në projekte rajonale/ndërkombëtare.	Policia e Shtetit/MPB, PP SHISH	Në vazhdimësi	Treguesit: Numri i personave që kanë përfituar nga trajnimet, seminarët, takimet, vizitat studimore dhe veprimtaritë rajonale/ndërkombëtare.	Policia e Shtetit/MPB, PP, SHISH nëpërmjet TAIEK, EUROPOL, donatorë
1.(a).4	Rritje e përdorimit të hetimeve financiare në çështjet antitrafikim (pastrimi i parave si dhe konfiskimi, ngrirja dhe sekuestrimi i pasurive, bashkëpunimi me SHISH).	Ministria e Financave/Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Prokuroria e Përgjithshme (PP) PSH/Drejtoria kundër Krimit Ekonomik, Doganat, SHISH	Në vazhdim	Numri dhe përqindja e çështjeve antitrafik ku përfshihen hetime financiare; Numri/sasia e pasurive të konfiskuara dhe të ngrira; numri i dënimeve penale për pastrim parash	MF/DPPPP, PP, PSH SHISH
1.(a).4.1.	Forcimi i bashkëpunimit në hetimet financiare antitrafikim mes Njësisë së Informacionit Financiar, PP dhe Njësisë për Krimet Ekonomike në PSH, nëpërmjet hartimit të procedurave standarde të veprimit (PSV-ve) dhe trajnimeve të përbashkëta. Dhënia e kontributit të SHISH në informimin paraprak për veprat e trafikimit të personave, në funksion të hetimit të këtyre veprave.	Ministria e Financave në bashkëpunim me PP, PSH/ Drejtoria kundër Krimit Ekonomik, SHISH	Gjysma e parë e 2015	Ekzistenca e PSV-ve Trajnime të organizuara Mbatja e takimeve të rregullta	Ministria e Financave PP PSH SHISH
1.(a).5	Forcimi i bashkëpunimit mes policisë, Inspektoratit Shtetëror të Punës (IshP) dhe Departamentit të Tatimeve SHIH TEK MBROJTJA 1. (d). 4.	PSH, IshP, MF me mbështetjen e OSBE-së	2014 - 2015	Takime të rregullta Trajnime, personeli i trajnuar	PSH, IshP, MF, OSBE

1.(b) OBJEKTIV SPECIFIK

Sigurimi i përputhjes së kuadrit ligjor dhe rregullator kombëtar mbi TtP në të gjitha format e tij, me standardet dhe praktikat evropiane dhe ndërkombëtare (të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Kombeve të Bashkuara) nëpërmjet rishikimit sipas nevojave të legjislacionit, si dhe garantimit të zbatimit të tij.

Treguesit: Numri dhe përqindja e hetuesve, prokurorëve dhe gjyqtarëve, të cilët janë të familjarizuar me trafikimin e personave, kontrabandimin, shfrytëzimin për punë, trafikimin e brendshëm, dhe që mund t'i përshkruajnë ato; numri i dënimeve për trafikim me qëllim punën e detyruar.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(b).1	Sigurimi i respektimit të klauzolës për mosdënimin e personave të trafikuar nëpërmjet: Ndryshimit të nenit 52/a të Kodit Penal në përputhje me klauzolën për mosdënimin e VT-ve të Konventës së Këshillit të Evropës për masat kundër trafikimit të personave.	PSH, PP, GJKR, MD ZKKA, PSH, PP, MD, partnerët	2015	Treguesit: neni 52/a i ndryshuar; Hyrja në fuqi e nenit të ndryshuar Numri i raportimeve për raste me VMT dhe VT të ri-viktimizuara, të ndaluara, ndjekura penalisht apo të paditura	Kosto administrative
1.(b).2	Ndryshimi i nenit 128/b mbi trafikimin e të miturve, që të përfshijë në mënyrë të qartë trafikimin e brendshëm.	ZKKA, MD, PSH, PP, partnerët	2015	Treguesit: Neni i ndryshuar; Hyrja në fuqi e nenit të ndryshuar	Kosto administrative
1.(b).3	Ndryshimi i Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që të garantojë aksesin në drejtësi dhe mbrojtjen e të drejtave të VT/VMT-ve në procedimet penale.	ZKKA, MD, PSH, PP, partnerët	2015	Tregues: Legjislacioni i ndryshuar parashikon: Këshillim ligjor falas për viktimat. VT si palë në procesin penal Prania e një punonjësi social/psikologu gjatë intervistimit të VT/VMT gjatë hetimit dhe gjykimit. Detyrimi i ligjzbatuesve të informojnë VT mbi të drejtat e tyre sa më herët të jetë e mundur gjatë fazës së hetimeve. Numri i VT-ve të cilët marrin këshillim ligjor falas. Numri i intervistave me VT me/pa praninë e punonjësit social/psikologut	Kosto administrative
1.(b).4	Ndryshim i Kodit të Procedurës Penale, për të siguruar të drejtën e kompensimit të viktimave në vendimin për konfiskim.	ZKKA, PP, MD Partnerët	2015	KPrP i ndryshuar Hyrja në fuqi e legjislacionit të ndryshuar Numri i vendimeve për kompensim	Kosto administrative
1.(b).5	Ndryshimi i nenit 114 (2) i KP në lidhje me shfrytëzimin e të miturve për prostitucion, për të siguruar harmonizimin me Konventën e KE-së mbi masat kundër trafikimit të personave	ZKKA, MD, PSH, Partnerët	2015	Treguesit: Shfuqizimi i paragrafit 2 të nenit 114 të KP Zbatimi i nenit 114/2.	Kosto administrative
1.(b).6	Ndryshimi i Ligjit për Policinë e Shtetit për të garantuar mbrojtjen e VMT dhe VT-ve.	PSH, ZKKA, MD	2014	Ligji për Policinë e Shtetit i ndryshuar. Ligji për Policinë e Shtetit parashikon të drejtën e VT dhe VMT-ve për mbrojtje, duke i përkufizuar ata si persona të cilët gëzojnë të drejtën për mbrojtje fizike.	Kosto administrative
1.(b).7	Udhëzimi i punonjësve të policisë të seksioneve të trafikeve të paligjshme, prokurorëve dhe gjyqtarëve mbi ndryshimet ligjore të sipërpërmendura, dhe sidomos mbi dallimet mes trafikimit të personave dhe kontrabandimit, trafikimit për shfrytëzim për punë dhe kontrabandimit apo punës së paligjshme, si dhe mes trafikimit të brendshëm dhe atij ndërkufitar	PP, PSH, GJKR, ZKKA	Fundi i 2015	Udhëzimet e hartuara dhe të shpërndara Organizimi i një trajnimit të	Kosto administrative PP, PSH, PKR



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	nëpërmjet: Trajnimit të trajnerëve për punonjës të policisë të seksioneve të trafikeve të paligjshme nga prokurorë të PKR/PP; Trajnimit të punonjësve të policisë të seksioneve të trafikeve të paligjshme nga punonjësit e trajnuar të PSH.		2015	brendshëm dyditor Numri i punonjësve të PSH të trajnuar për trajnerë Numri i punonjësve të PSH të trajnuar	

1. (c) OBJEKTIV SPECIFIK

Rritja e aftësive dhe kapaciteteve profesionale të punonjësve të policisë dhe prokurorëve në mënyrë që të përmirësohet bashkëpunimi dhe bashkë-rendimi mes policisë dhe prokurorisë, gjë që do të sjellë një përmirësim të hetimeve mbi trafikimin e personave.

Treguesit: Numri i punonjësve të policisë (meshkuj/femra) me kohë të plotë dhe të kualifikuar, kundër trafikimit të personave, në nivelin qendror dhe atë rajonal; lëvizjet/qëndrimi në detyrë i punonjësve antitrafik; numri i prokurorëve antitrafik të trajnuar dhe i gjyqtarëve të Gjykatës së Krimeve të Rënda; numri dhe cilësia e dosjeve hetimore të përgatitura nga oficerët e policisë gjyqësore (OPGj); numri i dënimeve përkundrejt numrit të ndjekjeve penale përkundrejt numrit të arrestimeve, në numra absolutë dhe në përqindje.

Synimi: Përmirësimi i cilësisë së akteve të hartuara nga OPGj-të. Deri në mes të 2015, një rritje e numrit dhe cilësisë së dosjeve hetimore, ndjekjeve penale të suksesshme dhe dënimeve, si dhe një numër më i madh arrestimesh që përfundojnë me ndjekje penale dhe dënime.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(c).1	Sigurimi i profesionalizmit dhe kapacitetit të Seksioneve Antitrafik në PSH në nivelin qendror dhe atë rajonal nëpërmjet personelit të mjaftueshëm dhe të kualifikuar/trajnuar, si dhe një numri të rritur të punonjësve femra dhe të kualifikuar.	Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) Qendra e Formimit Policor në bashkëpunim me Sektorin Antitrafik të DPPSH, PP me partnerët ndërkombëtarë	Në vazhdimësi	Treguesit: Numri i punonjësve të policisë të specializuar dhe me kohë të plotë të cilët luftojnë trafikimin e personave në nivelin qendror dhe rajonal Synimi: Të paktën një punonjëse policie femër, e trajnuar, është caktuar në çdo seksion antitrafik në drejtoritë e policisë në qarqe dhe në PKK-të kryesore.	DPPSH
1.(c).2	Furnizimi i seksioneve antitrafik të policisë me pajisjet e nevojshme.	DPPSh, partnerët	Në vazhdimësi	Pajisjet e nevojshme janë në dispozicion	DPPSH, partnerët
1.(c).3	Sigurimi i një bashkëpunimi të ngushtë dhe bashkërendimi e shkëmbimi informacioni të rregullt mes seksioneve antitrafik si dhe seksioneve për mbrojtjen e të miturve dhe dhunës në familje, nëpërmjet mbajtjes së takimeve rutinë (në ditë të caktuara fikse)	DPPSh	Në vazhdimësi	Shënimet e takimeve të zakonshme Numri i çështjeve të hapura për TIP nëpërmjet seksioneve për mbrojtjen e të miturve dhe dhunën në familje	DPPSH
1.(c).4	Zbatimi i politikave për rekrutimin në polici për të siguruar mbajtjen e punonjësve të policisë të specializuar për antitrafikimin në ato funksione	DPPSh	Në vazhdimësi	Regjistrat e personelit tregojnë një mesatare të qëndrimit në punë në njësitë qendrore dhe të specializuara për antitrafikimin prej të	DPPSH



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	për të paktën 3 vjet.			paktën 3 vjetësh	
1.(c).5	Vazhdimi i trajnimit bazë ndërgjegjësues për të gjithë prokurorët dhe gjyqtarët e ardhshëm si dhe i trajnimit të rregullt, të specializuar e të përbashkët për punonjësit e policisë antitrafik, prokurorët dhe gjyqtarët e Krimeve të Rënda.	Shkolla e Magjistraturës, PP, Qendra e Formimit Policor, me partnerët	Në vazhdimësi	Numri i të trajnuarve në nivel fillestar (për hyrje) në vit Numri i seancave të përbashkëta të trajnimit (për një vit), si dhe ndarja e pjesëmarrësve sipas institucioneve	Shkolla e Magjistraturës, PP, Qendra e Formimit Policor, partnerët
1.(c).6	Nxitiqja e zbatimit të procedurave standarde të veprimit (PSV) gjatë hetimeve antitrafik nëpërmjet trajnimit dhe monitorimit.	Prokuroria e Përgjithshme (PP), PSH	Në proces	Numri i trajnimeve mbi PSV-të Formati tip dhe standardet e cilësisë për dosjen hetimore Raportet e monitorimit Numri dhe përqindja e aktorëve përkatës të cilët njohin dhe zbatojnë PSV-të	Kosto administrative
1.(c).7	Rishikimi i manualit/udhëzimeve të posaçme për hetimet antitrafik për OPGj-të dhe njësitë e specializuara të policisë si dhe shpërndarja e versionit të përditësuar tek OPGj-të dhe njësitë e tjera të specializuara të policisë. Hartimi i varianteve të përditësuara në intervale të rregullta. Trajnimi i brendshëm i OPGj-ve mbi praktikën më të mira të hetimit.	PP, DPPSH	Brenda 2014 2016 Në vazhdimësi	Ekzistenca e manualit të përditësuar Mbajtja e takimeve për prezantimin e manualit Numri i OPGj-ve dhe njësitë të tjera të specializuara të policisë të cilët janë të familjarizuar me përmbajtjen e manualit dhe e zbatojnë atë Varianti i përditësuar i radhës i përfunduar në vitin 2016 Trajnime të organizuara Numri i të trajnuarve	Kosto administrative
1.(c).8	Kryerja e trajnimeve në vazhdimësi në lidhje me zbatimin e detyrimeve që rrjedhin nga Kodi i Procedurës Penale për krijimin e dosjeve (akteve) hetimore, si dhe mbledhjen e provave nga OPGj-të.	PP, DPPSH, Qendra e Formimit Policor	Në vazhdimësi	Tregues: Numri i akteve që janë në përputhje me PSV-të dhe dispozitat e KPP, të krijuara dhe referuara nga OPGj-të Numri dhe përqindja e OPGj-ve të trajnuar	Kosto administrative
1.(c).9	Bashkërendimi i veprimeve mes OPGj-ve – prokurorëve të Krimeve të Rënda dhe mes prokurorëve të rretheve – prokurorëve të Krimeve të Rënda.	PP, Prokuroria e Krimeve të Rënda (PKR)	Në vazhdimësi	Numri i çështjeve të referuara nga prokuroritë e rretheve tek PKR-ja. Mbajtja e takimeve të rregullta	Kosto administrative
1.(c).10	Përmirësimi i bazës së të dhënave për VMT dhe VT mbështetur në analizën dhe raportimin e të dhënave	ZKKA	Brenda 30 ditësh nga miratimi i Planit të Veprimit Antitrafik	Shqyrtimi i kryer Shqyrtimi me rekomandimet për përmirësimin e sistemit është i shpërndarë për informim dhe veprim	ZKKA
1.(c).11	Mirëmbajtja e një sistemi të unifikuar të dhënash mbi çështjet penale të trafikimit (për të ndjekur të gjitha çështjet penale nga hetimi, gjykimi, shpallja fajtor dhe dënimi), që të përdoret bashkërisht nga prokuroria dhe policia (këta të fundit do të kenë akses të kufizuar)	PP, DPPSH, MD.	2015	Baza e të dhënave mbi çështjet penale është funksionale dhe në dispozicion të prokurorëve dhe punonjësve të specializuar të policisë Disponueshmëria e raporteve	PP, DPPSH, MD.



1. (d) OBJEKTIV SPECIFIK

Përmirësimi i bashkëpunimit dhe bashkërendimit mes policisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe institucioneve të drejtësisë penale, si dhe krijimi i një sistemi të unifikuar për menaxhimin dhe raportimin e informacionit dhe të dhënave.

Treguesit: Ekzistenca e raporteve të përbashkëta, ndër-institucionale statistikore dhe vlerësuese, ku përfshihet numri i hetimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve.

Synimi: Bashkëpunim i përmirësuar mes policisë, prokurorisë dhe gjykatave për shkëmbimin, hartimin dhe analizimin e të dhënave për arrestimet, ndjekjet penale dhe dënimet, dhe një vlerësim i përbashkët i të dhënave; statistika ndër-institucionale për arreste, ndjekje penale, dënime dhe vendime penale e apele në çështje trafikimi, ku të përfshihen të dhëna mbi numrin, gjininë, moshën, shtetësinë dhe statusin e viktimave.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(d).1	Krijimi i Task Forcës për Analizimin e Integruar të Çështjeve të Mbyllura të Trafikimit të Personave për garantimin e një qasjeje multiinstitucionale për shqyrtimin e detajuar dhe përmirësimin cilësor të veprimeve antitrafik.	ZKKA, PSH, PKR, GjKR e Shkallës së parë, partnerët	Tremujori i fundit i 2014	Treguesit: TF e ngritur Numri i takimeve Raportet e takimeve të Task Forcës, me rekomandimet	Kosto administrative
1.(d).1.1.	Kryerja e analizës së integruar të çështjeve të mbyllura të trafikimit të personave.	TF, Grupi Këshillimor i TF	Deri në mes të 2015	Dokumenti me Termat e Referencës (TR) i hartuar dhe miratuar: ZKKA, PKR, PSH, MD, dhe PP Dokumenti me Matricën e Shqyrtimit të Çështjes i hartuar dhe miratuar nga Grupi i Shqyrtimit të Çështjes, sipas termave të referencës 12 çështje të shqyrtuara dhe raportet e përgatitura, miratuara dhe shpërndara (një analizë çështjeje në muaj) deri në mesin e vitit 2015.	Kosto administrative, dhe kontributi i ekspertëve të PAMECA, ICITAP
1.(d).2	Krijimi dhe mirëmbajtja e një sistemi të unifikuar për menaxhimin e të dhënave statistikore dhe informacionit, për policinë, prokurorinë dhe institucionet e drejtësisë penale, për mbledhjen, analizimin dhe shpërndarjen e të dhënave statistikore të unifikuara tek të gjithë aktorët, bazuar në përkufizimet e rëna dakord. Në këto të dhëna do të përfshihen ato mbi arrestimet, ndjekjet penale, dënimet dhe vendimet penale si dhe raportet 3-mujore.	Grupi i Punës Ndër-Institucional nën drejtimin e Ministrisë së Drejtësisë, PP, PSH, ZKKA, shoqëria civile.	Deri në fund të vitit 2015	Treguesit: Ekzistenca e raporteve analitike dhe të dhënave statistikore të unifikuara ndër-institucionale, 3-mujore	

1. (e) OBJEKTIV SPECIFIK:

Përmirësimi i bashkëpunimit dypalësh, rajonal dhe ndërkombëtar ligjor, juridik dhe ligjzbatues në luftën kundër TtP.

Treguesit: Numri i ekstradimeve; numri i kërkesave të suksesshme/pasuksesshme për ndihmë të ndërsjellë ligjore; numri i protokolleve të rinj për bashkëpunim policor; numri i operacioneve të përbashkëta; numri i arrestimeve dhe ndjekjeve penale që vijnë si rezultat i bashkëpunimit ndërkufitar apo ndërkombëtar.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(e).1	Nxitiqja e zbatimit të protokolleve të Konventës së Këshillit të Evropës mbi Ndihmën e Ndërsjellë Juridike dhe ekstradimet, si dhe monitorimi i zbatimit të tyre Hartimi i protokolleve të reja sipas nevojës	Ministria e Drejtësisë, PP	Në vazhdimësi	Treguesit: Raportet e monitorimit	MD, PP
1.(e).2.	Forcimi i bashkëpunimit dypalësh dhe ndërkombëtar në fushën e zbatimit të ligjit kundër TËP (parandalimi i TËP, identifikimi, referimi dhe mbrojtja e ndjekja penale ndër-shtetërore e viktimave) dhe sidomos bashkëpunimi për kategori të ndryshme fëmijësh të shoqëruar apo të pashoqëruar (VMT, VT, fëmijë në rrezik të madh, fëmijë migrantë me dokumente të rreme apo pa dokumente) SHIH EDHE TEK MBROJTJA	PSH/MPB, MPJ si dhe OJF shqiptare dhe aktorë të tjerë partnerë, shtetërorë dhe jo-shtetërorë, në vendet e destinacionit	Në vazhdimësi	Numri i takimeve dhe ushtrimeve të përbashkëta të mbajtura rregullisht Ekzistenca e listës së kontaktit Ekzistenca e ndjekjeve penale ndër-shtetërore, dhe e standardeve dhe PSV-ve për identifikimin, referimin dhe mbrojtjen/ndihmën e VMT dhe VT-ve Ekzistenca e marrëveshjeve dhe PSV-ve të posaçme për fëmijët	PSH/MPB, MPJ (si dhe OJF shqiptare dhe aktorë të tjerë partnerë, shtetërorë dhe jo-shtetërorë, në vendet e destinacionit)
1.(e).2.1	Përfundimi dhe/ose zbatimi i marrëveshjeve/protokolleve për shkëmbimin e të dhënave dhe hetime të përbashkëta me Malin e Zi, Greqinë, Kosovën, Maqedoninë dhe Serbinë, Italinë, Mbretërinë e Bashkuar dhe vende të tjera të BE-së sipas nevojave. Mbajtja e takimeve të rregullta dhe ushtrimeve të përbashkëta	PSH/MPB, MPJ	2015	Marrëveshje/protokolle të firmosura me Malin e Zi, Greqinë, Kosovën, Maqedoninë dhe Serbinë, Italinë, Mbretërinë e Bashkuar Takime dhe ushtrime të përbashkëta të mbajtura rregullisht Synimi: të paktën një ushtrim i përbashkët/vizitë kontaktesh e organizuar çdo vit me secilin vend partner	PSH/MPB, MPJ
1.(e).2.2	Vazhdim i pjesëmarrjes në ushtrime rajonale/ndërkombëtare antitrafik të Qendrës SECI për Luftën kundër Krimit si dhe të Interpol-it	PSH	Në vazhdimësi	Numri dhe shpeshtësia e operacioneve hetimore të përbashkëta	PSH

1. (f) OBJEKTIV SPECIFIK:

Respektimi dhe forcimi i të drejtave të personave të trafikuar (VMT dhe VT) dhe siguri i trajtimit të drejtë, jodiskriminues, nga autoritetet ligjzbatuese dhe gjyqësore.

Treguesit: Numri i personave të trafikuar të cilët raportojnë për trajtim diskriminues; numri dhe përqindja e personave të trafikuar të cilët kanë marrë këshillim ligjor dhe përfaqësim ligjor.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(f).1	Trajnimi i vazhdueshëm i zyrtarëve kryesorë (punonjës policie, prokurorë, gjyqtarë të krimeve të rënda) për trajtimin e ndjeshëm, mbrojtjen dhe asistimin e viktimave përgjatë gjithë procedimit penal, për trajtimin etik të viktimave/dëshmitarëve në gjykatë; për PSV-të lidhur me bashkëpunimin dhe referimin mes institucioneve ligjzbatuese, të	Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Policisë, Gjykata e Krimeve të Rënda, ZKKA, OJF	2014	Numri dhe përqindja e zyrtarëve përkatës të trajnuar Shpërndarja e materialeve udhëzuese/PSV-ve mbi trajtimin e ndjeshëm të viktimave Raporte të rregullta monitorimi Raporti i zyrtarëve përkatës (nga gjykatat, prokuroria,	Shkolla e Magjistraturës, Akademia e Policisë, Gjykata e Krimeve të Rënda, ZKKA, OJF



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	ndjekjes penale, gjyqësorit dhe shërbimeve për ndihmën ndaj viktimave, si dhe mbi të drejtën e viktimës për t'u informuar. Monitorimi në mënyrë të rregullt i zbatimit.			njësitë e specializuara të policisë dhe OJF-të të cilët janë të familjarizuar me standardet dhe PSV-të si dhe të drejtën e viktimës për tu informuar dhe për këshillim/përfaqësim ligjor falas.	
	Fillimi i trajnimit të detyrueshëm për standardet dhe trajtimin specifik të fëmijëve, si parakusht për të gjithë aktorët e zbatimit të ligjit dhe drejtësisë penale në kontakt me fëmijët. Monitorimi më i rreptë i zbatimit të tyre	MPB, PSH, MD	Fillimi i 2015	Numri dhe përqindja e zyrtarëve përkatës të trajnuar Ekzistenca dhe shpërndarja e materialeve udhëzuese/PSV-ve për trajtimin e fëmijëve Raporti i zyrtarëve përkatës (nga gjykatat, prokuroria, njësitë e specializuara të policisë) dhe OJF-të të cilët janë të familjarizuar me standardet dhe PSV-të për fëmijët Protokollat e çështjeve	MPB, PSH, MD
1.(f).2	Nxitiqja e zbatimit të udhëzimeve për intervistimin e ndjeshëm ndaj VT/VMT-ve si dhe për teknikat sensitive të intervistimit dhe marrjes në pyetje të VT/VMT. Nxitiqja e zbatimit të udhëzimeve specifike për intervistimin të fëmijëve.	PP, PSh/Qendra e Formimit Policor, organizatat partnere PSH, ShSSH, PP,	Në vazhdimësi	Treguesit: Udhëzuesit e shpërndarë si dhe numri i aktorëve të trajnuar; Raporti i zyrtarëve përkatës që kanë njohuri mbi udhëzimet si dhe mbi udhëzimet specifike për fëmijët, dhe të cilët mund të përshkruajnë qasjen e intervistimit të ndjeshëm ndaj fëmijëve Protokollat e intervistave Prania e punonjësit social/psikologut të akredituar gjatë intervistimit	PP, PSh/Qendra e Formimit Policor, organizatat partnere
1.(f).3	Sigurimi i listës me punonjës socialë/psikologë të akredituar për intervistim të VMT/VT-ve, dhe me specialistë për trajtimin e fëmijëve VMT/VT	MMSR	Fundi i 2015	Ekzistenca e listës me punonjës socialë/psikologë; Ekzistenca e listës me specialistët për fëmijë	MMSR
1.(f).4	Caktimi i një fondi të posaçëm për PKM dhe për Sektorin e Luftës kundër Trafiqeve të Paligjshme, në mënyrë që të mbulohen nevojat bazë të VMT/VT-ve në drejtoritë rajonale të policisë dhe Policisë Kufitare. SHIH EDHE TEK MBROJTJA	PSH, MF, organizatat partnere	2015	Treguesit: Fondi i posaçëm i caktuar dhe mund të përdoret pas kërkesës Numri i VMT/VT-ve që përfitojnë nga fondi i posaçëm Dosjet e çështjeve mbi VMT-të që kërkojnë ndihmë të menjëhershme	DPPSH
1.(f).5	Sigurimi i dhomave të posaçme me kushtet e duhura për kryerjen e intervistave të VT-ve dhe për strehimin e tyre teksa presin të strehohen në një qendër/familje/etj. Sigurimi i ambienteve të posaçme, të përshtatshme për fëmijët	MPB, DPPSh	Deri në mes të 2015	Ekzistenca e ambienteve të përshtatshme për VMT dhe VT si dhe fëmijë VMT e VT	DPPSH
1.(f).6	Garantimi që VMT dhe/ose VT informohen mbi të drejtat e tyre si dhe rreziqet e mundshme dhe përfitimet gjatë procedimeve	PSH, PKR, KKSAT, organizatat partnere	Në vazhdimësi	Treguesit: Ekzistenca e materialeve informuese. Numri dhe përqindja e VT-ve që janë informuar dhe	PSH, PKR, KKSAT, organizatat partnere



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	penale, nëpërmjet seancave informuese dhe materialeve informuese.			kanë marrë materialet informuese. Numri/përqindja e VT-ve që kanë njohuri dhe mund të përshkruajnë të drejtat e tyre si dhe përfitimet/rreziqet e mundshme në lidhje me procedimet penale	
1.(f).6	Zbatimi i të drejtave ligjore të viktimave për këshillim ligjor dhe përfaqësim ligjor falas. Caktimi nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë i avokatëve për të siguruar këshillim dhe përfaqësim ligjor të VT/VMT-ve Sigurimi i fondeve të nevojshme	Komisioni për Ndihmen Juridike	Fundi i vitit 2014 2015	Treguesit/Synimi: Ekzistenca e listës me avokatët e caktuar për VMT' e VT' Këshillimi dhe përfaqësimi ligjor kanë fondet e mjaftueshme Numri dhe përqindja e rasteve të përfaqësuara dhe këshilluara	Komisioni për Ndihmen Juridike

2. SYNIMI STRATEGJIK

Garantim i kompensimit dhe dëmshpërblimit ligjor të viktimave të trafikimit.

Treguesit: Ekzistenca e fondit të kompensimit të viktimave; numri dhe përqindja e viktimave, të cilat kanë marrë kompensim, si dhe shumat e shpërndara: nga këto, cilat kanë qenë për çështje trafikimi me qëllim shfrytëzimin e punës; përqindja e viktimave të cilat janë të informuara mbi mundësitë e kompensimit; numri i urdhrave të lëshuar për kompensim automatik; numri i kërkesave të dorëzuara në Gjykatë në lidhje me çështje kompensimi.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
2.1	Nxjtja e zbatimit të ligjit nr. 10192, i datës 11 nëntor 2009 “Mbi parandalimin dhe luftën kundër krimit të organizuar dhe trafikëve nëpërmjet masave parandaluese mbi pasuritë” si dhe akteve nënligjore të lidhura me të (ligji antimagjia)	MF, MPB, Policia e Shtetit, ZKKA, Ministria e Drejtësisë,	2015	Treguesit: Numri i vendimeve të Komitetit Këshillues mbi përdorimin e pasurive të konfiskuara për kompensimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit si dhe shifrat (numra absolutë dhe përqindje e totalit)	MF
2.2	Përcaktimi në përqindje i pjesës së Fondit të Posaçëm për parandalimin e kriminalitetit dhe edukimin ligjor në përfitim të VT/VMT-ve për kompensimin dhe rehabilitimin e tyre dhe për qendrat e asistencës dhe rehabilitimit të VT.	MF, ZKKA	2015	Tregues: Vendim i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e një përqindjeje fikse të Fondit të Posaçëm për kompensimin dhe rehabilitimin e VT/VMT -ve Synimi: Të paktën 40 % e shumës është caktuar për kompensimin dhe rehabilitimin e viktimave të trafikimit.	MF
2.3	Zbatimi i skemës shtetërore të kompensimit për kompensimin dhe rehabilitimin e viktimave të TtP, duke përdorur si pasuritë e sekuestruara ashtu edhe fondet shtetërore; si edhe publikimi i procedurave për përdorimin e tij.	MF, PSH, në bashkëpunim me PP dhe MD, ZKKA, partnerë të tjerë	Fundi i 2015	Ekzistenca e skemës shtetërore të kompensimit Procedurat për përdorimin e Skemës ekzistojnë dhe janë publike Numri i viktimave të cilët kanë marrë kompensim nëpërmjet kësaj skeme	MF
24.	Informimi i hershëm i viktimave mbi të drejtën e tyre për	PP, PSH, Ministria e Drejtësisë	Në proces	Numri dhe përqindja e viktimave që kanë marrë	PP, PSH



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	kompensim dhe mbi mundësitë e përfitimit nga fondi shtetëror i kompensimit; dhënia e ndihmës dhe përfaqësimit ligjor falas për kompensimin e viktimave nëpërmjet skemës shtetërore të kompensimit.			material informues dhe këshilla mbi mundësitë për kompensim. Numri i viktimave të cilët kanë marrë ndihmë dhe përfaqësim ligjor	

3. SYNIMI STRATEGJIK

Garantimi i sigurisë fizike dhe mbrojtjes së të gjitha viktimave si dhe i mbrojtjes së posaçme të viktimave që paraqiten si dëshmitarë, në Programin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve.

Treguesit: Numri i incidenteve të raportuara kundër VT-ve; numri i VT-të që përfitojnë mbrojtje; përqindja e viktimave-dëshmitarë të cilët janë marrë nën kujdesin e një skeme të posaçme mbrojtjeje dëshmitarësh për VT-të.

Synimi: Rritja e numrit/përqindjes së VT-ve që marrin mbrojtje; rritje e numrit/përqindjes së VT-ve nën programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.

3. (a) OBJEKTIV SPECIFIK

Garantimi i sigurisë fizike dhe mbrojtjes së të gjitha viktimave të mundshme të trafikimit, pavarësisht nëse janë bashkëpunëtorë të drejtësisë.

Treguesit: Numri i incidenteve të raportuara kundër VMT dhe VT-ve; numri i VT-ve që marrin mbrojtje.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
3.(a).1	Hartimi dhe zbatimi i planeve individuale të sigurisë për të gjithë viktimat e mundshme të trafikimit	Policia në bashkëpunim me qendrat/punonjësit socialë vendorë	Fillimi i 2016	Ekzistenca e planeve individuale të sigurisë; numri dhe përqindja e VMT-ve që marrin mbrojtje	DPPSH

3. (b) OBJEKTIV SPECIFIK

Garantimi i mbrojtjes së posaçme për të gjitha viktimat që bashkëpunojnë me drejtësinë gjatë procedimeve penale (mbrojtje përpara procesit penal, gjatë dhe pas procesit, përfshirë vlerësimin e vazhdueshëm të rrezikut), duke nxitur kështu rritjen e numrit të viktimave që bashkëpunojnë me institucionet e zbatimit të ligjit/gjyqësorin.

Treguesit: Numri i incidenteve të raportuara kundër VT-ve, numri dhe përqindja e viktimave-dëshmitarë të cilët marrin mbrojtje të posaçme; numri/përqindja e viktimave/dëshmitarëve nën skemën e mbrojtjes së posaçme të dëshmitarëve; numri dhe përqindja e viktimave të trafikimit që janë bashkëpunëtorë të drejtësisë.

Synimi: Rritje e numrit/përqindjes së VT-ve që marrin mbrojtje; rritje e numrit/përqindjes së VT-ve që janë në programin e mbrojtjes së dëshmitarëve.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burimet
3.(b).1	Përmirësimi i zbatimit të Ligjit nr. 10173, dt. 22 tetor 2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarëve dhe bashkëpunëtorëve të drejtësisë": Forcimi i Departamentit për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë Firmosja/zbatimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për zhvendosjen	PP, DPPSH,	Në vazhdimësi	Tregues/Synimi: Numri i viktimave/dëshmitarëve të zhvendosur Rritje e numrit të viktimave të trafikimit të përfshira në Programin e Posaçëm për Mbrojtjen e Dëshmitarëve	PP, DPPSH



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/synimet	Burimet
	e viktimave/dëshmitarëve me strukturat partnere jashtë vendit Monitorimi i zbatimit të masave të posaçme të mbrojtjes.			Raportet e monitorimit	
3.(b).2	Garantimi i mbrojtjes së çdo viktime që paraqitet si dëshmitar /e (mbrojtje përpara procesit, gjatë dhe pas tij, përfshirë vlerësim të vazhdueshëm të rrezikut) në përputhje me planet individuale të sigurisë/mbrojtjes si dhe standardet e miratuara të mbrojtjes.	PP, PSH – Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë, GjKrr, AP, palët e MKR-së	Në vazhdimësi	Ekzistenca e standardeve të mbrojtjes dhe formateve tip për planet individuale të mbrojtjes Ekzistenca e protokolleve të çështjeve me plane individuale mbrojtjeje dhe vlerësime të rregullta të rrezikut Ekzistenca e pikave të kontaktit të caktuara për viktimat/dëshmitarët, për të marrë të gjitha masat e nevojshme, përfshirë mbrojtjen e viktimës Kryerja e vlerësimeve të vazhdueshme të rrezikut për të gjitha VT-të, të cilët janë bashkëpunëtorë të drejtësisë Numri i VT-ve/dëshmitarëve me masa mbrojtëse	PP, PSH
3.(b).3	Forcimi i rolit të koordinatorëve të viktimave tek Prokuroria e Krimeve të Rënda	PKR, ZKKA	Në vazhdimësi	Numri i viktimave të trafikimit të cilat kanë marrë ndihmë	PKR
3.(b).4	Garantim i sigurisë dhe mbrojtjes së dëshmitarëve në Gjykatën e Krimeve të Rënda dhe gjykata të tjera, në Prokurorinë e Përgjithshme dhe në Polici (nëpërmjet udhëzimeve, pajisjeve për lidhje me video, ambienteve të posaçme të pritjes, etj.)	PP, GjKrr, PSH, SECI, MD, partnerë të tjerë.	Në vazhdimësi	Përdorimi i pajisjeve teknike të sigurisë dhe ekzistenca e udhëzimeve Numri i rasteve ku përdoren këto teknika Numri dhe përqindja e prokurorëve të cilët janë të familjarizuar me përmbajtjen e udhëzimeve si dhe me nevojat për mbrojtje të viktimave të TIP.	PP, GjKR, DPPSh, MD organizatat partnere

4. SYNIMI STRATEGJIK

Forcimi i integritetit të punonjësve të zbatimit të ligjit në trafikimin e personave dhe lufta kundër korrupsionit në radhët e tyre.

Treguesit: Numri i pushimeve nga puna, masave disiplinore/administrative, si dhe ndjekjet penale/dënimet penale të punonjësve të policisë, prokurorisë, si dhe zyrtarëve të tjerë të përfshirë në trafikim; numri i informacioneve konfidenciale (telefonata, etj.) mbi përfshirjen e zyrtarëve në trafikim, të cilat janë regjistruar nga policia; numri i çështjeve të hapura në bazë të informacioneve konfidenciale të marra nga qytetarët.



Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
4.1	Ndjekja penale dhe dënimi i të gjithë punonjësve të policisë, gjyqtarëve, prokurorëve dhe të gjithë nëpunësve publikë të cilët marrin pjesë apo favorizojnë trafikimin e personave	Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm/MPB, MD në bashkëpunim me PP	Në vazhdimësi	Numri i punonjësve të policisë, gjyqtarëve, prokurorëve dhe nëpunësve të tjerë publikë të ndjekur penalisht dhe të dënuar	Ekzistuese
4.2.	Forcimi i Drejtorisë së Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm për të përmirësuar hetimet e përfshirjes së nëpunësve në trafikimin e personave.	MPB, Shërbimi Informativ Shtetëror, ShKB	Në vazhdimësi	Numri i hetimeve të suksesshme në lidhje me trafikimin e personave, të kryera nga kjo drejtori.	MPB
4.3.	Zbatimi i akteve ligjore/nënligjore ekzistuese mbi verifikimin paraprak të personalitetit të punonjësve të strukturave ligjzbatuese (performancës, integritetit etik dhe moral)	MPB, DPPSH, Shërbimi Informativ Shtetëror (ShISh)	Në vazhdimësi	Numri i punonjësve të strukturave ligjzbatuese të cilët janë emëruar, ngritur në detyrë apo shkarkuar në përputhje me verifikimin paraprak (të performancës, integritetit etik dhe moral)	Ekzistuese
4.4.	Vazhdim i krijimit të besimit nga publiku tek strukturat e zbatimit të ligjit dhe i nxitjes së denoncimit të punonjësve të korruptuar: Vazhdimi i fushatës publike për politikën e tolerancës zero ndaj krimit Vazhdimi i funksionimit të linjës telefonike publike antikorrupsion për raportimin e rasteve të përfshirjes së punonjësve Krijimi i formave anonime (në internet) për raportimin e rasteve të përfshirjes, dhe Informimi i publikut mbi veprimet antikorrupsion të kryera si dhe rezultatet e tyre	MPB, ZKKA, DPPSH,	Në vazhdimësi	Numri i çështjeve të hapura në bazë të informacionit konfidencial të marrë nga qytetarët Numri i telefonatave që raportojnë përfshirjen e punonjësve në trafikimin e personave, si dhe numri i raporteve anonime të marra Statistikat mbi numrin e ndjekjeve penale kundër punonjësve të korruptuar, të bëra publike	MPB, DPPSH, ZKKA

MBROJTJA

1. Synimi strategjik: Garantimi i identifikimit të hershëm dhe referimit të të gjithë të miturve dhe të rriturve si viktimë të mundshme trafikimi dhe viktimë trafikimi për qëllime shfrytëzimi, dhe referimi i menjëhershëm pranë shërbimeve të duhura të asistencës, bazuar në nevojat individuale në përputhje me Procedurat Standarde të Veprimit (PSV-të) e miratuara.

Treguesit: Numri i përgjithshëm i identifikimeve, dhe identifikimi i personave të trafikuar brenda vendit, personave të trafikuar për qëllime shfrytëzimi për punë, si dhe numri i viktimave fëmijë në veçanti; koha mesatare e shfrytëzimit para identifikimit, përmbajtja e protokolleve të çështjes (në përputhje me PSV).

Synimi: Rritja e numrit të identifikimeve dhe asistencës ndaj viktimave në përputhje me standardet e MKR dhe PSV-të me 20% në vit; rritja/arritja e shkallës së përputhshmërisë me standardet e MKR.

1. (a) OBJEKTIVI SPECIFIK:

Garantimi në vazhdimësi i funksionimit efikas të “Mekanizmit Kombëtar të Referimit” dhe shtrirja e tij në nivel qarku, bashkie dhe komune (nëpërmjet grupeve vendore të koordinimit për marrjen e masave parandaluese dhe identifikimin e personave të trafikuar) në përputhje me standardet dhe PSV-të në zbatim.

Treguesit: Numri i viktimave të mundshme të trafikimit dhe viktimave të trafikimit të identifikuar, referuar, asistuar në nivel qarku/bashkie/komune dhe sipas aktorëve identifikues; cilësia e protokollit të çështjes (shkalla e përputhshmërisë me PSV), numri i grupeve koordinuese aktive/funksionale në nivel bashkie/ komune përgjegjëse për parandalimin dhe identifikimin.



Synimi

Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat Përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(a).1 E njëjtë me Bashk. 1.(a).2	Forcimi i kapacitetit të autoritetit përgjegjës (AP) për të përmbushur funksionin e tij, kryesisht për të bashkërenduar dhe kontrolluar zbatimin e marrëveshjes së MKR dhe PSV për identifikimin, referimin për asistencë dhe riintegrimin e viktimave, menaxhimin e informacionit dhe raportimin mbi VMT dhe VT (duke mirëmbajtur bazën e të dhënave në lidhje me rastet e referimit të VMT dhe VT): Caktimi i një nëpunësi me kohë të plotë tek ZKKA si Sekretariat i AP-së; Përcaktimi si detyra funksionale në përshkrimet e tyre të punës i detyrave të anëtarëve të AP-së.	ZKKA, të gjithë firmëtarët e MKR-së, AP	Deri në fund të 2014	Treguesit/Synimet: Një nëpunës i ZKKA me kohë të plotë ngarkohet për të asistuar AP Ekzistenca e profileve të punës për pikat e kontaktit që janë firmëtarë të AP Përshkrimet e punës për pikat e kontaktit të AP, përfshirë detyrat në lidhje me AP si pjesë e detyrave funksionale.	ZKKA, Firmëtarët e MKR –së
	Përmirësimi i bazës së të dhënave për viktimat e trafikimit për regjistrimin, ndjekjen dhe monitorimin e rasteve, si dhe raportimin pranë AP/ZKKA: Caktimi i një nëpunësi me kohë të plotë dhe garantimi i mbështetjes teknike për hedhjen dhe mirëmbajtjen e të dhënave. Garantimi i raportimit të rregullt nga AP/ZKKA sipas formateve të miratuara.	ZKKA, AP, TI	Në vazhdim Tetor 2014	Treguesit : Funksionim i plotë i bazës së të dhënave mbi viktimat Një nëpunës me kohë të plotë i caktuar në ZKKA Prania e raporteve analitike Paraqitje e rregullt e të dhënave nga të gjithë aktorët kryesorë sipas modaliteteve dhe formatit raportues të miratuar Raporte (tremujore) të rregullta nxirren nga AP-ja	MPB/ZKKA dhe mbështetje teknike/TI
1.(a).2	Hartimi dhe zbatimi i një Plani Pune vjetor të MKR në veçanti në lidhje me monitorimin dhe rishikimin e PSV të MKR, si dhe organizimi i takimeve të rregullta në grup të MKR.	ZKKA, MKR	Fundi i 2014 dhe fundi i 2015 Në vazhdimësi	Treguesit: Ekzistenca e planeve vjetore të punës të MKR për 2015 dhe 2016, si edhe raporteve vjetore Numri i takime dhe procesverbalet e takimeve të MKR	Ekzistuese
1.(a).3	Ngritja e mekanizmave multidisiplinare në nivel bashkie për parandalimin, identifikimin, referimin dhe asistencën/mbrojtjen e VMT dhe VT PËR AKTIVITETET SHIH BASHKËRENDIMIN 1.(b).3	Bashkitë dhe KRAT me mbështetjen e ZKKA, AP, MKR, dhe partnerëve	Deri në fundin e 2015	Treguesit: Prania e një mekanizmi bashkërendues multi-disiplinor vendor për TiP në të gjithë vendin, duke përfshirë. Grupe vendore koordinuese dhe pika fokale koordinuese PSV vendore për identifikimin, referimin dhe asistencën për VMT/VT Sistem për menaxhimin e rasteve PSV për identifikimin e asistencës për VMT/VT Grupet janë të integruara, ose punojnë ngushtë me administratorin social,	Pushtet lokal, ZKKA



Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat Përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
				dhunën në familje/grupet gjinore dhe sistemet për mbrojtjen e fëmijëve/NjMF	

1. (b) OBJEKTIV SPECIFIK:

Forcimi i kapaciteteve të të gjitha strukturave/aktorëve të përfshirë në parandalimin, identifikimin, referimin dhe asistencën ndaj VMT/VT, në përputhje me PSV-të për identifikimin dhe referimin.

Treguesit: Numri i personave të identifikuar dhe referuar, cilësia e protokolleve të rastit (shkalla e respektimit të PSV-ve), numri dhe përqindja e aktorëve përkatës që njohin treguesit e trafikimit të personave dhe roli i tyre në parandalimin/trajtimin e fenomenit, në përputhje me PSV-të.

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat Përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(b).1	Përmirësimi i njohurive mbi standardet për trajtimin e VT/VMT dhe PSV-të, si dhe mbi PSV-të specifike për fëmijët e identifikimi, referimi, ofrimi (riintegrimi) i asistencës dhe monitorimi i procesit të riintegrit	ZKKA, AP dhe MKR, OJF/ON dhe partnerët	Në vazhdimësi	Numri dhe përqindja e aktorëve përkatës të trajnuar, numri dhe përqindja e njohësve të PSV dhe cilësia e standardeve të shërbimit	ZKKA/Mbështetur nga partnerët
1.(b).1.1	Hartimi i udhëzimeve specifike për institucionin dhe udhëzime mbi detyrat e institucionit në lidhje me zbatimin e PSV-ve për trajtimin e VMT dhe VT, si dhe shpërndarja e tyre.	Të gjithë firmëtarët e MKR, ZKKA	Fundi i 2015	Prania e udhëzimeve të posaçme për institucionin Numri dhe përqindja aktorëve që njohin udhëzimet, PSV-të dhe detyrimet e tyre si pjesë e MKR-së.	Firmëtarët e MKR-së, ZKKA
1.(b).1.2	(Ri-) Trajnimi i anëtarëve të AP-së dhe i anëtarëve të Task Forcës së MKR-së dhe hartimi i një programi trajnimi të vazhdueshëm mbi PSV-të; shpërndarja e kopjeve të PSV-ve (sipas aktorëve individualë)	ZKKA, AP, Shkolla e Magjistraturës, Akademia Diplomatike, Qendra e Formimit Policor, OJF, ON dhe partnerët ndërkombëtarë.	Në vazhdimësi	Treguesit: Ekzistenca e moduleve të trajnimit të hartuara sipas aktorëve individualë dhe planet vjetore të trajnimit Numri i trajnerëve (sipas institucionit/organizatës) PSV-të të shpërndara tek aktorët individualë; Përqindja e aktorëve përkatës që kanë një kopje të PSV-ve.	ZKKA, Shkolla e Magjistraturës, Akademia Diplomatike, Qendra e Formimit Policor, partnerët
1.(b).1.3	Trajnimi i të gjithë aktorëve në nivel rajonal dhe vendor, të cilët ofrojnë shërbime dhe janë në kontakt me grupe	ZKKA, AP, KRAT OJF, ON dhe partnerët ndërkombëtarë	2014 - 2017	Treguesit: Numri i sesioneve për Trajnimin e Trajnerëve (IT), dhe numri i trajnerëve rajonalë të trajnuar (koordinatorët teknikë të KRAT) Numri i trajnimeve për çdo	ZKKA, KRAT, partnerët



Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat Përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	vulnerabël në lidhje me PSV-të dhe trafikimin e personave nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta multidisiplinare (në veçanti trajnime të përbashkëta ndërmjet zyrave rajonale të ShSSH, drejtorive rajonale të PSH dhe NJMF, etj.) Trajnimi i trajnerëve për KRAT KRAT trajnon grupet në nivel vendor			bashki/komunë dhe numri i aktorëve të trajnuar (sipas institucionit)	
1.(b).1.4.	Shkëmbimi i eksperiencave midis ofruesve të shërbimeve në qarqe dhe bashki të ndryshme.	KRAT, ZKKA, MKR	2015 -2017	Takime të rregullta të grupeve/aktorëve vendorë në nivel rajonal.	MKR, KRAT

1. (c) OBJEKTIV SPECIFIK: Nxitja e zbatimit të PSV-ve nëpërmjet monitorimit të tyre dhe siguri i përputhshmërisë së PSV-ve nëpërmjet shqyrtimit të standardeve dhe të vetë procedurave.

Treguesit: Përmbajtja e protokolleve të rasteve (shkalla e përputhshmërisë me PSV-të).

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat Përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(c).1	Krijimi dhe zbatimi i një mekanizmi monitorimi që garanton zbatimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve: të paktën dy herë në vit inspektive/vizita në terren nga entet e pavarura në përputhje me treguesit për monitorimin e PSV-ve të miratuara 1. Identifikimi i ekipeve të pavarura për monitorimin/vlerësimin 2. Raportimi i vazhdueshëm sipas modelit të miratuar të monitorimit 3. Hartimi i udhëzimeve mbi metodologjinë e monitorimit (në përputhje me ligjin nr.10 433, datë 16.6.2011 për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë) 4. Trajnimi i ekipit monitorues mbi TiP dhe PSV 5. Kryerja e vizitave/inspektimeve në terren, të paktën dy herë në vit 6. Hartimi i raporteve dhe rekomandimeve për anëtarët e MKR/palë të interesuara për njohje dhe veprim	ZKKA, AP, MKR, Task Forca e MKR, Ministrinë e Linjës (departamentet e inspektimit)	Deri në fund 2014 Pranverë 2015 Fund i 2015	Mekanizmi i miratuar i monitorimit, përfshirë modelin e monitorimit Ekipi i monitorimit i identifikuar, udhëzimet, protokollat e inspektimit dhe oraret të vendosura, dhe ekipi i monitorimit i trajnuar brenda 3 muajve nga miratimi i Planit të Veprimit të A/T. 1 inspektim i kryer dhe marrja e të dhënave të monitorimit; raporti i parë i monitorimit i miratuar dhe shpërndarë te anëtarët pjesëmarrës të MKR për informacion dhe veprim 2 inspektive të kryera, nxjerrja e raportit të monitorimit brenda një viti nga miratimi i Planit të Veprimit të AT	Task-Forca e MKR, Ministrinë e Linjës



Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat Përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(c).2	Krijimi dhe zbatimi i një mekanizmi vlerësues për përputhshmërinë e standardeve të MKR-së dhe PSV-ve, d.m.th. nëse ato janë të përshtatshme për të arritur qëllimet e MKR-së, dhe shqyrtimi i PSV-ve sipas nevojës Identifikimi i grupit vlerësues dhe miratimi i Termave të Referencës (TeR) Kryerja e rishikimit bazuar në raportet e monitorimit dhe misionet të tjera të rishikimit, nëse është e nevojshme Nxjerrja e raportit të parë të shqyrtimit, përfshirë rekomandimet për rishikim të marrëveshjes së MKR dhe PSV-ve, nëse është e nevojshme.	Grupet e ZKKA dhe MKR, firmëtarë me asistencën e komunitetit ndërkombëtar	Fillimi i 2015 Nga mesi i 2015 Gjysma e dytë e 2016	Treguesit: Identifikimi dhe trajnimi i ekipit të shqyrtimit TR të miratuara për shqyrtim Shqyrtimi i parë, përfshirë rekomandimet për rishikim të MKR dhe PSV-ve të saj, të përfunduara dhe pranuar nga grupi i MKR deri në mes të 2015 Një shqyrtim i mëtejshëm për t'u kryer në gjysmën e dytë të 2016	ZKKA, PSH, MKR OJF-të, asistencë e komunitetit ndërkombëtar (KN)
	Rishikimi i standardeve dhe PSV-ve të MKR-së bazuar në shqyrtimin në fjalë Krijimi i një grupi rishikimi Pranimi i PSV-ve të rishikuara dhe shpërndarja e tyre; trajnimi i të gjithë aktorëve	ZKKA, AP, MKR	Fundi i 2016	Ekzistenca e PSV-ve të rishikuara të MKR	MKR, ZKKA

1. (d) OBJEKTIV SPECIFIK

Rritja e numrit të identifikimeve dhe referimeve fillestare të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit dhe për të gjitha format e shfrytëzimit brenda vendit, në kufi, jashtë vendit, si dhe rritja e vetëidentifikimit të viktimave.

Treguesit: Numri i identifikimeve të viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit sipas moshës/gjinisë/kombësisë/llojit të shfrytëzimit/strukturës së identifikimit.

Synimi: Rritje vjetore me 20% e identifikimit të viktimave të trafikimit dhe viktimave të mundshme të trafikimit.

Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat Përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(d).1	Rritja e identifikimit proaktiv të viktimave të mundshme dhe viktimave të trafikimit në vend.	ZKKA, PSH KRAT, firmëtarët e MKR-së, ON, OJF-të	Në vazhdimësi	Treguesit: Numri dhe përqindja e VMT të identifikuar nga njësitë e lëvizshme dhe nga grupet e koordinimit në nivel bashkiak/komune Synimi: Numri për çdo vit kalendarik të VMT dhe VT të identifikuar të rritet në 20%	Ekzistues, organizatat partnere
1.(d).1.1	Intensifikimi i punës në terren sipas modelit të Njërive Lëvizëse nëpërmjet: 1. Përcaktimit të statusit, roleve dhe përgjegjësisë të Njërive Lëvizëse (NjL), dhe koordinimi i tyre me MKR dhe të gjitha palët e interesit, në veçanti me Shërbimin Social dhe Policinë e Shtetit	TF e MKR-së, OJF, ON	Deri në mesin e 2014	Treguesit: Ngritja e 3 NjL të reja Qartësimi i statusit dhe rolit të NjL Miratimi i Memorandumit të Mirëkuptimit midis PSH në nivelin rajonal dhe NjL Prania e TR dhe standardeve të shërbimit për NjL, si dhe profilet/përshkrimet e punës	PSH, MMSR, partnerët



Nr.	Veprimtaritë dhe nënveprimtaritë	Strukturat Përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	2. Hartimit të standardeve të shërbimit të njërive lëvizëse në identifikimin dhe referimin e VMT' dhe VT' 3. Identifikimit, trajnimit dhe pajisjes së 3 Njërive Lëvizëse 4. Krijimit të një mjeti për vlerësimin e efikasitetit të Njërive të Lëvizëse dhe rishikimi i rregullt i tyre 5. Garantimi i qëndrueshmërisë së njërive lëvizëse, nëpërmjet sigurimit të fondeve		Deri në mesin 2015	për anëtarët e NjL Vlerësimi i NjL sipas mjetit vlerësues të miratuar më parë Rishikimi i parë brenda vitit nga miratimi i AT PKV Sigurimi i financimit për vitet e ardhshme	
1.(d).1.2	Përmirësimi i identifikimit nëpërmjet strukturave të koordinimit në nivel bashkie/komune	ZKKA, KRAT, TF e - MKR, OJF, ON dhe partnerët	Deri në fundin e 2015	Prania e grupeve në nivel bashkie/komune me PSV lokale, dhe PSV të veçanta për fëmijët Numri i identifikimeve nëpërmjet strukturave në bashki	Ekzistuese, partnerët
1.(d).2	Rritja e identifikimit proaktiv të viktimave të mundshme të trafikimit në Shqipëri dhe viktimave të trafikimit jashtë vendit dhe kthimi i tyre vullnetar në Shqipëri, në përputhje me PSV-të Marrja e masave të veçanta në lidhje me fëmijët	MPJ/ Stafi diplomatik, PSH/Oficerët Ndërlidhës	Në vazhdimësi	Numri i identifikimeve nga jashtë vendit (dhe në përqindje për të gjithë) Numri dhe përqindja e VMT' në Shqipëri dhe VT' jashtë vendit të asistuar në përputhje me PSV-të ndërkufitare, përfshirë njoftimet para kthimit, vlerësimet e riskut, planet e kthimit, etj.	MPJ, PSH
2.(a).1.3	Ngarkimi i zyrave rajonale/vendore të punës për tu marrë në mënyrë aktive me viktimat e mundshme dhe personat e trafikuar dhe për tu dhënë informacionin e nevojshëm.	MMSR, Zyrat Kombëtare të Punës, AP	Në vazhdimësi	Ekzistenca e termave të referencës për zyrat e punës, në lidhje me përparësinë e gjetjes së vendeve të punës për personat/grupet e identifikuar si “në rrezik”; nxjerrja e udhëzimeve Numri i vendeve të punës të	MMSR, ZKKA, Partnerët



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
				gjetura për viktimat e mundshme si dhe personat e trafikuar, nga zyrat e punës (në një vit)	
2.(a).2	Promovimi i mundësive të sigurta dhe të ligjshme për imigrim, si dhe ndërgjegjësimi mbi ato që mund të bëjnë grupet në rrezik për të ulur rrezikun, duke harmonizuar veprimet me Strategjinë për Migracionin.	MMSR (Drejtoria për Migrimin), MPJ, MPB, PSH (Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin)	Në vazhdimësi	Tregues: Numri i përfituesve të punësuar nëpërmjet programeve për migrimin e ligjshëm	MMSR, MPB, Partnerët
2.(a).2.1	Krijimi i më shumë mundësive për punësim të ligjshëm jashtë vendit, nëpërmjet marrëveshjeve për punëtorë sezonalë (në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Migrimin) me vende evropiane etj.; hartimi i dispozitave për mbrojtjen dhe të drejtat e punëtorëve migrantë (sidomos që lejët e punës të mos jenë të lidhura tek një punëdhënës i vetëm).	MMSR/ Drejtoria për Migrimin, MPJ, Drejtoria për Kufirin dhe Migracionin (PSH) dhe partnerët, ZKKA	Në vazhdimësi	Ekzistenca e marrëveshjeve për punëtorë sezonalë me Italinë, Greqinë dhe me shtete të tjera të BE-së Synimi: Rritja e numrit të vendeve të punës në kuadër të marrëveshjeve për punëtorë të huaj/migrantë	MMSR, MAS, Donatorët.
2.(a).2.2	Mbajta e një linje telefonike informuese dhe verifikuese për vende pune, si dhe vazhdimi i dhënies së informacionit mbi migrimin e sigurtë në faqet e internetit të institucioneve shtetërore (MPJ dhe MPB), si dhe publikimi i tyre tek grupet e viktimave të mundshme.	MMSR, MPB, MPJ, KRAT, Grupet koordinuese në nivel lokal, ZKKA, OJF partnere	Në vazhdimësi	Ekzistenca e linjave telefonike informuese dhe verifikuese për vende pune, faqet e internetit me informacion për migrimin e ligjshëm në internet. Informacioni në linjën telefonike dhe linket për migrimin e ligjshëm janë të disponueshme në vendet që frekuentohen nga grupet e viktimave të mundshme. Përqindja e personave “në rrezik” të cilët dinë si të verifikojnë ofertat për punë dhe mënyrat e tjera të mbrojtjes së vetes përpara se të nisen për jashtë vendit	MMSR, MPJ, ZKKA Partneret
2.(a).2.3	Informimi i shtetasve shqiptarë që punojnë jashtë vendit mbi legjislacionin e punës dhe këshillimi i tyre, nëpërmjet stafit diplomatik/konsullor shqiptar, duke përfshirë informacion për legjislacionin e punës dhe të drejtat e tyre, si dhe ndihmë për zbulimin e kontratave të punës të rreme.	MPJ (Shërbimi Konsullor), MMSR, (Drejtoria për Migrimin, Shërbimi Kombëtar i Punësimit) ZKKA	Në vazhdimësi	Materiali informues i shpërndarë Numri i personave të informuar/këshilluar Numri i rasteve të identifikuara të shtetasve shqiptarë të shfrytëzuar për punë në vendet e destinacionit	MMSR, MPJ, ZKKA

2. (b) OBJEKTIVI SPECIFIK: Përmirësimi i përfshirjes sociale të grupeve të viktimave të mundshme të trafikimit. (Duke harmonizuar veprimet me “Dekada e përfshirjes së Romëve” PKV 2010-15 dhe Strategjinë e Përfshirjes Sociale).

Treguesit: Shifrat e braktisjes së shkollës në grupet e viktimave të mundshme; niveli i formimit shkollor/profesional/aftësi jete të djemve, vajzave, grupeve të pakicave.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
2.(a).2	Fuqizimi i familjeve të të gjitha viktimave duke dhënë mbështetje socio-ekonomike	MMSR, Shërbimi Social Shtetëror	2014 -2017	Ekzistojnë skemat e ndihmës sociale për familjet në nevojë Numri i përfituesve	MMSR, ZKKA, Partnerët
2.(b).3	Rritja e regjistrimeve në gjendje civile, sidomos i fëmijëve romë dhe të rrugës, si bazë për regjistrimin në shkollë dhe përfshirjen sociale (shih më poshtë)	MPB/Drejtoria e Gjendjes Civile	Në vazhdimësi	Përqindja e fëmijëve romë dhe të rrugës të regjistruar në gjendje civile dhe të regjistruar në shkollë	MPB, ZKKA, MKR, KRAT, AP, Partnerët
2.(b).4	Rritja e nivelit arsimor/trajnimin profesional/aftësive të jetës të grupeve të viktimave të mundshme, nëpërmjet nxitjes së arsimimit dhe programeve që ofrojnë shkollim plotësues dhe trajnim profesional për ata që kanë braktisur shkollën, sidomos të rejtat dhe të rinjtë (bazuar në modelin “Mundësia e dytë”)	MAS, MMSR, me partnerët,	2014 -2017	Shkalla e ndjekjes së shkollës mes grupeve të viktimave të mundshme Ekzistenca e programeve të posaçme për personat që braktisin shkollën, në të gjithë vendin Numri dhe përqindja e atyre që braktisin shkollën (femra/meshkuj) që marrin pjesë në programe	MMSR, ZKKA, Partnerët
2.(b).5	Nxita e zhvillimit dhe pasurimit të komunitetit, dhe fuqizimi i grupeve dhe komuniteteve në rrezik, nëpërmjet forcimit të organizatave apo grupeve të këshillimit të bazuara në komunitet. (Bashkërenduar me Strategjinë e Përfshirjes Sociale)	MMSR, KRAT, bashkitë, udhëheqësit e komunitetit	2015 -2017	Ekzistenca e organizatave aktive të bazuara në komunitet/grupet e këshillimit në komunitet, në komunitetet romë dhe egjiptiane, dhe të përfshira në sistemet vendore të mbrojtjes së fëmijëve dhe mekanizmat e referimit	MMSR, KRAT, qarqet, bashkitë, partnerët
2.(b).5.1	Zbatimi i programeve dhe veprimtarive që synojnë zhvillimin dhe mbështetjen e komunitetit, ku përfshihen: Veprimtaritë edukative dhe psiko-sociale (kopsht, kampe verore, veprimtari kulturore) Seancat ndërgjegjëse Trajnim profesional Mbështetje për punësim Veprimtari fitimprurëse për nënat Skema mikro-kredish Asistencë sociale Programe fuqizimi personal për gratë dhe të rinjtë (përfshirë të drejtat e njeriut dhe aftësitë e jetës)	MAS/ Drejtoria Arsimore Rajonale, MMSR, Shërbimet Sociale, KRAT, Bashkitë, ZKKA, OJF, ON dhe partnerët ndërkombëtarë	2014 - 2017	Ekzistenca e programeve për zhvillimin e komunitetit në të gjitha komunitetet me viktimë të mundshme të identifikuar Financim afatgjatë i organizatave të bazuara në komunitet dhe veprimtarive në nivel komuniteti	MAS, MMSR, ZKKA, KRAT, Partnerët
2.(b).6	Vazhdim i forcimit të mjediseve mbrojtëse për fëmijët, duke ngritur/forcuar grupe vendore për mbrojtjen dhe referimin e fëmijëve viktimë të mundshme të trafikimit, të përbëra nga: 1. Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve; 2. Shërbimet psiko-sociale në shkollë/”mbrojtësit e fëmijëve”; dhe 3. Organizatat e bazuara në	MMSR, pushteti vendor, bashkitë, ON/OJF dhe partnerët	Në vazhdimësi	Numri i grupeve të mbështetjes dhe referimit, në bashki Numri i çështjeve të identifikuar dhe ndihmuara nga grupet e mbrojtjes së fëmijëve, psh Numri i fëmijëve në rrezik Numri i fëmijëve VT dhe VMT	MMSR, MPB, ZKKA, Partnerët.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	komunitet apo grupet e këshillimit si pika kontakti për komunitetet e tyre				
2.(b).7	Forcimi i kapaciteteve të Njësive për Mbrojtjen e Fëmijëve (NjMF) për të identifikuar VT/VMT nëpërmjet trajnimeve, ndarjes së informacionit, etj.	MMSR, ZKKA, OJF-të, partnerët ndërkombëtarë	Fillimi i vitit 2015	Synimi: Mbulim i plotë kombëtar me NjMF nga MMSR. Ekzistenca e profileve të punës për punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve, punonjës socialë të licencuar. NjMF-të do të jenë pjesë përbërëse e strukturave për mbrojtjen dhe asistencën për fëmijët	MMSR, ZKKA, Partnerët
2.(b).8	Institucionalizimi i “sistemeve për mbrojtjen e fëmijëve” në shkolla, duke vendosur një psikolog dhe një punonjës social të trajnuar si “mbrojtës të fëmijëve” në çdo shkollë; kjo do të rrisë mbështetjen/këshillimin për fëmijët/të rinjtë, për të zbuluar raste të mundshme të VT dhe për të marrë masa me njësitë vendore të mbrojtjes së fëmijëve.	MAS (Drejtoritë Rajonale të Arsimit), OJF/ON dhe partnerët.	2015 -2017	Numri i sistemeve për mbrojtjen e fëmijëve të paktën në shkollat më të ndikuara (sipas vlerësimit) me të paktën një pikë kontakti/psikolog/punonjës social të trajnuar, të lidhur me grupin vendor të referimit	MAS, ZKKA, Partnerët

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
2.(c).2	Rritja e ndërgjegjësimit tek punëofruesit e sektorit privat për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit	ZKKA, MMSR, Zyra kombëtare e Punësimit,	2015-2017	Numri i viktimave të trafikimit të identifikuar nga sektori privat	ZKKA, MKR, Sektori privat, Partnerët

3. SYNIMI STRATEGJIK

Garantimi i mekanizmave parandalues dhe mbrojtës si dhe dhënia e ndihmës në nivel bashkie, duke iu shërbyer grupeve/personave viktimë të mundshme si dhe viktimave të trafikimit.

Treguesit: Numri i personave të identifikuar dhe ndihmuar si viktimë të mundshme, si dhe numri i viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar, referuar, asistuar, sipas moshës, gjinisë, qarkut, bashkisë; numri i mekanizmave funksionale për bashkërendimin/referimin në nivel bashkie; përmbajtja e protokolleve të çështjeve.

3. (a) OBJEKTIVI SPECIFIK

Krijimi/forcimi i një mekanizmi funksional në nivelin vendor për parandalimin (identifikimin e personave viktimë të mundshme, si dhe ndërhyrjet parandaluese dhe mbështetëse), si dhe identifikimin, referimin dhe dhënien e ndihmës ndaj personave të trafikuar.

Treguesit: Numri i personave të identifikuar si viktimë të mundshme, dhe asistuar, sipas moshës, gjinisë, qarkut, bashkisë; numri i mekanizmave funksionale në nivel bashkie/komune për bashkërendim/referim; numri dhe përqindja e aktorëve vendorë që kanë njohuri mbi TP dhe njohin indikatorët e tij.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
3.(a)	Integrimi i grupeve vendore për mbrojtjen dhe referimin e fëmijëve VT dhe VMT në grupet bashkërenduese të nivelit të bashkive (shih më lart)	SHSSH, pushteti vendor (NjMF), KRAT	Fundi i 2015	Ekzistenca e grupeve të integruara bashkërenduese në nivel vendor	Pushteti lokal, ZKKA, partnerët,



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet

3. (b) OBJEKTIVI SPECIFIK:

Garantimi i shërbimeve psiko-sociale, ligjore, shëndetësore dhe mbështetjes së përshtatshme për viktimat e mundshme dhe grupet/personat e trafikuar, për riintegrimin e tyre në shoqëri, duke përfshirë shërbime për parandalimin e krizave, si lehtësimi i përdorimit të shërbimeve sociale, ndihma sociale, strehimi, aftësimi për jetën, shpërndarja e informacionit tek grupet dhe personat në nevojë.

Treguesit: Numri i personave nga kategoritë/grupet e viktimave të mundshme, të cilët përfitojnë nga shërbimet e ndihmës; koha mesatare e pritjes përpara se të pranohen në programet e ndihmës; numri i viktimave/viktimave të mundshme të rritur ose të mitur të cilët përfitojnë nga shërbimet për krizat.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
3.(b).1	KRAT do të: Kryejnë vlerësime të rregullta të situatës rajonale, ku të përfshihen identifikimi i grupeve/kategorive të personave viktimë të mundshme të trafikimit, si dhe nevojat përkatëse për shërbime dhe programe specifike Bazuar në vlerësimet rajonale të situatës, do të hartojnë një Plan Veprimi shumë-sektorial për Antitrafikimin, ku të përfshihen programe specifike për parandalimin e TP si dhe programe/shërbime ndihme/rehabilitimi për Planet e Asistencës për antitrafikimin (shërbime parandaluese dhe reaguese/rehabilituese) Monitorojnë zbatimin e tyre	KRAT, bashkitë, MMSR, Shërbimi Social Shtetëror, Zyrrat Rajonale të Punësimit, ZKKA me mbështetjen e partnerëve	Në vazhdimësi	Prania e vlerësimeve rajonale të situatës Ekzistenca e vlerësimeve të rregullta (6-mujore) të situatës Ekzistenca e strategjive të para vjetore, shumë-sektoriale rajonale për antitrafikimin për vitin 2015, ku përfshihen programe/skema specifike për parandalimin/ndihmën ndaj viktimave të mundshme dhe personave e grupeve të trafikuar. Strategjitë vjetore 2016 Shërbimet e nevojshme dhe skemat e asistencës janë planifikuar/ekzistojnë Raportet e monitorimit	KRAT, ZKKA, MMSR, Partnerët
3.(b).2	Lehtësimi i përdorimit të shërbimeve sociale (përfshirë ndihmën sociale, strehimin, shërbimet e kujdesit shëndetësor, arsimimin, trajnimet profesionale/aftësitë për jetën, skema (vetë-)punësimi) për grupet e viktimave të mundshme dhe personat “në rrezik” trafikimi, si dhe personat e trafikuar Nxjerrja dhe detyrimi i zbatimit të udhëzimeve për të gjithë ofruesit e shërbimeve që të kenë si përparësi grupet/personat “në rrezik” Shpërndarja e informacionit tek grupet/ personat në nevojë	Anëtarët e KRAT-eve me ministrinë e linjës (sidomos MAS, MMSR, MSH) nëpërmjet zyrrave të tyre rajonale, bashkitë, ZKKA me partnerët	Në vazhdimësi	Udhëzimet janë nxjerrë Ekzistenca e listave me shërbimet në dispozicion të grupeve të synuara Numri i personave të identifikuar si “në rrezik” të cilët përfitojnë nga keto shërbime Numri dhe përqindja e grupeve të synuara të cilët kanë njohuri mbi ndihmën sociale dhe shërbimet që kanë në dispozicion.	Ministritë e Linjës, Partnerët

4. SYNIMI STRATEGJIK: Ndalimi (Parandalimi) i trafikimit të mundshëm të personave dhe eliminimi i situatave aktuale të trafikimit nëpërmjet masave administrative.

Treguesit: Numri i rasteve të trafikimit të parandaluara, numri dhe përqindja e rasteve të trafikimit të identifikuar dhe eliminuar nëpërmjet masave të kontrollit administrativ.



4. (a) OBJEKTIVI SPECIFIK

Sigurimi i normimit dhe monitorimit të të gjithë sektorëve të shoqërisë që mund të ndikohen nga trafikimi, si dhe parandalimi/identifikimi nëpërmjet masave në kufi.

Treguesit: Ulje në numrin dhe përqindjen e viktimave të trafikimit të identifikuar të cilët raportojnë se janë rekrutuar nëpërmjet agjencive private të punësimit, agjencive të udhëtimit dhe turizmit, agjencive martesore dhe birësuese; numri i personave në rrezik dhe personave të trafikuar të cilët janë identifikuar në PKK.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
4.(a).1	Vazhdimi i licencimit dhe monitorimit të agjencive private të punësimit	MMSR/Inspektoriati Shtetëror i Punës; Forumi i Agjencive Private të Punësimit	Në vazhdimësi	Ekzistenca e planit të monitorimit dhe të raporteve periodikë të monitorimit Numri i rasteve të raportuara të shkeljeve dhe sanksioneve Numri/përqindja e agjencive private të punësimit/stafit të cilët janë të trajnuar dhe e njohin Kodin e Etikës	MMSR, Partnerët
4.(a).2	Rritja e rolit të agjencive private të punësimit që respektojnë ligjin Publikimi i Kodit të Etikës dhe i të gjitha agjencive private të punësimit të licencuara në faqen e internetit të MMSR, faqen e internetit të Shoqatës së Agjencive Private të Punësimit, si dhe trajnimi i stafit të këtyre agjencive mbi parandalimin/luftën e TP	MMSR, Shoqata e Agjencive Private të Punësimit, Partnerët	Në vazhdimësi	Kodi i Etikës si dhe të gjitha agjencitë private të punësimit janë të publikuara Puna e agjencive private të punësimit është e reklamuar Stafi i agjencive private të punësimit është i trajnuar Numri (i rritur) i personave të punësuar (në vit) nëpërmjet agjencive private të punësimit në përgjithësi, si dhe i viktimave të mundshme të trafikimit në veçanti	MMSR, ZKKA, Partnerët.
4.(a).3	Promovimi i Kodit të Etikës në Turizëm dhe trajnimi i të gjithë punonjësve të turizmit/hotelerisë mbi rolin e tyre në parandalimin dhe zbulimin e TP; si dhe monitorimi i zbatimit të tij duke sanksionuar ndëshkimin deri në heqjen e licencës për rastet e përsëritura të shkeljes së Kodit të Etikës.	Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, PSH, ZKKA, OSBE, agjencitë e turizmit, hotelet/motelet, operatorët turistik Shoqata Shqiptare e Turizmit,	Në vazhdimësi	Raporti i parë i monitorimit deri në mesin e 2015 Raporte monitorimi periodikë Numri i rasteve të raportuara të shkeljeve dhe sanksioneve Numri i stafit të trajnuar	MZHUT, PSH, ZKKA, Donatorët.
4.(a).4	Zbatimi i sistemeve të licencimit dhe monitorimit si dhe nxitja e respektimit të Kodit të Etikës edhe për industrinë e tjera (të udhëtimit, transportit, bujqësisë, ndërtimit, agjencitë martesore dhe ato birësuese); si dhe hartimi e zbatimi i një Kodi Sjelljeje për Bizneset, ku të theksohet ndalimi i shfrytëzimit të punës së të miturve	MMSR, Inspektoriati i Punës, Ministria e Ekonomisë, si dhe ministri të tjera të linjës, me mbështetjen e partnerëve	2015	Ekzistenca e sistemeve të licencimit dhe monitorimit për të gjitha industrinë e përmendura Ekzistenca e një Kodi Sjelljeje për Bizneset Stafi i trajnuar mbi Kodin e Sjelljes dhe TP Ekzistenca e sistemeve të monitorimit dhe raporteve të monitorimit	MMSR, ME, dhe ministrinë e linjës, Donatorët.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
4.(a).5	Monitorimi në vazhdimësi i njoftimeve në media dhe internet për vende të lira pune për të zbuluar përpjekje të fshehta për rekrutim për qëllime trafikimi.	ZKKA, Policia e Shtetit/Spektori për Trafikun e Paligjshëm	Në vazhdimësi	Ekzistenca e raporteve të monitorimit Numri i rasteve të zbuluara	ZKKA, PSH,
4.(a).7	Forcimi i Inspektoriateve të Punës, për të qenë në gjendje të detyrojnë zbatimin e të drejtave dhe standardeve të punës si dhe për të parandaluar apo zbuluar rastet e shfrytëzimit të punës dhe trafikimit (SHIH TEK IDENTIFIKIMI)	MMSR, ISHP, PSH (Policia Kufitare dhe e Migracionit) me mbështetjen e partnerëve	Në vazhdimësi	Numri i viktimave të mundshme të identifikuar dhe rasteve të referuara për hetim.	MMSR, PSH, ZKKA, PAMECA IV
4.(a).8	Trajnimi i Policisë Kufitare dhe të Migracionit: Për të identifikuar migrantët që hyjnë/dalin nga Shqipëria e të cilët mund të jenë viktimë të mundshme Për tu dhënë informacion mbi të drejtat e tyre; si dhe si të kërkojnë ndihmë jashtë apo në Shqipëri (SHIH TEK IDENTIFIKIMI)	MPB, PSH, OJF/ON dhe partnerët	3-mujori i fundit 2014 - 2015	Policia Kufitare dhe e Migracionit është e trajnuar Prania e posterave dhe broshurave në të gjitha zonat e pikave të kalimit kufitar. Viktimave të mundshme të trafikimit u është shpërndarë material informues.	MPB, PSH, PAMECA IV

4. (b) OBJEKTIVI SPECIFIK

Detyrimi i zbatimit të kërkesave për regjistrim në Gjendjen Civile (dokumentacioni i ligjshëm për lindjet, shtetësinë dhe martesën) në mënyrë që të lehtësohet përfshirja sociale dhe përdorimi i sistemit të arsimit dhe shërbimeve të tjera sociale.

Tregues: Përqindja e popullsisë e regjistruar dhe me dokumentacion të ligjshëm.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
4.(b).1	Përmirësimi i regjistrimit të lindjeve, duke përdorur sisteme nxitëse, garantuar regjistrimin falas të familjeve me të ardhura të ulta, përmirësuar bashkëpunimin mes institucioneve shëndetësore dhe Zyrës së Gjendjes Civile si dhe duke bashkërenduar ngushtësisht me OJF-të.	MPB, MSH, OJF, partnerë të tjerë	Në vazhdimësi	Synimi: Rritje e numrit dhe përqindjes së popullsisë të regjistruar që pas lindjes.	MPB, MSH, Donatorët.
4.(b).2	Regjistrimi i lindjeve në ambasadat e Republikës së Shqipërisë jashtë vendit (thjeshtimi i procedurave të regjistrimit).	MPJ, MPB, OJF, partnerë të tjerë	2015	Ekzistenca e procedurave të thjeshtuara Rritja e numrit të lindjeve të regjistruara.	MPJ, MPB, Partnerët

BASHKËRENDIMI

1. SYNIMI STRATEGJIK: Bashkërendimi i të gjitha masave antitrafik dhe bashkëpunimi i frytshëm mes të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit në Shqipëri dhe veçanërisht me Mekanizmin e Dhuës në familje dhe Mekanizmin e Dhunës ndaj Fëmijëve.

Treguesit: Të gjithë aktorët e përfshirë perceptojnë efikasitet të bashkëpunimit; të gjithë aktorët e përfshirë janë të kënaqur me bashkërendimin.



1. (a) OBJEKTIV SPECIFIK

Garantim i mbikëqyrjes së vazhdueshme të të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër trafikimit të personave dhe i projekteve/masave të marra në vend, si dhe nxitja e shkëmbimit të informacionit mes të gjitha organizatave partnere, shtetërore dhe joshetërore.

Treguesit: Ekzistenca e një liste të përditësuar rregullisht me OJF, institucione shtetërore, organizata ndërkombëtare, si dhe një pamje e përgjithshme e masave të marra në fushën e antitrafikimit; faja e internetit e ZKKA përmban informacion të përditësuar si dhe lajme të publikuara rregullisht.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(a).1	Mirëmbajtja e një liste të përditësuar aktorësh dhe veprimtarish, e aksesueshme nëpërmjet faqes së internetit të ZKKA	ZKKA	Në vazhdimësi	Ekzistenca e një liste të përditësuar rregullisht me aktorë dhe një liste me projekte/masa të marra në fushën e antitrafikimit Faja e internetit e ZKKA përditësohet rregullisht	MPB ZKKA
1.(a).2	Shkëmbim i rregullt informacioni mes të gjithë aktorëve, nëpërmjet: Faqes së internetit të ZKKA Buletineve periodike Takimeve të rregullta me Task-Forcën Kombëtare të MKR-së, organizatat ndërkombëtare, donatorët, etj.	ZKKA	Në vazhdimësi	Faja e internetit e ZKKA përditësohet rregullisht Mbahen takime rregullisht Ekzistenca e raporteve gjashtë-mujore dhe vjetore mbi situatën dhe veprimtarinë antitrafik	MPB ZKKA
1.(a).3	Raportim i rregullt (2 herë në vit) i të gjitha agjencive zbatuese tek ZKKA mbi veprimtaritë e tyre aktuale dhe ato të planifikuara, si dhe mbi planet e punës për gjysmën tjetër të vitit (shih edhe monitorimin më poshtë)	Të gjitha agjencitë zbatuese	Në vazhdimësi	Numri dhe përqindja e aktorëve që raportojnë dy herë në vit Ekzistenca e listës së përditësuar	Të gjitha agjencitë

1. (b) OBJEKTIV SPECIFIK

Funksionimi efikas i kuadrit bashkërendues dhe bashkëpunues për të mundësuar përcaktimin e politikave dhe standardeve, monitorimin dhe shqyrtimin, si dhe mekanizma efikas menaxhimi çështjesh për identifikimin, referimin, mbrojtjen, ndihmën, integrimin dhe riintegrimin e personave të trafikuar (viktima dhe viktimat të mundshme të trafikimit) nëpërmjet Mekanizmit Kombëtar të Referimit (MKR), duke qartësuar rolet dhe përgjegjësitë përkatëse, si dhe ndarjen e detyrave dhe mekanizmat e bashkëpunimit dhe bashkëveprimit mes të gjithë aktorëve në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, si dhe duke forcuar kapacitetet e organeve bashkërenduese.

Treguesit: Ekzistenca e termave të referencës të rëna dakord për të gjithë aktorët, si dhe PSV për bashkëpunim dhe bashkërendim.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(b).1	Forcimi i kapaciteteve të Zyrës së Koordinatorit Kombëtar (ZKKA) për të marrë përsipër funksionet e saj të bashkërendimit dhe mbështetjes së zbatimit të PKV, sidomos: Hartimin e politikave dhe përcaktimin e standardeve, si dhe monitorimin e përmbushjes së tyre Monitorimi dhe rishikimi i luftës antitrafik/PKV Funksionimi efikas i kuadrit bashkërendues kundër trafikimit në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor, përfshirë terma reference të qarta për të gjitha strukturat si dhe aktorët/stafin e përfshirë Informimi/trajnimi i të gjithë aktorëve antitrafik mbi temat e referencës, standardet dhe PSV-të si dhe shpërndarja e paketave udhëzuese sipas nevojave Kryesimi dhe mbështetja e AP/MKR në detyrat e tyre, si dhe mbajtja e një baze të dhënash mbi viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit Menaxhim i informacionit dhe të dhënave kombëtare, vlerësim i situatës Raportim Komunikim me të gjithë aktorët e përfshirë Komunikim me donatorët dhe mobilizim burimesh Mirëmbajtje e një liste të përditësuar me aktorë/veprimtari Organizim veprimtarish ndërgjegjësuere dhe fillim/zbatim i veprimtarive të tjera kyçe të PKV Për të arritur sa më lart, duhet të: Përforcohen burimet njerëzore me terma reference dhe përshkrime pune të qarta, të sigurohen zyra të mjaftueshme e të përshtatshme, si dhe burimet financiare Të hartohen dhe vihen në zbatim plane vjetore pune	MPB, ZKKA	Në vazhdimësi	Treguesit/Synimi: Përmirësim i bashkërendimit dhe mbështetjes për zbatimin e PKV Rritje e burimeve njerëzore dhe financiare të ZKKA Synimi: Të paktën 4 punonjës më shumë në ZKKA si dhe rritje e buxhetit vjetor me 10% Ekzistenca e infrastrukturës dhe ambienteve të zyrave e përshtatshme Ekzistenca e planeve (vjetore) të punës Ekzistenca e përshkrimeve të punës individuale të punonjësve të ZKKA Raport vjetor mbi veprimtaritë e ZKKA	MPB, ZKKA MKR AP Donatorët
1.(b).2	Forcimi i kapacitetit të Autoritetit Përgjegjës (AP) për të kryer funksionet e tij, kryesisht bashkërendimin dhe mbikëqyrjen e zbatimit të marrëveshjes për MKR dhe të PSV-ve për identifikimin, referimin për ndihmë dhe riintegrimin e personave të trafikuar, menaxhimin e informacionit dhe raportimin mbi VT dhe VMT (mirëmbajtja e bazës së të dhënave të menaxhimit të çështjeve të VT	ZKKA, të gjithë firmëtarët e MKR	Fundi i 2014	Tregues/Synimi: Një punonjës me kohë të plotë i ZKKA është ngarkuar me detyrë në shërbim të AP Ekzistenca e profileve të punës për pikat e kontaktit të firmëtarëve të AP Përshkrimet e punës të pikave të kontaktit në AP përmbajnë edhe detyra që kanë lidhje me AP, si pjesë e	ZKKA MKR AP



	dhe VMT të referuara): Caktimi i një punonjësit me kohë të plotë në ambientet e ZKKA, si Sekretariat i AP Krijimi i profileve të punës për pjesëtarët e AP, dhe garantimi i përfshirjes së detyrave që kanë lidhje me AP në përkrahjet e punës të “institucioneve mëmë” të pikave të kontaktit të caktuara në AP			detyrave të tyre të zakonshme	
1.(b).3	Qartësim dhe konsolidim i kuadrit të bashkërendimit, mandateve, ndarjes së detyrave dhe roleve e përgjegjësiwe përkatëse të të gjithë aktorëve të përfshirë: Krijimi i një grupi ndër-institucional me aktorë dhe ekspertë kyçë për të shqyrtuar kuadrin aktual dhe për ta rishikuar/përmirësuar atë nëse është e nevojshme; Konfirmimi apo rishikimi i termave të referencës të ZKKA, AP, MKR, Task - Forcës Kombëtare për TËP, KRAT-eve, grupet e koordinimit në bashki, etj. Konfirmimi apo transferimi i përgjegjësiwe për hartimin e politikave të përgjithshme, monitorimin dhe shqyrtimin e luftës antitrafik tek një grup kombëtar koordinimi (Task Forcë për TËP) Formalizim i Grupit Këshillimor të organizatave antitrafik të shoqërisë civile, të ngarkuara me detyrën e dhënies së rekomandimeve ZKKA, si dhe kryerjen e vlerësimeve të pavarura Hartim i profileve të punës dhe termave të referencës për pikat e kontaktit të caktuara nga të gjitha organet bashkërenduese, si dhe përfshirja e detyrave antitrafik në përkrahjet e punës normale që kanë në “institucionet mëmë”	ZKKA, me aktorët përkatës të interesuar	Nëntor 2014 Janar 2015	Ekzistenca e grupit ndër-institucional Është rënë dakord për kuadrin e bashkërendimit Ekzistenca e termave të referencës për të gjitha organet e përfshira në nivel kombëtar, rajonal dhe vendor Ekzistenca e profileve të punës për pikat e kontaktit të të gjitha strukturave bashkërenduese, si dhe ekzistenca e termave të referencës individuale Përkrahjet e punës të të gjitha pikave të kontaktit përfshijnë detyra që kanë lidhje me antitrafikun, si pjesë e detyrave të tyre normale tek “institucionet mëmë” Janë caktuar përgjegjësitë për caktimin e politikave, monitorimin dhe rishikimin e përpjekjeve antitrafik Është formalizuar Grupi Këshillimor i organizatave antitrafik të shoqërisë civile	MPB KRAT MKR AP Shoqëria Civile Donatorë
1.(b).4	Sigurimi që ndarja e detyrave, roleve dhe përgjegjësiwe të kuptohen mirë dhe miratohen nga të gjithë aktorët e interesuar, nëpërmjet mbajtjes së seancave informuese/trajnuese në lidhje temat e referencës përkatëse si dhe funksionet dhe detyrat e pikave të kontaktit; gjithashtu nëpërmjet dhënies së informacionit mbi standardet përkatëse si dhe PSV-të; si dhe nëpërmjet shpërndarjes së paketave udhëzuese të krijuara posaçërisht për të gjithë aktorët	ZKKA, KRAT për aktorët në nivel bashkie/komune, me mbështetjen e ZKKA	3-mujori i parë i 2015	Përqindja e aktorëve/pikave të kontaktit që janë të familjarizuar me rolet dhe përgjegjësitë e tyre Numri i seancave të trajnimit/informimit Ekzistenca e paketave udhëzuese të krijuara posaçërisht për të gjithë aktorët kyçë antitrafik	MPB MKR KRAT Donatorë



1. (c) OBJEKTIV SPECIFIK

Forcimi i luftës antitrafik në nivel rajonal dhe në nivel bashkie

Treguesit: Ekzistenca e mekanizmit bashkërendues ndërinstitucional në nivel bashkie/komune. Numri dhe përqindja e personave në rrezik të identifikuar/ndihmuar nga grupet bashkërenduese vendore; numri dhe përqindja e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar dhe ndihmuara nga grupet bashkërenduese vendore, sipas qarqeve.

Synimi:

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(c).1	Forcimi i Komiteteve Antitrafik, për të përmbushur detyrat e tyre, në bashkërendim të ngushtë me Komitete të tjera rajonale/Tryezat për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe çështjet gjinore/dhunën në familje; përfshirë vlerësime të rregullta rajonale të situatës, strategji rajonale për antitrafikimin, planifikim të fondeve për pushtetin vendor, bashkërendim, monitorim dhe mbështetje e aktorëve në bashki, nxitje e shkëmbimit të informacionit dhe përvojave brenda qarkut 1.Hartim i termave të referencës për komitetet rajonale dhe tryezat teknike, si dhe siguri i anëtarësimit të të gjithë aktorëve të interesuar; 2. Zgjerim i anëtarësimit të KRAT-eve (duke përfshirë anëtarë të këshillit të qarkut, zyrës së nën-prefektit, kryetarit të këshillit të qarkut, drejtoritë rajonale të PKM, si dhe OJF); 3. Caktim i një koordinatori me kohë të plotë, të nivelit teknik, për Tryezat Teknike të KRAT (ideale do të ishte të caktohej edhe një punonjës përgjegjës për tryeza të tjera rajonale); 4. Organizim i trajnimeve/seminareve me Komitetet Rajonale për të hartuar plane pune të KRAT dhe Tryezave Teknike në përputhje me termat e reja të referencës; si dhe shpërndarja e paketave udhëzuese. Hartimi dhe zbatimi i planeve vjetore të punës.	ZKKA, Këshillat e Qarqeve, KRAT, MKR	3-mujori i dytë i 2015 Në vazhdimësi	Treguesit: Ekzistenca e termave të referencës për Komitetet Rajonale dhe Tryezat Teknike Ekzistenca e një koordinatori antitrafik me kohë të plotë, të nivelit teknik, në çdo Komitet Rajonal Antitrafik, i cili në rastin ideal duhet të bashkërendojë me Task Forcat rajonale për mbrojtjen e fëmijëve, dhunën në familje/çështjet gjinore, si dhe të organizojë takime të përbashkëta të të gjitha tryezave rajonale. Numri i koordinatorëve të KRAT të trajnuar Ekzistenca e një pakete udhëzuese për KRAT Ekzistenca e planeve vjetore të punës për çdo KRAT Raporte vjetore për veprimtaritë e KRAT Mbajtja e takimeve të rregullta të KRAT, numri dhe përqindja e takimeve të përbashkëta të tryezave teknike rajonale për antitrafikun, çështjet gjinore/dhunën në familje si dhe mbrojtjen e fëmijëve. Mbajtja e takimeve të rregullta rajonale të pikave të kontaktit/ grupeve bashkërenduese në bashki. Shënimet e takimeve	MPB KRAT MKR Partnerë Donatorë
1.(c).2	Përshtatje e strukturave rajonale antitrafik, në përputhje me reformën administrativo-territoriale dhe reformën në shërbimin social, në kohën e hyrjes në fuqi të ndarjes së re territoriale: Përgatitje e shkrirjes eventuale të KRAT-eve me tryeza të tjera rajonale në komitete të integruara rajonale për mbrojtjen dhe ndihmën sociale.	ZKKA, MMSR, Përfaqësuesit e KRAT-eve	Në vazhdimësi	Mbajtja e konsultave të rregullta Nisja e përshtatjes së strukturave antitrafik në kohën kur jepet një program me afate të qarta për zbatimin e reformës territoriale	ZKKA MKR MMSR Donatorë



1.(c).3	Krijimi i mekanizmeve ndër-institucionale në bashki për parandalimin, identifikimin, referimin dhe ndihmën/mbrojtjen e grupeve dhe personave në rrezik si dhe personave të trafikuar (VT dhe VMT), ku përfshihen: - Grupe vendorë bashkërenduese, të përbërë nga të gjithë aktorët shtetërorë e jo-shtetërorë në kontakt me personat/grupet e rrezikuar/të trafikuar, p.sh. punonjësit arsimorë, mbrojtësit e fëmijëve në shkolla, punonjësit e shëndetësisë, mjekët, policia, zyrat vendore të punës, inspektorët e punës, organizatat në komunitet, etj. ëKëto mekanizma apo të paktën pikat e kontaktit për bashkërendim vendor të jenë të njëjtë me mekanizmat që trajtojnë çështje sociale të ngjashme (ndihma dhe mbrojtja sociale, mbrojtja e fëmijëve, çështjet gjinore/dhuna në familje, etj) dhe që mekanizmat të bashkëpunojnë ngushtësisht me njeri-tjetrin]. - Pika kontakti për bashkërendim vendor, për bashkërendimin, referimin dhe menaxhimin e çështjeve, si dhe bashkërendimin dhe raportimin tek KRAT dhe AP Si më poshtë:	Bashkitë, KRAT me mbështetjen e ZKKA, AP, anëtarët e MKR, partnerët ndërkombëtarë	2015 e në vazhdim	Treguesit: Numri i mekanizmeve bashkërendues ndër-institucionale të nivelit vendor për TIP Ekzistenca e termave të referencës Ekzistenca e standardeve/PSV-ve vendore për trajtimin e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit Përshkrimet e punës të të gjithë anëtarëve përbajnë detyra në lidhje me antitrafikimin Numri dhe përqindja e anëtarëve të mekanizmeve të trajnuar dhe të familjarizuar me përpjekjet antitrafikim, të cilët mund të rendisin treguesit/shenjat si dhe kanë njohuri mbi PSV-të Pikat e kontaktit bashkërenduese në nivel vendor emërohen nga Këshilli Bashkiak/i Komunës Përshkrimet e punës të organeve/punonjësve të emëruar në bashki përbajnë detyra në lidhje me TIP.	ZKKA MKR KRAT Donatorë
1.(c).3.1	Të hartohen tema reference për mekanizmin, organizatat pjesëtare dhe pikat e kontaktit bashkërenduese, si dhe përcaktimi i mekanizmeve të qartë për bashkërendim, bashkëpunim dhe raportim në nivele kombëtare dhe rajonale		2015		ZKKA MKR KRAT Donatorë
1.(c).3.2	Të hartohen tema reference për të gjithë anëtarët/pikat e kontaktit të mekanizmit, për tu siguruar që përpjekjet antitrafik të jenë pjesë e termave të referencës rutinë		2015		ZKKA, KRAT
1.(c).3.3	Të vihen në zbatim standardet dhe PSV-të për trajtimin e çështjeve individuale në përputhje me standardet e MKR dhe PSV-të		Në vazhdimësi		ZKKA MKR KRAT Donatorë
1.(c).3.4	Të emërohen pika kontakti për bashkërendim vendor, dmth personel teknik ekzistues në nivel bashkie, të cilëve tu ngarkohet kjo detyrë si pjesë e punës së tyre të përditshme, dhe të trajnohen për të.		2015		ZKKA KRAT Pushtet lokal
1.(c).3.5	Të trajnohen grupet ndër-institucionale në nivel bashkie, për PSV-të për identifikimin.		Në vazhdimësi		ZKKA Partnerë ON



1.(c).4	Të sigurohet përshtatja e strukturave antitrafik të bashkive në përputhje me reformën administrativo-territoriale, në kohën e hyrjes në fuqi të ndarjes së re territoriale; Të përgatitet shkrirja eventuale e grupeve vendore që merren me trafikimin e personave me grupe të tjera vendore në komitetet e integruara rajonale për mbrojtjen dhe ndihmën sociale; të përfshihet një sistem i integruar për menaxhimin e çështjeve dhe të të dhënave (mundësisht bazuar në modelin e atij për dhunën në familje)	ZKKA, MMSR, KRAT këshilli bashkiak/i komunës dhe aktorët në to	Në vazhdimësi	Mbajtja e konsultave të rregullta Nisja e përshtatjes së strukturave antitrafik në kohën kur jepet një program me afate të qarta për zbatimin e reformës territoriale	MPB ZKKA KRAT MMSR
---------	---	--	---------------	--	-----------------------------

1. (d) OBJEKTIV SPECIFIK

Ndërgjegjësimi i të gjithë vendit mbi Strategjinë Antitrafik dhe Planin Kombëtar të Veprimit, si dhe garantimi që rolet dhe përgjegjësitë përkatëse të jenë kuptuar qartë dhe të nxisin zbatimin e strategjisë/planit kombëtar të veprimit.

Treguesit: Përqindja e aktorëve të cilët janë të familjarizuar me strategjinë si dhe detyrat e tyre përkatëse; përqindja e veprimtarive të parashikuara në PKV të cilat janë të zbatuara.

Synimi:

Nr.	Veprimtari dhe nënveprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(d).1	Promovimi i Strategjisë dhe PKV, gjerësisht në të gjithë vendin, duke shpërndarë kopje të Strategjisë dhe PKV-së nëpërmjet kanaleve zyrtare, etj.	ZKKA	Nëntor 2014	Prezantimi i strategjisë dhe shpërndarja tek të gjithë aktorët kryesorë Numri dhe përqindja e aktorëve të nivelit kombëtar, rajonal dhe vendor të cilët janë të familjarizuar me strategjinë/PKV e re	MPB ZKKA
1.(d).2	Organizim i seminareve/takimeve me të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e PKV, për të: 1. Prezantuar Strategjinë/PKV, për të diskutuar/sqaruar detyrat dhe përgjegjësitë përkatëse 2. Dhënë informacion dhe udhëzime mbi detyrimin për të hartuar Plane Pune (vjetore) me Plane Burimesh dhe Plane Monitorimi për çdo njësi antitrafik	ZKKA	Fund 2014 - fillim 2015	Seminare të organizuara me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve të nivelit kombëtar e rajonal Ekzistenca e planeve të punës dhe planeve burimore vjetore, si dhe e planeve të monitorimit për organe e aktorë kryesorë	MPB ZKKA Gjithë aktorët
1.(d).3	Mbajtja e takimeve të rregullta me aktorë kryesorë për të diskutuar ecurinë apo problemet me zbatimin, sipas raporteve të monitorimit (shih më poshtë), dhe rënie dakord mbi hapat që duhet ndërmarrë për të përmirësuar gjendjen	ZKKA, Grupi Bashkërendues Kombëtar	Në vazhdimësi	Numri i takimeve Shënimet e takimeve janë shpërndarë për informim e veprim	MPB ZKKA MKR



2. SYNIMI STRATEGJIK: Garantimi që i gjithë informacioni dhe të dhënat e nevojshme për vlerësimin e trafikimit të personave dhe për luftën dhe parandalimin e suksesshëm të tij ekziston, është i përdorshëm nga të gjithë aktorët e përfshirë dhe shkëmbehet rregullisht si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Treguesit: Përqindja e të dhënave kyçe për të cilat ka të dhëna faktike të plota, ekzistenca e raporteve të rregullta me të dhëna kyçe; ekzistenca e vlerësimeve të rregullta të situatës si dhe e raporteve të vlerësimit.

Synimi: Ekzistenca e vlerësimeve të situatës bazë përsa i përket trafikimit të personave në nivel rajonal dhe kombëtar deri në fund të vitit 2014.

2. (a) OBJEKTIV SPECIFIK: Krijimi i mekanizmit për shpërndarjen e informacionit dhe të dhënave, në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale, në përputhje me përkufizimet e rëna dakord dhe për të dhënat kryesore të përcaktuara.

Treguesit: Përqindja e aktorëve që kuptojnë dhe veprojnë në përputhje me mekanizmin e rënë dakord; ekzistenca e raporteve të vlerësimit mbi TIP.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
2.(a).1	Rënie dakord mbi listën e informacioneve dhe të dhënave kyçe (shifrat/kategoritë statistikore) për trafikimin e personave, të dhëna social-ekonomike e të tjera, të cilat duhet të mblidhen dhe monitorohen sistematikisht	ZKKA, KSH, KRAT, studiues, aktorë të tjerë të interesuar, partnerë/ekspertë ndërkombëtarë	2015 e në vazhdim	Seminar me aktorët kryesorë Ekzistenca e një liste me të dhënat dhe informacionin përkatës mbi trafikimin e qenieve njerëzore si dhe fushat përkatëse, të cilat duhet të mblidhen dhe monitorohen në shkallë vendi	MPB KSH KRAT Donatorë
2.(a).2	Institucionalizimi i mekanizmit për mbledhjen, analizën dhe shpërndarjen e të dhënave/informacionit të identifikuar: Rënie dakord mbi formatin e raportimit dhe modalitetet për të dhënat që do të mblidhen në nivel kombëtar (ZKKA) dhe nivel rajonal/vendor (KRAT)	ZKKA, KSH, KRAT, të gjithë aktorët e përfshirë	Fund 2014	Ekzistenca e modaliteteve të rëna dakord për shkëmbimin e informacionit (formati tip dhe shpeshtësia e raportimit) Fillimi i mbledhjes së të dhënave Ekzistenca e raporteve të rregullta, me të dhënat kyçe; listat e shpërndarjes	MPB, ZKKA KRAT, donatorët
2.(a).2.1	Përgatitje e vlerësimeve të situatës së trafikimit në çdo qark në mënyrë të rregullt (2 herë në vit), bazuar në të dhënat e mbledhura në nivel rajonal (nga bashkitë) dhe të vërtetuara nga aktorët rajonalë të antitrafikut.	KRAT, në bashkëpunim me bashkitë, ZKKA, OJF, ON	Fundi i 2014 Mesi i 2015	Ekzistenca e vlerësimeve të situatës për çdo qark, si bazë për tu përdorur për shqyrtimin e PKV antitrafik Ekzistenca e raporteve të vlerësimit të situatës (dy herë në vit)	ZKKA KRAT ON OJF Donatorë
2.(a).2.2	Hartimi nga ana e ZKKA i raporteve vlerësues të situatës së TIP në nivel kombëtar, bazuar në raporte vlerësimi rajonale si dhe të dhëna e studime të tjera në nivel kombëtar, dhe të vërtetuara nga aktorët antitrafik të nivelit kombëtar; shpërndarja e këtyre raporteve në nivel kombëtar e ndërkombëtar.	ZKKA, MKR	Çdo fund viti	Ekzistenca e vlerësimit të verifikuar të situatës kombëtare, si bazë për shqyrtimet e ardhshme Ekzistenca e raporteve të rregullt të vlerësimit të situatës (dy herë në vit)	ZKKA MKR

2. (b) OBJEKTIV SPECIFIK: Rritja e kërkimeve mbi të gjitha format e trafikimit të qenieve njerëzore si dhe mbi të gjitha fushat e luftës antitrafik.

Treguesit: Vëllimi i përgjithshëm financiar i projekteve për trafikimin e qenieve njerëzore; përqindja e buxhetit shtetëror për kërkimet, e cila përdoret për kërkime në lidhje me trafikimin e qenieve njerëzore.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
2.(b).1	Ngritja e një rrjeti kombëtar studiuesish për trafikimin e personave dhe çështje të lidhura me të, si dhe organizimi i një tryeze të rumbullakët periodike me të gjithë studiuesit dhe institucionet kërkimore, përfshirë takime mes studiuesish dhe aktorësh antitrafik	ZKKA me institucionet kërkimore/universitetet partnere	2015	Rrjeti kombëtar i studiuesve/institucioneve kërkimore Numri i tryezave të rumbullakëta të organizuara	MPB ZKKA ON Donatorë
2.(b).2	Programe bashkëpunimi me universitetet për të nxitur kryerjen e tezave të masterit dhe disertacioneve mbi çështje të TiP	ZKKA, universitete	Në vazhdimësi	Ekzistenca e programeve të bashkëpunimit me universitete Numri i tezave/disertacioneve të shkruara në lidhje me TiP	ZKKA Donatorë
2.(b).3	Porositja e kërkimeve specifike mbi çështje përparësore të identifikuar më parë (në përputhje me raportet e vlerësimit), përfshirë kërkime për shkaktarët e faktorëve shtytës/tërheqës të TiP të cilët favorizojnë trafikimin, në mënyrë që të shërbejnë për përpjekjet parandaluese në të ardhmen	ZKKA, aktorë të tjerë	Në vazhdimësi	Janë identifikuar përparësitë, në përputhje me vlerësimet e situatës dhe diskutimet e aktorëve të përfshirë Ekzistenca e studimeve mbi temat përparësore të identifikuar	ZKKA Donatorë

3. SYNIMI STRATEGJIK

Përmirësimi i vazhdueshëm i luftës antitrafik në nivelet strategjike dhe operacionale, dhe përshtatja e tyre me kërkesat e reja dhe rrethanat e ndryshuara, duke krijuar/forcuar një sistem për shqyrtimin, monitorimin dhe vlerësimin e rregullt të strategjisë dhe PKV antitrafik

Treguesit: Ekzistenca e një strategjie dhe PKV të përditësuar deri në fund të vitit 2016; ekzistenca e një raport-progresi në mes të afatit kohor, me përshtatje afatshkurtra të PKV-së sipas nevojave.

3. (a) OBJEKTIV SPECIFIK: Garantimi i mbledhjes dhe analizës sistematike dhe të vazhdueshme të të gjitha informacioneve dhe të dhënave me interes në nivelet operacionale dhe strategjike në përputhje me ligjin “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, për krijimin/forcimin e një mekanizmit funksional në nivel vendor për parandalimin (identifikimin e personave viktimë të mundshme, si dhe ndërhyrjet parandakuese dhe mbështetëse), si dhe identifikimin, referimin dhe dhënien e ndihmës ndaj personave të trafikuar.

Tregues: Ekzistenca e termave të referencës për monitorim; përfshirja e monitorimit në PKV; ekzistenca e raporteve periodikë të monitorimit, si dhe e një raport-progresi afat mesëm; përqindja e veprimtarive të ndërmarra në kontekst të PKV, për të cilat ka një raport monitorimi me shkrim.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
3 (a) 1	Hartimi dhe zbatimi i një mekanizmi monitorimi dhe shqyrtimi të Mekanizmit Kombëtar të Referimit, për të siguruar aplikimin e vazhdueshëm të standardeve dhe PSV-ve për trajtimin e personave të trafikuar (shih tek MBROJTJA)	ZKKA, AP, MKR, Ministrinë e Linjës (Departamentet e Inspektimit)	2015	Publikimi i raportit të monitorimit brenda një viti nga miratimi i Planit të Veprimit Antitrafikim	MPB ZKKA MKR AP Ministrinë e Linjës
3. (a).2	Krijimi i termave të referencës për monitorimin, si pjesë e “Planit të Monitorimit, vlerësimit dhe shqyrtimit”; Përcaktimi i agjencisë monitoruese (ZKKA dhe/ose një organ i pavarur) dhe Hartimi i planit të monitorimit për të gjithë aktorët dhe veprimtaritë antitrafik, sipas termave të referencës, përfshirë hartimin e protokolleve specifike të punës për të gjithë pjesëtarët/punonjësit e përfshirë, me përshkrime pune dhe tregues të qartë për të monitoruar progresin e punës së gjithsecilit (shih veprimtarinë 1.(c).2 më poshtë) Fillimi i raportimit çdo 3 muaj nga të gjithë aktorët drejt organit të monitorimit, sipas formatit të rënë dakord për monitorimin	ZKKA, KSH, MKR, KRAT, partnerët ndërkombëtarë	Dhjetor 2014	Ekzistenca e termave të referencës për monitorimin Plani i monitorimit i miratuar nga të gjithë aktorët e përfshirë (nëpërmjet Grupit Bashkërendues Kombëtar) Seminar mbi monitorimin i mbajtur me të gjithë partnerët zbatues Numri dhe përqindja e aktorëve që janë të familjarizuar dhe zbatojnë planin e monitorimit dhe detyrimet për raportim	MPB ZKKA MKR KRAT
3.(a).3	Publikimi i rregullt i raporteve të monitorimit dhe organizimi i rregullt i takimeve me grupe bashkërenduese kombëtare për të diskutuar progresin e zbatimit me të gjithë aktorët e interesuar si dhe për të rënë dakord mbi masat përmirësuese dhe ndryshimet afatshkurtëra të PKV sipas nevojave.	ZKKA dhe/ose agjencia monitoruese, Grupi Bashkërendues Kombëtar	Fundi i 2014/pranverë 2015	Ekzistenca dhe miratimi i raportit të parë 3-mujor të monitorimit Takime çdo 3 muaj Shënimet e takimeve, me masat përmirësuese të marra, janë shpërndarë për informim dhe veprim	ZKKA Gjithë aktorët
3.(a).4	Organizimi i takimeve të rregullta (vjetore) me Komitetin Shtetëror kundër Trafikimit, për të diskutuar gjendjen e zbatimit dhe veprime të propozuara për përmirësim	ZKKA me MKR dhe me Komitetin Shtetëror	Duke filluar nga mesi i 2015	Mbajtja e takimeve të rregullta me Komitetin Shtetëror (çdo vit) Shënimet e takimeve	MPB KSH

3. (b) OBJEKTIV SPECIFIK: Vlerësimi rregullisht i të gjitha veprimtarive të parashikuara në PKV.

Treguesit: Ekzistenca e termave të referencës për vlerësim; PKV-ka ka të përfshirë detyrimin për vlerësim; përqindja e veprimtarive të ndërmarra në kuadër të PKV, për të cilat ka një raport vlerësimi me shkrim.

Synimi: Të paktën 50% e veprimtarive të parashikuara në PKV janë të vlerësuara.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
3.(b).1	Nisja e zbatimit të detyrimit për vlerësimin e të gjithë aktorëve dhe masave të parashikuara në PKV	ZKKA me Task Forcën Kombëtare e MKR-së	Fundi i 2015 – mesi i 2016	Numri dhe përqindja e aktorëve të familjarizuar me detyrimet për vlerësim Ekzistenca e raporteve të vlerësimit	ZKKA MKR
3.(b).2	Kryerja e vlerësimeve të pavarura për disa pjesë apo për të gjithë PKV-në	Grupi Këshillimor i shoqërisë civile, aktorët e tjerë	Mesi i 2016	Ekzistenca e një raporti të pavarur vlerësimi për disa pjesë/të gjithë PKV-në	ZKKA donatorët

3. (c) OBJEKTIV SPECIFIK: Garantim i shqyrtimit rregullisht të të gjitha veprimtarive të parashikuara në PKV dhe i rishikimit/përditësimit të strategjisë/PKV 2014-2017 duke u mbështetur tek gjetjet e shqyrtimit.

Treguesit/Synimi: Ekzistenca e termave të referencës për shqyrtimin; shqyrtimi është i parashikuar në PKV; ekzistenca e një shqyrtimi me shkrim të përpjekjeve antitrafik deri në mesin e 2016; ekzistenca e një strategjie/PKV të rishikuar/përditësuar, deri në fundin e 2016

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
3.(c).1	Zbatimi i monitorimit dhe shqyrtimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit dhe PSV-ve të tij (shih tek MBROJTJA)	AP, MKR	2015		MKR AP
3.(c).2	Hartimi i një "Plani për monitorim, vlerësim dhe shqyrtim" dhe rënia dakord mbi rezultatet dhe treguesit e ndikimit (për matjen e synimeve strategjike dhe objektivave specifike) si dhe mbi të dhënat bazë (bazuar në raportet e parë të vlerësimit të situatës), përfshirë temat e referencës për shqyrtimin	ZKKA me Task Forcën Kombëtare për TiP	Fundi i 2014	"Plani për monitorim, vlerësim dhe shqyrtim" i miratuar Ekzistenca e të dhënave bazë, rezultateve dhe treguesve të ndikimit të rëna dakord Ekzistenca e termave të referencës për shqyrtim	ZKKA, ekspert për monitorimin dhe shqyrtimin
3.(c).3	Shqyrtimi i Strategjisë/PKV 2014-2017 (me përjashtim të MKR dhe PSV-ve) sipas termave të referencës të rëna dakord, dhe bazuar në raportet e monitorimit dhe vlerësimit Krijimi dhe trajnimi i një grupi pune për shqyrtimin e PKV (anëtarë të një Task Force për TiP apo ekspertë të pavarur) Diskutim dhe miratim i shqyrtimit si dhe nga Task Forca Kombëtare për TiP	ZKKA, TF Kombëtare për TiP, me mbështetjen e ekspertëve të jashtëm dhe partnerëve kombëtarë/ndërkombëtarë	Mesi i 2016	Anëtarët e Grupit të Punës për Shqyrtimin janë identifikuar dhe trajnuar Ekzistenca e një shqyrtimi me shkrim Shqyrtimi i miratuar nga TF Kombëtare për TiP	ZKKA Ekspertë
3.(c).4	Hartimi, bazuar në shqyrtimin e kryer, i strategjisë/PKV të rishikuar, si dhe miratimi nga Komiteti Shtetëror/qeveria	ZKKA, TF Kombëtare për TiP me Komitetin Shtetëror	Fundi i 2016	Ekzistenca e një strategjie/PKV-je të re dhe miratimi nga Komiteti Shtetëror/Qeveria	ZKKA KSH

4. SYNIMI STRATEGJIK: Sigurimi i të gjitha burimeve të nevojshme për zbatimin e strategjisë kombëtare antitrafik dhe PKV-së si dhe për rritjen e pjesës së fondeve shtetërore dhe burimeve financuese të tjera shtetërore në fondin e përgjithshëm për zbatimin e strategjisë/PKV-ve.



Treguesit: përqindja e burimeve të nevojshme për zbatimin e PKV-së (çdo vit); përqindja e fondeve të qeverisë (të zakonshme dhe të posaçme) si pjesë e financimit të përgjithshëm për strategjinë/PKV-në (çdo vit); përqindja e fondeve vendase përkundrejt atyre të huaja për strategjinë/PKV.

Synimi: Rritje e vazhdueshme e fondeve shtetërore për strategjinë/PKV, me synim arritjen e 25% në vitin 2017.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
4.(a) 1	Sigurimi i një pamjeje të përgjithshme të kostos totale (materiale dhe financiare) për zbatimin e PKV: nisja e përdorimit të një skeme raportimi financiar dhe kontrolli për të gjithë aktorët në nivel vendor, rajonal dhe kombëtar, me synim rritjen e burimeve në dispozicion	ZKKA me të gjitha institucionet/aktorët që kanë detyra në kuadër të këtij PKV	Tetor 2014	Udhëzimet/instruksionet janë shpërndarë tek të gjithë aktorët shtetërorë etj. Ekzistenca e planeve vjetore të burimeve si dhe raporteve mbi shpenzimet për zbatimin e strategjisë/PKV-së	ZKKA, dhe të gjithë aktorët
4.(a).2	Të gjithë aktorët të hartojnë plane dhe buxhete individuale (vjetore) sipas instruksioneve, dhe t'ia dorëzojnë ZKKA	Të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e strategjisë/PKV-së	Tetor 2014, dhe deri në muajin mars të çdo viti pasardhës	Ekzistenca e planeve të punës me planin e burimeve për të gjithë aktorët e përfshirë në zbatimin e PKV-së	Të gjithë aktorët
4.(a)3.	Hartimi i Planeve Vjetore për Burimet në Total për të gjitha masat e parashikuara në PKV, përfshirë mangësinë në financim.	ZKKA, me kontributin e të gjithë aktorëve	Tetor 2014	Ekzistenca e Planit Total të Burimeve (vjetor), ku të përfshihet financim i rregullt dhe i jashtëzakonshëm nga qeveria; financimet nga donatorët e jashtëm dhe mangësitë në financim	Të gjithë aktorët
4.(a)4	Të gjithë aktorët i dorëzojnë ZKKA-së raporte vjetorë shpenzimesh, në fund të vitit, për shpenzimet e kryera për zbatimin e detyrave të tyre në kuadër të PKV, në përputhje me udhëzimet e lëshuara nga ZKKA.	Të gjithë aktorët	Qershori i çdo viti për vitin paraardhës	Vënia në dispozicion e raporteve të shpenzimeve	ZKKA Të gjithë aktorët
4.(b) 1	Hartimi i planeve për mobilizimin e burimeve, dhe rritje graduale e fondeve kombëtare për strategjinë/PKV, përkundrejt fondeve të pritshme nga ndërkombëtarët.	ZKKA, të gjithë aktorët	Tetor 2014	Deri në vitin 2017, 25% e fondeve për PKV do të mbulohen nga burime financiare kombëtare.	ZKKA Të gjithë aktorët
4.(b)2	Organizim i takimeve të rregullta me organizatat, agjencitë dhe donatorët ndërkombëtarë për të kërkuar mbështetje për zbatimin e strategjisë/PKV-së	ZKKA me aktorët kryesorë	Në vazhdimësi	Mbajtja e takimeve të rregullta Financimi nga donatorët ndërkombëtarë/BE në shifra, si dhe përqindje e financimit total	ZKKA Të gjithë aktorët



4.(b) 3	Të gjithë aktorët shtetërorë të garantojnë përfshirjen e kërkesave të tyre për fonde për zbatimin e PKV në plan-buxhetin e Qeverisë së Shqipërisë, në buxhetin normal apo si fonde të posaçme.	Të gjithë aktorët shtetërorë	Fund 2014, dhe deri në muajin mars të çdo viti pasardhës	Përqindja e shpenzimeve të parashikuara të cilat janë përfshirë në kërkesën që dërgon Ministria në lidhje me plan-buxhetin e Qeverisë Synimi: rritje graduale	Të gjithë aktorët
4.(b) 4	Identifikim dhe sigurim i burimeve të tjera të financimit vendas për zbatimin e PKV-së: Sektori privat/biznesi shqiptar Fondacionet shqiptare Fondi i posaçëm, nga pasuritë e konfiskuara Etj.	ZKKA me partnerët	Në vazhdimësi	Burimet e financimit të identifikuar Përqindja e fondeve për zbatimin e PKV-së vijnë nga burime vendase, jo-shtetërore	ZKKA Institucione shtetërore Sipërmarrje private AAPSK

FËMIJËT

I. MASA NË LIDHJE ME NDJEKJEN PENALE

1. SYNIMI STRATEGJIK

Rritja e numrit të ndjekjeve penale të suksesshme, si dhe masave të duhura të dënimit për të gjitha format e trafikimit të fëmijëve, dhe mundësi të procedimeve penale të duhura e të ndjeshme ndaj fëmijëve, të cilat garantojnë të drejtat dhe interesin e fëmijës.

Treguesit: Numri i arrestimeve, ndjekjeve penale dhe dënimeve për trafikim fëmijësh. Numri i çështjeve penale të trafikimit të fëmijëve (arrestime, ndjekje penale, dënime) sipas llojit të trafikimit; përqindja e arrestimeve që përfundojnë në dënime; përqindja e viktimave fëmijë të cilët paraqiten si dëshmitarë; numri i viktimave fëmijë që denoncojnë trajtim diskriminues.

Synimi: Rritja e numrit të çështjeve penale me 30%.

1. (a) Objektiv specifik: Sigurimi i përpunimit të bazës ligjore e rregullatore kombëtare mbi trafikimin e personave në të gjitha format, me standardet dhe praktikën evropiane dhe ndërkombëtare (të Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Kombeve të Bashkuara) duke ndryshuar legjislacionin sipas nevojës, si dhe përmirësimi i zbatimit të legjislacionit aktual.

Treguesit: Numri dhe përqindja e hetuesve, prokurorëve dhe gjyqtarëve të cilët janë të familjarizuar me të gjitha format e trafikimit të fëmijëve, përfshirë trafikimin e brendshëm; numri i çështjeve të trafikimit të brendshëm; numri i ndjekjeve penale/dënimeve në lidhje me çështje të fëmijëve të trafikuar.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1. (a).1	Për një listë gjithëpërfshirëse me ndryshime ligjore të sugjeruara në lidhje me fëmijët, lutemi referojuni strategjisë – Ndjekja Penale 1. (b)	Ministria e Drejtësisë MPB	2015	Shih Strategjinë	

1. (b) Objektiv specifik: Zbatimi i standardeve dhe procedurave standarde të veprimit (PSV-ve) për trajtimin e ndjeshëm të viktimave fëmijë gjatë hetimeve dhe procedimeve penale, nëpërmjet specializimit dhe përmirësimit të aftësive të punonjësve përkatës, si dhe garantimi i të drejtave të fëmijës për kompensim dhe dëmshpërblim ligjor.

Treguesit: Numri dhe përqindja e hetuesve, prokurorëve dhe gjyqtarëve të cilët janë të familjarizuar me të gjitha format e trafikimit të fëmijëve, dhe trajtimin e duhur të fëmijëve viktimë të mundshme të trafikimit si dhe viktimë të trafikimit; numri dhe përqindja e fëmijëve viktimë të trafikimit që paraqiten si dëshmitarë, numri i kompensimeve të dhëna për fëmijët viktimë të trafikimit, numri i incidenteve të sigurisë të raportuara në lidhje me fëmijët e trafikuar.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(b).1	Trajnim i specializuar, sistematik dhe përsëritës, për punonjësit e zbatimit të ligjit dhe të sistemit të drejtësisë në lidhje me trafikimin e fëmijëve dhe trajtimin e posaçëm të tyre.	MD, MPB, Qendra e Formimit Policor, ZKKA, Shkolla e Magjistraturës	Në vazhdimësi	Skemë trajnimi përsëritës për trafikimin e fëmijëve dhe standardet për trajtimin specifik të fëmijëve. Plane vjetore trajnimi. Numri dhe përqindja e punonjësve përkatës të trajnuar.	MPB, MD, Qendra e Formimit Policor, Shkolla e Magjistraturës, Donatorët
1.(b).2	Zbatimi i udhëzimeve për intervistimin dhe mbledhjen e provave nga fëmijët viktimë të trafikimit, për të garantuar standardet e OKB-së / kombëtare, përfshirë edhe që ata duhet të pyeten në prani të kujdestarit ligjor; Garantim i asistencës së punonjësit social dhe/ose psikologut të specializuar, i intervistimit në një mënyrë të përshtatshme me moshën dhe gjendjen e fëmijës; Komunikimi duhet bërë duke patur parasysh interesin më të lartë të fëmijës; duhet respektuar dinjiteti i fëmijës; ai/ajo duhet të informohet mbi të drejtat që ka në atë proces; të dhënat dhe dëshmia duhen marrë duke shmangur lëndimin e fëmijës; Shmangje e përballjeve të drejtpërdrejta në gjykatë apo e përsëritjes së dëshmisë, nëpërmjet video-regjistrimit të dëshmimeve.	Ministria e Drejtësisë, Prokuroria e Përgjithshme, Drejtoria e Përgjithshme e Policisë, Gjykatat, Grupi i MKR, si dhe OJF e ON	Në vazhdimësi	Ekzistenca e udhëzimeve (standarde dhe procedura) mbi intervistimin dhe marrjen e provave nga fëmijët viktimë, në përputhje me Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve si dhe me legjislacionin kombëtar mbi të drejtat e fëmijëve. Numri dhe përqindja e punonjësve përkatës të cilët janë të njohur me këto udhëzime. Përmbajtja e protokolleve të çështjeve Numri dhe përqindja e VT fëmijë që trajtohen në përputhje me këto udhëzime	MD, PP, PSH, Gjykata, Anëtarët e MKR, Donatorët
1.(b).3	Hartimi i një liste me psikologë të licencuar për fëmijët, që të ofrojnë mbështetje gjatë procedimeve penale.	MMSR, PSH,	2016	Një listë me psikologë të licencuar fëmijësh për në gjykata	MMSR, PSH
1.(b).4	Caktimi i punonjësve socialë dhe psikologëve të specializuar, në të gjitha çështjet penale ku ka të përfshirë fëmijë	MMSR,	Fundi i 2016	Përmbajtja e protokolleve të çështjeve.	PP, MMSR, donatorët
1.(b).5	Te sigurohet dhe mirëmbahet një ambient i përshtatshëm për fëmijët në PKK, ku të intervistohen fëmijët viktimë të mundshme apo viktimë të trafikimit; si edhe qendra sociale/streha të specializuara, të hapura 24/7, ku të shoqërohen, trajtohen dhe mbështeten fëmijët nën moshën 18 vjeç (si dhe për intervistime/pyetje nga policia).	MPB/Departamenti për Kufirin dhe Migracionin; Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Mesi i 2016	Ekzistenca e ambienteve të përshtatshme për fëmijët në PKK; Ekzistenca e qendrave sociale/strehave të specializuara për fëmijët viktimë të mundshme apo viktimë të trafikimit (rimodelimi i shërbimeve të QKPVT në Linzë), dhe e një fondi të posaçëm për nevojat e menjëhershme për asistencë të fëmijëve/të rriturve viktimë apo viktimë të mundshme të trafikimit.	MPB/PSH, MMSR, donatorët



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(b).6	Bashkëpunim i ngushtë mes strukturave të ndryshme brenda policisë, për të luftuar trafikimin e personave dmth Seksioneve për Mbrojtjen e të Miturve dhe dhunën në familje, dhe atyre për trafiket e paligjshme, Sektorit për Krimin Kompjuterik, hetimin e aseteve, dhe të gjithë sektorët e hetimit të krimeve, etj. Rritja e kapaciteteve të tyre, nëpërmjet trajnimeve të përbashkëta, për identifikimin dhe referimin e fëmijëve viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit (shih edhe strategjinë kryesore).	PSH/ Drejtoria Për Narkotikëve dhe Trafikimit/ Sektori për Trafiket e Paligjshme, OJF, ON dhe partnerët ndërkombëtarë	Në vazhdimësi	Numri i mbledhjeve të rregullta Numri i trajnimeve të përbashkëta për identifikimin e viktimave të mundshme dhe viktimave të trafikimit.	PSH, ZKKA, donatorët
1.(b).7	Zbatimi i plotë i Ligjit “Për ndihmën ligjore falas” për fëmijët VT, ofrimi i përfaqësimit/mbështetjes ligjore gjatë procedimeve penale, si dhe sigurimi i mbështetjes ligjore për marrjen e kompensimit (mbështetje për padi civile); sigurimi i mjeteve të nevojshme buxhetore (për masa të mëtejshme për tu siguruar kompensim të gjithë personave të trafikuar, lutemi referojuni strategjisë kryesore)	Ministria e Drejtësisë, OJF/ON dhe partnerët ndërkombëtarë	2016	Synimi: Të gjithë fëmijët viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit marrin ndihmën ligjore falas të përshtatshme për fëmijët Buxheti i shtetit ka të parashikuar mjetet buxhetore. Ekzistenca e një liste me avokatë të caktuar për fëmijët viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit Numri dhe përqindja e rasteve që kanë marrë përfaqësim dhe këshillim. Numri i vendimeve të gjykatave civile për kompensim të viktimës (fëmijë) të trafikimit Numri i fëmijëve viktimë të trafikimit të cilët kanë marrë kompensim.	MD, Donatorët
1.(b).8	Sigurimi i mbrojtjes fizike dhe i mbrojtjes së të gjithë fëmijëve viktimë të trafikimit (shih strategjinë kryesore).	Shih strategjinë kryesore	Në vazhdimësi	Shih strategjinë kryesore Numri i fëmijëve viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit, për të cilët janë marrë masa mbrojtjeje	MPB/PSH, MMSR, SHSSH, Donatorët

II. MASA NË LIDHJE ME MBROJTJEN

1. Synimi strategjik:

Identifikimi, referimi dhe dhënia e mbrojtjes dhe asistencës për riintegrim fëmijëve në rrezik dhe fëmijëve viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit, në përputhje me PSV-të për trajtimin e fëmijëve.

Treguesit: Numri i përgjithshëm i identifikimeve, si dhe identifikimeve të fëmijëve të trafikuar brenda vendit për qëllime shfrytëzimi, koha mesatare e shfrytëzimit përpara identifikimit, përmbajtja e protokolleve të çështjeve (zbatimi i PSV-ve).

Synimi: Rritje me 20% në vit e numrit të fëmijëve të trafikuar që janë identifikuar e ndihmuar; përmirësim i zbatimit të PSV-ve specifike për fëmijët.

1. (a) Objektiv specifik: Përmirësimi i zbatimit të PSV-ve për trajtimin e fëmijëve viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit, si dhe monitorimi nga afër i zbatimit të tyre.



Treguesit/Synimi: Përmbajtja e protokolleve të çështjeve; ekzistenca e monitorimit të rregullt/raporteve të progresit për çështjet; të gjitha rastet e trafikimit të fëmijëve janë trajtuar në përputhje me PSV-të; numri dhe përqindja e protokolleve të çështjeve që kanë vlerësim rreziku, plan sigurie, plan asistence për riintegrim pas kthimit, menaxher përgjegjës për çështjen, si dhe raporte të rregullta nga menaxheri i çështjes mbi asistencën e marrë si dhe procesin e riintegrit.

[illegible]



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	bashkërenduese, të gjithë aktorët që mund të jenë në kontakt me fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit				
1. (a).4	Zbatimi i një mekanizmi monitorimi të respektimit të PSV-ve specifike për fëmijët (si pjesë e monitorimit të PSV-ve)	Shih tek strategjia kryesore	Mesi i 2015	Numri i misionëve monitoruese dhe i auditimit të çështjeve Synimi: të paktën dy raporte monitorimi në vit	ZKKA, donatorët
1. (a).5	Kryerja e një shqyrtimi të sistemit, bazuar në gjetjet/rekomandimet e monitorimit, dhe rishikimi i çështjes dhe mekanizmit të zbatimit të PSV-ve sipas nevojës.	Shih tek strategjia kryesore	Fundi i 2015	Kryerja e shqyrtimit Ekzistenca e mekanizmit të rishikuar të zbatimit	ZKKA, MKR, AP, Donatorët

1. (b) Objektiv specifik: Identifikimi i fëmijëve viktimë të mundshme dhe viktimë të trafikimit dhe referimi i tyre tek shërbimet e duhura si dhe për mbrojtje.

Treguesit: Numri i fëmijëve viktimë të mundshme apo viktimë të trafikimit të cilat janë identifikuar dhe referuar në përputhje me PSV-të, brenda vendit (duke identifikuar burimin), në pikat e kalimit kufitar apo jashtë vendit.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.(b).1	Identifikimi dhe referimi brenda vendit.	MPB/PSH, MMSR, NjMF, KKSAT,	Në vazhdimësi	Numri i fëmijëve viktimë apo viktimë të mundshme të trafikimit të identifikuar brenda vendit (sipas aktorëve identifikues).	PSH, SHSSH, NjMF, OJF
1.(b).1.1	Rritja e numrit të njësisë në terren të policisë së shtetit dhe punonjësve socialë shtetërorë, për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit, dhe trajnimi i tyre për identifikimin e referimin e rasteve të trafikimit të fëmijëve si dhe mbi PSV-ve.	ZKKA, PSH, AP, OJF, ON dhe partnerët ndërkombëtarë.	2015- 2016	Numri i njësisë në terren të trajnuara Numri/përqindja e punonjësve në terren të cilët kanë njohuri mbi trafikimin e fëmijëve dhe mbi PSV-të	ZKKA, AP, OJF, ON, Donatorët
1.(b).1.2	Forcimi i “grupeve për mbrojtjen e fëmijëve” (NjMF, NjRF, shërbimet psiko-sociale në shkollë, pikat e kontaktit në bashki, punonjës shëndetësorë, etj) dhe lidhja e tyre me grupet vendore bashkërenduese për trafikimit; trajnimi i tyre mbi trafikimin e fëmijëve dhe PSV-të specifike për fëmijët (shih edhe tek strategjia kryesore)	KRAT, Këshillat bashkiakë, MMSR, ZKKA	2015	Numri i mekanizmave/grupeve bashkërenduese në bashki për TËP (të rritur e të mitur) Numri i trajnimeve ndër-institucionale në nivel vendor Numri/përqindja e punonjësve vendorë përkatës, të cilët janë të familjarizuar me PSV-të specifike për fëmijët.	ZKKA, KRAT, NRM, OJF, Donatorët
1.(b).1.3	Identifikimi i pikave të kontaktit për fëmijët viktimë të mundshme të trafikimit dhe për trafikimin e fëmijëve (punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, identikë apo që punojnë ngushtësisht me pikat e kontaktit për trafikimin e të rriturve) në secilën bashki/komunë, për veprim	Këshillat e qarqeve/bashkive, MMSR, KRAT, ZKKA	2015	Numri i pikave të kontaktit Numri i trajnimeve për PSV-të Synimi: Deri në mesin e vitit 2015 ekzistojnë mekanizma bashkërendimi (grupe/pika kontakti) për trafikimin e fëmijëve dhe të rriturve, në	Këshillat bashkiakë, MMSR, KRAT, ZKKA



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	bashkërendues, menaxhim çështjesh, dokumentim dhe monitorim të çështjeve me trafikim fëmijësh në bashkëpunim me drejtorinë rajonale të Shërbimit Social Shtetëror, si dhe trajnimi i tyre.			secilën bashki/komunë	
1.(b).1.4	Mbajtja e takimeve të rregullta me të gjithë pikat e kontaktit bashkërenduese vendore, në nivel rajonal (KRAT) për të diskutuar mbi të gjitha çështjet që kanë lidhje me trafikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve, nxitjen e bashkëpunimit, identifikimin dhe zgjidhjen e çështjeve, shkëmbimin e përvojave si dhe vlerësimet/planifikimin rajonal.	KRAT, aktorët në bashki	Në vazhdimësi	Numri i takimeve të organizuara në nivel rajonal Synimi: takime rajonale dy herë në vit	KRAT, Aktorët e përfshirë
1.(b).1.5	Përgatitja dhe shpërndarja e informacionit mbi trafikimin e fëmijëve, të përshtatur për punonjës, prindër, komunitetin dhe fëmijët.	KRAT, ZKKA; SHSSH; OJF/ON, partnerët ndërkombëtarë	Çdo vit	Ekzistenca e materialeve informuese për grupet e synuara	ZKKA, SHSSH, KRAT, Donatorët
1.(b).2	Përmirësimi i identifikimit dhe ndihmës së menjëhershme për fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit në kufi, si dhe referimi i shoqërimi i tyre për tek strukturat për riintegrim.	PSH/PKM/strukturat antitrafik, SHSSH	Në vazhdimësi	Numri i fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit (përfshirë ata migrantë) të cilët janë identifikuar në PKK Numri i çështjeve të trajtuara në përputhje me PSV-të (protokollet e çështjeve).	PSH, SHSSH, Donatorët
1.(b).2.1	Përmirësimi i PSV-ve ekzistuese për Pikat e Kalimit Kufitar (PKK) për identifikimin, ndihmën e menjëhershme dhe referimin e fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit, si dhe fëmijëve të tjerë (të shoqëruar apo jo) të cilët konsiderohen “shumë të rrezikuar” për shkak të lëvizjes, dhe që kanë nevojë për mbrojtje; përfshirë procedurë të qarta për shoqërimin e fëmijëve në banesat/strehat e tyre.	MPB, ZKKA, PSH/ Policia Kufitare dhe e Migracionit, AP	Fundi i 2015	Ekzistenca e PSV-ve specifike për PKK-të, mbi trajtimin e fëmijëve në rrezik dhe atyre të trafikuar.	ZKKA, PSH, AP
1.(b).2.2	Trajnim i specializuar i punonjësve të kufirit dhe migracionit mbi trajtimin e fëmijëve në nevojë për mbrojtje, si dhe mbi PSV-të për fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit.	MPB/Policia Kufitare dhe e Migracionit, Qendra e Formimit Policor, ZKKA, AP, OJF e ON	Në vazhdimësi	Ekzistenca e një moduli trajnimi specifik për fëmijët Numri dhe përqindja e punonjësve të PKM të trajnuar dhe të familjarizuar me PSV-të specifike për fëmijët Shpërndarja e udhëzimeve.	ZKKA, RA, Donatorët
1.(b).2.3	Regjistrimi i çdo fëmije që kalon kufirin, hyn (apo kthehet), ose largohet, pavarësisht nëse janë raportuar apo jo si viktimë të mundshme të trafikimit nga vendet fqinje, si dhe sigurimi i ndihmës së menjëhershme, mbrojtjes dhe referimit të tyre tek	MPB/Policia Kufitare dhe e Migracionit	Në vazhdimësi	Synimi: çdo fëmijë kontrollonhet dhe regjistrohet në sistemin TIMS si dhe trajtohet më tej sipas PSV-ve Përmbytja e protokolleve të çështjeve	PSH/DKM, AP



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	strukturat përgjegjëse për asistencën për riintegrim (shih edhe tek strategjia kryesore)				
1.(b).2.4	Krijimi i një sistemi ankesash të përshtatshëm për fëmijët, ku të raportohen incidentet apo shqetësime të tjera që kanë fëmijët viktimë apo viktimë të mundshme në PKK	MPB/Policia Kufitare dhe e Migracionit	2015	Ekzistenca e një sistemi ankesash të përshtatshëm për fëmijët Numri i ankesave	PSH/DKM , Donatorët
1.(b).2.5	Krijimi dhe zbatim i në mënyrë të rreptë i një sistemi monitorimi mbi zbatimin e PSV-ve për fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit, nëpërmjet një ekipi inspektimi të posaçëm nga AP/MKR;	MPB, ZKKA, AP, MKR, Task Force e MKR	2015	Ekzistenca e një sistemi monitorimi nga afër, si dhe misionet dhe raporte të rregullta monitorimi Synimi: Çdo PKK inspektohet në mënyrë të përvitshme	MPB, ZKKA, RA, MKR, MKR Task Force, Donatorët
1.(b).3	Përmirësimi i identifikimit dhe referimit të fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit jashtë vendit.	MPJ/Stafi diplomatik PSH/Oficerët ndërlidhës	Në vazhdimësi	Numri dhe përqindja e fëmijëve të identifikuar, referuar, asistuar në përputhje me PSV-të ndërkombëtare të rëna dakord	MPJ, MPB/PSH, Donatorët
1.(b).3.1	Përfshirja e detyrave specifike për fëmijët në termat e referencës së AP, sidomos për MPJ (stafi konsullor jashtë vendit)	MPJ, AP, ZKKA	2016	Detyra specifike për fëmijët të përfshira në përshkrimet e punës të firmëtarëve të AP, sidomos tek MPJ	
1.(b).3.2	Sigurimi që edhe trajnimi i stafit diplomatik mbi TiP dhe PSV-të të përmbajë një modul specifik mbi fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit, përfshirë ndjekjen e situatës së fëmijëve shqiptarë jashtë vendit, duke lehtësuar marrëdhëniet e tyre me familjet në Shqipëri, etj.	MPJ, Akademia Diplomatike, ZKKA, AP sipas strategjisë kryesore	2015	Trajnimi për stafin diplomatik përmban një modul për trafikimin e fëmijëve Numri i punonjësve diplomatikë të trajnuar dhe të familjarizuar me detyrat e tyre në lidhje me fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit jashtë Shqipërisë	MPJ, Akademia Diplomatike, ZKKA, AP, Donatorët
1.(b).3.3	Firmosja dhe/ose vënia në zbatim e marrëveshjeve të bashkëpunimit me vende kyçe fqinje/destinacioni në lidhje me fëmijët viktimë e viktimë të mundshme të trafikimit (përfshirë edhe fëmijët në lëvizje konstante, si dhe fëmijët migrantë të pashoqëruar, me dokumente të parregullta), të cilat përmbajnë: - Kaktim të personave të kontaktit/AP për çdo palë, përfshirë PKM, policinë antitrafik dhe punonjësit socialë - Hartimin e standardeve, PSV-ve dhe udhëzimeve (me formate, kuadre, pika kontakti dhe autoritete përgjegjëse të rëna dakord) për shkëmbim në kohë të informacionit në lidhje me çështjet si dhe referimin e çështjeve ndërmjet vendeve	MPB, MPJ, ZKKA, OJF, ON dhe partnerët ndërkombëtarë	2015	Ekzistenca e marrëveshjeve (të veçanta apo të integruara) me Greqinë, Maqedoninë, Kosovën, Malin e Zi, Francën, Mbretërinë e Bashkuar dhe Italinë për bashkëpunimin në lidhje me fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit Ekzistenca e një liste kontakti për AP, punonjësit e policisë dhe ata socialë Numri i takimeve të mbajtura Ekzistenca e mekanizmave trans-nacionalë të referimit si dhe PSV-ve dhe udhëzimeve për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit (përfshirë fëmijët	MPB, MPJ, ZKKA, partnerët ndërkombëtarë, Donatorët



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	firmëtare, jo vetëm për fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit, por edhe çështjet e fëmijëve migrantë të pashoqëruar apo me dokumente të parregullta -Organizimi i trajnimeve të përbashkëta ndërkufitare e ndërkombëtare, shkëmbim i rregullt informacioni për punonjësit e policive kufitare dhe stafin e shërbimeve sociale të palëve firmëtare.			migrantë) Numri i trajnimeve ndërkufitare apo ndërkombëtare Numri i çështjeve të identifikuar, referuara dhe asistuar me fëmijë në rrezik, fëmijë viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit, si dhe fëmijëve që janë në rrezik për arsye të tjera, sipas vendeve	
1.(b).3.4	Transportimi i fëmijëve për në shtëpitë e tyre apo në struktura që ofrojnë mbrojtje dhe mbështetje për to; të shoqëruar nga një punonjës social/punonjës i një strehe të specializuar dhe nga një punonjës policie, nëse ka një rrezik të mundshëm për fëmijën viktimë të trafikimit.	PSH, Drejtoria Rajonale e RSHSSH, punonjës të OJF/strehave, ON	Në vazhdimësi	Ekzistenca e PSV-ve për shoqërimin e fëmijëve. Numri dhe përqindja e fëmijëve të transportuar sipas këtyre PSV-ve	PSH, SHSSH rajonal, OJF/stafi i strehëzave, ON

1. (c) Objektiv specifik: Nxitja e riintegrit dhe përfshirjes sociale të fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit, si dhe ulja e rrezikut të ri-viktimizimit dhe ri-trafikimit, nëpërmjet sigurimit të mbështetjes së specializuar për riintegrim, të fokusuar tek familja dhe të mbështetur tek komuniteti, në përputhje me standardet e rena dakord dhe me PSV-të.

Treguesit: Përqindja e fëmijëve të trafikuar të cilët jetojnë me familjen apo në ambiente të tjera të mbrojtura dhe ndjekin shkollën rregullisht një vit pas kthimit/rivendosjes në komunitet; numri dhe përqindja e fëmijëve të trafikuar të cilët janë trafikuar më shumë se një herë.

Numri dhe përqindja e fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit të asistuar në përputhje me PSV-të; numri dhe përqindja e protokolleve të çështjeve që kanë vlerësim rrisht, plan sigurie, plan asistence për riintegrim pas kthimit, menaxher çështjeje të përgjegjshëm si dhe raporte të rregullta të menaxherit të çështjes mbi asistencën e marrë dhe procesin e riintegrit.

Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1. (c).1	Sigurimi i një mekanizmi funksional për dhënien e ndihmës për riintegrim fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit si dhe për monitorimin e procesit të riintegrit të tyre (shih 1. (a).2 më lart)	Si tek 1. (a).2 më lart	Në vazhdimësi	Si tek 1. (a).2 më lart	
1.(c).2	Ofrimi i shërbimeve bazë të komunitetit për mbrojtjen dhe riintegrimin e fëmijëve viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit si dhe fëmijëve të kthyer dhe atyre në lëvizje të vazhdueshme, për të përfshirë asistencën ligjore, regjistrimin në gjendjen civile, akomodimin, strehimin, ndihmën ekonomike,	MMSR, aktorët rajonalë dhe vendorë, NJMF, NJRF	Fundi i 2015	Ekzistenca e të drejtave të privileguara për të patur shërbime bazë komunitare për fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit si dhe familjet e tyre	MMSR, aktorët rajonal dhe lokal, NJMF,



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
	shërbimet shëndetësore dhe regjistrimin në shkollë, si edhe ndihmë për punësimin e prindërve, për shpërndarje nga punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve/aktorët vendorë.				
1.(c).3	Krijimi i një pakete bazë ndihme për fëmijët e kthyer, fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit dhe familjet e tyre, për të trajtuar nevojat urgjente gjatë fazës së parë të riintegrit.	MMSR aktorët rajonalë dhe vendorë, NjMF, OJF, ON,	Fundi i 2014	Ekzistenca e paketave të asistencës së menjëhershme të VMT dhe VT-ve, të financuara plotësisht Numri i përfituesve	MMSR, aktorët rajonal dhe lokal, NjMF, OJF, ON
1.(c).4	Krijimi i programeve për ndihmë afatgjatë për riintegrimin e fëmijëve të kthyer, fëmijëve në lëvizje të vazhdueshme dhe familjeve të tyre në nivel vendor; vënia në fokus e fëmijëve dhe familjeve të tyre	MMSR, aktorët rajonalë dhe vendorë, NjMF, OJF, ON,	2015	Ekzistenca e programeve afatgjatë mbështetjeje për viktimat dhe viktimat e mundshme të trafikimit Numri i përfituesve	MMSR, aktorët rajonal dhe lokal, NjMF, OJF, ON
1.(c).5	Krijimi i modeleve për mbrojtje dhe mbështetje të specializuar, për të mbështetur një proces ndërhyrjeje me shumë faza, duke filluar nga ndërhyrjet parandaluese dhe fuqizuese në sistemin aktual të fëmijëve, afër sistemit, dhe deri tek faza e fundit kur jepet përkujdesje rezidenciale; përfshirë: -Qendrat ditore për fëmijë/familje; -Streha për familje; -Jetesë gjysmë e pavarur; -Streha emergjence dhe përkujdesje rezidenciale afatgjatë.	MMSR, Këshillat e Qarqeve, ZKKA, MKR, OJF, ON dhe partnerët ndërkombëtarë	2015 -2017	Ekzistenca e modeleve të mbrojtjes dhe ndihmës, përfshirë ambiente dhe shërbime në mbështetje të procesit të ndërhyrjes me shumë faza Mundësi përdorimi të qendrave ditore për fëmijë/familje Mundësi përdorimi të strehave familjare dhe jetesës gjysmë të pavarur Ekzistenca e një strehe të specializuar për fëmijët (strehim emergjence dhe përkujdesje rezidenciale afatgjatë)	MMSR, SHSSH, Këshillat Rajonale, ZKKA, MKR, OJF, ON, dhe partneret ndërkombëtarë
1.(c).6	Sigurimi i strehimit emergjent /shërbimeve për fëmijët viktimë dhe viktimë të mundshme të trafikimit; Dhe krijimi i një mekanizmi për “përgjegjësinë administrative”, për tu dhënë mundësinë punonjësve socialë të bëjnë ndërhyrje të menjëhershme	MMSR, Këshillat e Qarqeve, ZKKA, MKR, OJF, ON dhe partnerët e tjerë	2016	Ekzistenca e strehimit dhe shërbimeve të emergjencës Numri i rasteve emergjente	MMSR, ZKKA, SHSHS, OJF, ON, dhe partnere të tjerë

III. MASA NË LIDHJE ME PARANDALIMIN

1. Synimi strategjik: Garantimi i një mjedisi mbrojtës dhe mbështetës për fëmijët dhe familjet e tyre, dhe sigurimi i ndihmës parandaluese, mbrojtëse dhe rehabilituese për personin e synuar.

Treguesit: Numri i fëmijëve në rrezik të identifikuar nga NjMF-të, shërbimet psiko-sociale në shkolla, personeli shëndetësor/mjekët e familjes, organizatat në komunitet, etj; numri i fëmijëve të ndihmuar si dhe lloji i ndihmës së dhënë.



Nr.	Veprimtari dhe nën-veprimtari	Strukturat përgjegjëse (Struktura kryesore në fillim)	Afati	Treguesit/Synimet	Burimet
1.1	Mbështetja e grupeve ndër-institucionale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut (“trjetat e sigurisë”) në nivel bashkie dhe integrimi apo lidhja e tyre me mekanizmat vendorë të bashkërendimit për parandalimin, identifikimin, referimin dhe ndihmën në rastin e trafikimit të personave -Sqarimi i roleve dhe përgjegjësi përkatesë të të gjithë aktorëve të përfshirë (shërbimet sociale në nivel qarku dhe vendor, NjMF dhe NjMF); -Forcimi i NjMF (krijim kapacitetesh për menaxhim çështje, punë në rrugë, standarde shërbimi, dhënie aksesit tek shërbimet/ndihma ekonomike për klientët fëmijë) dhe monitorimi i tyre; -Përmirësimi i shërbimeve psiko-sociale në shkollë -Mbështetja e organizatave në komunitet dhe përfshirja e tyre në mekanizmat mbrojtës; -Mbështetja e rolit parandalues të personelit shëndetësor/mjekëve të familjes. (Shih edhe tek strategjia kryesore)	MMSR, MAS, MSH, Këshillat e Qarqeve, bashkitë, OJF, ON	Në vazhdimësi	Mbulim kombëtar i NjMF-ve, dhe ndarje e qartë e detyrave mes aktorëve të përfshirë Kapacitetet e NjMF-ve janë të forcuara, si dhe janë përmirësuar aksesit në ndihmën ekonomike dhe shërbimet e tjera për fëmijët e identifikuar si viktima apo viktima të mundshme të trafikimit dhe familjet e tyre; kap Kapacitetet e “mbrojtësve të shkollave” janë forcuar Personeli shëndetësor/mjekët e familjes kanë marrë detyrë të parandalojnë/identifikojnë/referojnë fëmijët dhe të rriturit e trafikuar dhe janë të familjarizuar me PSV-të Grupet e mbrojtjes së fëmijëve janë pjesë përbërëse e grupeve bashkërenduese vendore për TtP	MMSR, MAS, MSH, Këshillat rajonal/ bashkitë, OJF, ON
1.2	Garantimi i shërbimeve parandaluese dhe mbrojtëse në nivel vendor për të gjithë fëmijët viktima dhe viktima të mundshme të trafikimit, si dhe fëmijët në nevojë për mbështetje dhe mbrojtje	MMSR, pushteti rajonal/vendor, OJF, ON	Në vazhdimësi	Mundësi përdorimi të shërbimeve në nivel vendor Numri i fëmijëve dhe familjeve të tyre të ndihmuar, sipas bashkive, sipas llojit të ndihmës	MMSR, ZKKA, MKR, pushteti rajonal/lokal
1.3	Harmonizimi i veprimeve me Planin e Veprimit për Fëmijët në Situatë Ruge (përfshirë programet parësore e dytësore për ndërhyrje në rastet e fëmijëve të rrugës)	MMSR, ZKKA, AP, OJF, ON dhe partnerët	2014-2016	Sipas Planit të Veprimit për Fëmijët në Situatë Ruge	Të gjithë aktorët e përfshirë

2. Lutemi shihni parandalimin edhe tek strategjia kryesore për veprimtari të tjera parandaluese me fokus fëmijët:

Rritja e ndërgjegjësisimit për fëmijët dhe të rinjtë, si dhe për aktorët që bien në kontakt me fëmijët në rrezik TtP, ose të ndikuar nga TtP.

Zbatimi i Kodit të Sjelljes të bizneseve të turizmit etj, përfshirë përmbushjen e standardeve të punës, si dhe monitorimi i rreptë dhe eliminimi i punës së fëmijëve.

Marrja e masave për nxitjen e përfshirjes sociale nëpërmjet përmirësimit të arsimit, përfitimit të aftësive të jetës, zhvillimit të komunitetit.



Anekset, pjesë e udhëzimit nr. 23, datë 9.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", botuar në Fletoren Zyrtare nr. 186, datë 10.12.2014

Deklarata e të punësuarve për here të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna. Nr. _____, datë _____

1) NIPT: _____

2) Emri i Tatimpaguesit: _____

3) Periudha Tatimore Viti _____; Muaji _____

4) Adresa Kryesore: _____

5) Veprimtaria Kryesore: _____

6) Veprimtaria e degës/njesisë: _____

Personat që do fillojnë punë për herë të parë tek subjekti apo që do të fillojnë punë rishtazi								Personat e larguar nga puna							
NR	7) Numri Personal	8) Emri e Mbiemri	9) Shënimet veçim për detyrat e huaj	10) Detyra, Funkzioni, Profesia apo Puna që do të kryejë	11) Numri i Kategorisë të punonjësit për kontribute	12) Data e fillimit të punës	13) Shënime shtesë rreth punonjësit përkatës	NR	14) Numri Personal	15) Emri e Mbiemri	16) Shënimet veçim për detyrat e huaj	17) Detyra, Funkzioni, Profesia apo Puna që ka kryer	18) Numri i Kategorisë të punonjësit për kontribute	19) Data e largimit nga puna	20) Shënime shtesë rreth punonjësit përkatës

Lidhur me sa më sipër DEKLAROJ që:

21) Duke filluar nga data:

21.a) "Numri total i punonjësve që punojnë dhe kanë punuar gjatë muajit në këtë subjekt përfshirë edhe të dhënat e këtij deklarimi" është persona

21.b) "Numri i punonjësve që mbeten të punojnë efektivisht në këtë subjekt përfshirë edhe të dhënat e këtij deklarimi" është persona

22) Deklaruesi (Administratori ose Personi i autorizuar për deklarimin) / Personi Fizik (I autorizuari)
(emër mbiemër dhe nënshkrimi elektronik)



SHËNIME

PËR PLOTËSIMIN E RUBRIKAVE TË DEKLARATËS “DEKLARATA E TË PUNËSUARVE PËR HERË TË PARË, ATYRE RISHTAZI, SI DHE E TË LARGUARVE NGA PUNA”

Të dhënat e kësaj deklarate, plotësohen nga të gjithë personat juridikë dhe fizikë, sa herë që rasti është i tillë, pra ka të punësuar që fillojnë punë për herë të parë, të punësuar rishtazi apo të larguar nga puna. Me këtë deklaratë, njëloj deklarohej të gjitha kategoritë e punonjësve përfshirë edhe nxënësit dhe studentët për kohën e praktikës mësimore, të punësuarit në formim profesional në kuptimin e VKM. nr.1114, datë 30.07.2008, i ndryshuar, të punësuarit e përfshirë në programet e nxitjes së punësimit, personat e përfshirë në programet e praktikave profesionale, etj.

Deklarimi për herë të parë pas regjistrimit nga personi juridik apo fizik i të dhënave për punonjësit e deklaratës “Listëpagesa e Kontributeve të Sigurimeve Shoqërore, Shëndetësore dhe Tatimit mbi të Ardhurat nga Punësimi”, përfshirë sipas përkatësisë, administratorin, vetë personin fizik apo punonjësin e papaguar të familjes, me të cilin ai punon e bashkëjeton ligjërisht, si dhe ndryshimet (shtesa ose paksime) në numrin e personave të një listëpagese ekzistuese, bëhen vetëm me anë të deklarimit elektronik të të dhënave të rubrikave të deklaratës “Deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”.

Të dhënat e kësaj deklarate plotësohen nga tatimpaguesi qoftë dhe për një të punësuar rishtazi apo të larguar të vetëm pavarësisht nga numëri i ditëve kalendarike. Të dhënat deklarohej sa herë që te tatimpaguesi ndodhin ndryshime të numrit të punonjësve.

Për punonjësit që fillojnë punë për herë të parë apo të punësuar rishtazi të dhënat e kësaj deklarate në formë elektronike deklarohej të paktën një ditë kalendarike përpara fillimit të punës nga ana e tyre. Punonjës që fillojnë punë për herë të parë apo rishtaz konsiderohen ata që fillojnë apo rifillojnë një marrëdhënie të re punësimi me tatimpaguesin mbi bazën e një kontrate të re pune, ndërsa punonjës që largohen nga puna konsiderohen ata që shkëpusin përfundimisht marrëdhëniet e punës me tatimpaguesin përkatës.

Të larguarit nga puna, personi juridik dhe fizik duhet t’i deklarojnë në formë elektronike me të dhënat e kësaj deklarate brenda 10 ditëve kalendarike nga data e largimit.

Për plotësimin e rubrikave të formularit “deklarata e të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë mbajnë parasysht sa më poshtë:

Për çdo deklaratë që tatimpaguesi dorëzon, në krye të saj, vendoset numri rendor i deklaratës në mënyrë automatike dhe data në të cilën kryhet deklarimi. Duhet të ruhet pa shkoputje numri rendor rritës nga deklarata paraardhëse në atë pasardhëse. Për efekte vlerësimi nga organet tatimore, datë e deklarimit nga subjekti e të dhënave të “Deklaratës së të punësuarve për herë të parë, atyre rishtazi, si dhe e të larguarve nga puna”, merret data e regjistruar në sistemin informatik të organit tatimor.

1. Në rubrikën 1) *NIPT*- Shënohet NIPT-i kryesor i Tatimpaguesit.
2. Në rubrikën 2) *Emri i Tatimpaguesit* – Shënohet emri i tatimpaguesit sipas NIPT-it kryesor të tij.
3. Në rubrikën 3) *Periudha tatimore* – Shënohet viti dhe muaji për të cilin bëhet ky deklarim.
4. Në rubrikën 4) *Adresa Kryesore* – Shënohet adresa kryesore e tatimpaguesit
5. Në rubrikën 5) *Veprimtaria Kryesore* – Shënohet Veprimtaria kryesore e NIPT-it
6. Në rubrikën 6) *Veprimtaria e degës/njesisë* – Shënohet veprimtaria ekonomike e degës/njesisë së tatimpaguesit në rast se ka një degë, filial, apo njësi.
7. Në rubrikat 7 dhe/ose 14 *Numri Personal* – Për punonjësit shtetas shqiptarë shënohet Numri Personal i Identitetit sipas kuptimit të ligjit nr.8951, datë 10.10.2002 “Për numrin e identitetit të shtetasve”, të ndryshuar dhe Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave. Për të punësuarit apo të vetëpunësuarit shtetas të huaj që punojnë në Shqipëri, si numër personal për efekt të deklarimit të kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore shërben numri i lejes së qëndrimit ose i lejes provizore të qëndrimit.



8. Në rubrikat 8 dhe/ose 15 *Emri e Mbiemri* – Shënohet emri e mbiemri i çdo punonjësi, që fillon punë për herë të parë të subjekti apo të punësuarit rishtazi, si dhe e të larguarit nga puna, kundrejt Numrit Personal të Identitetit të tij sipas kuptimit të Vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave apo numrit përkatës për shtetasit e huaj.

9. Në rubrikën 9 dhe/ose 16 *“Shtetësia vetëm për shtetasit e huaj”* – Shënohet shtetësia e shtetasve të huaj mbi bazën e dokumentave zyrtare të paraqitura nga ana e tyre.

10. Në rubrikën 10 dhe/ose 17 *Detyra, Funksioni, Profesioni apo Puna që do të kryejë/ka kryer punonjësi* – Shënohet detyra apo profesioni që punonjësi do të kryejë/ka kryer në subjektin përkatës. Detyra apo profesioni zgjidhen nga lista kombëtare e profesioneve sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.627, datë 11.6.2009 “Për miratimin e Listës Kombëtare të Profesioneve”, i ndryshuar.

11. Në rubrikën 11 dhe/ose 18 *“Numri i Kategorisë të punonjësve për kontributet”* – Shënohet numri i kategorisë së punonjësit duke zgjedhur një nga kategoritë e punonjësve për efekt të deklarimit dhe llogaritjes së kontributeve të cilës i përket punonjësi përkatës, si vijon :

Kategoria 1. I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më shumë se 87 orë në muaj.

Kategoria 2. I punësuar me kohë të plotë ose të pjesshme që ka punuar më pak se 87 orë në muaj.

Kategoria 3. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka qënë me raport paaftësie të përkohëshme deri në 14 ditët e para me raport mjekësor dhe më tej vijon të punojë ose jo, por nuk vazhdon me raport mjekësor, si dhe nuk ka shkëputur mardhëniet e punës me subjektin përkatës. Kur shuma e orëve të punës për ditët e punuara sëbashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës) është më shumë se 87 orë në muaj.

Kategoria 4. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka qënë me raport paaftësie të përkohëshme deri në 14 ditët e para me raport mjekësor dhe më tej vijon të punojë ose jo, por nuk vazhdon me raport mjekësor, si dhe nuk ka shkëputur mardhëniet e punës me subjektin përkatës. Kur shuma e orëve të punës për ditët e punuara së bashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës) është më pak se 87 orë në muaj.

Kategoria 5. I punësuar, i cili për një pjesë të muajit ka punuar, më pas ka qënë me raport paaftësie të përkohëshme deri në 14 ditët e para me raport dhe më tej nga dita e 15 vazhdon me raport mjekësor deri në fund të muajit dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, pavarësisht nga shuma e orëve të punës për ditët e punuara sëbashku me orët e llogaritura për ditët e raportit deri 14 ditët e para (sipas përcaktimit në kontratën e punës për orët ditore të punës).

Kategoria 6. I punësuar për herë të parë apo rishtazi të subjekti përkatës pavarësisht nga data e fillimit dhe orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 7. I punësuar i larguar nga puna (shkëputur përfundimisht marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës) pavarësisht nga data e shkëputjes dhe orët e punuara gjatë muajit.

Kategoria 8. I punësuar në dy subjekte (i dypunësuar) kur shuma e pagave të të dy subjektet është më e vogël, nga paga maksimale për efekt të llogaritjes së kontributeve shoqërore.

